

Bashkia Shkodër  
Biblioteka “Marin Barleti”

# Gegnia

*e përkohshme kulturore-artistike*

8 - 2019  
*Vjeti IV i botimit,*  
*Shkodër*

**Gegnia**

E përkohshme kulturore-artistike

8 -2019

Vjeti IV i botimit,

Shkodër

**Redaksia:**

Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija,

**Redaktor gjuhësor:** Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër  
dhe bibliotekës “Marin Barleti”**

**ISSN: 2519-73-91**

**Adresa e redaksisë:** Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

**E-mail:** [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

[info@bibliotekashkoder.com](mailto:info@bibliotekashkoder.com)

**Shënim:** *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

## PËRMBAJTJA E LENDËS

<b>▪Editorial ▪</b>	
Problemet tona.....	7
<b>▪Mendimi i traditës▪</b>	
Muzafer <b>PIPA</b>	
<i>Vetëdije apor krim?</i> .....	11
<b>▪Gjuhësi▪</b>	
Luljeta <b>DUSHI</b>	
<i>Trajtat Arb dhe Alb në gjuhën shqipe</i> .....	16
Isa <b>ÇELEPIJA</b>	
<i>Gjuha standarde dhe gegërishtja</i> .....	25
<b>▪ Histori▪</b>	
Mark <b>PALNIKAJ</b>	
<i>Relacioni i Stefano Gasparit i vitit 1672</i> .....	31
Sereta <b>KOPERAJ</b>	
<i>Revoltat qytetare në Shkodrën e viteve '30 të shekullit XIX</i> .....	37
Otto von <b>GERNSTNER</b>	
<i>“Albanien”, përktheu Gjergj J. Kola</i> .....	45
<b>Gëzim JUKA</b>	
<i>Një kujtesë historike nga Shkodra e periudhës së princ Wiedit</i> .....	51
<b>Hysen S.DIZDARI</b>	
<i>Kontributi i Kurbinit në fitoren e pavarësisë</i> .....	56
<b>▪Studime letrare▪</b>	
Arben <b>PRENDI</b>	
<i>Poezia e D. Agollit ndërmjet dy kohëve</i> .....	61
Xhahid <b>Bushati</b>	
<i>Shqyrtime kritike për vjershat për fëmijë e më gjerë të poetit</i>	
<i>Ndre Mjedja</i> .....	87
<b>▪Letërsi▪</b>	
Ervis <b>GASPRI</b>	
<i>Cikël poetik</i> .....	96

Krijimet letrare të konkursit:	
“Njeriu dhe koha”, “Unë jam poet” .....	110
Klevisa <b>BARDELI</b> .....	111
Evina <b>KOMI</b> .....	113
Arbri <b>KOPLIKU</b> .....	114
Edona <b>ZEFI</b> .....	116
Vitjola <b>DODA</b> .....	118
▪Ese▪	
Ermira <b>ALIJA</b>	
<i>Xhevahiri</i> .....	120
Elsa Stefi <b>KOLA</b>	
<i>Impresione</i> .....	123
▪Muzikologji▪	
Edmond <b>BUHARAJA</b>	
<i>Gjergj Kastrioti-Skenderbeu në muzikën operistike</i> .....	130
▪Trashëgimi kulturore▪	
Gjush <b>SHELDIJA</b>	
<i>Shpijat tipike të Shkodrës</i> .....	
162	
Adnan <b>MUKA</b> , Burhan <b>DIZDARI</b>	
<i>Shkodra dhe lulet</i> .....	172
Izet <b>BEBEZIQI</b>	
<i>Gjendja artistike dhe sociale e Vlorës</i> .....	176
▪Tradita arsimore▪	
Njazi <b>KAZAZI</b>	
<i>Një historik i shkurtër i shkollës Normale të Motrave Stigmatine</i> .....	182
▪Recensione▪	
Selman <b>SHEME</b>	
<i>Vepër me vlera teoriko-shkencore dhe aplikative</i> .....	191
Zef <b>ÇOBA</b> “	
<i>Opera” dhe “Kendemi” në librat e studiuesit Ferit Bala</i> .....	198
Gëzim <b>PUKA</b>	
<i>Një reflektim kritik rreth dramës “Jugori”</i>	
<i>të regjisorit Dino Mustafiç</i> .....	201

**▪Bibliofili▪**Zenepe **DIBRA***Kontributi i disa autorëve shkodranë në përkthimet në  
gjuhën shqipe.....* 203**▪In memoriam▪***Hasan Lekaj, pedagog, bibliofil dhe botues i shquar i  
letërsisë shqiptare.....* 210



## Editorial

### PROBLEMET TONA

Çdo shoqni ka problemet e veta. Shoqnia shqiptare edhe ma shumë. Përveç atyne që kena shtojmë përditë edhe të tjera. Po le t'i ritheksojmë edhe një herë sepse kjo ndoshta na ndihmon me u kthjellue.

Mbi të gjitha ajo që na dhemb ma shumë këto kohë, asht rreziku i zhbamjes së Shqipnisë sonë të dashtun si një ditë përditë. E kjo ka ndodhë në disa forma:

#### **Zhbamja e Shqipnisë përmes emigracionit**

Qysh prej rrëzimit të regjimit komunist shqiptarët tonë nuk kanë ba punë tjetër veçse tue ikë prej vendit të vet si prej kolere, dikush me të drejtë e dikush pa të drejtë. Ikë i varfri, e ikë i pasuni. Ikë i papuni, e ikë i punësuemi. Ikë ai me vila e pallate, ikë ai që i bjen cirka kresë e nuk ka ku me futë kryet. Ikë ai që e ka barkun bosh e ikë ai që e ka barkun plot. Ikë ai që e ka mendjen kosh e ikë ai që ka ide por s'ka me çka me i realizue. Ikë ai me shkollë edhe ai pa shkollë. Ikë i miri e ikë i keqi. Me të drejtë, për jetë ma të mirë e dinjitoze. Të gjithë këta ikin përditë e mallkojnë prej vendesh të hueja vendin e tyne fatzi, që edhe pa këto mallkime asht në ditë të zezë. Ata që janë përjashta na fajsojnë ne që nuk kena ikë ende, për gjendjen ku ndodhet vendi... Madje, madje tash po qarkullon fjala se në Shqipni paska mbetë llumi i shoqnisë e kurgja tjetër... Rezultati asht i mjerueshëm: përditë e ma pak shqiptarë në Shqipni. Ma shumë se gjysma e popullsisë asht në emigracion dhe pjesa tjetër asht në stacion pritjeje... Çka se bani hasmi e bame na vetë, kryesisht po due me thanë dritëshkurtësia e qeverive që na kanë telendisë në këtë periudhë, por pse jo edhe e jona si qytetarë, si e atyne që kanë ikë ashtu edhe e atyne që nuk kanë ikë ende...

Ose duhet me u pajtue me kohët e reja të globalizmit e të mos çajmë kopalla të kota tue rrahë gjoksin ose tue u mjerue për Atdhe: Atdheu nuk asht ma ai tradicional i që e trashëguem prej të Parëve, për të cilin

duhet edhe me dhanë jetën në rast nevoje, por atdheu asht ai ku ti shkon e i gjen gjanat gati, mjafton me u ba pjesë e tij, me hy në sistem si thuhet. Gjen punën, pagën e mirë, shtëpinë për banim, policin që ruen rendin, mjekun, shkollën e duhun etj. Si me thanë, nëqoftëse vendi yt nuk të jep gjithçka don, ik e gjej një vend tjetër ma të mirë... Ai asht atdheu tash e mbrapa e gjej paqen që kërkon! Këtu nuk bahet fjalë me pengue emigracionin, por me krijue kushte ma të mira jetese për ata që duen të jetojnë në vendin e tyne, qoftë edhe me një jetë modeste, por të mundshme.

### **Përmes politikës së gabueme demografike**

Si të mos mjaftonte kjo, asnjena prej qeverive nuk e çau kryet me e mbushë gollen e madhe që la emigracioni me kurrfarë strategjie apo investimi, përkundrazi përgjatë gjithë kësaj periudhe u financuene me paret e shoqatave e fondacioneve të llojllojshme politika të mbrapshta demografike për me i bindë shqiptarët me pasë sa ma pak, mundësisht aspak fëmijë; me pranue abortin e me kontrollue me profilaktikë lindshmëninë se, helbete popull gjigand e shumëmilionësh...

Rezultati tash i dukshëm: gjithnjë e ma pak fëmijë, gjithnjë e ma pak të rinj, gjithnjë e ma shumë pleq e plaka. Shtetet tjera i kushtojnë vëmendje mkambjes së shoqnive të tyne tue harmonizue brezat dhe perspektivën e shoqnisë, jo thjeshtë për nacionalizëm, por ma shumë për arsye zhvillimi ekonomik e kulturor sepse nuk don shumë mend se një popull nuk mund t'i bajnë ballë rrjedhës së pamëshirshme të historisë dhe të kohës pa ripërtrimjen e rrejtjen e ekuilibrave demografikë. Rrjedhimisht një popull që ka vijimisht numrin ma të naltë të vdekjeve sesa të lindjeve asht në rrezik me u shue ose me u zhytë edhe ma keq në prapambetje, arsyeja e thjeshtë: *Kush punon për me krijue të mira materiale e shpirtnore?! Këtu me qëllim ose pa qëllim asht harrue se vendi nuk bahet pa njerëz.*

### **Përmes korrupsionit të sistemit demokratik**

Shqipnia po zhabet edhe sepse nuk po mundena me ndërtue një sistem demokratik që të pasqyrojë vullnetin e vërtetë të shoqnisë. Prej këtij problemi burojnë shumë të këqija e gjithmonë na qeveris një qeveri që nuk e meritojmë. Pa zgjedhje të lira nuk mund të ndërtohet sistemi demokratik. Por kur ka me ndodhë kjo?!

Tue qenë popull i vogël e tue mos pasë institucione të ligjshme demokratike, kena mbetë ende patriarkal e farefisnor. Nuk duem me iu shtrua qytetnimit modern. Në fakt shqiptarët që shkojnë ndër vende të



tjera ku e gjejnë sistemin gati, i nënshtrohen atij sistemi, por sa vijnë në vendin e vet detyrohen me u përshtatë edhe një herë, sepse nuk bahet ndryshe. Patriarkal e farefisnor sepse nuk vemë në rend të parë rregull e ligje, por lidhjet familjare e klanore prej të cilave e kena të pamundun me shpëtue sepse sistemi i dalun prej shmangjes së vullnetit të shoqnisë korruptohet lehtësisht. Siç kena pa këto vite por edhe shekullin e kaluem, për me fitue zgjedhjet politike partitë apo individët që aspirojnë pushtetin, kanë mbajtë afër familjet e klanet përmes të cilave kanë ndikue në rezultatin e zgjedhjeve e mandej janë detyrue me u dhanë atyne *hakun* e vet: prona, pasuni, poste shtetnore etj. Shumë të punësuem si shpërblim prej partive që u kanë shërbye e jo për vlera e merita të tyne, që në fillim nuk prihen prej ligjit por prej interesit të padronit që i ka punësue. Edhe ata që janë të punësuem me merita pushteti u ban presion. Korruptimi i sistemit demokratik ban që shteti dhe rrogëtarët e tij të jenë vazhdimisht të korruptuem.

### **Çka do të bajmë?**

Sistemi i korruptuem rrezikon me na zanë të gjithëve përfundi, në mos na ka zanë dhe nuk e kena vue oroe. Na ka mbetë vetëm fjala e lirë, por edhe ajo duket se e ka humbë vlerën e saj. Fol sa të duesh e shkruaj sa të duesh se fatet e vendit i ka në dorë politika me do barksandalla e kryetula që maten medijene pasosun. Po kundërshtove njenën qeverisje vjen tjetra edhe ma për drejt, e mandej vijnë me radhë herë njena e herë tjera nësa populli i thjeshtë kqyr ku me gjetë rrugën për shpëtim.

Na ka mbetë pra vetëm kjo, me thanë sa ma shumë prej të vërtetave të hidhuna që na trazojnë, me shpresën se e vërteta ka me na ndihmue me ecë përpara në rrugën e qytetnimit. Na pra po vazhdojmë me rithanë të vërtetat që i njohim. Një prej këtyne të vërtetave të hidhuna asht edhe kjo që parashtruem kësaj radhe:

**Rreziku i zhamjes së Shqipnisë:** 1). prej emigracionit, 2). politikës së gabueme demografike dhe 3). paaftësisë me ndërtue një sistem demokratik.

Pra, na duhet me forcue lidhjet me emigracionin. Dikush edhe kthehet në vendin e vet kur i gjen disa kushte elementare por edhe atje ku ndodhet mundet me dhanë kontribut për vendlindjen. Shembull: sa të rinj mbarojnë sot universitetet perëndimore me shumë sakrifica e kur vijnë në atdhe u mbyllet dera e institucioneve me arrogancë, sepse në shumë institucione shtetnore janë të punësuem familjarë e anëtarë të partive në pushtet. Shembull tjetër: Pse ende sot emigracioni nuk ka të

drejtë e mundësi me votue për zgjedhjet që bahen në vendlindje?!

Na duhet ma shumë me mbështetë familjet e reja me punë, banesa, mbështetje financiare, në qoftë se duem seriozisht me pasë të ardhme ky vend. Të mos bajmë humor si kryeministri aktual që shkon tue u tallë me katundarët tonë me atë farë shpërblimi qesharak që ka përcaktue për kalamanin e parë, të dytë e të tretë.

Na duhet me ndërtue një sistem demokratik ku vullneti i popullit të mos shmanget përmes presionit, blemjes së votës; ku partitë politike atëherë të pranojnë rezultatet e zgjedhjeve e të përfaqësohen në qeverisje prej njerëzve ma të ndershëm e ma të aftë të këtij vendi.

## ▪Mendimi i traditës▪

Muzafer PIPA<sup>1\*</sup> (1914-1946)

### VETËDIJE APOR KRIM?

Në zemër t'Europës, si kyç i Adriatikut, Shqipnija shtet ndërballkanas, fatalisht dihet se gjindet shumë mbrapa nga shtetet e tjerë perendimorë. E pra, duhej t'ishte shtet model Shqipnija e jonë, mbasi nuk i mungojnë influencat natyrore e mundësit ekonomike për riformimin e vendit, si lëvizja intelektuale sidomos e 30 vjetve të fundit për m'e mëkambë nivelin e jetës e të kulturës dhe me përfutje kështu Shqipni të vërtetë e të mirë me Shqiptarë të denjë e të lirë.

Gjinden asish qi thonë se Shqipnija asht një Zvicër e dytë! Të tjerë kan guximin të shprehen se Shqipnija – Abisinija! Njena dhe as tjetra, por një mediokritet. Dhe mediokriteti asht i rrezikshëm. Nuk asht nevoja të na sugjerojnë të tjerët se kemi mbetë mbrapa. E pohojmë edhe na vetë kët të vërtetë t'idhët, por nuk dijmë a por hezitojmë t'a shërojmë kët plagë. Thuhet: Përgjegjsija e kësaj fatkeqësie i përplasit politikës së jashtëme dhe, faji bije kështu ndër anmiqt shekullorë Turq e Sllavë, Latinë e Neolatinë. Në kët mënyrë kujtojmë se justifikohemi dhe, numrojmë prap në vend.

Por fajin e kemi na vetë. Përgjegjës për vendin, asht jo katundari

---

*1 Myzafer Pipa, ishte njeni nga pinjollët e familjes së shqeme Pipa. Avokat, sportist dhe publicist i shquem. Në kallnuer 1944 themeloi dhe drejtoi së bashku me vëllanë Arshinë dhe Qemal Draçinin, revistën "Fryma". E përmuejshme letrare-kulturore. Revista doli në 8 –të numra. Ajo u mbyll në gusht të vitit 1944. Myzafer Pipa, arrestohet, torturohet egërsisht dhe vritet pa gjyq në oborin e ish- Degës së Brendshme në Shkodër; vetëm se guxoi të ushtronte detyrën e tij, tue marrë në mbrojtje ish-mësuesin, françeskanin Gjon Shllaku.*

*Artikulli, që tingllon real edhe në ditët e sodit asht marrë në: "Fryma", Nr. 7-8 – Korrik, Gusht 1944, ff. 298-292*

e malësori por kryesisht qytetari: qytetari borgez sikurse tregtari, industriali e profesionisti i pandërgjegjshëm qi manovrojnë kapitale në kurriz të popullit e në dam të shtetit. Përgjegjës gjithashtu asht funksionari i naltë qi nuk don me punue me ndërgjegje e vullnet por, me spekulue e me bashkëveprue me të parët.

Kjo asht e vërteta e idhët në kët fortunë mbrapështish.

Liri kërkue e liri do kemi por, ndërgjegje personale e kolektive nuk patme kurr. Nuk u edukue ky popull. Nuk muer kurr frymë si duhet pse e dreshti beun e aganë dhe e dreshti auktoritetin jo leal por feudal të shtetit. E prandej mbetme mbrapa.

Porsi një rrebesh i madh fortune qi me tym e pluhun, e shi e breshën merr me vedi rrëmbyeshem gjithçka gjen përpara në fushë të hapët tue lanë të paprekun llomin e skutuliqave, ashtu kohët e rrymat politike të kalueme por të paharrueshme, vuene përpara shum figura e ia ndruen vendit t'onë tue heqë e zavendësue personalitete të mbdhej: ministra e deputeta, këshilltarë e komisera të naltë, generala e komandanta, profesora e akademista politikaj por, ...kushedi, në bazë të së drejtës së trashigimis e të parimeve spekulative, mbetën po-aty pasardhësit e po-atyne zotnive të shquem!

Dhe kështu vazhdoi me triumfue politika e egoistave, e dallkaukve, e dallaverexhive e të tillve qi e ndreqen vedin dhe nuk deshten m'e përdorë kapitalin e tyne landuer e menduer për të miren e përbashkët. Në çdo kohë dhe në çdo rasë, veprimet inkoshiente të nëpunsave e të funksionarëve të naltë të shtetit dhe, në kohë turbullimi e luftash, krimet e tregtarve dhe t'industrialve shpirt-ultë, nuk e lanë me marrë frymë kët popull dhe nuk dhanë mundësi me ba as edhe një hap përparimi të vërtetë.

Për me formue bindje rreth gjendjes s'onë të statu quo-s, rreth apathisë, indiferentizmit e pasivitetit për të gjitha punët e detyrat e qytetarve përgjegjësa, na vjen me pyetë: Cili qe deri tash ay minister qi së pakut vuni vetëm një gur në themelin ktij tempulliqi po ndërtohet me gjakun e djersen e popullit? Ku janë veprat dokumentare e monumentaretë këtyne prijsave e dirigjuesave të masave, përveç pallateve e çifliqeve private nëpër Tiranë, Romë e gjetkë?

Janë këto pyetje të thjeshta e spontaneqi sot përgjigjen e tyne e prët me kërshtëri gjithkushi. Dhe përgjegje nuk vjen, pse problem paska në vetvedi shum mistere!

Mistere e jo mistere, por Shqiptari ndërkaq asht zgjue dhe nuk

han bar: Ay i ka kuptue mirë ngjarjet e jetës së mbrendshme dhe të jashtme dhe e ka kostatue bukur fort veprimtarinë e autoriteteve dhe të dikastereve nga të cilat mëvaret. Din populli dhe kupton gjithçka.

Din b. f. se *Arsimi*, qysh mbas vj. 1934 dhà shenjë dobësijet e shkatrrimit. Rrëshqiti mbrapa. Shënojmë për titull kronake se, kur ministri i asaj kohe i pat parashtrur parlamentit një projekt-ligjë shkollore, përgjegjja skandaloze e një deputetit personalitet qe kjo: “Shkëlqesë, ç’idoni gjith ato shkolla në vendin t’anë ; neve kemi nevojë për bujqër; ky millet është bile më tepër bari” !. Le të mos harrohet pra edhe qorkoreja e atij ministrit të kohës s’Italjanëve qi i detyronte profesorat dhe u imponohej atyne me kry akte spiunazhi kundra xansave! Le të kujtohen edhe shum e shum të tjera të të tjerve. Populli përditë ankohet edhe për shkollat e mesme tregtare, normale e industrial qi u mbyllen pa ndonji arsye për mi lanë vend, ndoshta për opurtinitet politik e jo për nevojë, hapjes së shkollave gjysmë-zyrtare. Dhe ndërsa ndollshin këto ndër qytete, nëpër katunde ku fëmijët ishin të djegun për shkrim e këndim, jo vetëm qi nuk hapeshin shkolla të reja si mbas projektit të caktuem, por suprimoheshin e mbylleshin edhe disa prej atyne shum të domosdoshme e të nevojshme për ato vende. Këto e të tjera banë për arsim ministrat qi kaluen.

Po *Ekonomija* me industri e me tregti dhe me gjith komisariate të naltë, ç’fryt i dha ktij vendi? Pak o aspak! Le t’a gjykojë vetë populli, mbasi gjithkushi asht në dijeni të gjithshkafes. Na këtu shënojmë se inisiativa private për qëllime private, përfitoi nga rastet e ndryshme, por shteti si shtet nuk bani asgja të dukëshme në dobi të popullit, me gjith konditat e favorshme natyrorë. U banë shpesh tentative për reformen agrare; u formuluen projekte e ligja, por kurr ato, çuditërisht nuk u zbatuen. E sot, bujku i varfën si nga hera e punon token me parmenden e drujtë prrallore të katragjyshit shekullor!

Nuk kemi kanalizime nga të cilalt të përfitojshim qinda-mija hektarësh tokë e të shpëtojshim për çdo vjetë ndoshta jeten e qinda banorve e të mija bagtivate nga innondatat e lumejve irruenta. Nuk kemi një energji elektrike nga këto lumej megjithse pasunit hydro-elektrike të vendit t’anë janë jashtëzakonisht të mjafta për ne. Dhe nuk kemi shum të tjera. Kemi vetëm tregtarë qi, në fushen e tregtis spekulative kan tregue aktivitet kondrbandistik të mrekullueshem në misionin e tyne; por qi nuk i kan sjellë asedhe ma të vogëlen dobí popullit e vendit.

Tue vezhgue rezultatet e deritanishme, na epet me pyetë: Ç’bani deri

tash *Botoreja*? Formuloi projekte e sistemoi plane apor goditi rruga e ndërtoi ura e pallate? Përgjegjja asht natyrisht negative: Asgja.

Për ç'farë reforme kodifikimi u orvat *Drejtësija*? Ç'ligja të reja dekretoi përveç atyne të vjetrave? Ku asht letërsija juridike e jona e ku janë revistat e duhuna të këtij lloji?

Ku asht vepra e *Drejtoris së Shëndetsis*? Ku janë sanatoriumet o së pakut spitalet e kompletueme me mjete dhe vegla përkatëse? Kuasht lufta kundra turbekulozit, sifilizit e malarjes qi janë përhapë aqe shum në kët vend?

Ku asht rezultati i punës së *Istituteve të naltë për studime*; ku asht *harti e muzika* e jonë; ku janë *bibliothekat e muzeumet*; ku asht *kultura popullore*? E në fund, ku qindroi deri tash liriya personale: ajo e fjalës dhe e shtypit? Ndoshta ndër burgje, ndër internime, ndër persekutime?

Po të bahet pra qoftë përceptas diagnoza e të gjitha këtyne veprimeve dhe po t'u përgjigjet pa-anësisht dhe pa-frigë pyetjeve të sipërme, problemi qi përpara ishte mister zgidhet vetvetiut dhe rezulton të dalin fajtorë të gjith ata intelektualë qi nuk ishin intelektualë por matrapaza në funksionin apor në misionin e detyrave qi u ishin besue. Dhe senkserë e matrapaza, asish qi harruen shpesh se ishin Shqiptarë, qi braktisen anën positive të mendësis e të karakterit të tyne, qi u lëshuen me i rrokë me pasion bastardhimet e imponueme nga të huejt bastardha, qenë ata zotnij të shquem pra edhe shkelqesa qi, bashkë me *buono-t* e famshme të mallnave shitën turpënisht edhe vendin, familjen dhe shtetin. E në propocion me numrin e intelektualëve dhe në relacion me funksionin e tyne, bashkë me tregtarët kapitalista rezulton gjithashtu të jenë përgjegjësa, të gjith ata qi tue pasë mundësin me dhanë kontributin e tyne të domosdoshëm umanitar për popullin kolektivitetet e për shtetin entitet, kan qenë jo vetëm indifirenta dhe pasivë, por shpesh edhe anmiq të vertëtë të vendit t'onë.

Dhe ja po t'i studiojmëpakëz këta tipa për karakter, nder e burrní të tyne si mbas temperamentit e zakonit Shqiptar, do të shofim se këto cillsi të dallueme ata i kan bjerrë krejtësisht për me i lëshue vendin pikpamjeve modern jo aqë të shëndosha e të qindrueshme se satë plogta oportuniste. Në vend të mësimave të urta e të qytetnimit të vertëtë, ata kan importue fundëri zakonesh të klasave të degenerueme, të cillat tue i fuzionue me ata t'onat, të mira e të këqija, kan shkaktue prishjen e racës thjesht Shqiptare. Ata u jane shmangë shumë perceptive dhe parimeve të kanunit të Lekë Dukagjinit, të zakoneve të mira e të ndershme qi

të parët na lanë trashigim. Pra, kan kopjue negativitetin e popujve jashtëballkanas. Shkurt : janë bastardhue jo vetëm shpirtnisht por edhe fizikisht. Gjinden asish qi nuk i u ban aspak përshtypje me genye, me vjedhë m'e pre në besë mikun; asish njerz të naltë (sic) qi, po t'u shkojë tymi i tyne drejtë, thonë: "të rroposet bota për mue" !

Janë të pandërgjegjshëm ata qi mendonjnë e veprojnë në kët mënyrë. Janë kriminela të tillë qi mundohen t'i a marrin frymën popullit dhe, t'a fusin shpejtazi në greminë Shtetin.

Dihet se të gjith kemi të drejta, por edhe detyra. Detyrat përpara të drejtave. Jo me jetue hipokritisht, jo si parasita. Kontributi qi secilli do t'i a api këtij vendi, duhet të jetëi vetëdishëm. Vetëm kështu shërohen plagët t'ona.

Dhe barka, duhet me pasë jo vetëm motor të fortë, por edhe kapidan të zot e të sakrificës. Përndryshe, ajo do të mbytet me gjith njerëz qi ka mbrenda.

**•Gjuhësi•**

Luljeta DUSHI

**TRAJTAT *ARB, ALB* NË GJUHËN SHQIPE**

Me problemin e studimeve etimologjike, ndër të tjerë, është marrë linguisti shqiptar Eqrem Çabej. Libri i tij *Studime gjuhësore* ka gjashtë vëllime: dy vëllimet e para përmbajnë studimet etimologjike në fushë të shqipes, të kryera gjatë dyzet vjetëve të punës intensive të prof. Çabejt; vëllimi i tretë përmban “Hyrtjen në historinë e gjuhës shqipe”, “Parashtesat dhe prapashtesat” dhe “Shumësin e singularizuar në gjuhën shqipe”; vëllimi i katërt përfshin historinë e brendshme e të jashtme të gjuhës shqipe të shkruar nga Çabej; vëllimi i pestë i rezervohet vëzhgimeve dhe studimeve të kryera prej Çabejt mbi Buzukun dhe gjuhën e tij dhe vëllimi i gjashtë përmbledh shkrimet e Çabejt mbi folklorin, letërsinë, biseda për gjuhën shqipe, fjalë kujtimi për Aleksandër Xhuvanin, Maksimilian Lambercin, Norbert Joklin, Anxhelo Leotin, diskutime rreth kumtesave të kolegëve të tij në kongrese e evente të tjera për probleme të gjuhësisë ballkanike, të albanologjisë e të onomastikës.

Një vit pas numrit të parë të revistës ndërkombëtare të studimeve ballkanike *Revue internationale des études balkaniques*, më 1935, Çabej boton një studim nga fusha e dokeve dhe e zakoneve shqiptare, *Sitten und Gebräuche der Albaner*, punim që tërhoqi vëmendjen e dijetarëve mbi shumë pika të trajtuara, duke sjellë informacione të reja dhe duke zbatuar një metodë të qëndrueshme shkencore.

Më 1938, Çabej i rikthehet problemeve gjuhësore, letrare dhe kulturës shqiptare me botimin e monografisë *Për gjenezën e literaturës shqipe*, që më 1939 doli broshurë më vete.

Në monografinë e tij, autori shkroi shumë probleme rreth emrit të



popullit, si p. sh. trajtat *arbën, arbër, arbënesh, arbëresh*, ku dy të parët emërtonin njëherë emrin e shqiptarëve, pastaj edhe vetë shqiptarët e të dytët shënonin vetëm shqiptarët, emra të dalë nga femërorja *arbëreshë-arbëneshë*. Emrat *arbën, arbër* ruajnë forma të forta përdorimi të dikurshëm të tyre në toponomastikën e vendit: *Arbona*-katund në Tiranë, *Arbënesh*-një katund në Krajë, *Arbënesh*-fshati i shqiptarëve të Zarës në Dalmaci; forma me *arb*-dëshmohet në Iliri: *Arbon, Arbonios, Arbonitis*; te bizantinët gjejmë *Albanos, Albania* sipas Çabejt forma savante, ndërsa trajta e përdorur në popull është vetëm *Arbanitis*, sot *Arvanit*.

Përballë trajtave me temën *Arb*, forma me *Alb*, na del shumë herët në truallin shqiptar, që në shekullin II pas Krishtit shënohet te gjeografi Ptolemaios-*Albanois*.

Le të shohim shpjegimet e grupeve të trajtave *Arb, Alb*; cila prej tyre del më e hershme? Holger Pedersen e gjen më të vjetër formën *Arb*, kurse trajtat me *Alb* i sheh sekondare, të dala nga format *Arb* të ndryshuara mbi bazën e analogjisë me emra gjeografikë me *-alb*. Për hershmërinë më të madhe të trajtave me *Arb* flet edhe ruajtja e tyre në ditët e sotme në gjuhët e popujve fqinjë, në serbokroatisht përdoret *Arbanas* me ngjytjen e sufiksit *-in*: *Arbanasin*, prapashtesën *as* të të cilave, linguisti kroat Petar Skok (Fjalori etimologjik i kroatishtes ose i serbishtes) e gjen me burim shqiptar, ndërsa *Raban* nga *Arban* ishte forma serbe e mesjetës. Shqiptarët e diasporës në jug të Italisë dhe në disa ishuj të Greqisë njohin vetëm *Arbër, Arbëresh*; enklava e vogël e shqiptarëve pranë Zarës në Dalmaci, lagjen e tyre e quajnë *Arbnesh*, as ata emrin shqiptar nuk e njihnin.

Ndërkohë, te Fjalori etimologjik i Gustav Meyer-it, shohim interpretimin që i bën pikërisht fjalës *arbër*: m. *arbëresh* m. *arbënor* m. “shqiptar”. Afërsisht arbërisht arbënisht “shqip”. Arbëni arbëri f. “Shqipëri”. Kështu emërtohen shqiptarët në Greqi dhe Itali, për të cilët emërtimi shqip, shqiptar është krejt i panjohur. Në Shqipërinë e mirëfilltë kështu emërtohen banorët e bregdetit në veri të Korfuzit dhe të prapatokës së tij, rrethet e Vlorës, Kurveleshit etj., që i përgjigjen afërsisht Kanonisë së vjetër. Kjo zonë quhet edhe Labëri, Lapëri, çka është një metatezë sipas ligjit fonetik të sllavishtes i \*albëri për arbëri.

Emri me të cilin sot quhen shqiptarët është më i vonë e rrjedh nga një emër familjeje, që qysh më 1368 në Drisht quhej Schibudar, Schepuder, Schapudar, Scapuder (Milan Sufflay, 1879-1931, historian dhe politikan

kroat, i cili është një ndër themeluesit e Albanologjisë). Emrat me të cilët thirren popujt, të shumtën e herës dalin të errët e burojnë zakonisht prej ndonjë fisi të vogël të tyre, me të cilin sot gjermanët e quajnë veten e tyre *aleman*: burimi i emrave *serb*, *kroat* është mjaft i errët. Emrin *shqiptar* G. Meyer-i (1850-1900, gjuhëtar gjerman, studiues i gjuhëve indoevropiane, një nga albanologët më të rëndësishëm që provoi se gjuha shqipe i përket familjes indoevropiane) e shpjegoi “banorë shkrepash ose malesh” më vonë e nxirrte prej latinishtes *excipere* me vështrim kuptoj; mbi këtë mendim mbështet shpjegimin e vet edhe G. Vajgand-i (1860-1930), gjuhëtar ballkanolog gjerman. Njihet sidomos si studiues i gjuhës rumune. Hartoi atlasin e parë dialektor të kësaj gjuhe. U mor edhe me studimin e gjuhëve të tjera të Evropës juglindore, sidomos me shqipen dhe me bullgarishten. Dukuritë e përbashkëta të këtyre gjuhëve i lidhi me një substrat të përbashkët trak. Gustav Vajgand-i që përfaqësuesi kryesor i tezës se shqipja buron nga trakishtja. Këtë tezë e shkroi në artikullin: *A janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo të trakasve?* Për gjuhën shqipe shkroi edhe veprën *Gramatikë e dialektit të gegërishtes jugore*, e cila mbështetet në materialet e të folmeve të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit dhe, krahas shpjegimeve, përmban edhe ushtrime, pjesë leximi dhe përralla popullore), duke u shprehur që *shqip* do të thotë flas qartë, kuptueshëm e *shqipoj*-kuptoj; në Gjirokastër *shqipëloj* del me vështrim *shpjegoj*, *bëj të qartë* (Çabej për gjenezën... 13). Albanologu austriak K. Treiner emrin shqiptar e binte të dalë nga rrënja indoevropiane *sm-kupo*, që do të thotë popull e që sipas tij lidhet me toskërishten *qipi-qipi me bar: mullar me bar*.

Këto teza të tjera mbi zanafillën e emërtimit të popullit tonë *arbën-shqiptar*, me gjithë gjasat e mëdha të jenë të vërteta e të drejta, nuk mund të pranohen gjithmonë pa rezerva.

Në periudhën e parë të veprimtarisë së tij, E. Çabej hartoi edhe krestomacinë me titull: *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, (Tiranë 1936, 201), për shkolla të mesme, paragrafi i parë i së cilës u kushtohet problemeve gjuhësore: gjuhët e botës, ndarja e tyre; bën një vështrim mbi gjuhët indoevropiane, vëzhgon përkatësinë e gjuhës shqipe në këtë familje të madhe gjuhësore; bën fjalë për dialektet e gjuhës sonë, rrok ndryshimet e tyre, trajton hipotezat e ndryshme mbi rrjedhjen e gjuhës shqipe dhe sjell disa mendime rreth emrit të shqiptarëve.

Po të kësaj kohe janë edhe tre kontribute të tjera nga fusha e

gjuhësisë, të botuara te *Revista Ndërkombëtare e Studimeve Ballkanike*, ku spikat interesi i veçantë i njëkohësit të çështjeve të diskutueshme në gjuhët dhe degët e tjera shkencore të popujve të Ballkanit: Rumanisch-Albanische Lehnbeziehungen, II. Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen, Albaner und Slaven in Süditalien II.

Këtë periudhë të punës së tij, Çabej e mbyll me botimin e disa studimeve nga fusha e letërsisë dhe folklorit, siç janë: poeti shqiptar Atë Gjergj Fishta, epika e Atë Gjergj Fishtës. Njëherë gjermanisht, pastaj edhe shqip, Çabej botoi një studim me interes të posaçëm: Kult und Fortleben der Göttin Diana auf dem Balkan te Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa, V(1941); 229-240, versioni shqip: *Diana dhe Zana*, (Hylli i dritës, 1-2, 3-4, 5-10, 1942).

Më 1941 botoi një numër jo të vogël artikujsh për *Enciklopedinë Kroate* e me këto studime E. Çabej mbyll periudhën e pasluftës dhe gjatë saj të veprimtarisë shkencore të tij.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Çabej pati fatin të qëndronte në Romë dhe si anëtar i një komisioni të ngritur më 1942 nga qendra e studimeve shqiptare pranë Akademisë Italiane të Romës, të punonte në hartimin e Atlantit Gjuhësor të Shqipërisë. Duke përfutur nga ky qëndrim disavjeçar, Çabej bëri përgatitjen për të transkriptuar “Mesharin” e Buzukut, që u botua i transliteruar dhe i transkriptuar si edicion kritik i veprës së parë të gjuhës shqipe, më 1968.

Atë kohë, Çabej punoi vepra të autorëve të tjerë të Veriut, me qëllim të përgatitjes së brumit leksikor për hartimin e fjalorit etimologjik, që ishte një ndër objektivat kryesore në punën e tij shkencore. Çabej në historinë e çdo fjale që zgjodhi, nuk la mangut asnjëherë leksikon e veprave të autorëve të vjetër të Shqipërisë Veriore. Më pas, Çabej angazhohet në punën e ngritjes së kuadrove pedagogjike e shkencore. Më 1947 përgatiti dy dispensa me titull: *Albanologji dhe Linguistikë*.

Në vitet pesëdhjetë, Çabej rishikoi një sërë problemesh nga fusha e fonetikës historike të gjuhës shqipe, duke plotësuar gurrën historike të kuantitetit të vokaleve të theksuara në gjuhën shqipe, duke na zgjeruar njohuritë mbi togjet konsonantike *mb, nd, n*.

Objekti e problemeve mbi shqiptarët dhe gjuhën shqipe e përbënin kryesisht këto çështje: A janë shqiptarët autoktonë nga koha greko-latine në viset ku gjallojnë sot apo jo? E lidhur me këto, edhe çështja: A është shqipja vazhduese e ilirishtes?

Këtu e dyqind vjet më parë, në veprën e tij madhështore *Hulumtime*

*mbi historinë e popujve të Evropës Lindore* (1774), historiani Tunmanskprehu mendimin se shqiptarët banojnë në viset e Ilirisë së vjetër, prandaj ato janë autoktonë. (H. Thunmann, 1746-1778, gjuhëtar, historian dhe teolog. Merita e Hans Thunmannit qëndron se është i pari që studioi, argumentoi dhe publikoi në nivel akademik ndërkombëtar tezën se prejardhja e shqiptarëve është nga ilirët. Në Shqipëri është bërë i njohur për punimin e tij *Kërkime për historinë e popujve të Evropës Lindore* të botuar në vitin 1774 në Lajpcig. Libri i kushtohet historisë dhe prejardhjes së shqiptarëve dhe rumunëve. Shumë nga studiuesit e marrin për bazë përfundimin e tij se: “Në historinë e shqiptarëve unë nuk kam gjetur ndonjë gjurmë mërgimi të mëvonshëm e gjuha e shqiptarëve ka dhënë dëshmi të atilla për fatet e popullit, sa që unë e kam të pamundur të mos njoh në ta fqinjët e lashtë të grekëve dhe qytetarët e Romës së lashtë. Të dyja këto më tregojnë ilirët”). Rrugën e tij e ndoqën pastaj disa dijetarë të tjerë, ndër të cilët shquhet J. G. Hani (1811-1869, austriak, i diplomuar për drejtësi në Universitetin e Haidelbergut, shërbeu si gjykatës në shtetin e sapoçliruar grek, ku arvanitët shqiptaro-grekë e mahnitën me gjuhën e tyre shqipe, që ishte aq e ndryshme nga greqishtja. Në vitin 1847 u emërua si nënkonsull i Austrisë në Janinë, ku u fut edhe studimi i gjuhës shqipe së bashku me gjuhëtarin Kostandin Kristoforidhi dhe bëri udhëtime të shumta nëpër Shqipëri. Më 1854 ai botoi veprën e tij themelore me tre vëllime *Studimet shqiptare, mbi kulturën, gjuhën dhe historinë shqiptare*. Burimet antike e bindën se ilirët, epirotët dhe maqedonasit nuk ishin grekë, por ishin më të vjetër se ata dhe e kishin prejardhjen nga pellazgët e lashtë. Ai ishte, ndoshta i pari që studioi fjalorin e ilirishtes së vjetër. Ai vërtetoi se shumë emra vendesh të viseve shqiptare ishin vazhdim i drejtpërdrejtë i emërtimeve të dikurshme ilire dhe hartoi rregulla për shpjegimin e ndryshimeve fonetike, që kishin ndodhur tek emrat e vendeve me kalimin e shekujve. Kjo bëri që të arrinte në përfundimin se gjuha shqipe ishte vazhduese e drejtpërdrejtë e ilirishtes, kurse vete ilirishtja rridhte nga pellazgjishtja), i cili me veprën madhore *Studimesh qiptare* që qëndron edhe sot si gur themeli në studimet albanologjike. Holger Pedersen (1867-1953) gjuhëtar i shquar danez, profesor në Universitetin e Kopenhagenit, indoeuropianist me interesa shkencore të gjera dhe me punime të vlefshme, vëmendjen fillestare ia kushtoi gjuhës shqipe dhe më vonë u përqendrua në studimet e armenishtes, keltishtes etj.. Ai vizitoi Shqipërinë e jugut më 1893 dhe për gjuhën shqipe ka botuar disa

punime me vlerë si: *Kontribut në historinë e gjuhës shqipe, Tingujt e shqipes, Asnjësi i shqipes*. Me shumë interes është edhe vepra *Tekste shqipeme fjalor*, ku janë botuar disa përralla dhe këngë popullore, të shoqëruara me shënime gjuhësore dhe fjalor. Ka dhënë mendime të vyera për shqipen edhe në studimet krahasuese të gjuhëve të tjera. Pedersen mbrojt tezën e prejardhjes së shqipes nga ilirishtja por vëren se asaj i mungojnë faktet historike; Mark La Pian si edhe Ribetzo mbajnë anën e autoktonisë shqiptare.

Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe (sipas David Lukës, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*), nuk mund të vështrohet i shkëputur nga një numër çështjesh, që kanë lidhje me të e që edhe ato kërkojnë zgjidhje.

Këto janë:

1. Prejardhja e shqiptarëve.
2. Prejardhja e gjuhës shqipe.
3. Autoktonia e shqiptarëve.
4. Koha e formimit të gjuhës shqipe.
5. Periodizimi i historisë së gjuhës shqipe. Për mungesë argumentimi shkencor të dokumentuar, mund të pohojmë se ato më të saktat që i afrohen më tepër realitetit janë:
  - a. Prejardhja e shqiptarëve të sotëm nga ilirët është mbase më e mundshme dhe më e argumentuara se tezat e tjera (E. Çabej, *Ilirishtja dhe shqipja*).
  - b. Hipoteza më e përhapur lidhur me burimin e gjuhës shqipe është ajo e prejardhjes ilire të kësaj gjuhe. Përfaqësuesit kryesorë të kësaj teze qenë Thunmann-i, Leak-u, Hahn-i, Miklošić-i, Meyer-i, Pedersen-i, Kreçmer-i, Jokli, Çabej, Çimohovski etj.
  - c. Në artikullin me titull *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, E. Çabej ka arritur në përfundimin se "... Ka një kontinuitet banimi të shqiptarëve në vendin e tyre të sotëm të paktën që nga koha e vjetër. Emrat e moçëm të vendeve në formën e tanishme, dëshmojnë se ky popull rron paprerë në brigjet e Adriatikut që prej asaj kohe e deri më sot". Mendimin e mësipërm E. Çabej do ta shtjellojë më tej edhe në artikullin tjetër me titull *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve*, botuar në të njëjtin Buletin. Në fundin e këtij shkrimi me një vështrim përmbledhës këto që shtruan këtu, do të themi se emrat topikë të Shqipërisë, që njihen prej kohës antike e

këtej, së bashku me terminologjinë detare të shqipes e me huazimet dorike greke veriperëndimore që ruhen në këtë gjuhë, dëshmojnë që viset bregdetare të Adriatikut bëjnë pjesë që moti, së paku prej epokës greko-romake, në atdheun ballkanik të shqiptarëve.”

- d. Për kohën e formimit të gjuhës shqipe ka dy mendime. I pari i Sh. Demirajt: “Gjatë periudhës midis fazës së fundit të sundimit romak dhe të dyndjes së sllavëve, në gjuhën e banorëve të këtyre brigjeve lindore të Adriatikut dhe të Jonit janë përftuar edhe mjaft procese të tjera gjuhësore që bënë të mundur formimin e gjuhës shqipe. Pra, gjatë asaj periudhe, si rrjedhim i evolucionit të shkallëshkallshëm të njërit a të disa dialekteve të ilirishtes, që flitej në këto troje, erdhi e u formua gjuha shqipe, e cila në një fazë më të hershme njihej me emrin gjuhë *e arbëneshe* a *e arbëreshe*. Ky evolucion i shkallëshkallshëm, pas gjithë gjasash, duhet të jetë kryer jo më vonë se fundi i shek. VI të erës sonë. Dhe atëherë fillon edhe historia e mirëfilltë e gjuhës shqipe.

I dyti i D. Lukës: “Shqipja u formua si gjuhë *bijë* nga *nëna* e saj ilirishtja në të njëjtat treva në shek. I-IV të erës sonë. Gjatë kësaj periudhe ajo përvijoi tipare gjuhësore, duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e nënës së saj ilirishte, por duke formuar në të njëjtën kohë edhe tipare të reja që e bënë të dallohet nga ajo. Kushtet historike të asaj kohe (pushtimi romak e në vazhdim dyndjet barbare) e përshpejtuan këtë formim. Në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj”. Për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe janë dhënë mendime të ndryshme. Po rendisim dy shkrimet e fundit të Sh. Demirajt dhe të D. Lukës:

Demiraj përcakton këto periudha:

1. *Periudha e parë (shqipja e vjetër)*, që zgjat që nga koha e formimit të shqipes... e deri aty nga shek. VII-VIII të erës sonë.
2. *Periudha e dytë (shqipja e mesme)*, që vazhdon deri aty nga shek. XIV-XV.
3. *Periudha e tretë (shqipja e re)*, që vazhdon deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare (gjysma e dytë e shek. XIX).
4. *Periudha e fundit (shqipja e sotme)*. (Shaban Demiraj, Gjuha shqipe 2009. Aty janë edhe periodizimet e dhëna nga H. Pedersen, E. Çabej, S. Riza, A. Desnickaja, B. Bokshi).

David Luka përcakton tri periudha të mëdha: *prehistoria, koha e formimit, historia*.



*Prehistoria* i përket gjithsesi nënës së shqipes. Në këtë periudhë dukuritë dalin të përbashkëta me gjuhët e tjera simotra indoevropiane me të cilat grupohet.

*Koha e formimit* (shek. I-IV). Tipari i përgjithshëm: ndërrimet janë të veçanta e vetëm për gjuhën e re që po formohet në të njëjtat treva nga nëna e saj ilirishtja.

*Historia* nis në shek. V. Idioma e re tani mund të emërtohet *shqipja e vjetër*.

Që këtu nis periodizimi i historisë së gjuhës shqipe. Te vepra *Studime gjuhësore* e Eqrem Çabejt shohim shpjegimin që autori bën për fjalët *arbër-arbën*, *arbëresharbënesh*, *arbërorarbënuer*, *Shqiptar*, *ArbërArbën* edhe emri i vendit, “Shqipëri”, *arbërisht*, *arbënisht* “shqip” del për të parën herë te Buzuku (XVIII/2b): *Gjithë popullinë ndë Arbanit ata n mortajet largo*. Pastaj te Budi (DC 223, 226, 229 RR 17, 40, 327, 360, SC3, 408), Bardhi (f. 3, 22, 189, 196, 197, 218, 223), Bogdani (Parath. *Dheu I Arbënit*, f. 180, 181). Gjithashtu rron ky emër dhe te Arbëreshët e Greqisë e t’Italisë, ku nuk njihet emri tjetër *Shqiptar*, *Shqipëri* etj., që shihet se është më i ri. Për Greqi khs. Fallmerayer (Das alb. Element in Griechenland II 31), Reinhold (Glosari 31), Laographia III12, te G. Meyeri (Alb Studien V 62) *turqisht e arbërisht*. Për Itali khs. Sidomos Kamardën I 10, 21, 30. Për përhapjen e emrit në Shqipëri e jashtë Shqipërisë e për historinë e tij khs. Thunmann (Untersuchungen 240a. 241) Malte- Brun (GéographieUniverselleIV 339), Pouqueville (Voyage II 26 vv. ), Hahn (Alb. Studien I 230, 231, Reise Drin- Vardar 13, 15) Hobhouse (Journey 128), Mitko 134, Philippson (Petermanns Mitteilungen 1890 f. 7), G. Meyer 14, Kretschmer (Enleitung in die Geschichte der gri. Sprache 262), Pedersen (KZ 33; 551, 36, 229), Tomaschek te Pauly- Wissëea I I 1307, Jokl (IJ XIVII 194, XIIVII 84, XXIVVII 137, Slavia XIII 619, Archivum Romanicum XXIV 27 v. ), Spitzer (Mitteil, d. Rum. Inst. EienI 334); Jireček (Illyr-alb. Forschungen I 66), Sufflay (Ungar. Rundschau 5. 1 vv., Städteund Burgen Albaniens 7 shën. 8, 18 v., Arhiv za arb. Starinu II 199, 210, Srbi i Arbanasi 24 vv. ), L. V. Szeg (Ungar. Rundschau 5. 62 vv), Bleichteiner (Berichte d. Forschungs- InstitutsfürOsten und Orient in Wien2, 1918, 9), Hüsingpoaty f. 3, Jorga (Helmolts EeltgeschichteVIII 435 v. ), Krahe (Geograph. Namen 12), M. Roques (Le dictionnaire albanais de 1635 f, 3, 45, 50 v, 52), Cordignano (Geogr, eccles. dell’ Albania 35, 259), Tagliavini 71, Bertoldi (Z. F. rom. Phil. 56, 179). Nga Shqiptarët vetë khs. Albania II

150, M. Sirdani (Hylli i Dritës VII 198 vv., 235 vv. ), Leka VII 185 v., VII 38 nn., Logoreci Cirka III 264 v., A Xhuvani (Kritikë mbi fjalorë të shqipes 17), E. Çabej (Hylli i Dritës XIV 646 v. = Leipz. Vierteljahrsschr. f. Südosteuropa IV 90 vv. ), F. Fishta (Shkëndija II, f. 141 vv. ).

Për burimin e emrit G. Meyeri nuk shprehet; vetëm se te emri *lab*, *Labëri* gjen një formë metateze të *Alb-* e, që del së pari si një popull ilir i Shqipërisë së mesme te gjeografi aleksandrin Ptolemeu i shek. II të erës sonë. Mendimi i identitetit të *lab* me *Alb* edhe te Skoku (Starohrvatska prosvjeta, N. S. 1, 1927, f. 71=IJ XIIIIVII 170). M. Logoreci nga shprehja *mal e arbën* sheh te ky emër, mundet me të drejtë, një fjalë me kuptimin “fushë”. A ka qenë ky më parë emërtimi i vendit apo i popullit - këtë çështje Furikis e zgjidh në kuptimin e alternativës së parë. Në Li. Posn.. VIII 83 vv. Te *Arbëresh Arbënesh*, Jokli (73 XXIV 137) sheh një zgjerim me – *esh* = lat. – *ensis* it. – *ese-*.

E ndërkohë mbetet e pasqyruar nga ana e etimologjisë, si shumë emra popujsh.



Isa ÇELEPIJA

## GJUHA STANDARDE DHE GEGËRISHTJA

Gjuha, si fenomen shkencor dhe shoqëror, përfshin një gamë të madhe, sa shkencore aq edhe politike, por për mendimin tim Gjuha Letrare Kombëtare më tepër u formua në analet politike sesa në ato shkencore. Flitet dhe shkruhet sot për Gjuhën Shqipe; mbahen edhe konferenca, por tëgjithë kapen pas degëve; asnjë nuk kapet pas trungut, pas rrënjëve, pas themelit, parimit themelor të drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që është Parimi fonetik.

Deri para vitit 1972, pavarësisht përpjekjeve të bëra për unifikimin e dialekteve, sidomos nga “Komisia Letrare” e Shkodrës (1916) shqipja vijonte të shkruhej në dy variantet, gegë dhe toskë. Në shumë periudha, gegërishtja ka qenë gjuhë zyrtare. Ishte një gjë shumë e mirë që shqiptarët të kishin gjuhën e vet letrare të njësuar për të gjithë. Kjo rriste prestigjin e shqipes, ndikonte në rritjen e unitetit të kombit, në kulturën gjuhësore të tij, etj. Po si u bë kjo gjë tek ne? A u bazua Drejtshkrimi i Gjuhës shqipe në dy dialekte njëkohësisht? Tek cili variant duhej mbështetë më shumë dhe pse?

Si kudo në jetën e vendit: në atë politike, ekonomike etj., edhe në atë sociale, shpirtërore; diktatura komuniste vuri dorën e saj. I pari i politikës dhe i shtetit të atëhershëm për këtë zgjodhi njeriun e tij, gjirokastritin Androkli Kostallari, të cilin më parë e kishte emëruar Drejtor në Institutin e Studimeve Gjuhësore, Tiranë. Ky institut propozoi thirrjen e një konference gjuhësore mbarëkombëtare, por instancat eprore, vendosen të mbahej një kongres.

Siç dihet, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe i zhvilloi punimet me 20-25 nëntor të vitit 1972. Në ditën e fundit, personalitetet e gjuhës do të firmosnin Drejtshkrimin e Ri të Gjuhës Shqipe. Por jo të gjithë ishin dakord për këtë. Kjo gjë u pa edhe në ditët e mëparshme nga diskutimet dhe kumtesat që u mbajtën nga pjesëmarrësit. Ateherë

u desh prezenca e numrit një të shtetit. U lajmërua dhe erdhi vetëai në lozhën e parë të sallës ku u mbajt Kongresi, me atë buzëqeshjen falso prej aktori pas së cilës fshihej kërcënimi. Vetëm atëhere të gjitha kokat e shkencës u ulën dhe firmosën. Ata firmosën atë që ishte “vulosë” më parë nga lart. Kështu u vendos, me pak fjalë, Drejtshkrimi i Ri i Gjuhës Shqipe.

Menjëherë pas Kongresit, Sekretari i II-të i Komitetit të Partisë së Punës, i rrethit Shkodër, shkoi në disa shkolla kryesore të qytetit dhe u tha mësuesve vetëm dy fjalë: “Kush nuk është dakort me Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, është armik”. Shkodra ishte “kalaja” më e fortë për t’u marrë në këtë drejtim. Censura vazhdonte. Të quheshe armik në atë kohë, donte të thoshte: të hiqeshe nga puna në arsim dhe të punoje në punë të rënda krahu; të internoheshe vetëm ose me gjithë familje, të burgoseshe etj. E kush nuk do të ishte dakord me Drejtshkrimin e Ri?!

Thuhet se Gjuha Letrare Kombëtare Shqipe është bazuar në dy dialektet kryesorë të saj. Kjo nuk është e vërtetë. Ajo është bazuar në dialektin toskë. Po pse u mor për bazë ai? Çfarë merite ka më tepër toskërishtja se gegërishtja? Përkundrazi. Kur vendosen kështu, ata harruan se:

- Gegërishtja mbarte potencialin kryesor dhe më të madh të letërsisë shqipe.
- Këngët e eposit shqiptar, u kënduan gegërisht.
- Vepra e parë e Gjuhës Shqipe, “Meshari”i Gjon Buzukut i v. 1555, është shkruar në gegërisht bashkë me autorët e letërsisë së vjetër shqipe.
- Ai që u quajt “Homeri” i Shqipërisë, i madhi Gjergj Fishta, shkroi në gegërisht.
- Ai që për herë të parë në Historinë e Letërsisë Shqipe shkroi me realizëm; që solli për herë të parë *Vargjet e lira*, pra Migjeni i paarritshëm, shkroi në gegërisht.
- Vargjet e ëmbla të Ndre Mjedes të shkruara në gegërisht, janë quajtur, simfoni e poezisë shqipe etj.

Ata harruan se:

- Kryeqendra arsimit, kulturës, shkencës sonë, Tirana, ishte në gegëri.
- Shkodra (gege) është quajtur nga të gjithë, djepi i kulturës shqiptare.
- Shkolla e parë normale u hap në Elbasan.
- Shkolla e parë e lartë pedagogjike në rrethe, u hap në Shkodër etj., etj.

Me këtë nuk dua të mohoj aspak pasurinë e madhe të folklorit të krahinave jugore. Dua të pohoj atë që vëllezërit Frashëri ishin ndër më të mëdhenjtë e Rilindjes sonë Kombëtare. Që shkolla e parë shqipe u hap në Korçë (e krahina e Korçës bën pjesë në nëndialekt. ), e pasuar nga ajo e Kuklit (Shkodër) e hapur nga Ndre Mjeda; se Ismail Kadare sot është me përmasa botërore etj. Por, ju lutem më ndihmoni të vemë pikat mbi i.

Le t'i referohemi Drejtshkrimit të sotëm të shqipes. Në të thuhet se parimi kryesor është parimi fonetik; që do të thotë që shqipja shkruhet ashtu sikurse flitet. Kjo e fundit nuk është e vërtetë. Edhe atëherë (1972) edhe sot, më shumë se gjysma e popullsisë shqiptare, në më shumë se gjysmën e territorit të vendit, kanë folur e flasin gegërisht. Pra këtu ka një abuzim të madh.

Po të marrim parasysh shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, të cilët flasin po ashtu, gegërisht, problemi merr përmasa akoma edhe më të mëdha. Është e vërtetë që edhe kosovarët e kanë pranuar Kongresin e Drejtshkrimit, por ama ne dimë gjithashtu që shumë gjëra ata i kanë bërë për hir të nacionalizmit dhe lidhjes me kombin mëmë.

Ne, gegët, jemi bërë gjysmakë në të folur, në kuptimin e asaj që as nuk mund të shkëputemi nga gjuha nan', as nuk mund të përdorim natyrshëm rregullat e drejtshkrimit të ri pasi nuk është gjetur rruga e drejtë, rruga e duhur, shoqërore dhe shkencore.

Dihet që ne flasim, komunikojmë, merremi vesh me njeri tjetrin jo me fjalë të shkëputura, por me fjalë të lidhura njëra me tjetrën, sintaksisht në fjali. Dhe shtylla që mban fjalinë në këmbë është folja; ndërsa forma kryesore gramatikore e foljes është forma e pashtjellur e paskajores apo infinitivi. Hartuesit, projektuesit e Drejtshkrimit të Ri të Gjuhës Shqipe, e kanë mohuar këtë pasuri të madhe të Gramatikës Shqipe. Kjo është bërë me ndërjegje, sepse po të pranohej paskajorja e gegërishtes (me punue, me ardh, me la etj. ), atëhere duhej të pranohej pothuaj e gjithë gegërishtja, me gjithë pasurinë e madhe sintaksore të ndërtimit të fjalive që sjell kjo paskajore.

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e madhe të gjuhëve indoeuropiane, si gjuhët e popujve të tjerë të Ballkanit, si gjuhët e popujve të tjerë të Europës. Të gjitha këto gjuhë të trungut indoeuropian, e kanë infinitivin si gegërishtja e shqipes. Ne e hoqëm atë (ç'paradoks).

Kjo gjë shihet edhe në fjalorët e tyre dygjuhësh. Këtu, të gjitha foljet e fjalorit, përkthehen në infinitiv. Që nga fillimet e saj e deri vonë kjo gjë

është praktikuar edhe tek ne. Pas Kongresit tonë të drejtshkrimit, nuk u ndoq më kjo praktikë e vjetër e Gjuhës Shqipe dhe kjo praktike e vjetër dhe e sotme e gjuhëve simotra. Që nga ajo ditë, në gjuhën shqipe, bëhet një gabim i rëndë shkencor. Foljet e formës së pashtjellur të paskajores nuk përkthehen si të tilla, por gabim në një formë tjetër gramatikore: në formën e shtjellur të mënyrës lidhore, në mënyrën dëftore ose edhe në një formë tjetër sipas dëshirës së autorit (?!).

Kështu folja: to work (anglisht); travailler (frangisht); lavorare (italisht); arbeiten (gjermanisht); rabotam (rusisht) etj. nuk përkthehen drejt, siç është në atë formë: *me punue*, por gabimisht në një formë tjetër: të punoj, punoj... Si është e mundur të ndodhë një gjë e tillë?! Kjo nuk është asgjë tjetër veçse një absurditet i qëllimshëm shkencor. Dhe, për çudi, kjo praktikë e gabuar, vazhdon të ndiqet edhe sot, jo vetëm në fjalorët dygjuhësh, por edhe në metodat e mësimi të gjuhëve të huaja. Ndoshta mund të tolerohet vetëm në ndonjë përkthim të ndonjë poezie për efekt rimimi, por absolutisht në raste të tjera. Ndokush mund të thotë se shqipja e ka paskajoren e saj të toskërishtes: *për të punuar, për të pirë, për të thënë* etj. Kjo nuk është e barazvlerëshme me: *me punu, me pi, me thanë*. Po të ishte ashtu, paskajorja e toskërishtes, do të përdorej menjëherë në fjalorët e metodat tona të mësimi të gjuhëve të huaja. Po japim një shembull të thjeshtë, nga një ndërtim sintaksor në një fjalë të urtë popullore: *Asht mirë me ba mirë*. Nuk mund te themi: *Eshtë mirë për të bërë mirë*.

Gjithashtu, mungesa e paskajores së gegërishtes e ka varfëruar shumë gjuhën shqipe. Ndërtimet sintaksore të fjalive janë të shumëllojshme dhe të larmishme, sidomos ato që ndertoohen me ndihmën e foljeve ndihmëse: *kam e jam* ose të ashtuquajtura gjysëm ndihmëse: *mund, duhet; fillon, vazhdon, mbaron* si: *kam me bâ, kam me kujtu, duhet me mendu, mundem me kalu, du me vazhdu* etj. ose *jam tue ardh, jam tue shkue (me percjellore)* etj. Imagjinojeni sa larg origjinalit janë përkthimet e kolosëve të letërsisë së huaj pa këtë paskajore.

Shkelje vërehen edhe në parimet e tjera të drejtshkrimit, edhe në kategoritë e tjera leksikogramatikore, në pjesët e tjera të ligjeratës. Po marrim si shembull të trajtojmë atë me të përdorshmin, më të njohurin, më kryesorin, emrin. Bie fjala emri *krye* dhe *kokë* del në dy variante sipas dy dialekteve. Nuk është marrë për bazë i pari i gegërishtes, por i dyti i toskërishtes, megjithëse me temën prodhuese fjalëformuese *krye* fitojmë një sërë fjalësh të reja si: *kryetar, kryesoj, kryesues, i, e perkryer,*

*kryetrim* etj. Ndërsa me fjalën *kokë* nuk gjej fjalë të tjera, përveçse ndonjë të dorës së dytë si: *kokëshkrete, kokëkungull*. A nuk është ky një nënvleftesim i qëllimshëm?

Po kështu nuk është pranuar nga drejtshkrimi i ri, përdorimi i zanores a hundore ose johundore në shumë fjalë si: *nana, zani, rana, baj(me ba) etj.*, megjithese fjalët me këtë zanore krijojnë një vazhdimesi të drejte në shqipe: *nina-nana, za zanore ( e jo ze zerore ), ran, tok ranishte ( e jo toke rerishte), baj (me ba), bamiresi ( e jo bej bemiresi), syni synoj ( e jo syri syroj) etj.* Këtu përveçse është errësuar zanorja a ne e, vërehet edhe fenomeni i rotacizmit, i përdorimit të bashkëtingëllores r nëvend te n: *nëna, zëri, rëra, syri.*

I theksuar është edhe përdorimi i ë-së sidomos në fund të fjalës, por edhe në trup të saj. Është ngulur kaq shumë këmbë në përdorimin e kësaj e-je të mirfilltë, në një kohë që asnjë nga gjuhët indoeuropiane nuk e kanë atë. Bile ajo nuk ekziston as në makinat e tyre të shkrimit. Këtë mund ta gjejmë vetëm në lituanisht.

Fenomene të tilla vërehen edhe tek përdorimi i grupeve të zanoreve: *ua, ue, ie, ye* apo në togjet e bashkëtingëlloreve: *mb, nd, ng, ngj.*

Këto dhe të tjera si këto që thamë më lart, hasen në të gjitha kategoritë leksikogramatikore të gjuhës shqipe. Këto janë padrejtesi shkencore që i janë bërë dialektit të gëgërishtes në veçanti dhe gjuhës shqipe në përgjithësi.

Me të drejtë studiuesit e gjuhës sot shqetësohen për shtrembërimet që i bëhen normës letrare. Këtë gjë ata e kanë vërejtur edhe te folësit e radiotelevizioneve tona. Si përshembull mosshqiptimi i ndonjë zanoreje apo edhe bashkëtingëlloreje në fund të fjalës, ose përdorimi i trajtës së pashquar në vend të trajtes së shquar tek emrat, përdorimi i gabuar i rasës dhanore *neve* në vend të emërores *ne* tek përemri. Shqetësuese për to është edhe përdorimi pa kriter i fjalëve të huaja në shqipe. Për t'i dhënë rëndësi vetes më tepër se sa duhet, politikanët tanë i përdorin me shumicë. Prindët e rinj, për fëmijët e tyre, duhet t'i lenë emrat e huaj dhe të kthehen nga emrat e vjetër e të bukur shqiptar. Bota e praktikon shumë këtë gjë. Ata e ruajnë shumë origjinalitetin e tyre kombëtar në të gjitha drejtimet.

Shkencëtarët e sotëm nuk shqetësohen për disproporcionin e madh që ekziston mes gjuhës së folur dhe asaj së shkruar. Dhe përgjegjës për këtë është vetë Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe i vitit 1972, me parimin themelor të tij (Parimi fonetik) i cili nuk zbatohet nga vetë

Drejtshtkrimi i Gjuhës Shqipe. Shqetësues është sot qendrimi i shumë gjuhëtareve, kryesisht të ardhur nga Jugu, të cilët i qëndrojnë strikt Kongresit të Drejtshtkrimit të vitit 1972. Ata nuk e pranojnë dialektikën e zhvillimit e të ndryshimit në shkencën e Gjuhës Shqipe. Prof. dr. Rami Memushaj, në Gazeten “Dita”, 20 nëntor 2017, duke bërë një sforcim jo të natyrshëm mes Kongresit të Manastirit me Kongresin e Drejtshtkrimit të vitit 1972; duke anashkaluar Kuvendin e Elbasanit dhe Komisionin Letrare të Shkodrës, na kujton se pa gjuhën e shkruar të njësuar, shqiptarët do të ishin ndarë të paktën në dy kombe.

Edhe unë jam për atë që shqiptarët të kenë një gjuhë të shkruar të përbashkët. Por dua ta di, se si ia kanë dalë ato popuj që sot kanë dy variante të të shkruarit? Sot në Spanjë po kërkohet edhe një variant i tretë. Edhe shqiptarët më janë dukur më kompakt në kohët e vjetra të lavdishme se sa sot.

Ndokush mund të më pyes: Po ti, përse nuk shkruan në gegërisht? Unë jam specialist i gjuhës shqipe dhe i respektoj “rregullat e lojës”. Në fuqi është Kongresi i Drejtshtkrimit të Gjuhës Shqipe i vitit 1972. Megjithatë një gjë të tillë edhe e kam bërë tek gazeta Kombëtare e Pavarur “Shkodra”. Arshi Pipa, thoshte: Po shkoj në Shkodër me e limue gjuhën.

Që nga viti 1972 e deri sot kanë kaluar 47 vjet. Megjithatë gegërishtja nuk është asimiluar nga drejtshtkrimi i ri. Ajo është folur gjatë gjithë kohës nga populli shqiptar brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Ajo sot edhe po shkruhet. Gegërishtja nuk duhet trajtuar si një gjuhë e vdekur, por të gezojë vendin e merituar që i takon në Gjuhën Letrare bashkë me toskërishten. Përkundrazi, gegët dhe gegërishtja, gjallojnë.

Pra, siç shihet, gjuha është dukuri shoqërore e shkencore që ndryshon e zhvillohet vazhdimisht.

---

## ▪Histori▪

Mark PALNIKAJ

### **RELACIONI I STEFANO GASPARIT I VITIT 1672 DHE RËNDËSIA E TIJ PËR HISTORINË E SHQIPËRISË**

Ky dokument konsiderohet relacioni më i rëndësishëm i historisë së Shqipërisë për shekullin e XVII, krahas relacionit të Marin Bicit të vitit 1610. I shkruar në 125 faqe format i madh, ky shkrim i tejkalon kufijtë e një relacioni informativ dhe ka rëndësinë e një studimi të plotë për zonat që ai i studioi dhe i shkeli me këmbë për dymbëdhjetë muaj pa ndërprerje.

Rëndësia e këtij relacioni qëndron në faktin se popullsia e Shqipërisë së Veriut, e përfshirë në teritoret e shtatë dioqezave, në shumicën dërrmuese i kishte mbijetuar asimilimit fetar dhe nuk e kishte pranuar të bëhej renegat i fesë katolike në pjesën më të madhe të tij.

Këtë qëndresë e kishin bërë në mënyrë të pavarur dhe pa mbështetje nga Selia e Shenjtë për afër një shekull e gjysmë. Në masë të madhe ata jetonin si shqiptarë, por si të krishterë jetonin vetëm për forcë zakoni dhe jo sepse kisha romane kishte treguar ndonjë përkujdesje për ta.

Mbas krijimit të organizatës për përhapjen e fesë, në janar 1622, e quajtur ndryshe edhe Propaganda Fide, u krijuan organizma për të rimëkëmbur besimin e harruar nga një pjesë e popullsisë së vendeve të pushtuara nga Perandoria Osmane, ku bënte pjesë edhe popullsia e Shqipërisë së sotme.

Për përmbushjen e këtij misioni organet më të larta të Selisë së Shenjtë në Vatikan vendosën të dërgonin një person për të paraqitur një panoramë të saktë të gjendjes së besimtarëve në këto treva.


Personi i ngarkuar me këtë punë duhet të shkonte fshat më fshat dhe të përshkruante në mënyrë të hollësishme realitetin në të cilin ndodhej

popullsia e këtyre vendeve.

Duhet të silleshin të dhëna për gjendjen dhe numrin e popullsisë, sa ishin konvertuar në fenë islame dhe sa e ruanin akoma besimin e mëparshëm, gjendjen e kishave dhe të inventarit të brendshëm, shpenzimet e nevojshme për riparimin e tyre, gjendjen e pronave të kishave dhe vlerën aktuale të tyre dhe të dhëna të tjera me karakter social dhe politik.

Relacioni përmban të dhëna të hollësishme për numrin e popullsisë, por edhe vendbanimet dhe emërtimin e tyre, edhe kur janë katër apo pesë familje.

Ka të dhëna gjeografike ku përfshihen emrat e lumenjve, maleve, krahinave, kufijtë gjeografikë të tyre etj.



### *Kapaku i relacionit*

Ka të dhëna me karakter ekonomik, ku tregohet për llojet e bimëve që kultivoheshin, për prioritetet, për gjendjen ekonomike të popullsisë, për monedhat, për shërbimet që ofroheshin si fetare ose edhe shëndetësore deri edhe kirurgjikale.

Nisur nga këto informacione që përfshin ky relacion është konsideruar nga studiuesit e huaj dhe më vonë edhe nga ata shqiptarë si relacioni më i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë për shekullin XVII. Por nëse një relacion i ngjashëm i Zmajeviqit i vitit 1704 është publikuar i



plotë dhe pa gabime, relacioni i Gasparit, megjithëse mjaft me rëndësi, akoma edhe sot e kësaj dite nuk është publikuar vetëm pjesërisht dhe me shumë gabime të cilat vazhdojnë të merren në konsideratë si burime historike të sakta dhe të prodhojnë shkrime me gabime të cilat nganjëherë shkojnë deri në tjetërsim të realitetit historik.

Nga të dhënat arkivore merret vesh se dërgimi i Stefano Gasparit në Shqipëri për të raportuar për gjendjen e kishës katolike në këto treva, por edhe për gjendjen sociale dhe shoqërore të popullsisë së këtyre trevave, është ndërmarrë nga organet më të larta të shtetit të Vatikanit. Ai ishte përzgjedhur për këtë mision, sepse ishte me kombësi shqiptare, njihte gjuhën dhe zonat në të shtatë Dioqezat me popullsi shqipfolëse, kishte mbaruar me sukses Kolegjin Ilirik të Loretos dhe Kolegjin Urban në Vatikan dhe mbi të gjitha ishte i njohur edhe për një inteligjencë të mirë në raport me kolegët e tjerë.

E thënë ndryshe, ai në vitin 1670 kishte mbaruar dy shkolla të larta nga më në zë për atë kohë dhe kjo ishte padyshim një arritje shumë e madhe e tij.


Në fillim ofertën për të kryer një mision të tillë ai nuk e ka pranuar me pretendimin se i rrezikohej jeta nga turqit që kishin pushtuar këto zona dhe se i kishin ofruar një pagesë të pamjaftueshme.

Mbas disa muaj negociatash midis tij dhe eprorëve, është rënë dakort që ai të vizitonte dioqezat me banorë shqipfolës jo si klerik, por si një turist, qytetar i thjeshtë kundrejt një shume shumë të madhe monetare për nevoja të shërbimit, si: ushqim, fjetje, pagesë për kuajt dhe shoqëruesit dhe për ryshfetet që parashikohej se do t'i duheshin për pushtetarët e korruptuar turq, nëse do t'i nxirrmin pengesa.

Shuma e madhe monetare që i është vënë në dispozicion për të përmbushur misionin e ngarkuar, e vinte atë para përgjegjësisë që detyrën e ngarkuar ta kryente në nivelin më të lartë të mundshëm.

Prandaj ka qark shumë rëndësi gjetja dhe publikimi korrekt i këtij relacioni, sepse në të është përfshirë maksimumi i mundshëm i informacioneve që mund të merreshin në atë kohë nga një person i huaj, nga vende kundërshtarë me pushtuesin osman të vendit tonë.

Në Shqipëri është publikuar i plotë për herë të parë në revistën "*Hylli i Dritës*" në katërmbëdhjetë numra, gjatë viteve 1930, 1931 dhe 1932.



*Kopje nga Napoli*

Historianët dhe studiuesit e ndryshëm që merren me histori ijanë referuar këtij relacioni në dhjetra shkrime të publikuara gjatë këtyre nëntëdhjetë viteve duke sjellë shumë herë konfuzion dhe pasaktësi të “çertifikuara” me autoritetin e revistës prestigjioze “*Hylli i Dritës*”.


I pari që ka reaguar mbas këtij publikimi, ka qenë studiuesi Fulvio Kordinjano i cili në vëllimin e tretë të librit të tij me titull “*L’Albania attraverso l’opera e gli scritti di un grande Missionario italiano il P. Domenico Pasi S. I. 1847-1914*”, botuar në Romë në vitin 1934, i ka kushtuar këtij relacioni një kapitull të tërë, atë të dhjetin, nga faqja 321 deri në faqen 332, duke i bërë një analizë të thellë historikut të këtij relacioni dhe publikimit në revistën “*Hylli i Dritës*”.

Ai ka shkruar se ka kërkuar kopjen origjinale të këtij relacioni në arkivat italiane të kohës dhe nuk e ka gjetur. Në vazhdim të punës së tij ai ka lexuar dy kopjet e këtij dokumenti që ishin të ruajtura në dy fonde arkivore në Romë dhe në Napoli.

Mbas studimit të vëmendshëm të të dyja kopjeve dhe të revistës, ai ka arritur në konkluzion se publikimi përmban më shumë se njëqind gabime që vinin nga pamundësia e leximit dhe rishkrimit të realizuar nga paleografët që janë marrë me këtë punë dhe ka publikuar në librin e tij një tabelë me njëqind gabimet që ai ka mundur të identifikojë. Kjo tabelë është e vendosur në faqet respektive 327 deri 332. Në këtë korrigjim të gabimeve të vërejtura ai nuk ka përfshirë paragrafet që

mungojnë në kopjen e Napolit.

Tani, mbas tetëdhjetë e shtatë viteve që është publikuar pjesa e fundit e kopjes së këtij relacioni të marrë nga Biblioteka Kombëtare e Napolit në Pallatin Mbretëror të këtij qyteti, duke marrë shkas nga gabimet e shumta që përmban ky publikim, vendosëm të merremi edhe një herë me këtë problem.



*Kopje nga Vatikani*

Për këtë arsye kemi marrë të plotë kopjen e këtij relacioni që gjendet në Napoli e që ruhet si dorëshkrim në 125 faqe, në një dosje me rreth 450 faqe dokumenta të ndryshme.

Kemi marrë edhe kopjen që gjendet në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan, edhe ky në dorëshkrim me mbi 125 faqe.

Nga krahasimi i dy kopjeve të përmendura dhe i shkrimit të publikuar në “*Hyllin e Dritës*”, lehtësisht dallohet që ka ndryshime të mëdha midis kopjeve në dorëshkrim dhe tekstit të publikuar në revistën në fjalë.

Nga studimi që u kemi bërë këtyre dokumenteve, kemi vënë re që kopjet dorëshkrim midis tyre kanë dallime dhe nuk janë kopjuar nga i njëjti person, por nga dy kopjues të ndryshëm.

Teksti i publikuar në revistën “*Hylli i Dritës*” është një rishkrim i kopjes dorëshkrim të Napolit por i rishkruar me më shumë se njëqind gabime.

Kopja që ruhet në Vatikan ka ndryshime të dukshme, sepse ka të shkruara të dhëna që kopja e Napolit nuk i përfshin.

Ajo është shumë më e plotë se kopja e Napolit dhe ka disa paragrafe shkrime më shumë, me të dhëna që kopjuesi që ka shkruar kopjen e Napolit, i ka lënë pa shkruar për motive që për ne nuk janë të qarta.

Një hamendësim mbi mospërfshirjen e disa paragrafeve në kopjen e Napolit mund të jetë që ai u çensurua për të ruajtur disa të dhëna që për atë kohë mund të konsideroheshin sekrete. Por kjo ide e jona mund të konsiderohet vetëm një hamendje e pabazuar në të dhëna konkrete. Arsyeja e mospërfshirjes në kopjen e dokumentit të këtyre paragrafeve mund të jetë krejt tjetër nga ajo që mendojmë ne.

Nisur nga ky fakt, jemi të mendimit që duhet kërkuar në arkiva të tjera për të bërë të mundur gjetjen e kopjes origjinale të shkruar nga autori dhe të bëhet rishkrimi dhe publikimi nisur nga kopja origjinale. Nëse kjo nuk arrihet, atëherë duhet rishkruar korrektësisht kopja që gjendet në Arkivin e Propagandës Fide dhe duhet përkthyer me kujdesin më të madh duke u konsultuar me persona njohës të mirë të terrenit në secilën Dioqezë.

Jemi të mendimit që kopja origjinale mund të ndodhet në Arkivin Sekret ose në fondin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Apostolike në Vatikan.

Nisur nga ky fakt, e ndërmorëm shkruarjen e këtyre radhëve për këto qëllime:

Së pari, me qëllim që institucionet shtetërore zyrtare të japin fondet e nevojshme për të bërë një studim dhe publikim zyrtar serioz të këtij dokumenti. Nëse jepen fondet e nevojshme, jemi të gatshëm për të bërë studimin e mëtejshëm dhe publikimin anastatik me ngjyra të të dyja kopjeve të këtij dokumenti me rëndësi.

Së dyti, nëse institucionet shtetërore zyrtare nuk merren me këtë problem, shoqëria civile në bashkëpunim me institucione arsimore, të mundohen që të gjejnë një kandidat për gradë shkencore dhe t'i ngarkohet kryerja e plotë e studimit të këtij dokumenti në këmbim të marrjes së gradës shkencore.

Së treti, ata që i referohen këtij dokumenti, t'i marrin në konsideratë të dhënat e këtij shkrimi për të mos rënë pre e gabimeve të kopjuesve dhe të publikuesve të tij.

Rëndësia e këtij dokumenti është shumë e madhe, prandaj u bëj thirrje institucioneve shtetërore që t'i japin rëndësinë që ka studimit të këtij dokumenti dhe të publikohet sa më i plotë.

Sereta **KOPERAJ**

## **REVOLTAT QYTETARE NË SHKODRËN E VITEVE '30 TË SHEKULLIT XIX**

Vitet '30 të shekullit XIX shënojnë një pikë kthese për Perandorinë Osmane. Në një kohë kur vendet e Europës Perëndimore, nëpërmjet revolucionit industrial dhe zbulimeve teknike po përparonin me hapa të shpejtë, në të njëjtënkohë Perandoria Osmane, e ngulfatur në mentalitetin e sundimit aziatik dhe e mbyllur për çdo risi në planin ekonomik, pombijetonte edhe në shekullin XIX vetëm në sajë të rivalitetit të papajtueshëm që kishin ndërmjet tyre Fuqitë e Mëdha për Çështjen e Madhe Lindore<sup>1</sup>. Në prag të riorganizimit të mbarë “Tanzimat-i Hayriye”, që synonte të arrinte modernizimin e shtetit dhe shoqërisë osmane, sundimi i sulltan Mahmudit II, në vitet '30, mundësoi Tanzimatit duke zgjeruarsferën e qeverisjes osmane përtej kufijve të saj tradicionalë. Në këtë mënyrë, në qeverisjen osmane u përfshi e drejta dhe detyra për të rregulluar të gjitha anët e jetës dhe për të ndryshuar konceptin e reformës osmane nga ai tradicional, që përpiquej të ruante institucionet e vjetra, në një koncept bashkëkohor të zëvendësimit të këtyre institucioneve më të reja, disa prej të cilave do të importoheshin nga Perëndimi. Përpjekjet për modernizim dhe për të mbajtur ende në këmbë Perandorinë, do të sillnin reagime të ndryshme në hapësirën e shtetit shumëkombësh osman. Në dekadën e tretë të këtij shekulli, kur Perandorisë në Ballkan, i ishte shkëputur Greqia dhe Serbia po fitonte autonominë, në territoret shqiptare rebelimet ishin bërë “dhimbja e kokës” për Portën e Lartë. Një ndër më të veçantët do të bënte në këtë periudhë pikërisht sanxhaku i Shkodrës, padyshim më i rëndësishmi në mbarë territoret shqiptare në këtë periudhë. Sipas statistikave zyrtare osmane të botuaranë “La Turqie” sanxhaku i Shkodrës me kazatë:

<sup>1</sup> G. Rizaj, *Shqipëria e Sipërme, 1800-1913, Prishtinë, 2011, f. 16.*

Shkodër, Tivar, Ulqin, Lezhë, Podgoricë, Shpuzë, Zadrimë, Durrës, Tiranë, kishte gjithsej 257 mijë banorë<sup>2</sup>, duke i siguruar shtetit osman të ardhura prej 15-16 milionë pjastrash, nga taksat ndaj banorëve, por më së shumti nga taksat doganore<sup>3</sup>. Në këto vite, kur Shkodra nuk ishte më nën drejtimin e Bushatlinjve, ajo administrohej nga pashallarë turq (*muhasëlli* që merrej me organizimin e administratës dhe të ushtrisë, si dhe me vjeljen e taksave). Duke iu referuar dokumentacionit të këtyre viteve, mjaft të trazuara, shihet se popullata e këtij sanxhaku, por më veçan, ajo e qytetit të Shkodrës me rrethinat e tij, ka përjetuar një dualizëm qeverisjeje, ashtu siç mbizotëronte edhe në vetë drejtimin e Perandorisë<sup>4</sup>. Ky dualizëm kishte filluar të lindte që me përpjekjet e para të sulltan Selimit III dhe u përforcuan më shumë në periudhën e sulltan Mahmudit II, të cilët u përpoqën të zbatonin mjaft reforma me karakter ushtarak dhe financiar e administrativ, që rezultuan në dobësimin e pushtetit krahinor të feudalëve të mëdhenj, por edhe vetë pashallarëve të provincave osmane. Kështu në këtë periudhë dallohen më qartë këto dy grupe që drejtonin perandorinë. Nga njëra anë, drejtuesit e mbështetur vetëm tek zgjidhjet përmes forcës së armëve, ku dallohet sidomos, Valiu i Rumelisë dhe shtresa e pashallarëve që drejtojnë sanxhakët (këtu mund të përfshihen edhe Ali Namik pashai dhe Hafëz pashai, qeverisja e të cilëve shkaktoi revolta dhe rebelim në qytetin e Shkodrës), ndërsa nga ana tjetër, drejtuesit që kërkojnë zbatimin e ligjit përmes respektimit të popullatës, duke iu shmangur sa më shumë përdorimit të armëve. Tek ky grup, mund të veçohet vetë Sulltan Mahmudi II, i cili qe dhe inisiatori kryesor për fillimin e modernizimit të asaj çfarë kishte mbetur nga Perandoria. Vetë Sulltani kishte kërkuar që reformat të shtriheshin fillimisht aty ku mundej, pa krijuar konflikte me popullatat që i qëndronin besnike traditave me të hershme osmane<sup>5</sup>.

<sup>2</sup> *Public Record Office-Foreign Office, London, 881, 3655 / M 04752, nr. 4, Mr. Layard to the Marquis of Salisbury, 11 June 1878-Inclosure extract from "La Turquie". Lidhur me këtë shih edhe B. Jezernik, Western Perceptions of Turkish Towns in the Balkans, në Urban History nr. 25/2 (1998), f. 216; I. Blumi, Reinstating the Ottomans: Alternative Balkan Modernities, 1800-1912. New York: Palgrave Macmillan, 2011, f. 32-41.*

<sup>3</sup> *J. G. von Hahn, Studime shqiptare, Vol. I, Tiranë, 2006, f. 148; Dumont, Paul – François, Georgeon. Villes ottomanes à la fin de l'Empire. Paris, L'Harmattan, 1992.*

<sup>4</sup> *I. Blumi, Reinstating the Ottomans: Alternative Balkan Modernities, 1800-1912. New York: Palgrave Macmillan, 2011, f. 68*

<sup>5</sup> *S. Shaw-E. Kural, Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne, Tiranë,*

Sanxhakun e Shkodrës, Ali Namik pashai, kërkonte që taksat e reja dhe marrjen e ushtarëve redifë, të merreshin qoftë edhe me forcë, duke ngjalluar kështu pakënaqësi tek shkodranët dhe banorët e malësive përreth, të cilët fillimisht i përgjigjen me mosbindje dhe më pas edhe reagojnë me armë. Përleshjet me armë mes banorëve dhe ushtarëve turq që mbrojnë kalanë e Shkodrës, nga e cila bombardojnë edhe qytetin, zgjat tre javë. Duke parë rebelimin e popullatës e cila drejtohej nga paria vendase, mytesarifi i Sanxhakut të Shkodrës Ali Namik Pashai, kërkon një ndërhyrje të fortë ushtarake, duke u përpjekur të justifikojë ashpërsinë e tij edhe me një lidhje të ngjarjeve në Shkodër me lëvizjet që bëheshin në Stamboll: “Me sa kemi dëgjuar ata (bejlerët vendas, shën. S. K. ), po bëjnë për vete një shumicë rrugaçësh dhe elementësh turbullues, duke përhapur parulla antiqeveritare, se në kryeqytet kanë plasur turbullira, se ata duhet të hedhin në dorë qysh taniqytetin, kështu që, kur të vijë pasha i tyre, ata të jenë të bashkuar. ... Prandaj, dënimidhe mposhtja e tyre është bërë detyrë e domosdoshme. Për këto arsye, kur të jenë grumbulluar ashtu siç duam ne forcat ushtarake me rrogë që kam mundur t’imbledh në Rumeli e në Toskëri, do të veprojmë ashtu siç duhet. Pa u ekzekutuar nja dy vetë nga këta dhe pa u internuar nja dy të tjerë, nuk do t’i dilej në krye punës”.<sup>6</sup>

Nga ana e saj Porta e Lartë, nuk e aprovon ndërhyrjen e ashpër ndaj popullsisë së Shkodrës. Iradeja perandorake lëshuar nga sulltani i kërkon që të përpiqet të gjejë tjetër rrugëzgjidhje përveç asaj të forcës. “... Iradeja perandorake është që t’i shkruhet atij një përgjigje siç e do puna, në të cilën thuhet se shqiptarët kanë një karakter të çuditshëm dhe se në Shkodër kanë ndodhur kaq herë turbullira. Prandaj, në rast se ju ngriheni dhe ekzekutoni njerëz të tillë si Halit beun, Sulejmanin dhe Jusufin, ka shumë mundësi që më vonë të lindë atje ndonjë turbullirë, e cila është e palejueshme në një gjendje të tillë. Të porositet për të qenë i vëmendshëm dhe i matur në veprimet e tij dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për një administrim të mirë të vendit”<sup>7</sup>. Synimi për të mos përdorur forcën ndaj popullatës vendase shihet qartë edhe në marrjen parasysh nga ana e sulltanit e një letre që paria e qytetit të Shkodrës i dërgon atij për të sqaruar shkaqet e revoltës tre javore në qytet, 2006, Vëll. II, f. 92

6 Hatt-i Hümayun Defteri nr. 1, 2, 12, vesika 21716, G, -Ali Namik, Fi 12 Zilkade 1248 Hixhri (2 maj 1833).

7 Hatt-i Hümayun Defteri nr. 1, 2, 12, vesika 21716, A. Fi 6 muharrem sene 1249 Hixhri (26 maj 1833).



shkaqe që lidheshin vetëm me një emër, me atë të Ali Namik pashait: “Mytesarif i Shkodrës, Ali Namik Pashai, meqë ka në natyrën e vet zullumet dhe dhunën, është bërë përkrahës i disa elementëve turbullues dhe ngatërrestarë. Për shkak të ftohtësisë që ka treguar ndaj popullit e për shkak të dhunimeve e të grabitjeve të të varfërve, qysh nga momenti që ka ardhur këtu, është prishur rregulli dhe disiplina. Ruajtja e rregullit është një shprehje e besnikërisë dhe e drejtësisë ndaj fesë dhe shtetit, por ai hoqi dorë krejtësisht nga ndihma dhe përkrahja që duhej t’i bënte popullsisë së malësisë të lartpërmendur. Të gjithë duruan zullumet, grabitjet, kapjet dhe burgosjet pa faj. Askush nuk ndërhyri.. por u përpoqëm të ruajmë rregullin dhe rendin e vendit. Përkundrazi u shfaqën zullumet dhe qëllimet e këqija të pashës së sipërshtënuar. Ditën e katërt të javës që kaloi, një jyzbash me mjaft vetë nga ushtarët e rregullt doli në treg, ku filloi pa asnjë shkak të marrë nëpër këmbë nderin dhe dinjitetin e banorëve, vrau disa myslimanë dhe mjaft të krishterë, u grabiti të hollat dhe plaçkat që kishin me vete, si dhe plaçkat e disa dyqaneve. Eli-Pazar (bëhet fjalë për tregtarët dhe njerëzit e tjerë që punonin në pazarin e Shkodrës, shën. im. ) u detyrua të mbrohet. Gjatë përlëshjes u flijuan dhe disa të tjerë. Meqenëse mbi qytet u qëllua me top, të gjithë banorët e qytetit braktisën tregun dhe ngritën krye në një aleancë të përgjithshme. Kështu lindi një revoltë e madhe e një grindje e pamasë nga e cila pati dëme dhe u krus nën peshën e tyre i gjithë populli i ndershëm dhe fukara si dhe shtresa e tregtarëve. ... Personi juaj myshirian, kur të mësojë gjendjen e pafuqishme të popullsisë së Shkodrës dhe të shikojë besnikërinë tonë, të ketë mirësinë të ndërhyjë për pushimin e pashës së lartpërmendur”<sup>8</sup>. Siç shihet dhe nga letra e cila është e firmosur jo vetëm nga bejlerë, tregtarë, por edhe përfaqësues fetarë, kërkohet drejtësi dhe dëmshpërblim edhe për banorët e krishterë, madje edhe për zonat e Malësisë së Mbishkodrës, duke e ndier si rrezik një afrim të mundshëm me malazezët: “.. Ashtu siç di bukëdhënësi ynë, populli i Shkodrës është në kufi me malazezët. Edhe shumica e popullësisë së malësive është e një kategorie dhe e një feje. Përveç kësaj është e qartë se ata janë të varfër. Në rast se ata nuk do të përkrahen e nuk do të ndihmohen nga Shkodra, është e qartë se ata do të bashkohen me malazezët”<sup>9</sup>.

Ndryshe nga sa mendohej, reformat dhe organizimi i ri i Perandorisë,

<sup>8</sup> AQSH, *Fondi Bushatllinjte*, D. Nr. 3, 1830, *Fletore 1*, fq. 3-4(dt. 14 gusht 1833).

<sup>9</sup> *Po aty*.



jo vetëm që nuk do të përkrahej nga banorët e këtyre zonave, por për ta do të ishte i rëndë nënshtrimi dhe bindja ndaj Perandorisë. Ata ruanin dëshirën për të fituar përsëri gjendjen e tyre të mëparshme. Këtë kishin filluar ta kuptonin mjaft mirë edhe në Stamboll<sup>10</sup>. Kryeveziri, Mehmet Reshit pasha, përpiket të mos e rëndojë përgjegjësinë e Ali Namik Pashës për kryengritjet e qytetarëve shkodranë. Është pikërisht ky kryeministër i cili ndau pushtetin civil nga ai ushtarak dhe që zëvendësoi qeveritarët vendas me ato turq. Por në raportin që i paraqet sulltanit, i duket i drejtë vendimi i këtij të fundit që ndërhyrja të mos bëhet e ashpër dhe me shumë forca. Po të kemi parasysh përgjigjen e sulltan Mahmudit II, i cili i kërkon kryevezirit të dërgohet një nëpunës për të hetuar mbi këtë çështje, për të mos vepruar me nxitim dhe për të mos shtuar pakënaqësitë tek popullata<sup>11</sup>, shihet qartë se Sulltani më shumë beson variantin e qytetarëve shkodranë. Në shtator të atij viti, Tajar beu, bën hetime mbi revoltën ndaj Ali Namik Pashait<sup>12</sup>, por në të njëjtën kohë përpiket të realizojë largimin e këtij të fundit dhe të krijojë qetësi dhe besim tek banorët e Shkodrës. Në relacionin e tij, në pozicionin e hetuesit, i ardhuri nga Stambolli, pranon seturbullirat dhe revoltën e madhe s'e kanë shkaktuar përpjekjet për të vendosur ligjin dhe rregullin, por "... vrasjet pa shkak, marrja nëpër këmbë e nderit dhe e dinjitetit dhe goditja e qytetit me top, përveç zullumeve e dhunës së shumtë të Ali Namik pashës, mytesarif i Shkodrës, veprime që bien në kundërshtim me pëlqimin e lartë e me urdhrin e madhërisë kurorëmbajtës". Por çfarë është për t'u theksuar është konstatimi se.. populli i Shkodrës prej kohësh është treguar i bindur ndaj shtetit të përjetshëm osman<sup>13</sup>. Përfaqësuesi i sulltanit, pas vendosjes së qetësisë në qytet dhe kthimit në normalitet të tregut dhe portit në Bunë, bën edhe dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga luftimet dhe bombardimet e bëra nga ushtria. "Kur ftohtësia dhe grindjet e popullsisë së Shkodrës me muhasëllin po përhapeshin me shpejtësi edhe në kazatë e tjera, mbërriti

10 *Hatt-i Hümayun Defteri nr. 1, 2, 12, vesika 21136, B. Fi 28 rebijylevvel sene 1249 Hixhri (15 gusht 1833), Mytesarifi Mehmet Emin Pashai ia dërgon kryevezirit.*

11 *Hatt-i Hümayun Defteri nr. 1, 2, 12, vesika 21624 (shtator 1833).*

12 *Në raportin kryeministrot pranohet që shkak i rebelimit ka qenë sjellja e Namik pashait "... nëpunësi i sipërpërmendur ka hetuar çështjen, këto veprime kanë të bëjnë personalisht, me të sipërpërkruarin (Ali Namik pashain, shën. S. K. ), prandaj, cilido nëpunës që do të emërohet, ata (shkodranët, shën. S. K. ) do t'i binden plotësisht.*

13 *AQSH, Fondi Bushatllinjte, D. nr. 3, v. 1830, Fletore 1(turqisht), f. 12, shtator 1833, dhe f. 27, janar 1834. (letra e Tajar beut).*

me respekt urdhëri i lartë me të cilin pushohej zotëria i lartpërmendur dhe kryengritja u eliminua plotësisht. Dëmshpërblimi i mallravitë grabitur në tregun e Shkodrës, kur ai ndodhej në duart e ushtarëve të zotërisë së sipërpërmendur, do të bëhej nga arka e muhasëllëkut. .... bile një e treta u pagua nga ana e të përlurur tuaj. U gjend mënyra e larjes së llogarisë me popullin<sup>14</sup>. Nga ana e tij vetë sulltani, në bazë të propozimit të muhasëllit të Shkodrës (tani Tajar beut) i fal dënimin 15 shkodranëve të internuar në Selanik, të cilët kishin qenë dënuar për pjesëmarjen në qëndresën e Mustafa pashë Bushatit, më 1831<sup>15</sup>, duke treguar një qëndrim më tolerant ndaj popullatës së Shkodrës dhe i gatshëm të ndalë abuzimin e vartësve të vet, një qëndrim më ndryshe që nuk e ndeshim në dokumentet e tjera që lidhen me kryengritjet në territoret e tjera shqiptare. Një qëndrim të ngjashëm ai do të mbajë edhe më 1835, ku duket se historia përsëritet brenda një periudhe dyvjeçare. Siç do të shihet, rasti i Ali Namik pashës nuk është i veçantë, sepse pas një periudhe gati një vjeçare qetësie nën drejtimin e Tajar beut, i ardhur si kajmekam, një tjetër drejtues i sanxhakut të Shkodrës, Hafëz pasha, me drejtimin e tij të ashpër, kryesisht në vjeljen e taksave dhe të alokimit të forcave ushtarake në disa shtëpi të qytetit, do të shkaktonte sërish një trazirë dhe revoltë edhe më të madhe në Shkodër e fshatrat rreth saj. Popullsia duke mos pranuar pagesën e taksave dhe duke kërkuar rikthimin e disa të drejtave të humbura nga reformat e reja, bëri një rezistencë të vendosur me armë, rezistencë që do të zgjaste tre muaj dhe që do të alarmonte e vinte në lëvizje pjesën më të madhe të trupave ushtarake në pjesën evropiane të Perandorisë<sup>16</sup>. Për revoltën e Shkodrës të vitit 1835<sup>17</sup>, u desh të ndërhynte flota ushtarake që u nis nga Stambolli drejt Bunës, për të shuar rebelimin. Edhe në raport me këtë

14 *Po aty*.

15 *Hatt-i Hümayun Defteri nr. 24, vesika 51792, Adhe Hatt-i Hümayun Defteri nr. 31, vesika 51671, A. Fi 19 Xhemazijelaha sene 1250 Hixhri (23 tetor 1834), letër e kryeministrit drejtuar pallatit sulltanor dhe përgjigjia e sekretarit të pallatit.*

16 *Hatt-i Hümayun Defteri nr. 12, vesika 21255, C, dhe Hatt-i Hümayun Defteri nr. 1, 2, vesika 21456, C, Fi 27 Muharrem sene 1250 Hixhri (25 maj 1835). Letër e Sulejman beut, Zaimit të sanxhakut të Elbasanit, dhe e Hafëz pashës drejtuar valiut të Rumelisë.*

17 *Më hollësisht për kryengritjen e Shkodrës së vitit 1835 shih P. Thëngjilli, "Kryengritja e Shkodrës e vitit 1835", në Studime historike, 1975, nr. 4, fq. 97-117(bashkë me literaturën e dokumentacionin arkivor); Z. Shkodra, Shqipëria në kohën e Tanzimatit, Tiranë 1959, f. 31-122, L. Mile, Kryengritjet popullore në fillim të Rilindjes sonë(1830-1877), Tiranë, 1962, f. 79-101.*

rebelim kemi një qendrim të dyanshëm të Portës së Lartë. Nga njëra anë, shtypje me dhunë, që përfaqsohej kryesisht nga Valiu i Rumelisë, i cili në shkresat e tij drejtuar Kryevezirit dhe vezirit të Luftës, dhe seraskerit të Selanikut, i kërkon mbledhjen e sa më shumë ushtarëve dhe dërgimine tyre drejt Shkodrës. “.. Ata kanë ngritur krye dhe kanë rrokur armët qysh prej fillimit të turbullirave e deri tani, janë të gjithë banorët e qytetit të Shkodrës, të fshatrave përreth, të rinj e pleq, turma malësorësh dhe fundërrinat e rajave të kapedanllëkut të Mirditës. Me sa thonë, numri i kësaj turme të mallkuar herë arrin në pesëmbëdhjetë mijë e herë i kalon. Nuk kanë udhëheqës të njohur dhe me emër. Frenat e drejtimit i kanë në dorë haxhinjtë e hoxhallarët e vetë Shkodrës”<sup>18</sup>. Valiu i Rumelisë, kërkon një ndërhyrje të ashpër, organizimin e një force të madhe ushtarake që do të shuante një herë e mirë kryengritjen, si dhe do të eliminonte madje edhe krerët e saj “të padukshëm”....”Myteselimët e Gjakovës dhe Pejës, Sejfedin dhe Arsllan pasha, Mahmut pashë Prizreni, Myteselimi i Dibrës, Haki pasha, Haxhi pashë Mati, myteselimëte Tiranës e të Peqinit, Abdurrahman beu e Nuri beu, myteselimi i Lezhës, Sinan beu, Ibrahim bej Kavaja, myteselimi i Elbasanit, Dalip beu, e të tjerë, farefis e miq të tyre, të cilët ndodhen në vende që janë nën administrimin e Hafëz pashës, në dukje tregohen fisnikë, por nga brenda janë të pabesë, që me zemër u kanë ndihmuar rebelëve të sipërpërmendur”<sup>19</sup>. Edhe në këtë rast, situata paraqitet me qëndrime të dyanshme. Vetë oficerët turq të ushtrisë perandorake i kërkojnë vetë Mehmet Reshit pashait (kryevezirit) që të mos ndërhyhet me forcë. Në një letër të nënshkruar nga 24 oficerë, shkruhet se për revoltën e shkodranëve “... shkak kanë qenë zullumet e kryera prej robit tuaj, Hafëz pashës. Që prej kaq kohësh banorët e sipërpërshkruarkanë qenë si një trup i vetëm me ushtrinë perandorake. Të dy palët kanë qenë të lidhur ngusht, kanë shkuar mirë edhe nuk e kanë prekur njëri-tjetrin. Prandaj kjo që ndodhi tani është dhuratë e fatit. Për t’i dhënë fund me mënyra paqësore, ashtu siç është dhe urdhri i lartë... ata (banorët) ankohen vetëm prej valiut të qytetit”<sup>20</sup>. Vetë sulltan Mahmudi II, i cili kërkon sërish një zgjidhje paqësore me popullatën qytetare, hoqi nga detyra Hafëz pashën dhe emëroi Hasan pashë Tërhallën, i cili krijoi

18 Po aty.

19 Hatt-i Hümayun Defteri nr. 1-2, vesika 21699, G, Fi 20 rebijylahar sene 1251 Hixhri (15 gusht 1835), Letër e Valiut të Rumelisë, drejtuar Kryevezirit.

20 Hatt-i Hümayun Defteri nr. 1-2, vesika 21698, A, Fi 21 rebijylahar sene 1251 Hixhri (16 gusht 1835), Letër e Valiut të Rumelisë, drejtuar Kryevezirit.

një këshill për qeverisjen e qytetit prej 12 anëtarësh, të gjithë vendas dhe që u përkitnin të dy besimeve. Megjithëse disa autorë shprehin mendimin se ky qëndrim i sulltanitka ardhur si rezultat presionit të lëvizjes kryengritëse<sup>21</sup>, nuk mund të mohohet edhe një lloj interesi që vetë ai kishte për këtë zonë, pasi nuk mund të shpjegohet ndërhyrjet e ashpra represive dhe dënimet e pashembullta ndaj kryengritjeve të tjera të shqiptarëve në Jug(kryengritja e Tafil Buzit, që i takon kësaj periudhe), apo dhe në zona të tjera të Ballkanit<sup>22</sup>. Megjithatë, duhet thënë, duke pasur parasysh edhe relacionet e Tajar beut, oficerëve të ushtrisë perandorake, letrat dërguar nga populli i Shkodrës Portës së Lartë(të cituara në artikull), se rezistenca dhe rebelimi i popullatës vendase nuk bëhej për kërkesa kombëtare dhe të drejta jashtë kornizës perandorake.

Marrja në shqyrtim e një periudhe të tillë ndihmon jo vetëm në hedhjen dritë të situatës që përjetonin territoret shqiptare, por edhe kontradiktat që shoqëronin përpjekjen për modernizim të Perandorisë<sup>23</sup>. Këto qëndrime shpjegohen me vetë drejtimin që u përpoq Sulltan Mahmudi II t'i jepte perandorisë. Ai kishte kuptuar se reformat që të ishin të suksesshme duhej të mbulonin të gjithë nivelet e institucionevedhe të shoqërisë osmane e jo vetëm disa elemente të ushtrisë. E vetmja mënyrë që institucionet e reformuara të mund të vepronin ishte shkatërrimii të vjetrave që do të zëvendësoheshin, në mënyrë që këto të fundit të mos sabotonin punën e parave, si dhe reformat duhej të planifikoheshin në mënyrë të kujdesshme dhe për to duhej të sigurohej mbështetje e duhur përpara se të viheshin në jetë<sup>24</sup>.

21 P. Thëngjilli, *Kryengritja e Shkodrës e vitit 1835, në Studime historike, 1975, nr. 4, fq. 115*

22 L. Stavrianos, *The Balkan Since 1453, New York, 1958, f. 123.*


23 S. Shaw-E. Kural, *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne, Tiranë, 2006, Vëll. II, f. 91*

24 *Po aty, f. 27.*

**OTTO VON GERNSTNER**

**“ALBANIEN”** (Historia e shqiptarëve)

*Përktheu Gjergj J. Kola*



(vijon nga numri i kaluem)

... Pjesa perëndimore e Shqipnisë tue kenë afër Romës e larg Bizantit, ishte natyrisht katolike romane. Mandej në lindje të vendit njerzit janë herë katolikë romanë e herë ortodoksë, simbas vetë influencës së Romës e të Bizantit.

Kështu na mundena me gjetë edhe sot në Jug dhe në Juglindje të vendit komunitete ortodokse. E tanë treva nga ana lindore e Drinit dhe nga ana lindore e Malit të Zi, Manastiri, Dibra, Prizreni, Gjakova, Ipeku, Amsfeldi dhe Sanxhaku – pra pjesa e mbretnisë së vjetër serbe – banoen kryesisht nga shqiptarët muhamedanë, të cilët përveç shqipes

flasin edhe serbishten. Shqiptarët e lindjes kishin mësue me bashkjetue me bullgarët Uskokë (dezertore) që para pushtimit osman e ma vonë edhe me serbët në qytetet e naltpërmenduna.

Mbas betejës së Amsfeldit - Fushë Kosovës gjendja e serbeve në Raszien, Ipek dhe Gjakove ishte ba e padurueshme: osmanet i përndiqnin ata nga Lindja, shqiptarët depërtuen përherë e ma shumë në shekujt 16 e 17 prej Perëndimit dhe Jugut e kështu nga kjo situatë ndodhi që në vitin 1693, 36. 000 familje serbe braktisen vendin dhe emigruen në Hungari, ku edhe u pritën krahaptë, se ishte koha e sulmeve turke.

Vetëm disa gjurmë mjaft të vogla familjesh serbe nga mbretëria e dikurshme e Dushanit mund të gjinden e ata kanë mbetë ende sot në qytetet e mëdha si Prizren, Gjakovë, Ipek dhe Mitrovice, si dhe në Sanxhak Novi Pazar. Si simbol i fundit i mbretërisë serbe mbeti Patriarkana e Deçanit (afër Ipekut).

Deri në pushtimin e Ipekut nga serbët në nandor 1912 Patriarkana e serbëve ishte krejt e izolueme, sepse të shtymë nga urrejtja fanatike, arnautët muhamedanë të zonave të Ipekut, Gjakovës dhe Gusinjes, ju ndaluen serbëve me shkelë këto vende, të cilat edhe nga ana kartografike mbetën të panjoftuna.

Nëse këto arnautë shqiptarë dijnë më folë edhe serbisht e disa ndoshta mund të jenë edhe me prejardhje serbe, prapëseprapë nuk asht e saktë me folë për „serbë shqiptarë“. Shqiptari ndjehet si zotni dhe shef me përçmim ndaj serbit, të cilit i lejon një prani të kushtëzuar afër tij.

Mbas emigrimit të serbëve ortodoksë nga fundi i shek. 15 prej Ipekut dhe rrethinave do kishte qenë ma e afërt për shqiptarët e atyshëm me marrë besimin katolik, sesa të konvertohen në besimin e armiqve të tyre kryesor: turqve.

Megjithatë në kohën e – përndjekjes Bogumile – kisha katolike në vendet e Ballkanit po viente shumë, kështu që në Bosnjë dhe në Lindje të Shqipnisë mësimit e Kuranit të përhapuna nga dervishet gjetën shumë pasues.

Mbas ikjes së komunave serbe, ata pak serbë që mbetën dhe shumë shqiptarë, në vend që të përqafohin katolicizmin, të gjithë sëbashku zgjodhën konvertimin në islam. Megjithatë duhet thanë se politikisht ky konvertim nuk luejti ndonji rol të madh sepse muhamedanët shqiptarë vazhduen me i pa si armiq pushtuesit turq, ndërsa ndaj katolikëve shqiptarë ishin krejt miqësorë.

Pjesa perëndimore e Shqipnisë, ku mund të përmbledhim malësorët

në jug të Malit të Zi, Mirditën dhe katër fiset në Jug të saj, të cilët ishin nën influencën shpirtnore të Romës, ka mbetë gjithnjë katolike e patundun dhe asht sot e kësaj dite një kështjellë e patundun e katolicizmit. Vetëm në qytetet bregdetare, si atë të Shkodrës dhe në qytetet e Epirit asht një pjesë e madhe muhamedane.

Megjithatë duhet theksue, se si muhamedanët ashtu edhe katolikët, të cilët varen në besimet e tyre me një qëndrim dhe bindje si prej populli pagan, asnjherë nuk e perdorën fenë për gjakmarrje, siç ishte zakon nëpërmjet fiseve. Islami nuk ja ka dalë kurrë me krijue një humnerë në mes të katolikëve dhe muhamedanëve shqiptarë, porse na gjejmë në malet shqiptare zakone tradicionale që i lidhin të dyja besimet.

Kjo e vërtetë e madhe asht për „Protektoratin e kultit austriak ndaj katolikeve shqiptarë“ shumë e randsishme. Muhamedanët shqiptarë tue mos pa te besimi i katolikeve shqiptarë kurgja të keqe, nuk kishin asnjë motiv që me e pa edhe protektoratin tonë me armiqësi, porse ata kishin për emnin e Austrisë të njëjtin respekt si katolikët shqiptarë.

Vetëm Xhonturqit, të cilët u çfaqën në Europe nën moton „Bashkim dhe Përparim“ me sloganin „Panottomanismus“, në kërkim të një shteti unik utopik turk, ja mohuen të drejtën për me egzistue çdo kombi jo-turk dhe besimi i krishterë, madje edhe latinishtja u shpallën të jashtligjshme. Ata, -xhonturqit- mbollën urrejtjen mesjetare të besimit gja që i ndau shqiptarët katolikë dhe muslimanë në dy kampe.

Që kjo manovër e xhonturqve ishte drejtue kundra „Protektoratit të kultit austriak ndaj katolikëve“ asht krejt e dukshme. Sigurisht një mosmirënjohje e palezetshme për miqësinë e nxitueme te politikës Aehrenthale që ju hodhë në krahë xhonturqve, këtyne shkatërruesve të kulturës.

Fillimet e Protektoratit asutriak ndaj katolikëve në Shqipni datojnë vitin 1642, me paqen e Szönyt. Ma vonë në nënshkrimet e paqes në mes të Austrisë dhe Turqisë në Karlovitz 1699, Passorovic 1718 dhe Beograd 1739 u riejtën të paprekuna. Artikulli 9 i Traktatit të Paqes në Beograd thotë:

„Të gjitha privilegjet që gëzojnë ndjekësit e kishës katolike – romake në vendet e perandorise osmane, në lidhje me ushtrimin e besimit, të nëshkrueme nga sulltanët osmanë, gjatë kapitullimeve të hërshme me akte perandorake, qofshin këto para apo mbas paqes së Passorovicit, u rinovuen sërish këtu prej sulltanit të osmanëve. Mbi të tana këto privilegje kanë të bajnë me të drejtën e Perandorit të Perandorisë romako-gjermane mbi meshtarët e urdhënit të shejtes Trini dhe lirimin



e të burgosunve si dhe lejen e ndërtimit të kishave e të ushtrimit të lirë të meshtarisë. Askush nuk guxon me i shtypë apo përzënë, qofshin të këtij urdhëni apo të urdheneve të tjerë të kishës katolike: te tanë duhet me ju gëzue mbrojtjes së perandorit. Gjithashtu i lejohet ambasadorit të perandorisë romako-gjermane me marrë në mbrojtje të tanë katolikët e kishat e tyne në tokën e shejtë dhe me ndërhye për to në mënyrë të kujdesshme te Porta e Naltë. “

Në fakt proteksione të tilla të besimit shpesh keqpërdoren për qëllime politike. Austria ban përjashtim në kët mes e askush nuk mund ta akuzojë atë për diçka të tillë- përkundrazi! Austria nuk ka dashtë asnjherë që nga këto protektorate fetare me krijue favore ekonomike e politike. Austrisë i ka mjaftue, në mënyrë vetmohuese, nisë nga të drejtat e saja mbi Shqipninë me ba një punë ma shumë në lamin e kulturës – frutet e së cilës kanë me i marrë të tjerët.

Austria ka ndërtue në Shqipni kisha katolike të pastërta, ju ka dhanë priftave një formim dhe edukim në mënyrë që ata të mundën me ju dhanë fëmijëve mësim në famullitë e tyne, e fundja na kena ndërtue në qytetet e mëdha shkolla e spitale e kështu protektoratin tonë e kena ushtrue vetëm në aspektin etnik.

Pa pasë qëllime politike na arritëm me fitue mjaft simpati në Shqipni, e emni i Perandorit të Austrisë dhe trashëgimtarit të tij njihej prej çdo shqiptari, e ky emën festohej me 18 gusht nëçdo famulli.

Kështu pra në Shqipni kanë dijtë ma shumë për Austrinë sesa kena dijtë na mbi gjendjen dhe randsinë e këtij vendi për ne.

Indiferenca që ka përfshi shtresa të gjana e deri te parlamentarët tonë mbi kët pjesë kaq vitale siç asht Ballkani, asht karakteristike tipike e një papërgjegjësi për me mbrojtë interesat e vendit. Porse duhet thanë se kjo indiferencë nuk ka lind sot se ajo i ka rranjët në qindra vjet të shkueme. Si në një hipnozë të pashpjegueme asht drejtue shikimi jonë nga Veriu e nga Perëndimi; në Spanjë, Hollandë, në Rein e në ultësinat e lumit Po u luftue për të ardhmen e Austrisë - pa sukses, sepse këto territore ndodheshin jashtëlinjave gjeografike e matanë kufijve natyrorë. Në lidhje me Juglindjen, për Ballkanin e afërt, në të cilin shteti i Danubit si nga ana gjeografike ashtu edhe ekonomike e politike asht i predestinuem, burrat e shtetit tonë patën shumë pak intuitë e kuptim.

Në të kundërt me burrat e shtetit, ishin gjithnji gjeneralët e ushtrisëaustriake ata që mbrojtën mendimin për me zotnue Ballkanit një herë e mirë.



Jo vetëm Princi i Badenit kishte një ide të tillë. Princat Eugjen e Laudon e njohën mirë vlerën e vendeve të Ballkanit për Austrinë e ata e çuen shqipojën dykrenare nga fitorja në fitore, në Bosnjë, Shqipni, Serbi e në Vllehi. Përpara tyne deshti edhe Wallensteinini me e çue Flamurin e Habsburgerve mbi bedenat e Konstandinopulit. Në historinë e Wallensteinit të Hallwich lexojmë<sup>1</sup>:

„Ishte qëllimi kryesor i Wallensteinit, përsa kohë ai komandonte ushtrinë perandorake, që mbas mbarimit të luftës gjermane, me bashkue tana armët e ushtrive të krishtena e sëbashku me u nisë në luftë kundra Turqisë. Kjo luftë do të niste nga ARBNIA“<sup>2</sup>.

Me 20 shtator 1627 i kujton gjenerali- prijës, këshilltarit ushtarak Questenberger mbi një kuvendim që kanë pasë bashkë në gusht ku kanë folë haptazi se në bisedimet në mes të Perandorit e Portës të naltë nuk asht ba fjalë për paqe, porse vetëm për një armëpushim.

„Pra këtu në perandori, tha Wallensteinini, Perandori duhet me rrujtë paqen e me përgatitë popullin kundra turqve. “

Ai i shkruen vetë Perandorit ku i lutet me ja ndi fjalën të plotë Questenbergerit sidomos në raport me paqen: “Kështu Ju Madhëri, e keni vetë në dorë me i dënue ata që ju kundërshtojnë në rrugën Tuej... e njilloj si mund të pastroni humorin e keq prej perandorisë, ashtu edhe mundeni me drejtue një luftë kundra turqve e me pasë përfitime të mëdha etj. “

Të huejt e padisiplinë e t'parregullt, Wallensteinini i akuzon me (27 shkurt 1628) se janë tue pengue paqen „ e për faj të tyne nuk mundet me e transferue luftën kundra turqve“. Plot shpresë lajmërohet ai disa ditë ma vonë e thotë se „ Prej Madhërisë së Tij kam marrë lejen me vendosëpaqen, të cilën shpresoj ta arrij... e me një fund të mirë, kështuqë asgja nuk më pengon me e kthye tanë ushtrinë kundra turqve“.

Vetëm një shqetësim të përhershëm ka ai me vete të cilën e shpreh kështu:

„Une e njof natyrën e suedezëve e nëse na e transferojmë tanë ushtrinë kundra turqve asht gjithnji rreziku që ata me na luejtë një lojë të keqe mbas krahëve. “ (Dy vjet ma vonë ky shqetësim u ba realitet)

<sup>1</sup> *Pesë librat e historisë së Wallensteinit në tre Libra. Nga këshilltari shtetmuer Dr. H. Hallxich, Vjenë.*

<sup>2</sup> *Meqë emërtimi Shqipnia del për herë të parë nga shek. i 18-të, mendoj se duhet përdorë emërtimi i saktë juridik ARBNIA kur bahet fjalë për një periudhë të tillë. Ashtu siç nuk përdorim emërtimin Arbni për trojet ilire, ashtu nuk mundena me përdorë termin Shqipni e shqiptar për trojet e Arbnisë dhe arbnorë. Shën. i përkthyesit.*

Me t'u gradue „Gjeneral i Përgjithshëm“ e „Gjeneral i oqeanëve e i Detit Baltik“ Wallenstini lajmëron Arnimin (me 18 Prill 1628) ku i thotë se ai i ka propozuar Perandorit me gradue katër gjeneralë të rinj, e Perandori nuk e ka kundërshtuar vetëm se ka çfaqë dëshirën me pritë kur të nisnin IMPRESA e Lindjes.

Në maj të 1682 u bë një takim në Pragë ku ndodhej oborri perandorak, e në praninë e perandorit ishin Wallensteini e gjenerali kolonel Collalto, Pappenheim e thajse të tanë ministri, të cilët ishin mbledhë mbase paqes së vendosur me Gjermaninë të gatshëm me hapë luftën kundër Turkut.

„Po aq sa unë dëshiroj me u bë i shejtë, thekson Wallensteini, aq e kam dashurë paqen me gjermanët sepse vetëm kështu mund ta drejtoj ushtrinë kundër turqve e për këtë i kam lajmëruar e bë për veditë të tanë, nisë nga Papa i Romës, Perandori e të tanë ministri perandorakë“.

(Në shkurt të po këtij vjeti, një i dërguar i Papës së Romës e kishte nderuar me një letër nga Papa gjeneralin e perandorise për „devotshmeninë e tij“)

Si përgjigje e këtij nderimi nga Roma Wallensteini përgjigjet: „E dhashtë Zoti e të bëjmë paqen këtu, në mënyrë që ti hidhena turkut në fytyrë!“

Paqja me Danimarkën po shtyhej krejtësisht kot e pa u mbyllë mirë tratativat e saj, po hapë një luftë e re në frontin Mantovian, të cilën Wallensteini u përpoq me tana mënyrat me e mbyllë. Në prill 1629 ai kujdes me marrë edhe Tillyn në rrethin e besnikëve të idesë së tij.

„Mbase kuvendimeve të gjata kam bë një propozim Tillyt për luftë kundër turkut“, shkruar Wallenstein, Collaltos.

E si të asht përgjigje gjenerali i lidhjes Tilly mbi këtë ide?

“Ai u hodhë përjetë e tue folë me kambë e duar më tha se kjo asht një Impresa e shejtë, e lehtë, e nevojshme dhe e lavdishme. Unë i thashë se rreth një vjetit mundena me u bë gati dhe ai më aprovoi menjherë”.

Sa më shpejt të bahet paqe në Itali, aq më shpejt, madje në këtë vjet mund të nisim luftën për lirinë e ARBENISË E MAQEDONISË.

Me padurim e priti Wallensteini ardhjen e të dërguarit spanjoll, që do ta përfshinte gjeneralin Octavio Sforza, në vendosjen e paqes e zgjidhjen e krizës mantoviane.

Gjenerali Wallenstein e mbyllë letrën e tij dërguar kontit Sforca me këto fjalë lapidare:

“Ndoshta takohemi bashkë diku në ARBNINË E LIRUEME”.

(vijon)

Gëzim JUKA

## NJË KUJTESË HISTORIKE NGA SHKODRA E PERIU DHËS SË PRINC WIEDIT



Princi Wilhelm Wied, Mbret i Shqipërisë. (Duhet të theksohet që Wiedi ishte Princ në Gjermani ndërsa në Shqipëri ishte Mbreti. Kjo, sepse përdoret nëkomunikim vetëm Princ). Mbret do vendosej juridikisht pas mbledhjes së Asamblesë Kombëtare e cila nuk u realizua për shkak të rebelimit të Shqipërisë së Mesme dhe fillimit të Luftës së Parë Botërore.

Përfundimisht u vendos që Fronin e Shqipërisë ta ketë Princ Wiedi. Për këtë do të ngrihej Komisioni i cili do shkonte për të bërë ftesën. Nga Shkodra pas shumë përpjekjesh u caktuan të shkojnë përfaqësues Ndoc Çoba dhe Pashko Kakarriqi.

Këtë e jep gazeta “Taraboshi” e datës 7-8 shkurtit 1914 me titullin:

*T’nisunit e Deleatëve*

*Sot n’nade n’mjes t’nji gzimit t’madh t’popullit jan nise për Durrës dy Deleatët, Zotnii Ndoc Coba e Pashko Kakarriqi, prejë Durrsit kan me u nisë me shokë t’jerë për në Berlin e prejë Berlinit për Potsdam.*

*Nense ishte heret shum ndjeri ish mbledhë për me percjedhë ulltaret derin’ Doganë e me popull ishte daulla e cila merrte kangë komtare n’mjes t’brohorisë s’pergjithshme.*

Ndërsa me 24 shkurt, kryetari i Bashkisë Shkodër që në atë periudhë quhej Kryetari i Katundarisë ka marrë telegramin që publikon gazeta “Taraboshi” e 23-24 shkurtit 1914

*Kryepari i Katundarisë Zot. Muharrem begu :Perlimtares Shkoder Sot patem nderen të dukemi përpara Lartemadhnisë së Tij, Mbretit thonë e me gëzim julajmeroj se e pranoj Thronin e dhe Kunoren e Shqypnisë.*

*Gjeneral Esat Toptani.*

Në Shkodër përfundimisht u arrit të pranohej ardhja e Princ Wiedit. Edhe gazetata që nuk e kishin përkrahur u pozicionuan për po.

Delegacionet që do të shkojnë në Durrës arrinin të gjenin të përbashkëtat. Interesant është fakti që shkodranët së bashku me pëlqimin e Princit, filluan edhe përpjekjet që Shkodra të ishte Kryeqendra e Shqipërisë.

Dy ditë përpara se Princi të arrinte edhe gazeta që botohej në Vlorë “Përlindje e Shqipërisë” nënr. 19 viti 1914 njoftonte “.. që me 5 Mars u mbajt në Shkodër një miting me thirrjen që Shkodra të jetë Kryeqytet. Komisioni nënshkrues janë: Emz. Jak Serreqi, Arqipeshkv; Emzot Primo Doçi Abat i Mirdites; Adem Efendi Myftia, Xhemal Efendi Kadiu, Muharrem Beg Gjylbegu, Kryetar i Katundarise, Emzot Bumçi, Ipeshkv i Kallmetit; Bajram Beg Curri, Nikoll Ivanaj, Ibrahim Gjyrezi, Kol Xhuxha, Rifat Beg Kopluku, Luigj Muzhani, Agostin Shiroka, Karlo Suma, Maliq Beg Bushati, Risto Siliqi.”

— 36 —

Lartestii!

Masi qì L. e Jote nuk pat mundjen, prej anghashticës s' kohës, me na ndigjine si ç' i lypme nderren L. s' Ate me ndermjetsii t' zot. Gastoldit, si Delegatit e Shkoders qì jemi, po marrim lëjen me i shkruie L. s' Ate çka máa poshtë.

Gjyteti i Shkoders, qandrra nder máa t' ndihajat e máa t' vjefshmet gjytete t' Shqypniis, shifet, nensë n' nevojs t' përteshme, e lánun máa Durrsit. Si ç' mnejte me u parapa, kjo rasë kaa njallë ankim e t' lkundun n' popull t' gjytetit, i cili lerg ç' do mëndimit qì me i urdhnuie vallndetin e vet Mretit, mas t' cilit nget me s'fy myllë e plot me besë e divoçmii, shifet i rrëjtun ndër máa t' dashtunat shpresë t' vetat, e i perkitun n' nderë t' madhniis s' vet, paa i kuptue arsyanat qì kan muajt me shkakuie t' marrunin e kasjë masë.

Shkodra, gjyteti prej t' cilit kaa datë shkëndis e parë e t' marrunin t' ubaas komtare; gjyteti i cili bashkë me Malcina t' veta qì kaa per rreth kaa dhaos provë t' ndritshme atdhetariet, qì kaa paraqitë shpiirt kundërshtar sidomos n' t' srramen herë, tuj i gjindue me burra t' posagme per shtat muaj nji rrethimit t' rrebët qì shtyni gjytetasit e vobekit me u fashye bariashat e qì á kënë n' jofitë zyrtariet nen sundim Osmanlii kryegjyteti i krahnis s' Shqypniis me kënë sot i lánun mas Durrsit e Tiranat áshit punë qì paa dyshim s' mund t' i pelqejn gjytetasve t' Shkoders, tuj kënë qì mandej Shkodra, sikurse e diin e e vertetojn Shqypnarët marë, kaa t' tana sëndet e nevojshme per kryegjytet t' Shqypniis si kah historia, si kah v' gjindunin e vet prej naturis e edhë si kah çashtja ekonomike.

Praa, njoftun, çka vueme deri ktë, na t' menashkruemit n' emen t' popullit t' Shkoders, i sillna me prëjtii L. s' Ate per me u lutë qì t' donë m' marrë n' kujdes t' lypun gjytetin qì kemi nderen me e paraqitë, tuj maji L. e Jote para s'fysah zhvëdhimin gjytetmner qì kaa muajt me marrë deri ktë kaa pasë mundjen, po s'j, máa fort se kurr nji gjytet tjetër áshit perqejkë n' punim t' gjuhës komtare tuj marrit me i dhaos at s' rritun e at stollit n' v' cilat sot Shqypnarët perbinden. Mandej aj mund t' levdohet per shum popull t' vet qì kaa báa kundimet e veta kah përdimi e qì s' srramit áshit ditue gjithmonë kundërshtar i ç' do qedhimit o s'dhit zotnisia i cili mjerisht n' t'jera vënde t' Shqypniis sundon edhë me rrajs t' forta n' dhunë t' nderës komtare t' onen.

Me shpresë se L. e J. kaa me dashtë me marrë n' kujdes t' dashtun prujn lutje t' onen qì kemi nderen me i paraqitë L. s' Ate t' ndjennet e máa t' madhes e t' vertetes divoçmii t' onen.

T' Lartestis s' Ate

Lejpsig, 24 Fruer 1914

Sherbtorë t' prajtsë

Ndoc Çoba — Pashko Kakarriqi.

*Letra e delegatëve të Shkodrës Ndoc Çoba dhe Pashko Kakarriqi ku i kërkojnë Princ Wiedit që Shkodra të jetë Kryeqytet.*

Gazeta “Taraboshi” i Uron me 7 Mars Mirëseardhjen:

MBRETIT

*Nuk e kee gjakun t'onë, nuk e kee gjuhën t'onë, jo istoriin, jo zakonet e Shqypniis, por Ti jee Mbreti i jonë, Ti, tuj vue kamen n'tokët'onë po bahesh babë e vllaa, msues e mik i sejcilit nesh.*

*Populli i Shqypniis tuej t'dhanë buken e krypen t'bahet dorxanë për bashkpunimin besnik n'fjalë t'besës mi ket fjalë nderet n' t' cilën perbindet marë bota e qì kurr nji popull i tokës nuk mund t'a kenë lavdin e saj.*

*Atdheja e ree e jotja e lirr e veturdhnuese po t' uron mire se kjosh i ardhun me shpresë e besë qì Ti ke me baa t'madhe, t'dashtun e t'drashtun.*



*Delegacioni i shqiptarëve në ceremoninë e ftesës së Princ Wiedit.*

Delegacionet nga Shkodra që u nisen me radhë për të uruar mirëseardhjen Princ Wiedit na japin sot me kuptuar se kush janë përfaqësuesit konkret në atë periudhë.

Më datën 7 Mars janë paraqitur në Durrës: Kryesunduesi i qytetit Koloneli Filipi. Kryepari i Katundarisë zotnija Muharrem Beg Gjylbegu e zotnija Riza Begu (Kopliku) si dhe nga një oficer për secilën pjesë ushtarake ndërkombëtare që ishte në Shkodër.

Me 14 Mars 1914 delegacioni i klerit katolik të Shqipërisë së Veriut u paraqit në Durrës tek Princ Wiedi në emër të popullsisë së Veriut.

Delegacioni përbëhej nga : Imzot Jak Serreqi, Kryipeshkëv i Shkodrës me sekretarin e tij Don Ernesto Kocin, Imzot Luigj Bumçi, Peshkop i Lezhës me Don Gjergj Haberin, famullitar i Kallmetit, Imzot Primo Doçi, Kryeabat i Mirditës me Don Domeniko Kolecin, famullitar i Planit, Imzot Benardin Shllaku, Peshkop i Pultit, me P. Tomaso Gjeksi, famullitar i Planit, Don Ndoc Sheldija, famullitar i Lacit dhe Don Jak Bushati, famullitar i Blinishtit të dy këto si përfaqësues të Peshkopit të Sapës që mungonte. Imzot Xhiovani Bushati, famullitar i Shkodrës, P. Xhiovani Batisti della Pietra, Rektor i Kolegjit të Jezuitve me P. Basharin, Pater Domeniko Farcin, komisarine përgjithshëm të françeskanëve me Pater Gjergj Fishtën dhe P. Angelo Paliq.

Më 16 Mars edhe paria myslimane e Shkodrës u paraqit në Durrës për t'i shfaqë nderimet Princ Wiedit. Delegacioni përbëhej nga: Tahir

---

Efendiu i biri i Myftiut kryetar, Xhemal Efendi Kadiu (Naipi), Haxhi Hafiz Alush Lohja, kryetar i Klubit Shqiptar, Mullah Rustem Beu, Myrteza Efendi Xhabija, Maliq aga Sokoli, Muharrem aga Kazazi, Xhemal Shaqir Beu, Seit aga Juka, Qamil bej Gjylbegu, Abdullah Efendiu i biri i ish Myftiut, Selman aga Drishti, Meto bej Tapia, Shaban Dragusha, Ahmet Beu.



**Hysen S. DIZDARI**

## KONTRIBUTI I KURBINIT NË FITOREN E PAVARËSISË

*Me 36 trima nga Kurbini e ruaninme pushkë në dorë si natën dhe ditën Flamurin kombëtar në vitin 1912, ngritur nga Gjin Pjetër Pervizi.*

Krahina e Kurbinit e vendosur në pjesën qendrore të truallit shqiptar, në kryqëzim të rrugëve tokësore dhe detare, mes Krujës dhe Lezhës, ka luajtur një rol të madh në mbrojtjen e tokave shqiptare nga pushtuesit e huaj, por edhe në fitoren e Pavarsisë kombëtare, veçanërisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare gjatë vitet 1878 -1912.



Gjin Pjetër Mark Pervizi i Skurajve  
Milot më 28 Nëntor 1912

Njëra nga familjet me të shquara të krahinës Kurbinit është familja Pervizi e përfaqësuar nga patrioti dhe atdhetari Gjin Pjetër Pervizi, i cili lindi në vitin 1856 në Skuraj të Kurbinit në një familje me tradita patriotike, shekullore që nga koha e Gjergj Kastriotit Skenderbeut. Gjin Pjetri Pervizi(1856-1914) krahas babait të tij, Pjetër Mark Pervizaj dhe xhaxhait Prengë Mark Pervizaj ishin udhëheqësit e lëvizjes çlirimtare në krahinë e Kurbinit. Në vitin 1883, qeveria osmane dërgoi Turgut Pashën me forca të mëdha ushtarake për shuarjen e kryengritjes të nxitur nga Lidhja e Prizrenit dhe për kapjen e krerëve të saj. Në Skurajt ata i vunë zjarrin kullave të Pervizajve dhe pastaj vazhduan të djegin me radhë krahinat e tjera të Shqipërisë Veriore për të



vijuar më tej në Kosove e Nish.

Në vitet 1903-1916, kulla e Gjin Pjetër Pervizi u bë qendra e lëvizjes çlirimtare patriotike për çlirimin e Shqipërisë së Mesme kundër pushtuesve të huaj.

Gjatë kësaj periudhe Gjin Pjetrit Pervizi që në vitin 1904, ishte prijës dheudhëheqës i fitores së luftës, në Tallajbe të Krujës kundër pushtuesve osmane.

Më 28 Nëntor 1912, kur trojet shqiptare po rrezikoheshin të coptoheshin patrioti, Gjin Pjetër Pervizi ngriti flamurin kombëtar në Milot të krahinës Kurbinit.

Ja sa bukur e përshkruan, P. Klement Miraj (o. f. m), Famulltar i Laçit në revistën, ” Hylli i Dritës” vjeta XII, nëntor 1937, f. 533, ngritjen e flamurit në Milot të Kurbinit:

*“Në këtë kohë ngre flamurin në Milot edhe Gji’ Pjetri i Skurajve. S’â goje qi mund t’a përshkruejë gzimin e asajë dite. Gji’Pjetri me flamur në dorë del para popullit e i thotë plot entusjazem : Per liri të këtij flamuri jemë djegë e pjekë e kemëluftue tash sâ vjet, qe sot na e báni Zoti nafakë me mujt me e ngrehë edhe ne ket vendint’onë.*

*Flamuri u pershndet me brohori e batate. Gjin Pjetri i vûni roje te madhe ktij flamurit--36 vete do ta ruejshin me pushk në dorë si naten si ditën”*

Një muaj më vonë në të njëjtën fletore, P. Donat Kurti (o. f. m), në artikullin: “Kontributi i krahinës së Kurbinit për çashtjen kombtare” (“Hylli i Dritës, vjeta XII, dhjetor 1937, f. 611)

përmes fakteve historikedokumenton marrëdhëniet e nderlikuara të Gjin Pjetrit me qeverinë e Durrësit të Esat Toptanit.

*“Ndërkaq- shkruan ai- Miloti u ba qanderr e fortë kundër aspiracioneve t’flligta t’Esad Toptanit, e Kurbini marë me Gji Pjetrin në krye u majtë tok per rreth ktij flamuri tuj i ndëjë në beh çdo sulmit a kercnimit prej ane t’Esadistave.*

*Tuj pa Esadi se Gjini nuk lidhej kurrsesi dërgoi në Milot nji delagacion prej Durrsit, tuj i premtue Gji Pjetrit shuma të mdha të të hollash e tui i lidhë me ia majtë aj vetë nji fuqi 500 vetësh me ká 100 fr. ár ne muej etj, por Gji Pjetri nuk e pranoi kurrnji qysh.*

*Çoi së mbrami nji fuqi t’madhe nen komandën e Ali Femi Kosturit, për me zánë Gji Pjetrin gjallëa dekun; por kúr komandanti mrrini nëShullaz afër Milotit me ushtrí, i telegrafoi ngutsisht Esadit tuj i thanë se pá derdhë gjak shumë nuk mund do të shtihej në dorë.*

*E pau at botë Esadi se nuk mûjte me e qitë kurrsesi me ket trim e fatosprandaj, tuj drashtë edhe mos të ndizej nji luftë e papritun në zonën e tí, dha urdhen të tërhiqej ushtria mâ parë në Krú e mandej në Durrës”.*

Por historia përsëritet nga brezi në brez edhe tek familjes fisnike dhe atdhetare Pervizi, dhe nuk është rastësi, që edhe sot, në ditët tona, pasardhësi i kësaj familjes patriotike, Lek Pervizi, pas qëndrimit të pamposhtur në burgjet komuniste, ka dhënë dhe jep ndihmesën e tij në proceset demokratike duke iu përkushtuar studimit dhe daljes në dritë të historisë së vërtetë të luftës së popullit shqiptarë për liri e demokraci.

Kontribut me vlera të mëdha kombëtare janë veprat e tij në fushën e historisë së popullit shqiptar dhe veçanërisht të historisë të krahinës patriotike të Skuraj të Kurbinit. Veprat më kryesore janë:

“Gji Pjetri - Luftëtar i shquar i Rilindjes Kombëtare”; “Gjeneral Preg Pervizi”; Dhimitër Frangut, „ Histori e veprave të lavdishme të Gjergj Kastriotit (përkthim, Tiranë 2005); Paolo Jovio, „ Skënderbeu e sulltanët e Turqisë (përkthim); Studimi me vlera historike: “Pellazge - etruskë- shqiptarë, nga legjenda në të vërtetën historike”(studim) etj. Në tetor të vitit 1993 ai themeloi në Bruksel revistën letrare artistike euro-shqiptare “KUQ E ZI,,.

Pos kontributit të tij në fushën e historisë, L. Pervizi ka kontribut me vlera të spikatuara edhe fushën e artit figurativ, si piktor i pasqyrimit me vërtetësi të realiteteve shqiptare në dy epokat historike, si të diktaturës komuniste ashtu dhe të kohës së demokracisë.

Kontributin atdhetar të Gjini Pjetër Pervizit nga Skurajt e Kurbinit, e përjetësoi në vargje edhe i ndjeri, Monsinjor Frano Ilia, ish-Arqipeshkëvi Metropolitan i Shkodrës.

**KËNGË PËR GJIN PJETËR PERVIZIN**

Në tokë të Kurbinit lshon kushtrim,  
Njaj Gjin Pjetri i urtë e trim,

\* \* \*

Ai Gjin Pjetri ç'ka ka thanë,  
Një besë kam dhe ia kam dhanë.  
Gjithë Kurbinit e Vogjilisë,  
Me ia rritë nderen Shqipnisë.  
E ju burra gjithë sa jini,  
C'ka falë Zoti hani e pini.  
Nesër herët tre djelm të ri,  
Shëndosh ju qesin der n'kufi.  
Në mbarë Kurbinin ka que fjalë,  
Të rrokim armët burrë dhe djalë.  
Kush lirinë don me e fitue,  
T'vijë mbas meje me luftue,  
ujku shpejt ka me na msy,  
Burra besën mos me thy.  
N'kodra t'Zhejes për nën kishë,  
Janë struk pritrat porsi bishë,  
Prin Gjin Pjetri, Llesh Bib Brozi,  
Nikoll Ndreu, Pjetër Bajlozi,  
E dy Lleshat prej Miloti,  
Trima tëçartun flakë baroti.  
E Llesh Vathi e Zef Piroli,  
Pjeter Hidri e Ndrec Sokoli,  
Prend Bardhoku me djelm tjerë.  
Tokës Kurbinit na i lanë nderë.

\* \* \*

Por shqiptart n' dor smujt me i shti.  
Thuj sulltanit e thuj barbarit.  
Asht que n'kam kombi i shqiptarit.  
Mjaft kët tokë e ke dhunue.  
Dum në liri na me jetue.  
Dum atdhe e dum liri..  
Dum flamurin kuq e zi.  
Kur agoi e bardha dritë.  
Vesh e mbath e pushk tuj qitë.  
Mblidhen tok djelmt e Kurbinit,  
Rreth parisë e perreth Gjinit.  
E Gjini Pjetri e Bajraktari,  
Ngrejn flamurin që na la i pari,  
Pesqint vjet mshefun nën dhe,  
Valon sot flamur mbi ne.  
Se me gjak në te kem ble.  
Merr valë pushka e qiftelija..  
T'gjithë brohorasin rroftë Shqipnija.  
Rrnoftë flamuri kuq e zi.  
Mbi tokë të lirë të ksaj Shqipnije.

## ▪Studime letrare▪

Arben PRENDI

### POEZIA E D. AGOLLIT NDËRMJET DY KOHËVE

#### 1. D. Agolli në letërsinë e viteve '60

Dritëro Agolli vjen në letërsinë shqipe në një moment me rëndësi, siç është viti 1961, kur po zhvillohej një debat i gjerë, kryesisht për poezinë (por që përfshiu krejt letërsinë), mes krijuesve më të vjetër, si Mark Ndoja, Andrea Varfi, Luan Qafëzezi, Kolë Jakova, Llazar Siliqi, Dhimitër Shuteqiqi etj., dhe atyre më të rinj në moshë (që sapo kishin botuar poezitë, apo vëllimet e para poetike), si: Ismail Kadare (1936), “Shekulli im” (1961); Dritëro Agolli (1931), “Hapat e mia në asfalt” (1961), Fatos Arapi (1930), “Shtigje poetike” (1962) etj. Me këtë brez poetësh, poezia shqipe, sipas vlerësimit të studiuesve, hyn në një fazë të re që shprehet në rritjen e cilësisë estetike të saj, megjithëse brenda kufizimeve ideologjike të kohës. Duke përfituar edhe nga një liberalizim i përkohshëm i jetës politike në vitet 1961, u mbajt edhe një diskutim i hapur në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, në të cilin u shtrua hapur *çështja e raportit ndërmjet traditës dhe novatorizmit* në letërsinë e kohës. Poetët e brezit më të vjetër (brezi '50), në këto diskutime mbronin tradicionalen, vargun e matur, rimën, fjalorin tradicional të poezisë përkundër qëndrimit të brezit më të ri (Kadare, Agolli, Arapi, Qiriazi), që ishte për përdorimin më të gjerë të vargut të lirë, rrjedhimisht të çliruar nga rima e qëllimtë, për fjalorin e ri poetik dhe mjete të reja të shprehjes artistike. Poetët e brezit më të vjetër e paraqesin përdorimin e vargut të lirë si një rrezik për poezinë shqipe.

Poeti i ri asokohe, Ismail Kadare, në artikullin “Asgjë tragjike s’ka ndodhur, asnjë traditë s’është mohuar”, botuar në gazetën “Drita” 23 korrik 1961, do të shprehej, se: “Vargu i lirë lidhet patjetër tek ne nga

disa me emrin e modernizmit. Po sikur të ngriheshim e të thoshim, po të niseshim nga pozita formaliste, se vargjet më të rregullta kanë qenë të lidhura me monarkitë dhe kanë lulëzuar, me tërë akademizmin e tyre, sidomos pranë oborreve mbretërore? [...] Unë mendoj, se në kohën tonë nuk është bërë tek ne asnjë shpikje forme. Tek ne përmbajtja e re ka sjellë gjetjen e disa mënyrave të reja shprehjeje, disa herë me sukses e disa herë pa sukses. Me sukses atëherë kur kjo ka ardhur si nevojë e brendshme, pa sukses atëherë kur ka ardhur për arsye snobizmi. Ja, kjo është e gjitha. Asgjë tragjike s'ka ndodhur, asnjë traditë s'është mohuar, asnjë klasik s'është përbuzur. Janë shthurur vargjet, mund të thotë dikush. Po. Por metra të shenjtë nuk ka, nuk ka ritme të shenjta. Ka ide të mëdha, ka përmbajtje të madhe. [...] Në qoftë se arti është i vërtetë, ai do të ketë brenda patjetër të renë, novatoren. Novatorja mund të jetë edhe brenda strofave të rregullta, ashtu siç mund të jetë edhe koservatorja në mes të vargjeve të lira. Kryesorja mbetet, pra, gjithmonë përmbajtja. Shpesh në disa artikuj dhe biseda ngrihet çështja e formës nacionale në poezi. Dhe prapë thuhet se poezia e disa poetëve të rinj nuk është shqiptare. [...] Forma nacionale, shpirti nacional, ajo që e quajmë “shqiptare” ngushtohet deri në një nocion etnografik. [...] Ç'është shqiptare në poezinë tonë? [...] Unë mendoj se shqiptarja në artin tonë është determinuar nga ai tension moral dhe fizik i popullit tonë, gjatë dhjetëra vjetve, për të mos u zhdukur si komb dhe për të fituar lirinë. [...] Nacionalja, fryma shqiptare, tradita krijohen për një kohë të gjatë. Ato janë aktive, pasurohen. Zhduken probleme jetike të një populli, dalin probleme të reja... ”<sup>1</sup>. Në poezinë “Sfidë”, tek vëllimi poetik “Shekulli im” (1961), Kadareja paraqet në një farë mënyre edhe “manifestin” e brezit të tij poetik: *“Hapni udhën, poetë të poezisë së deklasuar/ Ju që gatuani fjalë të zgjedhura/ siç gatuajnë terjaqinj të kafenë/ që vishni kostumin e ri me vija të dielave, / që çuditeni për shumë gjëra/ “Bah, punët si venë!” [...] Hapni udhën, fanatikë të artit/ që, si fanatikët e kohrave të shkuara/ u gëzoheshin buzëve të paputhura/ ju u gëzoheni/ rimave të paharxhuara. [...] Ju shoh tek trembeni si laraska prej sirenave/ se si tmerroheni prej formave që vijnë/ vegjetarianë të mjerë! Poet është ai që me dorën e fortë/ ashtu, siç këput një trëndafil në lëndinë/ mund të zbrërthejë pranë trëndafilin/ edhe një minë”*<sup>2</sup>. Poezia drejtohet së pari ndaj poetëve “reaksionarë” të traditës por edhe ndaj

1 I. Kadare, *Autobiografi e popullit të vargje*. Tiranë, 1971, f. 66-70.

2 I. Kadare *Vëpra letrare 1*. Tiranë, 1981, f. 162-164.

poetëve të viteve '40-'50, që mbrojnë ashpërsisht rimën, vargun e matur, frymën kombëtare në poezi etj.

Debati vijoi më tej edhe në organin e Lidhjes së Shkrimtarëve, në gazetën "Drita". Edhe poeti Dritëro Agolli, në artikullin "Traditë, natyrisht, por jo shtampë" duke iu kundërvënë poetit Mark Gurakuqi, kritikon poezinë skematike, poezinë e konsumuar nga përsëritja e mjeteve poetike, konvencave dhe procedimeve të njëjta artistike, të cilat përsëriten sa të një poet tek një tjetër dhe në emër të ruajtjes së traditës e varfërojnë poezinë.

Poezia e brezit të viteve '60, brenda kufizimeve ideologjike të kohës sollti transformime dhe vlera të reja në poezinë shqipe të këtyre viteve. Siç vlerëson studiuesi Agim Vinca, në poezinë e këtyre viteve "Afrimi i poezisë me jetën dhe zbulimi i anëve të reja e të panjohura të realitetit; futja e detajit realist dhe e faktit konkret në poezi; krijimi i një sistemi të ri figurativ dhe i një shkalle më të lartë abstragimi; përdorimi i një vargu më të lirë e të shpenguar dhe i një fjalori e sintakse të re poetike - ishin vetëm disa nga këto tipare e veçori novatore, gjegjësisht vetëm disa nga elementet e reja që depërtuan në strukturën e poezisë shqipe të viteve '60"<sup>3</sup>.

Ndërsa për studiuesin Sh. Sinani, mund të vërehen në këto vite ndikime edhe nga poezia futuriste dhe nga manifesti i futurizmit të Filippo Tommaso Marinetti-t<sup>4</sup>, por edhe nga "futurizmi" i poetit rus Majakovski, duke pasur parasysh, se tre poetët: Kadare, Agolli, Arapi vinin nga një formim në universitetet sovjetike. Sipas Sinanit: "Pothuajse të gjitha parimet dhe angazhimet që përmbante ky manifest u shfaqën në formë analoge, sido që të vonuar, sidomos në poezinë e atyre viteve. Ka një paralele evidente midis refuzimeve estetike dhe qëllimore të futuristëve dhe angazhimeve të poetëve të realizmit socialist"<sup>5</sup>. Për këtë studiues edhe vetë qëndrimi i poetëve të këtij brezi kundër poezisë së traditës, vargut të matur dhe folklorik, është një qëndrim futurist kundër

3 A. Vinca, "Vitet '60 dhe beteja për novatorizëm". "Alternativa letrare shqiptare". Shkup, 1995, f. 72.

4 U botua për herë të parë më 20 shkurt 1909, në gazetën parisienne *Le Figaro*. I përbërë nga 11 pika në këtë manifest përmbledhen kulti i ardhmërisë, teknikës, shpejtësisë, antitradicionalizmi, antiakademizmi, antisentimentalizmi, militantizmi, himnizimi i luftës, agresivitetit etj.

5 Sh. Sinani, "Mitë dhe demonët e letërsisë së realizmit socialist", në *Letërsia shqiptare e realizmit socialist/ Studime albanologjike /Universiteti i Tiranës, viti XV, 2010/2, f. 201*.

“mitit të sintaksës dhe rendit gjuhësor”.

Debati mes poetëve të brezit të viteve ‘50 dhe atyre të viteve ‘60 sollli në një farë mënyre mohimin e formave dhe konceptit të poezisë së “vjetër” dhe afirmimin e poezisë më të re, edhe pse me vështirësi edhe ndërfitjen e disa veçorive të poezisë moderne, siç përmendëm praninë e futurizmit, surrealizmit, simbolizmit, hermetizmit etj. Ndërkaq këta poetë për shkak të talentit dhe risive që sollën, por edhe të pozitës që kishin (Agolli, Kadare) në hierarkinë e kohës, i imponuan letërsisë dhe poezisë shqiptare përgjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë, duke lënë disi në hije brezat e mëvonshëm letrarë. Në fakt krijimtaria e poetëve të brezit të viteve ‘60-‘70 shtrihet dhe dominon edhe përgjatë viteve ‘70-‘80, por edhe më vonë, duke pasur parasysh se D. Agolli dhe F. Arapi, si më prodhimtarët, por edhe Kadare me poezi më të pakta, poezinë më cilësore e botuan në kushtet e lirisë.

Megjithatë pavarësisht risive, edhe në poezinë e këtij brezi (deri në vitin 1990), është i pranishëm glorifikimi i socializmit, “njeriut të ri” dhe shoqërisë së re socialiste, i rolit të rëndësishëm të Partisë Komuniste, më pas Partisë së Punës, diktatorit Enver Hoxha; në shndërrimin e Shqipërisë në kështjellën e socializmit në brigjet e Adriatikut. Ligjërimit ideologjik në këto vite, është element i rëndësishëm i poezisë së Ismail Kadaresë, veçanërisht në poemat *Përse mendohen këto male* (1964), *Ëndërr industrial* (1960), *Poemë e blinduar* (1962), dhe *Shqiponjat fluturojnë lart* (1966) sikurse edhe në poezinë e Dritëro Agollit, në poemat *Baballarët* (1969), në poemën *Komunistët* (1971), *Nëntoriada* (1976) *Nënë Shqipëri* (1974) etj., si edhe në disa vëllime të Fatos Arapitsi *Shtigje poetike*, poema *Republika* (1962), *Poema dhe vjersha*, poema *I përkasim komunizmit* (1966), *Ritme të hekurta* (1968), *Drejt qindra shekujsh shkojmë* (1977) etj. Ndërsa nga rrafshi tjetër, poetët e këtij brezi rikthyen poezinë me motive universale: poezinë e dashurisë, poezinë për natyrën, poezinë e ndjenjave dhe poezinë e mendimit, të cilat bashkëjetojnë nga njëri vëllim në tjetrin me motivin ideologjik, patriotik dhe historik. Poezia e ligjërimit ideologjik, në perspektivën e leximit dhe studimit të sotëm, nuk e ka as vlerën artistike as atë të mesazhit, si e tillë është e destinuar të vështrohet vetëm si “dokument” i instrumentalizimit të letërsisë nga ideologjia politike.

## 2. Poezia paralele: motivet ideologjike dhe motivet universale

Dritëro Agolli (1931) është poet, tregimtar, novelist, romancier, publicist e dramaturg. Arritjet më të rëndësishme artistike i pati në



poezi, aq sa mund të thuhet se është *figurë qendrore e poezisë shqipe*<sup>6</sup>, tëbotuar brenda Shqipërisë gjatë gjysmës së dytë të shek. XX. Ai është kryesisht poet lirik. Si poet liriko-epik shfaqet edhe në poema.

Në veprën letrare të D. Agollit kemi të pranishme dukuri të zakonshme, në letërsinë e krijuar nga shkrimtarët shqiptarë nën regjimin komunist: letërsinë konformiste, që himnizon arritjet e regjimit komunist dhe figurave politike të tij; letërsinë e singertë, që i bindet vokacionit poetik të autorit, në të cilën gjenden përpjekjet për të shkruar letërsinë e distancuar nga ideologjia dhe skemat e realizmit socialist. Në të njëjtën kohë, çmohej nga regjimi për veprat e kategorisë së parë, shihej me dyshim dhe qëllonte që ndonjë vepër e tij edhe të ndalohej, si përmbledhja me tregime: *Zhurma e erërave të dikurshme* (1964), fenomen i zakonshëm në këtë periudhë për të gjithë shkrimtarët. Në veprat e kategorisë së parë përzihen konformizmi me ideologjinë, ëndrrat utopiste me shërbimin pro propagandës së regjimit, në të cilin letërsia konsiderohej si ndihmëse e Partisë në brumosjen e masave me botëkuptimin e shëndoshë m-l. Në mjaft vepra Agolli na del si shkrimtar i formuar me botëkuptimin e kohës në të cilën jeton, si poet i angazhuar që ëndrron dhe dëshiron që “ëndrra socialiste” të realizohet në të mirë të botës së re, duke shembur “botën e vjetër” me revolucion. Më e ndjeshme është kjo në disa vëllime poetike, në të cilat, sikurse edhe te shumica e poetëve të kësaj periudhe, gjysma e poezive janë politike, deklarative, përçuese të ideologjisë dhe gjysma tjetër, kryesisht ato që përshkohen nga motive universale, si: motivi i dashurisë, motivi i jetës, motivi i vdekjes, motivi i natyrës etj., janë edhe më të realizuara artistikisht. Në kategorinë e dytë të veprave gjejmë vlerat e mirëfillta të poezisë së D. Agollit. Në këtë kategori mund të përfshijmë disa poezi të shkruara gjatë regjimit komunist dhe poezi të shkruara pas rënies së tij, në vitet 1990, të cilat e ruajnë vlerën e tyre artistike dhe kuptimore, poezi në të cilat shfaqet talenti por edhe mjeshtria dhe bota e poetit të vërtetë.

Prandaj për arsye studimi, edhe poezinë e këtij autori mund ta shohim në dy periudha: poezia e shkruar para viteve 1990, dhe pas këtij viti. Poezia e periudhës së parë është më e thjeshtë, më e drejtpërdrejtë, më optimiste, dendur deklarative dhe retorike (poezia me temë dhe mesazhe ideologjike), më “kombëtare”; ndërsa ajo e periudhës së dytë, më e ndërlikuar nga ana kuptimore, më pesimiste, meditative dhe

6 Sh. Sinani, “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit”. Tiranë, 2010, f. 16.

filozofike, por edhe më e sinqertë dhe më universale. Herë pas here kjo poezi bie në thjeshtëzime dhe shpjegime didaktike, vargëzime dhe rima të konsumuara e skematike, të cilat janë të kuptueshme po të kemi parasysh afro njëzet vëllime poetike këtij autori. Si e tillë, kjo poezi përmban elemente të poezisë romantike, realiste, futuriste, dhe sidomos të realizmit socialist. Krahasuar me poezinë evropiane të kësaj periudhe, por edhe me disa poetë bashkëkohës, (të ndaluar apo të pabotuar në Shqipëri, si: Martin Camaj, Zef Zorba etj. ), apo me poezinë shqipe, të kësaj periudhe, në Kosovë, poezia e Agollit, sikurse edhe pjesa e më e madhe e poezisë shqiptare të këtyre viteve, tingëllon e vonuar stilistikisht dhe kryesisht e ndikuar nga poezia ruse, ajo e Bashkimit Sovjetik, apo e vendeve të tjera të Lindjes komuniste. Ka studiues që shohin në poezinë e Agollit ndikime nga poezia popullore shqiptare, nga poezia e Naim Frashërit, Lasgush Poradecit, Robert Bërnsit, prej poetëve rusë të fillimit të shek. XX, prej poetëve klasikë persë, si: Mevlana Xhelaledin Rumiut etj. <sup>7</sup>, më pak (P. Eluard), ose aspak e poetëve modernë evropianë. Në tërësi nga ana metrike poezia e D. Agollit është polistrofike, isometrike e heterometrike, isoritmike e heteroritmike. <sup>8</sup> Ndërsa figurat letrare të përdorura dendur, janë: krahasimet dhe metaforat, <sup>9</sup> por vlerë dhe rol të veçantë marrin asonancat, konsonancat, aliteracionet, rimat, të cilat realizojnë atë që mund të quhet si bukuringëllim<sup>10</sup> dhe muzikalitet i vargut.

Disa nga vëllimet poetike e këtij autori janë: *Poezi: Në rrugë dola* (1958), *Hapat e mija në asfalt* (1961), *Shtigje malesh dhe trotuare* (1965), *Devoll, Devoll* (1964), *Mesditë* (1968), *Baballarët* (1969), *Nënë Shqipëri* (1974), *Fjala gdhend gurin* (1977), *Të pagjumët* (Prishtinë, 1980), *Udhëtoj i menduar* (1985) etj.

Pas vitit 1990 janë botuar edhe vëllimet poetike: *Pelegrini i vonuar* (1993), *Lypësi i Kohës* (1995), *Fletorkat e mesnatës* (1998), *Këmbana e largët* (1998), *Gdhihet e ngryset* (2000), *Prit edhe pak* (2016) etj.

### 2.1. Ndërthurjet tematike e motivore

Poezia e Agollit është e pasur me detaje autobiografike. Në historinë e letërsisë shqiptare vështirë se mund të gjendet ndonjë poet tjetër, që

<sup>7</sup> Sh. Sinani, "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit. Tiranë, 2010, f. 18.

<sup>8</sup> Po aty, f. 18.

<sup>9</sup> I. Lëngu, "Imazhi poetik dhe disa veçori të tij te Agolli, Arapi, Spahiu". "Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare". Prishtinë, 2005, f. 117-120.

<sup>10</sup> B. Kuçuku, "Përtëritje të lirikës shqiptare". D. Agolli, "Lutjet e kambanës". Tiranë, 1998, f. 363.

të vetërrëfeje me këmbënguljen dhe performancën estetiketë Agollit, të gjithë të dhënat jetësore, biografike të tij, të familjes, të vendlindjes, gjurmët dhe shenjat më domethënëse të botës së tij vetiake njerëzore.<sup>11</sup> Temat e preferuara të poezisë së D. Agollit lidhen me jetën e përditshme njerëzore: fëmijërinë, rininë dhe pleqërinë, por edhe me natyrën, poezinë, dashurinë.

Një nga motivet më domethënëse dhe më jetëgjata, në të cilin kombinohen shpesh tema dhe motive të tjera nga realitetet ku jeton autori, është motivi i udhës, motiv që përshkon gjithë krijimtarinë poetike të tij, por shtjellohet tërësisht në vëllimin “Udhëtoj i menduar” (1985). Në poema, këtyre temave u shtohet edhe tema sociale-ideologjike, e cila, bëhet kryetema ku realizohen e shpjegohen porositë politike të kohës. Dendur struktura e poezive ndërtohet në formën e bashkëbisedimit, mes poetit dhe lexuesit të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar, formë e cila i jep kësaj poezie një shkallë të lartë komunikimi, që është ndoshta një nga arsyet se kjo poezi i drejtohet lexuesit masiv, çka ka sjellë, përveç cilësive të tjera të kësaj poezie, edhe popullaritetin e Agollit si poet. Cilësi e përhershme e poezisë, por edhe prozës, është ndjenja e humorit popullor që shfaqet në formën e kritikës, sentencave popullore, qesëndisjeve për ngjarje e dukuri të jetës njerëzore.

Në poezinë e D. Agollit fryn një frymëzim naimian, prej të cilit burojnë sistematikisht motive si: natyra, njeriu, bagëtia dhe bujqësia: Poezinë e këtyre motiveve e përshkon bukolizmi, romantizmi, idealizimi i jetës së fshatit, fshatarit që jeton i lidhur me tokën, me bagëtitë, dhe e gjen aty kuptimin e ekzistencës, në përballje me vështirësitë dhe bukuritë e kësaj jete, duke qenë i lidhur me mësimet ideologjike, të cilat janë zgjidhje për të gjitha problemet. Si në poezinë e Naim Frashërit dhe të poetëve romantikë, janë të pranishme edhe këtu natyra, njeriu, bagëtia dhe bujqësia, përmes të cilave fshatari shqiptar dhe poeti i gëzohet jetës. Në këto poezi artikullohet ndjenja e mallit të poetit për fshatin, për hapësirat e blerta të tij, bagëtitë, shpendët, fshatarët, njerëzit e afërm. Kjo ndjenjë i përshkon të gjitha poezitë e kësaj teme, por zakonisht në pjesën e parë të poezisë ndihet frymëzimi dhe talenti i poetit, ndërsa në pjesën e dytë (nga ana kuptimore) në mjaft poezi poeti del si poet i revolucionit, i armatosur me ideologjinë e kohës, duke humbur mjaft nga vlerat artistike e kuptimore të kësaj poezie, e cila mbetet një ilustrim deklarativ i porositë politike.

11 R. Zisi, *Letërsia bashkëkohore shqipe-poezia*. Tiranë, 2008, f. 148-149.

D. Agolli është mbiquajtur (në fazën e parë të krijimtarisë), si “poet i tokës”, sepse “toka” është esencë e kësaj poezie. Në fakt, “Toka” poetizohet më shumë nga këndvështrimi i fshatarit/ i praktikës së tij, si lëvrues dhe përfitues prej saj; dhe nga këndvështrimi i poetit komunist, që sheh te “toka” jo thjeshtë ambientin dhe mjedisin natyror që frymëzon poezinë e tij, por terrenin në të cilin zhvillohen përplasjet mes klasave të përmbysura dhe klasës fitimtare etj. Është për t’u vënë re, se mungon fryma universale që ka zakonisht poezia moderne me këtë temë. (Mjafton të përmendim “Tokë e shkretë”<sup>12</sup> e T. Eliot). Ja një shembull nga poezia “Kënga e tokës”<sup>13</sup>: “Unë jam marrë shumë/ me tokën/ dhe e njoh/ më mirë se agronomët, / Kur ul në brazdat e ugarit/ kokën/ Ndjej rrahjet e damarëve të dheut/ e aromën. / Unë i fus gjer në bërryla/ të rëndat duar/ Në tokën e zezë, /në tokën djerrë/ Dhe s’lë plis/ pa thërrmuar, / Dhe s’lë rrënjë pa nxjerrë. / Aherë/ me duar lyer me dhe në arë, / Me këmbë/ ngulur në brazdë thellë, / Zemra, / një metër afër tokës, / më rreh e pret farën/ Të mbijë/ e gjelbërimi/ të zgjatet në djellë...”. Edhe në poemën “Toka ime, kënga ime”, raporti njerëzor dhe i frymëzuar nga toka, atdheu, burimi i të mirave jetësore shndërrohet menjëherë në një raport ideologjik, ku “yshtjet” ideologjike janë çelësi i “ndryshimeve që kërkon toka” nga biri i saj, bujk dhe poet komunist: “Tokë e dashur, / Ti diçka ke kërkuar nga unë:/ “Ndryshomë, o biri im”, - më ke thirrur nga grykat e maleve/ E gërxhe përmbysa e ngrita diga në lumë/ [...] A s’isha unë ai që erdha kongreseve të Partisë/ Me kokrra gruri në xhepe/ Me këpucë me dherin tënd, / E fola për ty me zërin tim të fuqishëm, / e fola për ty kuvend më kuvend/? E mora vendimet e Partisë me vete? E krahët përvesha, o toka ime, o kënga imel!”<sup>14</sup>

Edhe atëherë kur këndon për vendlindjen e tij në poemën “Devoll, Devoll” (1964) duke dashur të shprehë lidhjen e tij të fortë me të, poeti kalon në një retorikë bombastike dhe vetëmburrëse duke e paraqitur Devollin, si “qendrën e botës” dhe veten si misionar që nga Devolli e sjell jetën e gjallë në Lidhjen e Shkrimtarëve: “Po, Devoll, i tillë qenkam unë, / Paskam marrë baltën tënde arave, / Në një trastë leshi/ ndënë gunë/ Për t’ia sjellë Lidhjes së Shkrimtarëve”<sup>15</sup>. Në kontekstin e viteve 1964, kur është shkruar, poema mund të lexohet si shprehje e lidhjes së artit dhe shkrimtarit me jetën e gjallë të popullit/baltës, siç

12 *Përkth. në shqip Rudolf Marku, Tiranë, 1995.*

13 D. Agolli, *Poezi. Naim Frashëri, Tiranë, 1979, f. 155-156.*

14 *Po aty, f. 330-331.*

15 *Po aty, f. 173.*

ishte edhe një nga direktivat politike të kohës, ndërsa në nëntekstin e saj tingëllon si një imponim që poeti “rebel”, bolshevik, i bën Lidhjes së Shkrimtarëve/shkrimtarëve reaksionarë, mikroborgjezë, që shkruajnë për hënën dhe dashuriçkat, të cilët i kanë humbur lidhjet me “baltën”. Imazhi pseudopoetik që krijon poeti në këtë rast, me dashje ose padashje, është imazhi i përbaltjes së tempullit të shkrimtarëve dhe i poezisë, me baltën e Devollit, vendlindjes së tij. Përforcohet ky imazh dhe bëhet bindës kur autori i përbaltur deklaron më tej me vetëmburrje: “Hej alarm, alarm, o komunist! / Jam njeri i fortë i pagjumë / Dhe çdo tingull kap, çdo tingull gjuaj / Dhembje njerëzore kur ndiej unë, / sentimentalizëm nuk e quaj... / Ndaj unë komunisti nga Devolli / Që kam pendë, letër edhe armë, / që hedh firmën: “Dritëro Agolli”, / Ngrihem kur kap tingullin: “alarm!” / Se e di, që komunistët s’fënë, / Vetë komunizmit i përkas”<sup>16</sup>. Autoportreti deklarativ përputhet me imazhin e poetit komunist të angazhuar, që lufton me pushkë e me penë, për një art revolucionar. Nënkuptohe, pena dhe letra i shërbejnë poetit për të krijuar artin ideologjik, dhe pushka për ta mbrojtur nga “armiqtë” e këtij arti: shkrimtarët reaksionarë, mikroborgjezë, të mykur. Përputhet kjo, edhe me vlerësimin që i bëhet në “Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist” (1978), ku thuhet: “Devoll, Devoll” (1964) i ngjan një monologu lirik që pohon lidhjet e ngushta shpirtërore të individit me popullin dhe çështjen e socializmit. Dashuria e flaktë për atdheun formon patosin e poemës, të cilën e përshkon tejendane si rrymë gurgulluese hareje për popullin që rron i lirë dhe i lumtur, krenaria që i zgjon poetit vetëdija se është “një plis” i këtij trualli, një ushtar i revolucionit. Duke folur për jetën e re të Devollit, poeti merr shkas të zbulojë qëndrimin e tij ndaj problemeve të rëndësishme që shqetësojnë vendin. Me gjithë elementin autobiografik, poema fiton në këto këngë një kuptim më të gjerë; ndjenjat dhe mendimet e poetit janë ndjenjat dhe mendimet e brezit të tij, heroi lirik është poeti qytetar që hyn në bisedë me atdheun dhe pohon kuptimin e misionit të poetit në shoqëri, të lidhjes së artit të vërtetë me jetën e popullit”<sup>17</sup>.

Në fund të poemës, sipas skemës së realizmit socialist, poeti përveçse të ashpër e të fortë duhet ta paraqesë veten edhe të butë, sepse ndryshe do “të nxihej realiteti” dhe do të krijohej imazhi se poetët komunistë janë të ashpër dhe të dhunshëm ndaj kulturës, prandaj: “Po

<sup>16</sup> *Po aty, f. 179.*

<sup>17</sup> *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Tiranë, 1978, f. 231.*

megjithatë jam shumë i butë. / Ti, Devoll, më bërë delikat. / Unë i dua zogjtë edhe drutë, / Barin që burimi e spërkat”<sup>18</sup> etj. Për imazhin poetik dhe bukurinë estetike të poezisë kjo situatë është mjaft paradoksale: Si mund të jetë delikat, poeti që në kohë paqeje dhe “begatie” është i armatosur me armë, ideologji, dhe i mbart torbat me baltë nga Devolli (provinca/periferia/ ruralja, prapambetja kulturore, ekonomike etj. ) për t’i derdhur në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, në tempullin e artit, në kryeqytetin e shqiptarëve?!

Por në poezi të tjera si poezia: “Themelet”, poeti ia del të ikë nga ideologjia për të shprehur botën e tij të singertë dhe universale: raportin me familjen, shtëpinë e vjetër të lindjes, raportin me ëndrrat e rinisë, mbi të cilat ngrihen ëndrra të tjera njerëzore: “Ahere ulem nën pemë e them me vete, / Duke përtypur një fije bari: Vërtet shkrova poema në qytete, / Po mbeti esenca ime prej fshatari.../ Dhe nuk skuqem që këtë esencë me vete e mora/ Esencën e ëndrrave të mira/ Se ëndrra të tjera mbi atë ndërtova, / Ëndrra të bukura, të dlira...”.<sup>19</sup>

Në poezinë e periudhës së parë, poetizohet dëndur dashuria “e shëndoshë” në ara, fabrika, kantiere, uzina dhe kritikohet dashuria “mikroborgjeze”, nën dritën e hënës, apo në baret e natës. Edhe atëherë kur poezia nisët nga ndjenja të ngrohta njerëzore, përfundon në një poetizim të femrës “burneshë”, si në poezinë: “Për gratë tona”<sup>20</sup>. Pasi poeti pranon *gabimin* se këndon pak për gratë, e korrigjon atë duke poetizuar gruan “burrë”, gruan novatore: “E si të mos këndojmë, poetë, / Për ato që kanë ditur në jetë/ të lindin kreshnikë e perri/ në maternitet e shtëpi, / Në mal e në arë/ Duke prerë dru e duke hedhur farë...”. Sigurisht, këtu nuk është “faji” vetëm i poetit, kjo poezi shpreh edhe konceptin e shoqërisë socialiste për femrën, e cila nuk ka kohë për “dashuriçka”, “pispillosjet” (sipas fjalorit tipik për kohën), për t’u përkujdesur për veten, veshjet, modën etj., por vetëm për të shtuar numrin e popullsisë, për të mbjellë në ara, apo në punët më të rënda në uzina etj. Ndjenja e ngrohtë njerëzore dhe shumë poetike në pjesën e parë dhe të dytë të poezisë, përfundon në një surrogato *socialiste* në pjesën e tretë të saj.

Kurse në poezinë “Dashuria”, heroi lirik qesëndis ish-të dashurën e tij të rinisë, të cilën burri mikroborgjez që merr pako nga jashtë, e mbështjell “me najlone të sjellë deteve”. Ajo pra, është bërë mikroborgjeze dhe ka

18 D. Agolli, *Poezi*, T. 1979, f. 181.

19 *Po aty*, f. 374.

20 *Po aty*, f. 167.

harruar “kohën e lumtur” kur: “Ikëm ne të dy e ikëm larg, / Fjetëm shumë net kazermave/ dhe me vullnetarët hymë varg, / hëngrëm bashkë gjellën e gavetave”.<sup>21</sup> Spikat këtu qëndrimi klasor dhe meskin edhe ndaj ndjenjave dhe lirisë së secilit, për ta rregulluar jetën sipas shijeve të veta. Për *heroin lirik* janë të huaja komoditetet e jetës, aq më tepër kur vijnë nga matanë detit. Dashuria e pastër klasore është ajo e poetit me mjelësen e lopëve, në poezinë “Përsëri”, sepse ajo e frymëzon poezinë e vërtetë: “Po kam ardhur të t’i ngre kushitë/ Edhe lopës pak tërfil t’i jap, /T’i spërkat me qumësht poezitë/ Shtigjeve të tua t’i përhap”<sup>22</sup>. Ndërsa në poezinë “Dy fjalë poetëve që vijnë”, poeti “justifikohet” se: “Ne s’kemi pasur aq kohë të shkruanim për dashurinë/ Megjithëse kemi qenë dashnorë të marrë/ Vendi kërkonte këngë për lirinë, / Vendi kërkonte këngë për bukën që piqej në arë. // [...] Po ne s’kishim kohë që fjalët e bukura t’i botonim/ Dhe shtypshkronjat i kishim për gjëra më të larta... ”<sup>23</sup>. Me një farë pendese, poeti sakrifikon poezinë për ndjenjat dhe problemet njerëzore në dobi të gjërave “më të larta”, nënkupto: veprat ideologjike për brumosjen e lexuesit. Ndërsa në poezinë “Dashuri dhe ferrobeton”<sup>24</sup>, dashuria e klasës punëtore është dashuri e ashpër, epike, pa fjalë të ëmbla dhe pa delikatesë ndjenjash, ajo është shkëmbim i ashpër fizik mes teknikut të betonit dhe hidraulistes tërë pluhur, e cila natën e ramazanit pasi ka marrë “forcë” nga ky shkëmbim, ngrihet e këlthet kundër ramazanit, besimit fetar dhe xhamive: “Ramazan, ramazan, o marrëzi!”<sup>25</sup>. Kjo është “dashuria e shëndoshë” socialiste, me beton, motorë, tela, tunele, dinamit, gurë. Vetëm kjo dashuri do të jetojë si ferrobetoni, të tjerat janë pa vlerë: “Urra!Urra! Njëqind herë urra/ për dashurinë e teknikut dhe hidraulistes, / Që kotësira parfumesesh nuk ka, / As gogësima në frona lulishtesh!”<sup>26</sup>. Tërësisht e kundërt me këtë lloj poezie është poezia: “E bukura”, ku është e pranishme poezia e vërtetë e dashurisë që buron nga ndjenja thjesht njerëzore që bashkojnë dy qenie në një dimension: “Unë rritem kur jam me ty, si Anteu, / E gjaku muret e aortës godet. / Të dy jemi bërë nga lulet, nga dheu, / të dy njërit-tjetrit i duhemi me ditë, me net/ E bukura, tokësorja, e thjeshta

21 *Po aty*, f. 140.

22 *Po aty*, f. 138

23 *Po aty*, f. 407.

24 *Po aty*, f. 205.

25 *Po aty*, f. 207.

26 *Po aty*, f. 212.



grua!”<sup>27</sup>. Atmosferë intime e personale kemi edhe në poezinë “Dashuri e vështirë”<sup>28</sup> ku marrëdhënia e ndërlikuar ndërmjet dy të dashuruarve shprehet kështu: “Të kam pasur ëndërr çast e orë, / Ëndërr të trishtuar e të mirë, / Po të jem vërtet një Pitagorë, / Ti je teorema më e vështirë...”. Gjithashtu në poezinë “Kur të jesh mërziur shumë”<sup>29</sup>, një nga poezitë më të bukura artistikisht të kësaj periudhe, që përshkohet nga sinqeriteti dhe humanizmi, gjejmë poetin e vërtetë. Poeti mëton të jetojë edhe pas vdekjes, përmes artit të tij të thjeshtë e njerëzor, pa porosi e teza ideologjike: “Po kur të jesh mërziur shumë/ Në raft të librave kërkomë, / Atje i fshehur do jem unë, / Në ndonjë fjalë e ndonjë shkronjë”.

Jeta e ditës dhe e përditshme njerëzore, poetizohet në të gjitha poezitë e Dritëro Agollit. Përveç poezive që e shohin atë nën thjerrëzën ideologjike ka edhe mjaft poezi ku shfaqet poeti i ndjeshëm dhe njerëzor, apolitik, si poezinë “Bukuria”<sup>30</sup>: “Kalojmë pranë bukurisë shpesh, / kalojmë heshtur si udhëtarë/ Dhe s’vëmë re si nis e buzëqesh, / si pjeshka kur zë piqet në një arë// Dhe vjen një çast kur shtangim para saj;/ Ajo qëndron si pjeshkë e arrirë, / Ajo qëndron... / dhe themi ne pastaj:/ S’të vumë re, mes nesh ti paske mbirë!” Përmes një gjuhe të thjeshtë poetike poeti ngacmon vëmendjen e lexuesit dhe njeriut ndaj gjërave të bukura në jetën e përditshme. Nevojën që njeriu të shkëputet nga rrjedha e të përditshmes dhe të dallojë, të zbulojë e të kuptojë të bukurën e vërtetë në jetë. Në poezinë “Nuk dua” vërejmë natyrën e poetit “të fortë”, që sikundër sivëllai i tij Don Kishoti, nuk i pëlqen të mëshirohet në disfata nga të tjerët, por thjesht dëshiron të bisedojë me ta: “Ndofta prandaj e kam dashur don Kishotin aq shumë, / se me gjithë disfatat e mëdha të tij/ në udhët e largëta me gjumë e pa gjumë, / Nuk lejoi ta ngushëllonte njeri... ”<sup>31</sup>. E ndjeshme, e sinqertë dhe njerëzore është edhe poezia “Vdekja e fshatarit”<sup>32</sup>. Fshatari ka lëruar tokën gjithë jetën dhe një ditë vdes, dhe mblidhen për ta përcjellë bashkëfshatarët, thëllëzat, lopët e demat: “Botohet nekrologjia jote në librin e grurit në rrëza/ Dhe zogjtë me majën e sqepit firmosin e larg fluturojnë...”. Ndërsa në poezinë me nuanca fabule “Kungulli”, rikthehet “tema e ditës”: qarkullimi i kuadrove, përmes fabulës së kungullit që nuk i

27 *Po aty*, f. 154.

28 *D. Agolli, Udhëtoji i menduar. Vepra letrare II. Tiranë, 1987, f. 18.*

29 *Po aty*, f. 54-55.

30 *Po aty*, f. 380.

31 *Po aty*, f. 383.

32 *Po aty*, f. 390.



pëlqen qarkullimi nga njëra arë në tjetrën dhe bëhet farë e keqe, poeti ironizon kuadrot që nuk qarkullojnë siç e kërkonte direktiva politike e kohës: “Filluan kungujt vit për vit të dalin/ Të vegjël sa një kumbull e domate... / Burimi që ia dinte mirë hallin/ i tha: “po s’qarkullove, vate!” Do bëhesh farë e keqe dhe bastarde!”<sup>33</sup>. Kurse në poezinë “Kënga e njeriut” poeti artikulon kredon e tij artistike dhe njerëzore, që përmban vizionin për njeriun dhe krijuesin e kohës së tij: Njeriu i pandalshëm, që sfidon, ecën, zbulon, krijon dhe transformon botën ku jeton. Ky vizion frymëzohet nga optimizmi hiperbolik dhe patetizmi prej zbuluesi e transformuesi të botës së re, karakteristik i kohës kur jeton autori. Poezia është botuar në përmbledhjen poetike “Fjala gdhend gurin” (1977): “Plakem-rinohem, luftë pa fund e mbarim. / Një grimëz e tokës së madhe jam unë, / por gjithçka krijoj e zbuloj... / Në veten time fle një histori e përbotshme plot zhurmë, / Unë eci, s’ndaloj, transformoj...”<sup>34</sup>

## 2.2. Mbitheksimi i mëtejshëm i temës ideologjike

Kjo temë, po të perifrazojmë poezinë “Të shkruajmë baladë”<sup>35</sup>, shkruhet në “*mënyrë komuniste*”: “Të shkruajmë baladë për komunistin që ra, / të shkruajmë baladë në mënyrë komuniste/ Nuk ka rëndësi se kishte a s’kishte/ atë natë hënë dhe ujë mbi zallishte//Të shkruajmë baladë e të themi që ra/ I madh, i fuqishëm me plagë në kokë;/ të themi: u shtri dhe rrënjët i hodhi në tokë/ Dhe askush nuk guxon ta shkulë, shokë!”. Tiparet e kësaj poezie mund t’i shohim si një “*manifest*” i poezisë me temë ideologjike. Së pari, personazhi kryesor i kësaj poezie do të jetë poeti dhe komunisti shqiptar që bën çudira; partia komuniste shqiptare; udhëheqësi i saj legjendar, Enver Hoxha, jeta e lumtur e Shqipërisë socialiste, e cila edhe pse e izoluar nga bota, në varfëri dhe mjerim, qëndron krenare, si kështjellë e pamposhtur në brigjet e Adriatikut. Së dyti, poezia me këtë temë duhet të shkruhet në “*mënyrë komuniste*”, pra, në përputhje me porositë politike dhe kriteret estetike të realizmit socialist. Së treti, *mënyra komuniste* sjell *hiperbolizmin*, deformimin e së vërtetës jetësore dhe artistike, sipas logjikës që jep poezia: nuk ka rëndësi nëse kjo mund të ndodhë, ka ndodhur, apo s’ka ndodhur, rëndësi ka që ndryshe të shkruhet: “Të shkruajmë baladë e të themi që ra, / I madh, i fuqishëm me plagë në kokë/ të themi: u shtri dhe rrënjët i hodhi në tokë/ Dhe askush nuk guxon ta shkulë, shokë!”. Retorika, patetizmi,

33 *Po aty*, f. 446.

34 *Po aty*, f. 404.

35 *Po aty*, f. 168.

brohoritja, i japin poezisë me këto motive atmosferën propagandistike të realizmit socialist dhe parimeve të tij, frut i së cilës janë edhe poemat: “Devoll, Devoll” (1964), “Komunistët”, “Nëntoriada”, “Nënë Shqipëri” (1974) etj.

Por le të qëndrojmë te kryevepra e poezisë ideologjike të D. Agollit, që është padyshim poema “Nënë Shqipëri” (1974). Poema mbështetet në dy linja narrative poetike: në njëërën linjë poeti rrëfen vuajtjet e tij për të krijuar poemën e atdheut; në tjetrën, kërkon të ndërtojë mitin e atdheut dhe krenarisë kombëtare. Të dy linjat bashkohen përmes metaforës, që përbën titullin e poemës: *Nënë Shqipëri*. Metaforë, e cila ndërton edhe raportin ndërmjet poetit/birit dhe Shqipërisë/nënës. Vargjet në të cilat elementi ideologjik është ende i jashtëm, për shkak të frymëzimit dhe talentit të autorit, e ruajnë vlerën e tyre estetike dhe kuptimore të marra në kontekstin e kohës së krijimit, problemi si zakonisht qëndron me shndërrimin e temës ideologjike në kryetëm të poemës. Qëndrimi klasor dhe ideologjik ndaj ngjarjeve dhe figurave historike e politike çon në poetizimin nga këto pozita të historisë kombëtare dhe ndërkombëtare, d. m. th., në deformimin e tyre, sipas “mënyrës komuniste” të shkrimit. Qëndrimi klasor tendencioz, si parim i realizmit socialist, përgatit ardhjen në poemë të udhëheqësit “legjendar”, diktatorit komunist Enver Hoxha: “Ec ai që ti, Shqipëri, nënokja e maleve/ i thua me fjalën prindore:/ Bir!/[...] Dhe ti i thoshe: “Pri, /Biri i nënës, / Enver!”<sup>36</sup>. Poeti optimist pasi ka rrënuar klasat e përmbysura, shpall dominimin përfundimtar të shoqërisë shqiptare nga klasa punëtore, grushti i hekurt i së cilës do të binte mbi secilin që do të shprehej kundër saj: “Pa klasë puntore mendimi mbetet gjysmak, / Pa klasë puntore ndërgjegjja mbetet e cekët/ si lumi në gusht, / pa klasë puntore s’ka yll në bajrak/ pa klasë puntore njerëzit revolucionari/ S’i mbledh në të vetmin grusht!”<sup>37</sup> dhe pastaj: “Po klasa puntore lind gjenium e saj të vërtetë/ Mes dhembjes e gjakut, kur retë mbledhin stuhinë, / gjenium e madh, të urtë e të drejtë, / Gjenium më njerëzor-Partinë”<sup>38</sup>. Poema shndërrohet në një himn për dhunën e klasës punëtore, diktaturën e proletariatit që ua shtyp kokën atyre që mendojnë ndryshe, armiqve të saj: “I flak me tërbim si deti në breg leshterikët, / A s’flaku Lulot, Premtet, / Spahitë, Lubonjë,

36 D. Agolli, *Poezi. Tiranë, 1979, f. 609.*

37 *Po aty, f. 617.*

38 *Po aty, f. 618.*

Paçramët, / Rufjanët e zinj politikë?<sup>39</sup>. Këtu ngrihen pikëpyetje të mëdha mbi vlerën estetike të poezisë e cila shndërrohet në një pllakatë propagandistike të thatë, moralizuese e kërcënuese, që në fakt artikulon ferrin që kishte ndërtuar sistemi i ri, diktatura e proletariatit: “Shsht, komandoj unë/ Me diktaturën e proletariatit!”<sup>40</sup>. Dhuna psikologjike mbas këtyre vargjeve, me siguri mbështjell edhe lexuesin e mundshëm të kohës, të cilit shprehimisht i kërkohet të heshtë për çdo pakënaqësi, mendim ndryshe, sepse: “Ndaj socializmi godet/ Me çekanin e klasës me natë me ditë”<sup>41</sup>. Këtu mitizohet diktatura e proletariatit dhe humb gjithçka nga ëndrra idealizuese e Atdheut/Nënë Shqipëri. Nënë Shqipëria humb të gjitha cilësitë morale, etike, estetike që poeti me mjeshtëri dhe ndjeshmëri atdhetare i ka artikuluar në kapitujt e parë, ajo shndërrohet në një Nënë ideologjike, në një nënë mizore, që mbyl fëmijët e saj, me drapër e çekan: “Me çekanin e klasës me natë me ditë”. E meta e poemës është pikërisht, estetizimi i ideologjikes dhe dhunës së diktaturës; servirja e saj si përparim dhe sukses i Shqipërisë; servirja si çelësi magjik i të ardhmes së saj. Në poemë glorifikohet figura e diktatorit Enver Hoxha, i cili “gjasme” kthehet nga ara, rrin gju më gju me popullin, pi duhan dhe qan hallet me të dhe poeti mëson shumë nga udhëheqësi i dashur e i qeshur... Në kushtet kur kjo është vetëm hipokrizi e udhëheqësit, që kuron imazhin e tij në sytë e popullit poema vetëm sa bëhet pjesë e propagandës politike të regjimit komunist. Ndaj, edhe për poetin e indoktrinuar plotësisht, zgjidhja e problemeve të popullit shqiptar është: “Internacionale/ Do të jetë Bota e Re!”<sup>42</sup>. Mesazh, në të cilin, nuk ka më asgjë kombëtare, as humane; ndërsa është devijuar totalisht nga pikësynimi fillestar i poemës, duke rënë në ilustrim të ideologjizmit të doktrinës së m-l. Për ta interpretuar më mirë poemën na vjen në ndihmë receptimi i studiuesve të kohës, i cili vë në dukje parimet dhe idetë që e përshkojnë atë: “Idetë kryesore të poemës, në qoftë se do t’i përmblihdhnim shkurt janë: forca e njeriut tonë qëndron në lidhjet e tij me popullin, me tokën mëmë, me çështjen e ndërtimit të socializmit; shoqëria jonë ka si qëllim kryesor të saj të mbrojtje dhe të bëjë më të lumtur njeriun; historia e çlirimit të popullit nga shtypja, historia e ngritjes dhe e përparimit të punëtorëve, të fshatarëve si dhe e shtresave të tjera lidhet me ekzistencën e Partisë dhe me drejtësinë e

39 *Po aty, f. 626.*

40 *Po aty, f. 626.*

41 *Po aty, f. 625.*

42 *Po aty, f. 647.*

vijës së saj marksiste-leniniste; zhvillimi i paparë i jetës sonë dhe në përgjithësi, i shoqërisë socialiste, forcimi i vendit është arritur përmes luftës klasore, e cila ka qenë faktor përparimi, këndej buron edhe thirrja për vigjilencë, për të mos harruar strehën, për të luftuar burokratizmin e mendjemadhësinë, për të qenë i thjeshtë, për të ruajtur diktaturën e proletariatit dhe demokracinë socialiste; lumturia e popullit dhe e çdo individi është e lidhur me fatet e komunizmit, me Partinë, me çdo pëllëmbë toke të këtij vendi, me punën, me pyjet dhe lumenjtë, me bukuritë e pashoqe të atdheut; poezia duhet të jetë e fuqishme si jeta jonë, rrugët e kërkimit të saj janë të vështira, por poeti i Shqipërisë socialiste duhet të punojë dhe të jetë këmbëngulës për t’ia arritur krijimit të një poezie për popullin”.<sup>43</sup>

### 2.3. **Kalimet nga optimizmi, ideologjizmi në dramën e zhgënjimit dhe pesimizmit**

Pas rënies së regjimit komunist, në vitin 1990, sikurse edhe në poezinë tjetër shqipe, edhe për poezinë e D. Agollit kemi një ndryshim të rëndësishëm, që ka të bëjë me ndarjen nga ideologjizmi dhe zgjerimin e përmasës shpirtërore e universale të saj. Mund të thuhet, vargjet poetike artistikisht më të arrira Dritëro Agolli i krijoi, kryesisht, në mbyllje të shekullit të njëzetë dhe në fillim të atij të njëzetënjë.<sup>44</sup> Siç shprehet vetë poeti: “Për poetët e brezit tim erdhi koha e zhgënjimeve dhe e dilemave, erdhi koha e peshimit të atij materiali që e prodhuam, pa e harruar dhe pa e mohuar atë të bukur humane që kemi sjellë tek njerëzit. Por, ajo kështjellë idesh dhe idealesh që e kemi besuar ku përgjithësisht e ku pjesërisht, pothuajse u rrëzua dhe në muret e saj digjen zjarret e ëndrrave tona. Këto zjarre zgjojnë një poezi të një lloji tjetër, poezinë thellësisht shpirtërore, me të cilën poeti shpreh vetveten dhe ia rrëfen atë njerëzve pa fshehur asgjë”.<sup>45</sup> Me rastin e botimit të vëllimit poetik “Pelegri i vonuar” (1993), poeti përpiket të bëjë edhe një lloj “apologjie” për poezinë e mëparshme të shkruar në rrethanat ideologjike: “Ne besonim në ndërtimin e një shoqërie, ku njerëzit të jetonin në liri dhe në barazi, ku të mos kishte padrejtësi dhe gjytime ndërgjegjeje; besonim në një shoqëri të mendimit të lirë dhe të individit të lirë dhe prisnim që ajo të vinte, duke i falur shtrembërimet dhe gjytime që vinim re në të sotmen, pasi mendjen e kishim drejt të nesërme. Nuk e dinim se plaga e

43 *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Tiranë, 1978, f. 403-404.*

44 *A. Aliu, Don Kishoti shqiptar. Një histori ndryshe e letërsisë shqipe. Toena, Tiranë, 2010, f. 245.*

45 *D. Agolli, Pelegri i vonuar. Tiranë, 1993, f. 257.*

të sotmes bëhej kangrenë e të nesërme! Ardhja e shoqërisë së ëndërruar vonohej dhe ne, fëmijët e shekullit, ua hidhnim fajin paragjykimeve në mjegullin e kohës, duke arsyetuar se çdo gjë e re nuk e kishte të lehtë të hidhte rrënjë dhe të bëhej realitet. Teksa besonim, shoqëria ku jetonim sa vinte e bëhej më e zymtë dhe më mbytëse për njerëzit dhe poezinë. Në qafën e ëndrrave tona, me kalimin e viteve, shtrëngohej laku i litarit dhe ndjehej rënkimi i mbytur i tyre. Ne mezi merrnim frymë në vrimën e historisë<sup>46</sup>.

Nga rrafshi estetik/stilistik poezia e D. Agollit do të ruajë ato veçori karakteristike për periudhën e parë, ajo që ndryshon ka të bëjë me këndvështrimin e ri të realitetit të qenies njerëzore dhe me lirinë e shprehjes. Poeti artikulon shprehjen e tij artistike, pa sjellë ndryshime në llojin e vargut, strofave, figuracionit, por sjell ndryshime në tonin dhe rrafshin përmbajtjesor të poezisë, që kontraston shpesh herë me atë të periudhës së parë, duke nxjerrë në pah dyzimin e poetit. Agolli vijon të jetë poet që krijon një poezi të imazheve të larmishme, të ideve dhe të mesazheve të shtjelluara shkallë-shkallë, nga njëri varg në tjetrin, duke krijuar një poezi që artikulon probleme etike, morale, e filozofike të botës së individit dhe të shoqërisë njerëzore.

Ndryshimi i këndvështrimit ndaj të gjitha temave e motiveve ka sjellë ndryshime cilësore në qëndrimin e poetit ndaj jetës individuale dhe sociale, ndaj nocioneve themelore të ekzistencës, ndaj të kaluarës dhe ndaj të tashmes. Në periudhën e dytë të poezisë, megjithëse vijnë të jenë të pranishme elemente të poezisë romantike dhe realiste, mbizotërojnë temat metafizike dhe kontrastet e forta emocionale, të cilat, për studiuesit, kanë sjellë një rilindje poetike të autorit. Jo rastësisht poezia e kësaj periudhe përshkohet nga motive e tema metafizike, si: dhimbja, trishtimi, humbja, dëshpërimi, vetmia, vuajtja, vdekja, por edhe zhgënjimi dhe prirja drejt “fetares” apo figurave simbolike që kanë origjinë fetare.

Disa prej vëllimeve poetike të periudhës së dytë, janë: *Pelegriini i vonuar* (1993), *Lypësi i kohës* (1995), *Vjen njeriu i çuditshëm* (1996), *Kembana e largët* (1998), *Fletorka e mesnatës* (1999), *“Këngët e buzëqeshjes* (1998), *“Gdihet e ngryset”* (2000) etj. Në këto vëllime shfaqet poeti me ideal të humbur, që duhet të gjejë vlerën dhe kuptimin e jetës së vet dhe të brezit që përfaqëson, në kushtet e tronditjeve të mëdha të shoqërisë dhe të ndryshimeve rrënjësoretë rrugës drejt së

46 *Po aty*, f. 258.

ardhmes së saj të paqartë<sup>47</sup>; në kontrast të fortë me poetin e periudhës së parë, që vlerën dhe kuptimin e jetës e gjen në vlerat e diktaturës së proletariatit dhe besimit të plotë tek ideologjia marksiste-leniniste.

Rruga krijuese e poetit është rruga e një pjese të konsiderueshme të shoqërisë shqiptare përgjatë gjysmës së dytë të shekullit XX ku pati ëndrra të bukura por edhe gabime të mëdha që buruan nga koha, perceptimi i gabuar i realitetit, apo zelli i tepërt ideologjik. Prandaj, këto vëllime janë në kontrast të dukshëm me atë pjesë të poezisë ideologjike të periudhës së parë, dhe njëkohësisht janë shembulli i dyzimit të poetit, por edhe i shembullit se si do të kishte qenë poezia e Agollit, por edhe poezia shqipe pa kërkesën ideologjike dhe realizmin socialist.

Emblema e kësaj poezie është vëllimi “Pelegri i vonuar”, me të cilin autori hyn në një rrjedhë të re poetike prej nga burojnë dhe vëllimet tjera, të mëvonshme. Studiuesit, por edhe vetë autori e shënon dhe e shpreh këtë kthesë të fortë: “Pas një rruge të gjatë mundimesh dhe zhgënjimesh lindi një metaforë e re në poezi, metafora e iluzioneve e shoqëruar me ndjenjën e bashkëfajësisë dhe njëkohësisht atë të shfajësimit të poetit para shoqërisë, që nuk ka mundur ta thoshte më parë të gjithë të vërtetën”<sup>48</sup>; “... Boshti rreth të cilit vërtitet materiali i librit “Pelegri i vonuar” është ai i iluzioneve dhe deziluzioneve, i tragjedisë së një utopie dhe të një ëndrre. Me këtë material poetik artisti nuk përpiqet të provojë apo të vërtetojë diçka që ka ndodhur”<sup>49</sup>.

Vetë poezia me të njëtin titull ka vlerën e një “manifesti” të poezisë së krejt kësaj periudhe, të dramës së zhgënjimit si njeri dhe si poet nga e kaluara dhe e tashmja: “Unë jam prej kohësh pelegri/ Udhëtar në vendin e shpresës së thyer, / Jam ndarë pa dashur nga karvani im/ Mes shtigjeve nga vapa e shirat gërryer. // Kërkoj karvanin tim në rërë e në shpat, / Karvanin që e ka ndërruar drejtimin me kohë, / Ndaj në udhë jam krejt i humbur, jam fillikat/ Me shami të grisur lidhur në kokë”<sup>50</sup>. Libri është botuar menjëherë pas rënies së regjimit komunist dhe përmbysjes së “parajsës” socialiste, ku krahas mbytjes së “gjemive” të nomenklaturës politike dhe kulture, ka edhe mjaft shpresa për të ardhmen e popullit shqiptar. Autori, si poet dhe si pjesë e nomenklaturës kulturore të regjimit komunist, radhitet tashmë në shtresën e të zhgënjyerve nga regjimi të cilit i shërbyen, dhe zhgënjimi

47 Sh. Sinani, *Njerëzit e krisur*” të Dritëro Agollit. Tiranë, 2010, f. 163.

48 Po aty, f. 258.

49 Po aty, f. 259.

50 Po aty, f. 5.

artikulohet me dhimbje tragjike: poetikisht heroi lirik tragjik përjeton dramën dhe zhgënjimin e udhëtarit që ka humbur rrugën/karvanin e tij. Kujtojmë këtu një nga motivet themelore dhe komplekse të poezisë së periudhës së parë: udha/udhëtari. Ka ndodhur zëvendësimi i udhëtarit (të periudhës së parë) me pelegrinin.

Pelegrini nuk ka tashmë asgjë të përbashkët me udhëtarin optimist e materialist, të rrugëve të atdheut socialist që përmbys botën e vjetër në emër të së resë; poeti me pushkë e me penë që zbulon, transformon etj., që i gëzohet jetës së lumtur dhe ndryshimeve sociale-politike (“Udhëtoj i menduar”<sup>51</sup> etj. ), por është “pelegrini” i shkretë e i mjerë, me një “premtim” të parealizuar, “udhëtar në vendin e shpresës së thyer” që ka humbur “karvanin”, domethënë çdo gjë, sepse humbja e karvanit për pelegrinin në shkretëtirë është e barabartë me vdekjen. Vëmë re kalimin nga udhëtari i fortë, ideologjik, optimist, materialist, agresiv, i poezisë së periudhës së parë, në “pelegrinin” e lodhur, të etur e fillikat, të hutuar e të përloitur, që s’ di nga t’ia mbajë sepse ka humbur “karvanin”, shenjat orientuese, perspektivën e ekzistencës. Veçojmë kalimin nga: “Të ndiej në oshëtimën e historisë sime, / që nga gjeneza e gjer te socializmi/ të ndiej në të ardhmen që vjen me gjëmime, / që nga dita më e afërt e gjer te komunizmi”<sup>52</sup> në “udhëtar në vendin e shpresës së thyer”, “shtegtar i karvanit të humbur”<sup>53</sup>; është ky një kalim dramatik që shpreh dyzimin e poetit ndërmjet dy kohëve, shembjen e ëndrrave ideologjike dhe bashkë me to përjetimin e apokalipsit, humbjen e shpresës për atë çka sjell koha tjetër, ku mungojnë ëndrrat dhe iluzionet ideologjike. Ndaj mund të thuhet, se kjo poezi shpreh edhe dramën e zhgënjimit dhe hutimit, që pasoi për shumë krijues me rënien e regjimit dhe realizmit socialist. Atdheu, këtu nuk është më atdheu i shquar, Nënë Shqipëri me ngjyra të kuqe, të ndezura flakë, por është zëvendësuar nga imazhi i vendit anonim, pa emër, vulëhumbur, vendi i shpresës së thyer.

Siç e dimë, *pelegrini* është një besimtar që udhëton drejt Tokës së Shenjtë, pra e ka të përcaktuar objektivin e tij. Jo çdo udhëtar është edhe pelegrin. Ndërsa *pelegrini* i poetit e ka humbur rrugën dhe nuk e di as cakun ku do të mbërrijë. Një njeri që sillet kuturu në shkretëtirë nuk mund të jetë pelegrin, ndërsa një besimtar edhe kur ka humbur rrugën e ka të qartë vendmbërritjen, dhe mbetet pelegrin. Pelegrini

51 D. Agolli, *Vëpra letrare II. Tiranë, 1987, f. 12.*

52 Po aty, “*Atdhe*”, f. 22.

53 D. Agolli, *Pelegrini i vonuar. Tiranë, 1993, f. 5.*



i poetit jo vetëm ka humbur rrugën, por nuk flet as për cakun e tij. Sikundër shprehet studiuesi B. Kuçuku: “Zhgënjimi prej komunizmit, apokalipsi në botë dhe në ndërgjegje, realiteti i ri politik shqiptar tepër i turbullt, pasiguria e përgjithshme dhe vetjake dhanë një çarje të madhe, ndryshuan mënyrën e trajtimit poetik, duke e zhvendosur nga bregu i artë i himnizimit dhe idealizimit, pra i estetizimit të krejt botës shqiptare, në rrëpirat e zhgënjimit, mosbesimit dramatik dhe tragjik. Por mbeti ura lidhëse mbi këtë çarje të madhe: nuk humbi ndjenja e zbulimit të bukurës, qoftë edhe në jetën e tronditur e të çoroditur, nuk u tret thelbi idealist, por u zhvillua shumë më tepër, nuk u tjetërsua idealisti dhe as vetë poeti”.<sup>54</sup> Por, gjithsesi dallohet qartë sinqeriteti i poetit për përshkruar pozicionin e tij shpirtëror dhe intelektual në këtë kufi ku ndahen të dy kohët. Hutimi shpirtëror duket edhe në strofën e fundit të vjershës, ku poeti barazon “pelegrinin” me “shtegtarin”, dy nocione krejt të ndryshme: Unë jam prej kohësh pelegrin, / Shtegtar i karvanit të humbur”<sup>55</sup>. Një pelegrin, nuk është thjesht shtegtar dhe një shtegtar nuk është pelegrin. Pelegrini ka të veshur si petk besimin fetar.

Ndërkohë në poezinë “Pritja e diçkaje” poeti pret “Të nisë çdo gjë nga fillimi...”.<sup>56</sup> Ndërsa në poezinë “Pasqyrimi”, gjuha poetike bëhet edhe më e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, poeti e sheh veten edhe më vulëhumbur: “Po s’isha unë, ish një mjeran i sflitur/ me torbë të mbushur plot brengë e zhgënjime”<sup>57</sup>. Drama e zhgënjimit tek poezia “Vështrim pas gjurmëve”, është e përzier me bashkëfajësinë për atë që ka ndodhur në të kaluarën, ku poeti nuk e kishte të mundur ta shprehte të vërtetën dhe që i detyruar të gënjente herë pas here, lexuesin, popullin e tij: “Më lodhi mundimi në shpirt tërë jetën/ Ta them lakuriq të vërtetën, // Po s’munda ta them ngaherë të plotë, / Se ishte zuskë kjo botë// Tani më vjen keq për aq sa gënjeva”.<sup>58</sup> Edhe në poezinë “Kishat e shëmbura”, kemitë njëjtën ndjenjë të bashkëfajësisë për të kaluarëateiste, të diktuar nga regjimi komunist, por edhe nga zelli i tepërt antifetar i shumë shkrimtarëve: “I shembëm kishat e xhamitë, / E mburrëm shembjen me zjarr e me hekur/ Dhe thamë: u shporrën nga ne perënditë!// Por në gërmadhat e tyre tymonte shpirti i pavdekur/ Dhe

54 B. Kuçuku, “Përtëritje të lirikës shqiptare”. D. Agolli, “Lutjet e kambanës”. Tiranë, 1998, f. 343.

55 D. Agolli, *Pelegrini i vonuar*. Tiranë, 1993, f. 5.

56 *Po aty*, f. 46.

57 *Po aty*, f. 49.

58 *Po aty*, f. 23.



zoti nga ne ngrinte kokën e thinjtë/ Mes tymit të hirtë... ”<sup>59</sup>. Ndërkohë në poezinë “Di pak më shumë”<sup>60</sup> poeti përpriqet të reflektojë edhe më tej për të kaluarën e vështirë nëpër të cilën eci shoqëria shqiptare dhe poetët e saj: “Ç’ti bësh? Shekulli më ngarkoi me një barrë/ Tek eca rashë, por zotit falur, eca e krejt nuk rashë... ”. Në ndonjë poezi tjetër poeti e shpall me pezëm pafuqinë për t’i realizuar ëndrrat apokaliptike të brezit të tij: “Kënga e të dëshpëruarve”: “Po, ishim vërtetë romantikë/ kërkonim përmbysjen e botës, / por bota na ktheu në alkoolikë/ na mbyti në fundin e gotës”.<sup>61</sup> Është e shprehur drama e një brezi që të trullosur nga ëndrrat ideologjike e utopike, të etur për krijimin e një “bote të re” duke përmbysur të vjetrën, në fakt e shndërruan vendin ku jetonin në një ferr për të tjerët, por edhe për veten e tyre. Ironia e ekzistencës, ku marrëzja dhe mençuria shkojnë për dore.

Në poezinë e periudhës së dytë, motivi më i pranishëm që kombinohet edhe me motive të tjera është ai i jetës dhe vdekjes, që rrjedhimisht kombinohet me motive, si: e përkohshmja e përjetshmja, rinia, pleqëria, dhimbja, vuajtja, të cilat mbitheksohen nga motivi i zhgënjimit. Në poezitë e këtij motivi, poeti vlerëson jetën dhe vdekjen me dinjitet të njeriut. Në poezinë “Tani më duhet të mësoj”<sup>62</sup> poeti i drejtohet vetes se pasi ka mësuar aq shumë gjëra në jetë, pasi ka mësuar të jetojë, i duhet të mësojë edhe të vdesë. Fati i qenies njerëzore që është e vdekshme.

Edhe në poezinë “Sot pasdite”<sup>63</sup>, shtjellohet tema e jetës dhe vdekjes, duke kërkuar një varrim pa nekrologji, pa fjalime, pa lëvdata dhe pa shumë njerëz, sidomos pa lotët e lëvdatat e të ligjve. Ndërsa në poezinë “Frika e vdekjes”, poeti ka frikë se mos vdekja i vjen në formën e sklerozës, në jetë dhe në poezinë e tij: “Vetëm një gjë kam frikë nga vdekja:/ Mos vdes me sklerozë, / me mendje të prishur, i ikur nga vetja/ Në hiç, në hi e në blozë...”<sup>64</sup>.

Kombinimet motivore janë të pranishme edhe brenda një poezie të vetme, si në rastin e poezisë “Ëndrra e prerë”<sup>65</sup>. Poeti i drejtohet dikujt që është duke vdekur (nënkupto, edhe vetes): “Mos vdis!” sepse misioni nuk është kryer, ëndrra nuk është realizuar. “Ne ëndërronim të bënim

59 *Po aty*, f. 25.

60 *Po aty*, f. 130.

61 *D. Agolli, Fletorka e mesnatës. Tiranë, 1998, f. 40.*

62 *Po aty*, f. 64.

63 *Po aty*, f. 57.

64 *Po aty*, f. 86.

65 *Po aty*, f. 99.

një anije, / Kurrkush s'e mendonte me ç'dru do ta ngrinim, / Kishim ndërmend ta ndërtonim me dru hardhie/ Dhe vela t'i vinim". "Mos vdis!" sepse është ende herët për të vdekur: "Mos vdis në dhomën e heshtur i shtrirë, / Është turp kaq shpejt të rrish e të vdesësh". Gjithashtu shprehet përsëri zhgënjimi për të tashmen dhe pendesa: "Ne ëndërronim një vdekje pak më të mirë:/ Duke vdekur fytyrat tona t'i shihnim në pikën e vesës", pra vdekja pak më e mirë është vdekja dinjitoze përballë vetes dhe të tjerëve, gjë e cila nuk është plotësisht e mundur me sa duket, sepse e shkuara ka lënë gjurmët e saj në fytyrën e njeriut, e cila nuk është më aq e pastër sa të pasqyrohet në pikën e vesës. Prandaj pa ndërtuar një "vdekje pak më të mirë" nuk duhet vdekur, sepse për qenien njerëzore jeta dinjitoze duhet përmbyllur edhe me një vdekje të tillë.

Ndonjëherë poeti dëshiron të vdesë për t'i hequr qafe disa njerëz që i kanë mërztur jetën, por ndërron mendje: "Po shpejt u pendova: s'do vdes/ Se dua të gjej origjinën tuaj prej qeni"<sup>66</sup>. Meditimi për vdekjen dhe ekzistencën e njeriut, poetin ateist të periudhës së parë, e bën fetar dhe meditues për perëndinë si në poezinë "Fluturat e varrezave"<sup>67</sup>: "Bëhem fetar kur shkoj në varreza:/ Vërtet nga vetja më vjen çudi!/ Rreth meje flutura të zeza/ Me krahë të zi/ [...] Pa dashur të sjellin në mend perëndinë/ Edhe sikur të jesh ateist".

Referenca në librat e shenjtë, Bibla, Kurani, dhe figurat simbolike të tyre, si: Adami, Eva, Krishti, Juda, Muhameti etj., prej këtij vëllimi poetik bëhet një referencë aktive e reflektimit etiko, moral, fetar e filozofik si mënyrë analize e jetës së gjallë. Nëse gjatë periudhës së parë kjo referencë është tërësisht mohuese/përkeqësuese, tani ajo bëhet referencë pohuese, vlerësuese, por edhe kontradiktore. Në moshë të thyer poeti duket sikur dëshiron t'u kthehet rrënjëve të tij, tek poezia "Me një prift në tavernë": "I kam të parët katolikë, / I kam të dytët bektashinj, / Dhe unë i treti asnjëçikë, / S'besoj në shpirta dhe qirinj"<sup>68</sup>/ Se m'u mërztitën gjyshrit shumë, / që fetë i kthenin mot për mot, / Ndaj hoqa dorë i shkreti unë, / Nga çdo besim e nga çdo zot..."<sup>68</sup>

Pavarësisht toneve të errëta dhe gri që dominojnë në poezitë me motivin e vdekjes, përsëri poeti ka vetëdijen se tek poeti vdes trupi por jo shpirti, si në poezinë "Pastaj"<sup>69</sup>, në të cilën pasi shpjegon se bota do të

66 *Po aty*, f. 121.

67 *Po aty*, f. 123.

68 D. Agolli, *Lypësi i kohës. Tiranë, 1995*, f. 33.

69 *Po aty*, f. 160.

vazhdojë rrugën e vet edhe pasi ai të ketë vdekur, por: “Ndonjë poetuc do bëjë me kokë:/ “Nuk qenka çrrënjosur ende ky qen?”/ Dhe hiri im do përgjigjet nën tokë:/ “Jam hiri, të zotin në libra e gjen”!... ” Ide që e gjejmë të artikuluar që herët në poezinë “Kur të jesh mërzhitur shumë” (1983)<sup>70</sup>, në të cilën i drejtohet të dashurës për ta ngushëlluar kur ai të mos jetë më: “Po kur të jesh mërzhitur shumë/ Në raft të librave kërkomë, / Atje do jem i fshehur unë, / Në ndonjë fjalë e ndonjë shkronjë”.

Nëse në përmbledhjen “Pelegrini i vonuar”, në poezitë e këtij motivi dominon toni melankonik e deri tragjik; në vëllimet e mëvonshme, ky ton kalon në ton ironik e humoristik, si në poezinë “Pleqtë e hyrjes së parë”<sup>71</sup>: Pasi përshkruan se pleqtë po rrallohen, vëren me humor se ai dhe fqinji i tij Jashari janë ende gjallë dhe presin se cili do të ikë më parë: “Kështu, vëllezër, jam pak më i vështiri, / S’largohem po s’u nis andej Jashari, / Ta shoh si ndrit në varr të tij qiriri, / Të kem dhe një përvojë për së mbari”. Ndërsa në poezinë “E rëndë është jeta”, pasi rendit disa prej shpjegimeve pse është e tillë, poeti përfundon në ironi dhe humor: “ E zuri një burrë të ndershëm kolera, / Një plake i ra nga ballkoni një vazo në kokë... / E rëndë është jeta si gjërat e tjera, për vdekjen kjo dihet me kohë”.<sup>72</sup>

Në mjaft prej poezive të D. Agollit të periudhës së dytë, dallohet gjendja e krizës etiko-morale, por edhe estetike e poetit që diktohet sa nga rrethanat e reja sociale e politike aq edhe nga pengjet, deformimet dhe plagët e së shkuarës. Ai shpesh ndodhet ndërmjet ekstremesh etiko-morale, të cilat dalin edhe si gjendje pa rrugëdalje të ndërgjegjes së trazuar të heroit lirik, aq edhe si gjendje e individit dhe shoqërisë shqiptare të kësaj periudhe. Shembulli më tipik i kësaj gjendjeje është poezia “Judë e Krisht”<sup>73</sup>. Juda, tradhtari dhe Krishti, misionari/shpëtimtari i njerëzimit, sipas besimit të krishterë. Megjithëse Agolli “mburret” herë pas here me ateizmin e tij, parapëlqen që në mjaft prej poezive të periudhës së dytë, të përdorë personazhe e figura biblike e kuranike, si përçuese të mesazheve etiko-morale e filozofike. Mirëpo, për arsye të kuptueshme i përdor ato me një lirshmëri artistike që ndonjëherë krijojnë edhe situata paradoksale nga pikëpamja etiko-morale, estetike dhe fetare. Gjendja pa rrugëdalje, e artikuluar në këtë poezi, është ilustrim i krizës shpirtërore, etiko-morale, të “heroit lirik”

70 D. Agolli, *Udhëtoj i menduar. Vepra letrare 11*. Tiranë, 1987, f. 54-55.

71 D. Agolli, *Lypësi i kohës*. Tiranë, 1995, f. 18.

72 *Po aty*, f. 66.

73 D. Agolli, *Lutjet e këmbanës*. Tiranë, 1998, f. 9.

dhe të një pjese të shoqërisë shqiptare, e cila vuan prej komplekseve dhe plagëve të së shkuarës dhe të tashmes. Kjo gjendje krizës edhe në perceptimin e vlerës dhe antivlerës, prodhon situata alogjike jo vetëm nga pikëpamja fetare, por edhe nga pikëpamja e boshtit etik e moral të njeriut si qenie. Duke dashur të japë natyrën kontradiktore të njeriut “si një kundërshti e plotë, antinomi e vetvetes”<sup>74</sup>, poeti shkon në ekstremitetet e dyzimit dhe tjetërsimit saj: “I penduar shkoj drejt Krishtit, / Ik nga Krishti, bëhem djall”. Sipas një reflektimi të thjeshtë, një i penduar (akt shumë i rëndësishëm dhe i thellë në besimin e krishterë dhe jo një trill dosido) që shkon drejt Krishtit, nuk ka se si njëkohësisht të ikë nga Krishti dhe të “bëhet djall” (fundi i çdo vlere etiko-morale, estetike e fetare). Njeriu në besimin e krishterë, pendohet dhe merr në zemër Krishtin, ose nuk pendohet dhe ia shet shpirtin djallit. Njeriu i penduar në Krishtin, që e ka pranuar Krishtin, nuk mund të bëhet njëkohësisht djall. Pra, një i penduar në Krishtin edhe sikur të dëshirojë nuk mundet të shkojë më drejt djallit, ose atëherë pendimi i tij ka qenë një hipokrizi, pendim i rrejshëm. Vlora e pendesës këtu përmban forcën ta shmangë njeriun nga djalli. Prandaj situata poetike del paradoksale por shpreh në thelb dyzimin dhe tjetërsimin e heroit lirik. Nga ana estetike, “kthimi në djall” është njësimi me të keqen, të shëmtuarën, përkundra pendimi dhe marrja në zemër e Krishtit është njësimi me të mirën, dashurinë, të bukurën etiko-morale por edhe estetike.

Gjendja e krizës dhe pamundësisë për të bërë zgjedhjen e duhur, pamundësia për të përcaktuar qëllimin e ekzistencës mbishtresohet edhe në strofën përmyllëse të kësaj poezie: “Hesht në prehje, rend në lodhje, / Njëren ndreq e tjetren prish;/ Kur mbledh lule, dua rrodhe, / Guvë e jetës- Judë e Krisht!”. Subjekti lirik këtu është në kaos me kuptimin dhe qëllimin e ekzistencës, dhe nuk di se çfarë kërkon dhe çfarë bën me ekzistencën e tij, ndaj e përjeton atë si gjendje kontradiktore, paradoksale: ndërmjet Judës dhe Krishtit, përkatësisht ndërmjet tradhtarit: hipokritit, djallit; dhe heroit: vlerës në jetë, misionarit/shpëtimtarit të njerëzimit në rrafshin etiko-moral e fetar. Mirëpo edhe kjo gjendje është alogjike, e papëlqyeshme si në aspektin etik-moral, fetar, estetik por është si e tillë, gjendje kontradiktore e një pjese të shoqërisë shqiptare që qëndron pezull pa ditur nga t’ia mbajë; drejt Krishtit: të mirës, të bukurës, besnikërisë, dashurisë, drejtësisë, sinqeritetit, vlerës së jetës apo drejt Judës: të shtrembrës, të shëmtuarës,

74 B. Kuçuku, *Pas eklipsi letrar. Tiranë, 2014, f. 149.*

tradhtisë, hipokrizisë, korrupsionit, antivlerës; apo paradoksalisht në atë gjendje budallëku që jeton, drejt të dyve, gjë e cila nuk mund dhe nuk ka kuptim të bëhet. Arsyeja nga rrafshi kuptimor është e qartë, njeriu i cili e jeton ekzistencën e tij ndërmjet Judës dhe Krishtit, nuk mundet ta jetojë këtë ekzistencë, sepse kjo do të ishte hipokrizi e të jetuarit dhe e të ekzistuarit. Sipas legjendës biblike, Juda, një nga dishepujt e Krishtit e tradhëton Krishtin, duke e spiunuar te ushtarët romakë, dhe Krishti, megjithëse tradhtia e tij e çon në kryq, e fal atë por nuk pajtohet me aktin e tij, që është një akt i shëmtuar. Pra, zgjedhja e subjektit lirik është një zgjedhje në konfuzion të plotë që shpreh krizën e horizontit të vlerave, sepse në jetë dhe në art njeriu mund të zgjedhë si ideal etik, moral, fetar, estetik ose Krishtin, ose Judën (në kuptimin e vlerës dhe antivlerës), ose jetën e njeriut pa Judën dhe pa Krishtin; por edhe nëse nuk ka mundësi të zgjedhë, vetë jeta do t'ia imponojë, edhe pa qenë i vetëdijshëm, të zgjedhë ose njërin ose tjetrin.

### **Përfundime**

D. Agolli është njëri ndër poetët e rëndësishëm të letërsisë shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XX. Poezia e tij (sikurse pjesa më e madhe e letërsisë së shkruar gjatë regjimit komunist), pas kaq vitesh, ka nevojë për një vështrim tërësor dhe objektiv të kuadruar saktë në problematikën komplekse të kohës së krijimit të saj, si edhe pa rënë në mohim por as edhe në mitizim.

Për lehtësi studimi, krijimtaria e poetike e këtij autori mund të shihet e ndarë në dy periudha: nga fillimet deri në vitin 1990, dhe prej këtej deri më sot. Në periudhën e parë, ajo karakterizohet nga një ndërthurje të temës ideologjike me temën universale; ndërsa në periudhën e dytë, nga një prani e lirë e temës metafizike. Stilistikisht poezia e Agollit ndjek rrugën e saj që nga fillimet e deri më tani, ndryshimi i ndodhur pas rënies së realizmit socialist është kryesisht përmbajtjesor, tematik e motivor.

Në ato poezi dhe poema, ku tema ideologjike shtjellohet si kryetemë, pavarësisht talentit artistik dhe frymëzimit të autorit, në vështrimin e sotëm të leximit dhe studimit, kemi shndërrimin e veprës letrare në një ilustrim të propagandës ideologjike, rrjedhimisht bjerrje të vlerave universale artistike. Si të tilla, këto krijime sigurisht nuk kanë nevojë të përjashtohen as nga leximi dhe as nga studimi, përkundrazi mund të lexohen dhe të studiohen si vepra *eksperimentale*, për të kuptuar nivelin

e instrumentalizimit të letërsisë nga ideologjia politike. Ka më shumë mundësi t'i rezistojë kohës poezia e të dy periudhave, që përshkohet nga motivet universale dhe metafizike, poezi në të cilën shprehet bota e vërtetë dhe mjeshtëria poetike e autorit.

### **Bibliografia:**

- Agolli, D. Fletorka e mesnatës. Tiranë, 1998.*  
*Agolli, D. Poezi, Tiranë, 1979.*  
*Agolli, D. Udhëtoj i menduar. Vepra letrare II. Tiranë, 1987.*  
*Agolli, D. Pelegrini i vonuar. Tiranë, 1993.*  
*Agolli, D. Lypësi i kohës. Tiranë, 1995.*  
*Agolli, D. Dritëro. Lutjet e këmbanës. Tiranë, 1998.*  
*Agolli, D. Jeta në letërsi. Tiranë 1987.*  
*Aliu, Ali. Don Kishoti shqiptar. Toena, Tiranë, 2010.*  
*Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Tiranë, 1978.*  
*Kadare, I. Autobiografi e popullit të vargje. Tiranë, 1971.*  
*Kadare I. Vepra letrare I. Tiranë, 1981.*  
*Kuçuku, Bashkim. Pas eklipsi letrar. Tiranë, 2014.*  
*Lëngu, I. "Imazhi poetik dhe disa veçori të tij te Agolli, Arapi, Spahiu". "Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare". Prishtinë, 2005.*  
*Selmani, Ahmet. Bashkëbiseduesit e mi. Tetovë, 2001.*  
*Sinani, Sh. "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit". Tiranë, 2010*  
*Sinani, Sh. "Mitet dhe demonët e letërsisë së realizmit socialist". Letërsia shqiptare e realizmit socialist. Studime albanologjike. Universiteti i Tiranës, viti XV, 2010/2.*  
*Vinca, A. Alternativa letrare shqiptare. Shkup, 1995.*  
*Zisi, R. Letërsia bashkëkohore shqipe-poezia. Tiranë, 2008.*

Khahid **BUSHATI**

## **SHQYRTIME KRITIKE MBI VJERSHAT PËR FËMIJË E MË GJERË TË NDRE MJEDJES**

1.

Dom Ndre Mjedja është larguar nga kjo jetë 81-vjet më parë. Çdo vit që kalon, nuk bën gjë tjetër veçse dimensionon dhe ridimensionon figurën e tij prej poeti, prozatori, gjuhëtari, hartuesi i teksteve shkollore e pedagogu mendjendritur. Siç shikohet, Mjeda ishte dhe mbetet një figurë poliedrike. Pra, ka shumë fusha pamjeje për t'u studiuar. Nga gjurmimi im për këtë figurë, për disa fushë-pamje, argumenti shkencor, letrar e artistik ende nuk është shterruar, ashtu si nuk është shterruar edhe thellësia e fjalës për të.

Për vetë vitet që jetoi e kaloi Mjedja, për procesin e tij shumëplanësh studimor; historiografia letrare para viteve '90, në analizat e përfundimet e saj e kanonizuan figurën e Mjedjes duke e gjykuar sipas parimeve të metodës së realizmit socialist. Dëmi, që i kanë shkaktuar kësaj figure të traditës e me jetësi bashkëkohësie, është aq i madh, sa edhe sot e kësaj dite disa dukuri që duhet të kapërceheshin, kanë mbetur në udhëkryq, veçanërisht me strukturën gjuhësore të të folmes e të shprehësisë poetike të Mjedjes. Shpesh botimet e sotme mjedjane, në një farë mase po ia humbin identitetin poetit. Ndërsa pas viteve '90, studimet kanë më të thelluara dhe me kahje gjithëpërfshirëse. Po përmend disa syresh: Mark Gurakuqi, Vehbi Bala, Jup Kastrati, Rinush Idrizi, Sabri Hamiti, Mentor Quku, Rexhep Ismaili, Dhurata Shehri.

2.

Ndre Mjedja, përveçse ishte një poet i shquar dhe realist; por ishte dhe një poet 'i amël' e 'ngjyrë vjollcë' si vetë pranvera. Ai lindi më 20 nëntor të vitit 1866 në Shkodër. E deshti shumë këtë qytet Verior, sa 'lamtumirën e fundit' ia dha vetëm Vendlindjes përmes vargut që i buroi

nga zemra e shpirti: “Lamtumirë, o mori Shkodër!.. ” “Lamtumirë, o mori Shkodër!.. ” - kësaj here si Mësues i Gjuhës Shqipe, po jepte një lamtumirë plot dhimbje.

3.

Për Mjedjen dhe krijimtarinë e tij poetike për fëmijë, prej kohësh më ka munduar pyetja: “A ishte një fenomen letrar Mjedja? Nga studimi im për këtë figurë madhore, më rezultoi se ishte dhe mbetet i tillë edhe sot e kësaj dite. Siç thotë studiuesi Rinush Idrizi: “Dom Ndre Mjedja nuk është një subjekt i thjeshtë për një biografi. Ai ishte një njeri i madh në një vend të vogël; jo të vogël për nga popullsia dhe sipërfaqja, por për nga niveli kulturor i epokës së tij, sensi historik dhe vizioni kohor.”<sup>1</sup> E në vazhdim të përgjigjes së mëtejshme të pyetjes sime, më vijnë ndihmë edhe fjalët e studiuesit Sabri Hamiti, i cili thotë: “Të lexohet Mjedja sot. Të shkruhet për Mjedjen sot: përpara del një problem me ngarkesë të dyfishtë. E para, poezinë e tij e kemi pasur jo vetëm lekturë të obligueshme, po edhe të dashur që nga mësimet e para të letërsisë në fillore. Shumë ide të tij, vargje të tij, shumë vjersha të tij, jo vetëm se i kujtojmë përmendësh, po i kemi bërë edhe pronë të dijes personale, na kanë hyrë në mënyrën e të menduarit. Pra, lexuesi jo rrallë i përdor si vlera të vetat. Vështirësia rritet mu këtu: si të hidhet përpara në fushën e analizës teksti, i cili njëherë është pranuar me adhurim.”<sup>2</sup>

Duke qëmtuar shkrimet për Mjedjen, të cilat janë të gjinive dhe zhanreve të ndryshme, si dhe studimet; qasjet ndaj kësaj letërsie fëmijërore mjedjane, më rezultojnë se studiuesit janë përqëndruar kryesisht si objekt shqyrtimi tek vëllimi me poezi “Guxo”. Por, në vite, ka edhe shqyrtime të tjera si këto: 1. Larmia e motiveve dhe e formave artistike, 2. Vlerat artistike dhe edukative në poezinë fëmijërore të Mjedës, 3. Karakteristikat e vargjeve të amla, 4. Poet i gjuhës ‘si diell pa hije’, 5. Veçoritë e rimës në poezinë e Ndre Mjedës, 6. Struktura e vargut, 7. Vjersha të motivuara nga realiteti jetësor i botës së fëmijëve, etj.

Prijëtarë të studimeve për poezinë për fëmijë e për tekstet shkollore, ku dritësonte emri itë Mjedjes ishin: - (pa autor) Një jubile, 70-vjetori i lindjes së Ndre Mjedës, - Nga jeta e tij, “Cirka”, nr. 13-14, 27. 12. 1936, f. 216-217; - Dom Ndre Mjeda vdiq në Shkodër, Gazeta Shqiptare, nr. 1 Idrizi, Rinush: *Ndre Mjedja, botim i dytë i ripunuar*, Onufri 2017; *Një fëmimi e ndërprerë...*, f. 11.

<sup>2</sup> Hamiti, Sabri: *Ndre Mjedja: Shtëpia Botuese FAIK KONICA, Prishtinë 2016, Ndre Mjedja poet*, f. 7.



185, 06. 08. 1937; - Ernest Koliqi: Dom Ndre Mjeda (kryeartikull për vdekjen e tij), revista “Cirka”, Shkodër, viti i dytë i botimit, nr. 28-29, 05. 09. 1937; - Antonin Fishta: “Në dekë të Ndre Mjedës”, “Hylli i Dritës”, nr. 7-8, 1937, f. 414-416; - Jakov Milaj (me pseudonimin Horus): Dom Ndre Mjeda, nekrologji, shënime biobliografike, “Përprjekja Shqiptare”, nr. 11-12, shtator 1937, f. 263-264. ; për të vazhduar në vite me studiues, shkrimtarë e kritikë, si: Gjergj Fishta, Injac Zamputi, Kolë Ashta, Pashko Gjeçi, Justin Rrota, Eqrem Çabej, Mark Gurakuqi, Vehbi Bala, Jup Kastrati, Nexhat Hakiu, Razi Brahimi, Sabri Hamiti, Rinush Idrizi, Ejup Idrizi, Bedri Dedja, Astrit Bishqemi, Rexhep Qosja, Drago Siliqi, Llazari Siliqi, Dalan Shaplllo, Selami Tabaku, Andrea Varfi, Ramazan Çadri, Odhise K. Grillo, Agim Deva, Xhevat Sylja, Shefik Osmani, Hasan Hasani, Faik Shkodra, Veli Veliu, Pandora Dedja, Sokol Jakova, Stavri Kristo, Myzejen Velça, Afërdita Andoni, Nexhip Ejupi, Ilias Larashi, Neshyt Sadiku, Nehas Sopaj, Rizah Sheqiri, Nol Berisha, Fejzi Bojku, Nonda Bulka, Nikë Ukgjini, Anton Çetta, Kin Dushi, Zihni Sako, Mark Ndoja, Ali D. Jasiqi, Vehbi Kikaj, Rushit Ramabaja, Dashnor Kokonozi, Milazim Krasniqi, Kastriot Mahilaj, Mark Marku, Shefqet Riza, Bardhyl Xhama, Shkëlqim Zjarri, e për të arritur tek ai studiues që me kolanën e tij të përgatitur plot kulturë e klas i dha shkëlqimin e vërtetë Mjedës, dhe ky ishte Akademiku i palodhur Mentor Quku.

## 4.

Fenomeni Mjeda! Për një fenomen të tillë letrar, ku epika, lirika dhe filozofia; ku urtia, zotësia dhe largëpamësia shfaqen estetikisht harmonishëm, - me të drejtë studiuesi Sabri Hamiti teksa analizon në mënyrë të thukët *Stinët e jetës*, - citon kështu: “... te cikli i vjershave për stinët: *Pendvera, Vera, Vjeshta e Dimni*, që në thurjen e tij poetike nuk janë stinë të natyrës, por stinë të jetës së njeriut, të mbytura në metafizikë. ... Në të katër stinët është uni i tij që lakohet poetikisht duke përvetësuar në intimitet figurat e mëparshme të poezisë së vet, natyrën e njeriut, gjendjet shpirtërore e përngjasimet e jashtme. ... Vjen *Dimni* me metaforat e shkuarjes, vdekjes: Murlani, Stuhia, Akulli, Ngrica, Pika e gjakut. *Po del dimni me kosë ndorë*, po ashtu, *Qet balkoni pjalm e borë*. Atëherë lutja e fundit e shqiptuar nga dimri si stinë e natyrës, apo e shqiptuar nga njeriu (poeti) si stinë e jetës: *Struku, struku, i shkreti plak*, është hyrje në elegjinë e përbotshme personale.”<sup>3</sup>

3 Sabri Hamiti: *Ndre Mjedja: Shtëpia Botuese FAIK KONICA, Prishtinë 2016, 2. Stinë e jetës, f. 78 -79.*

5.

Edhe pse kaluan më shumë se një shekull e gjysmë nga lindja e atij njeriu zëmardh që fëmijëria e tij bashkëjetoj me varfërinë e skamjen; sot Mjedja na vjen më i dritshëm se kurrë, më real se kurrë, më madhështor e hapësinor, më i ëndërrt se kurrë. Plaku i moçëm Ndre, i fundmi i Rilindasëve dhe i pari i Modernëve, për kohën që jetoj dhe udhëtoj edhe përtej saj, ishte poeti më interesant, më i papërsëritshmi në rrëfimin e poetikën të poezisë shqipe për fëmijë. Mjedja vazhdoi traditën e gjithë rilindasve, e në mënyrë të veçantë të N. Frashërit, S. Frashërit, K. Kristoforidhit, etj., të cilët, nëpër librat shkollorë botuan edhe krijime për të vegjëlit. Aq shumë e çmuan këtë brezni, sa i falën edhe shpirtin, edhe talentin. Sepse poezia e Mjedjes mbartëte një realitet magjik. Me këtë magji e nektar mbushi zemrat e shpirtrat e fëmijëve (carrokëve). Se, vetë, shpirti i Mjedjes ishte i drithshëm si një gjethe, si një pupël zogu, i dridhshëm si ajri, si një agim i bekuar. Bekoi çdo poezi me vargje muzikale (të lëmuara), me plot figura si bukureza në një natë maji. Se, vetë, shpirti i Mjedjes (Mjedologjisë) ishte amanet: Guxo! Guxo – ishte lejtmotivi i këtij cikli të gjerë, me shumë rrezatime kushtuar fëmijëve e poezisë së kësaj moshe. Duke iu drejtuar kësaj moshe, vargjet e Mjedjes kanë si bërthamë elementin edukativ e moral, përmes së cilave ai shpreh dëshirën që fëmijët të rriten trima, të mësuar, të thjeshtë, të pastër (me virtyte), të sjellshëm me shokët dhe prindërit, me të gjithë njerëzit e punës. Brenda kësaj substance ishte dhe thirrja diturore, dhe porosia prej Mësuesi e Didakti, prej Prindi e Poeti : “Çfarëdo sendi me fitue, / Trimni lypet e guxim.”

E, kur “Lundërtar-i qi s’rrezikohet, / Kur a deti shkum’ e valë”, sepse ‘shëtiti’ nëpër hapësirat poetike të vjershës “Guxo”, më sjell në mendje një poezi të FriedrichNietzsche, i cili thotë: “Që kur u lodha së kërkuari, / Unë mësova të gjej. ... Që kur një erë më ngadalësoi anijen / Nisem për lundrim sapo fillojnë erërat”.

Gjithashtu më sjellë në mendje edhe një arsyetim analitik plot dije e kulturë të Prof. Vehbi Balës që portretin e Mjedjes si stilist, e shikon në këto rrafshë: “\*Mjeshtria teknike – figurative e Mjedës është për t’u çmuar vërtet. \*Metrika dhe prozodia shqiptare kanë se çfarë të trashëgojnë nga arritjet e tij profesionale. \*Gjuha poetike e Mjedës është shumë e pasur në fjalor dhe në ndërtimin elokuent të frazës, .... \*Figuracioni i tij artistik është po aq i pasur dhe i ngritur me shije të hollë prej liriku dhe pikëzuesi plastik.”

6.

Ndre Mjeda i urtë shkroi për dijen dhe urtësinë. Reflekset e mendimeve dhe të mesazheve xixëllojnë pothuajse në të gjitha poezitë. Herë janë në formë porosie, herë janë në formë këshille. Sido që të jenë, ato nuk janë të mërzitshme, as moralizuese. Janë jashtë kornizave dhe standarteve që gëlonte poezie para kohës së Mjedës dhe pas kohës së tij. Mjeda ndriçoi kohën e vet përmes një poezie të zhdërvjelltë e me vlera virtytësh. Mjeda ‘dritën e diturisë’ e çoi më tej. E çoi në ato lartësi sa urtësinë e ndërtoi dhe në formula përmbyllëse të poezive, që në të shumtën e rasteve mbartin një lirizëm fatlum. Edhe këtu gjeti dhe ndërtoi modele, që Mjeda zakonisht i quan ‘Mjeshtër’, si në rastin e Mësuesit. Janë si një monument betimi këto vargje që kanë një shtrirje hapësinore: “E sa t’kem shpirtin, sa t’shofim dritën / Dashtnin’ e nderen gja s’na pakon.”

Poezitë e Mjedjes mbartin ‘copëza realitetesh’, ku shkëlqejnë dukshëm prirjet realiste.

Mjeda edukator. Edukon fëmijët me shenjtërinë e tij: poezinë. Fëmijët, -thotë Mjeda, - duhet që të dëgjojnë më shumë, të shohin më shumë, të punojnë më shumë, të flasin pak, shkurt dhe saktë. Në këtë kalejdoskop porosish të vyera, Mjeda kapërcen kohën e vet dhe mbetet aktual edhe sot. Dhe në këtë vazhdë, jo më kot portretin e këtij poeti e ‘qëndisin’ fjalët: urtia, puna, nderi, djersa, bleta punëtore, thnegla (milingona), dallëndysha. Kjo e fundit, përmes një shqiptimi përkëdhelimos e mirësie, poeti ‘vendosë’ të paraqesë misionin e saj-simbol:

“M’buz’ t’nji strehe, o n’kulm t’shtëpisë / Rri dalldysha tue punue, / Tue godit’ rri çerdhen fmisë, Deri nata t’vin’ punon.”

Mjedja për vetë natyrën e tij të magjishme poetike, edhe vargjet i përzgjedh si ato gurët e çmueshëm, që përmes frymëzimit, si në rastin edhe të kësaj poezie, ai himnizon dashurinë ndaj prindërve dhe veçanërisht nënës. Po citoj nga vjersha “Nëna me buzë në gaz”:

Se lulet qi n’prenverë  
Fillojn’ në kopsht m’u rritë,  
Mue nana, kur m’shikon,  
Me buz’ në gaz m’gazmon.

Në këtë poezi Mjeda, e shkruar me ndjenjë si zakonisht, na flet për shpërblimin që duhet t’i japë fëmija nënës me sjelljen e vet të mirë, për

përkujdesjet e saj plot dhembshuri. Fëmijës asgjë nuk i duket aq e bukur në qiellin me yje se sa nëna, që ia shton jetën dhe gëzimin.

*Mjeda i urren veset.* I qorton me forcë fëmijët që i mbartin dhe i manifestojnë, si: lakmia, mendjelehtësia, rrena (gënjeshtra), mos i bje shoqit, etj. Jo vetëm i qorton, jo vetëm i këshillon, por Mjeda arrin të brengoset dhe kthehet në një britmë, kur thotë: “Vesh’ me t’arta e zhele t’shkreta / Nderen plaku e meriton; / Dhun’ e kore, po, i shkoft’ jeta / Faqeziut që s’e nderon.” (poezia: “Nderoni pleqtë”).

*Mjeda peizazhist.* Si një piktor i zoti përdor ngjyrat, përgjithësisht të ngrohta e të ëmbla, si në poezitë: “Agimi”, “Zani i nades” (mëngjesit), “Filloi toka me u përtri”, “Mbramja”, “Vera”, “Vjollca”, “Të nisunit e zogjve”, “Moti”, “Zambaku”, etj. Mënyra e përshkrimit, tonet, detajet e përdorura me finesë, etj., “shpërndajnë një aromë” që s’mund t’i shqitesh. Bën të largohesh e nuk largohesh dot. Kthehesh e i merr erë (erakande), dhe si në përrallë kthehesh, vetë, në aromë. Ndoshta është fuqia ‘çudibërëse’ e poezisë mjedjane. Ajo është vërtet!..

*Mjeda fabulist.* Vështrimet dhe konceptet estetike të Mjedës për këtë gjini, ruajnë mëvetësi dhe origjinalitet. Ofrojnë në disa aspekte me poezitë, por edhe largohen. Por gjithsesi, poeti, ruan me fanatizëm identitetin e fabulës. Mbase kujtojmë përfundimet e fabulave, si: “Dhelpna e bretkosa”, “Fëmija dhe zogu”, “Thnegla dhe pllumbi”, “Fili dhe mzati”, “Gomari dhe kali”, “Lari (dafina) e drandofillja”, “Krapit”, etj. Mësimet fabulore mbeten aktuale edhe në ditët tona. Ndaj dhe rrëfimet e Mjedës nuk njohin moshë, rendja e tyre është drejt përjetësisë.

Duke folur Mjeda për poezinë me zërin e tij poetik të papërsëritshëm, në një tekst përkthimor, nënvizon ca rreshta të kësaj natyre: “Bukuria mundet me kenë landa edhe e tjera arteve të bukura, si e pikturës e e skulpturës, por gjithë e cila e punon me mjete e vegla të veta: poezia e shfaq me të shprehun që i del prej tugës (tufëz, tuje\*) së zemrës e prej fuqisë së përfytyrimit.” (Artikuj: Përmbi poezi përgjithësisht (Natyra e poezisë)).

Po ta kqyrim e ta vlerësojmë poezinë e Mjedës në suksesin e saj, mbase do të ndalojmë detyrimisht te fuqia e përfytyrimit që te poeti ishte shpirtëzuar dhe shkrirë bërë një, si dhe te tuga (\*tuje) e zemrës që te poeti ishte gëzim i madh, hare, kënaqësi, lumturi, me të gjithë të mirat e dheut.

Po tjetër ç’mbartëte dhe ushqente poezia për fëmijë e Mjedës? – Figuracion plot fantazi e art. – Fisnikëri. – Himnizim. – I kursyer në fjalë.

–Nuk bie në thjeshtëzime. – Ka emocion. – Shquhen për tonin tregimtar, për gjetjen e subjektit dhe për mënyrën e shtjellimit të ngjarjes.

Po tjetër ç’mbartëte dhe ushqente poezia për fëmijë e Mjedës? – Njohu mirë realitetet familjare. – Njohu mirë marrëdhëniet prindër-fëmijë. –Njohu mirë psikikën e fëmijës, moshën e lodrat (lojërat) e tij. Është interesante të themi si dukuri se, pak shfaqen lojërat e fëmijëve. Siç duket, ndikon fëmijëria e varfër e poetit. Mbase e mban peng... Por Mjeda në poezinë e tij i mëshon me forcë edukatës, virtytit e moralit. Ndaj, ka jetëgjatësi kjo natyrë poezie që perceptoi dhe krijoi, që kurdo dhe kurdoherë të lexohet me ëndje. Me të drejtë studiuesja Pandora Dedja shprehet: “Si pedagog Mjedja e kuptonte se gjëzat, përrallëzat dhe fabulat i tërhiqnin shumë të vegjëlit, u nxitnin fantazinë, i detyrojnë të mendojnë dhe të mësojnë përmes vargjeve.”

Mjeda, falë talentit të tij, është treguar shumë i kursyer në fjalë te poezitë e tij, duke pasur kujdes që të mos thotë asgjë të tepërt e të mos bjerë në thjeshtëzime. Krijimet e tij nuk i kalojnë tri ose katër strofat, madje një pjesë e madhe janë edhe më të shkurtra. Megjithatë, edhe në këtë shpalim mahnitës poetik, ai ia arrin me shumë sukses që të japë përmbajtjen, të transmetojë emocione te lexuesit e vegjël e pse edhe tek të mëdhenjtë, të zgjojë mendime dhe t’i edukojë me frymë popullore. Në poezi, Mjeda shquhet për tonin tregimtar, për gjetjen e subjektit dhe për shtjellimin e ngjarjeve. E në vazhden e veçorive të poezive mjedjane, kritiku Ramazan Çadri shprehet: “Vjershat e Mjedjes për fëmijë përgjithësisht kanë strukturë bivalente. Ato ngrihen mbi dy komponentë kryesorë, ku komponenti i dytë herë përfaqëson një sintezë të mendimit poetik të shprehur më parë, herë kundërshton një gjendje a dukuri, herë përforcon mendimin e shprehur në komponentin e parë, mbi bazën e përqsjes së dukurive të ngjashme. Në përputhje me këto variante të strukturimit dhe të organizimit ideor, autori përdor mjetet dhe figurat përkatëse për përfitimin e efekteve poetike në mënyrë sa më emocionuese. Kështu, ndërsa në rastin e parë forcimi i theksit tregimtar shpie në përmbylljen e mendimit me anë të sentencës, në rastin e dytë struktura kundërshtuese shpie në përdorimin e antitezës, që shërben për të ndriçuar më me forcë idenë kryesore, kurse në rastin e tretë vjershat ndërtohen krejtësisht mbi bazën e krahasimit të zgatur apo paralelizmit figurative, që i jep gjallëri të veçantë mendimit poetik dhe përftimit të idesë në mënyrë sugjestionuese.”<sup>4</sup>

4 Prof. as. Dr. Ramazan Çadri: *Lindja dhe formimi i Letërsisë shqipe për fëmijë,*

7.

Ndre Mjeda, kohës dhe përtej saj i dha emrin dhe gjurmën e tij, kodet dhe shenjat e tij, edhe pse eca-jak-et e jetës së tij, shpesh, qenë të dhimbshme e të padurueshme. Krahas kulturës së tij të lakmueshme si poet i “Andrrës së jetës”, i “Vajit të bylbylit”, i “Shkodrës”, i “Juveniljes”, i studimeve gjuhësore, si deputet, si mësues, ai, përsëri, gjeti kohë të vizatonte poetikisht plot yje në qiellin e poezisë për fëmijë.

Po përmendim edhe një fakt dhe një vlerësim për Mjedjen. Kur doli në qarkullim “Juvenilja”, më 1917, shtypi i kohës heshti. U desht të vinte viti 1921 kur Gjergj Fishta do të shkruante për poezitë e Mjedjes kështu: “Qe një vepër poetike me të cilën mund të thohet, se përnjimend asht stolisë gjuha e rritë pasunija e literaturës shqipe. Në këtë vepër gjuhën e gjen të pastër, stilin e naltueshëm, shembëlltyrat e gjalla e plot njomsi e gjithmonë t’arsyeshme. Aty ke një prandverë lulësh e bylbylash, e një natyrë të kërnthestë e plot jetë; e fillim e mbarim në këtë vepër zotnon një melankoni e kandshme, e cila edhe sendeve ma të vogla u jep një interes e një randsi të veçantë; ... Si prej shllimeve t’zgjedhuna, si prej mjeshtriet me t’cilin janë ndërtime vjershat e lidhë mendimet, shifet çiltas se auktori, para se me e botue veprën e vet e ka përrshkue kushedi sa herë nën limë të mendjes e të tekniks. Prandej kjo vepër ka me kenë doemosdo e nevojshme me u përdorë si tekst ndër shkolla t’Shqypnis. Auktori mundet me kenë i sigurt se atdheu ka me ja dijt për nder mundin që ka hjekë në përpilimin e kësaj vepre”.<sup>5</sup>

8.

Ashtu fjalëpak, i kursyer, i mençur, më bëhet sikur, ende plaku i moçëm e urtak Ndre ecën, dhe ecën... “Shkodrani me veladon të zi, poeti gojëmjaltë e fjalëzjarrtë, dom Ndre Mjeda, gjatë tërë jetës i kishte vënë vetes qëllim parësor që fëmijëve, shpresave të ardhmërisë, t’u dhurojë vargje të ëmbla, të afërta, të kulluara, edukative, me përmbajtje të thellë duke i kënduar dashurisë ndaj punës, natyrës, vendlindjes, familjes, shkollës, jetës me të gjitha të mirat e saj.” Ndaj, kjo krijimtari për fëmijë ka vargje magjike të pasqyruara në një realitet magjik. Sepse “E thjeshta tek Mjedja është e përkryer, është *kreckë e bre përzi me lisa* dhe përtej kësaj, po të shtosh edhe një gjethe, shkatërron gjithçka. Këtë bukuri të thjeshtë, që të duket se shkon deri në zanafillën e natyrës, *Shtëpia Botuese Redona, Tiranë 2009, 1. Fillimet e Letërsisë shqipe për fëmijë (folklori për fëmijë, shkrimet fetare-didaktike, leximet dhe pjesët letrare në tekstet mësimore, f. 33.*

<sup>5</sup> Gjergj Fishta: *Hylli i Dritës, 1921, Nr. 2.*

Mjedja e kërkon gati me një stërmundim patologjik. Përsosmëria ka bërë që ai të kapërcej dekada dhe shkolla arti. Kjo është një shenjë gjenialiteti po të kujtosh që te Homeri ndesh tash e parë elemente që e kapërcejnë antikitetin.”<sup>6</sup>

Mjeda është në udhë, në udhëtim... Më ngjan me agun e një dite të re që lumturisht e solli edhe në poezinë për fëmijë. Po kujtojmë disa prej tyre, si: “Hana”, “Era”, “Jehona”, vjershat –gjëza..., “Ora e murit”, etj. Poeti Ndre Mjedja e kishte një Orë. Ajo Orë kapërceu Orën e kohës së tij. Kjo është arsyeja që Mjedja mbeti: Klasik e Bashkëkohor!

---

<sup>6</sup> Skënder Drini: *Shpërthimi i fshehtë...*, gaz. *Nacional* 06. 06. 2010.

## ▪Letërsi▪

Ervis GASPRI

## NJË VARG I LIRË

-Cikël poetik-



*Ervis Gaspri ka lindur në qytetin e Lezhës me 16. 05. 1983. Shkollën e mesme e ka kryer në vendlindje pranë gjimnazit të përgjithshëm “Hydajet Lezha”. Në vitin 2002 fillon studimet për Shkenca Juridike pranë fakultetit të Padoves, Itali. Në vitin 2015, falë pasionit për letërsinë dhe gjuhën shqipe, ka filluar studimet për gjuhë shqipe-letërsi pranë universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Aktualisht punon në sektorin e kulturës, në Bashkinë e Lezhës. Është ndër poetët e rinj që shfaqet befasisht duke u imponuar përmes një poezie që harmonizon gjuhën poetike me kuptime e domethënie të pasura. Botimi i këtij cikli poetik le të jetë një shtysë më tepër për botimin e librit të tij të parë me poezi.*

**Një varg i lirë**

Se di më, cila dashuri jam unë...  
Një cikël heroik, një ëndërr më shumë  
Se di më se ku të kam takuar  
Një varg i lirë në një perrallë të harruar.



Pergjigju! Dashuri e vetvetes...  
Predikat, rrugë për të së vërtetës  
Pergjigju e moho botën verbërisht  
Një varg i lirë përsëritet pafundësisht.

Se di se te cila dashuri të kam humbur  
Një luftë botërore në dhimbje e kllapi  
Se di më pse doja të isha i lumtur  
Një varg i lirë plot me nostalgji.

### **Substancë - Intensitet**

Filozofi e poezi, Apollo e Helios  
Filozofi dhe moral, një hije e zezë  
Filozofi tek ti, njeri, Aferdita dhe Eros!  
Filozofi në ekonomi, një apoteozë.

Filozofi si marrëzi? Apo si një problem?  
Filozofi e madhështi, një rrugë pa kthesë!  
Filozofi e industri, një krizë në sistem  
Filozofi e dëshirë, dëshirë e qëndresë.

Filozofia ngjan me retë, ngjan me stuhinë  
Filozofia është politike, luftë në dëshpërim  
Filozofia si një qëllim më ngjall mërzinë  
Filozofia në estetikë, një vepër në krijim.

Filozofia nuk ka substancë e s'mund të ketë  
Filozofi pa balancë, dhuna më e vërtetë  
Filozofia me arrogancë, kohën e ndalon  
Filozofia pa poezinë nuk ka pse ekziston.

## Barok në dashuri

Lëviz si retë silueta e saj  
E vetë diellin në sy e fsheh  
Lëviz në nota kënga e saj  
Vallëzon si muzë edhe më deh.

Levizin retë; fluturim te ajo  
Valëzon shpirti plot me delire  
Vetë qiellin me të, ajo e mbulon  
Me sytë e saj thur xhevahire.

Lëviz gjithë bota si një dëshirë  
E përqafohem në atë vallëzim  
Lëviz si dritë, lëviz si errësi  
Dashuria e brishtë mbjell gëzim.

Lëviz për tek ti në dëshirat e mia  
Bëj dashuri duke të të menduar  
Fluturon përmbi oqean fantazia  
Djeg e përvëlon si vaj i kulluar.

Lëviz si një skulpturë e antikitetit  
Dëshira mbi lëkurën e bardhë  
Ajo buzëqeshje; imazhi i amshimit  
Zinxhir ëndrrash që presin me ardhë.

Levizin toka në sytë e tu të kaltër;  
Dëshirat që po më gllabërojnë  
Endërrat e pastra në eter vallëzojnë  
Vetëm në shpirtin më të pastër.

Luan si një vjolinë në frenezi...  
Dëshira valë për tu kënduar...  
Lëvizje e shpejtë për në marrëzi  
Kaq i duhet barokut për të lulëzuar.

## Vetëvrasja e Ofelisë

Dashuri e errët e jotja, e di  
Përhumbur në sytë e nxirë  
Dashuri e mbytur në lavdi  
Përqaftim me liqenin e ngrirë.

Koha ka kaluar tashmë, Ofeli  
Ditë të humbura kjo jetë ofron  
Koha na ka mashtruar, Ofeli  
Dashuria e njeriut nuk ekziston.

E ëmbël e jotja dashuri, unike  
Mbështjellë në vell që shkëlqen  
Dashuria e vdekja janë si relike  
Që fundi i këtij liqeni i rrëmben!

## Peshorja e shpirtit

Çdo gjë të mirë që bë më,  
na kushtoi shumë lirë.  
Me borxhin që kemi lënë;  
U ndërtuan mrekullitë...

Por kjo vlen shume pak;  
nëse nuk të ngjall dëshirë.  
Borxhi përherë paguan gjak  
një mrekulli, për tu arrirë.

Çdo gjë të mirë të bejmë;  
se arrimë më dot...  
Pa borxhe nuk jetojmë,  
e mrekullueshmja sot!

## Horizonti

Mbaj frymën dhe shoh përtej  
Në qiejt e vjetër kundroj të ardhmen  
Mbi të shkuarën veten e gënjej  
Me grimcat e dritës krijoj të vërtetën.

Mbaj frymën dhe ëndërroj  
Një qiell të kaltër vetëm për shpirtin  
Ëndrrën e kap e me të vallëzoj  
Me copëza këngësh që japin idilin.

Mbaj frymën dhe shoh në hapsirë  
Shoh në horizontet e syve të mi  
Shoh detin, diellin... një shkretëtirë  
Me formën e tyre rikthehem fëmi.

## Aldebaran

Ndjek yllin e parë  
Ndjek dritën që vret  
Ndjek ëndrrën e vrarë  
Ndjek puthjen që djeg

Ndjek fjalët e profetit  
Ndjek ritin cifut  
Ndjek mësimet e Konfucit  
Ndjek një falje në talmud\*

Ndjek aktualen  
Ndjek brengën e Parisit  
Ndjek intelektualen  
Ndjek një film të Hollivudit.

Ndjek yllin e mëngjesit  
Ndjek në det Akejt  
Ndjek të paprekshmen  
Ndjek i dehur lumejt.

Ndjek ty të të kap  
Ndjek ditën që vjen  
Ndjek me sy cdo hap  
Ndjek ëndrrën që shkëlqen.

Ndjek një plak te verbër  
Ndjek një psalm ne ungjillë  
Ndjek një femër pa emër  
Ndjek me besim nje këshillë.

Ndjek harkun e diellit  
Ndjek rrugën pa fund  
Ndjek shkollën e Miletit  
Ndjek horizontin në sfond.

Ndjek shtigjet për në Romë  
Ndjek fitoren me cdo kusht  
Ndjek me hundë një aromë  
Ndjek perandorin August.

Ndjek me hap ritmin  
Ndjek thirrjen e marrë  
Ndjek nën shi fatin  
Ndjek dikë për ta vrarë.

Ndjek një hartë thesari  
Ndjek velat nën stuhi  
Ndjek një venë ari  
Ndjek fjalën që vjen nga ti.

## Çfarë është poezia?

Poezia është udhëtim,  
 udhëtimi në ferrin e Dantes  
 udhëtimi i Akejve drejt Trojes  
 i Uliksit për në shtëpi  
 udhëtimi i Aleksandrit në Indi  
 udhëtimi pa fund i Remboes  
 udhëtimi pa kohë i Pessoa  
 në rrugën pa shpresë të Eneas.

Poezia është dështim,  
 dështimi në marrjen e Romës  
 dështim në ëndrrën e Borges  
 dështim në cdo front  
 dështimi që tregon;  
 Dështimin e Agamemnonit  
 një dështim që mbretëron;  
 Si dëshirat e një demonit.

Poezia është flijim,  
 flijimi i cdo gjëje të pistë  
 flijimi i Ifigjenisë  
 flijimi i martirëve në kolose  
 flijimi i cdo njeriu për mbi dhe  
 flijim i një demi në Kretë  
 flijimi që s'më lë të fle!  
 Vizion i një zoti mbi ne.

Poezia është pafundësi,  
 pafundësi në pamundësi  
 pafundësia e Xhordano Brunos!  
 pafundësi në vargjet e Niçes?  
 pafundësi që bekon  
 e ndal kohën kur krijon  
 pafundësi që nuk ka si ekziston  
 por që prap, gjithsesi;  
 arrin e plotë tek ti!

## Ikje

Vjeshta kaplon shpirtin tim  
Në dëshira për ikje, në marrëzi  
Si dallëndyshet në fluturim  
Marr qiejt e përflakur me dashuri.

Dëshirat për ikje më provokojnë  
Në rryma të nxehta hedhin shtat  
Ëndjet e ikjes po më përvëlojnë  
Si zogjtë shtegtarë krahët i hap.

Vjeshta m'i merr sytë dhe mendjen  
Më bën të hidhem larg, të fluturoj  
Si një udhëtar ta shlyej dhimbjen  
Si shpirt i lirë kurrë të mos ndaloj.

Dëshira e ikjes rrugën ma tregon  
Në oqeane fatesh të pakuptueshme  
Mallkimi i vjeshtës kohën e ndalon  
Krujon iluzione të mrekullueshme.

## **Loja e pasionit**

Loja e pasionit - përjetësi e brishtë  
Që thur lavdinë nën hijen e një ulliri  
Loja e zhargonit si dashuri e pistë  
E përhumur në dehje opiumi e deliri.

Loja e pasionit - botën e rrotullon  
E fshehur pas njemijë e një maskash  
Loja e demonit kohën na e tregon  
Si karnevale të pafundme paradash.

Loja e pasionit është një statujë antike  
E derdhur në bronzin e vjetër  
Një dashuri e pastër dhe unike  
Një dëshirë që vlen të hidhet në letër.



## Dëshirë për jug

Dëshira për jug sytë e mi thërret  
Hapësira e munguar zemrën ma nget  
Si dëshira për jug sytë mi verbon  
Hapësira e pafundme që më mundon.

Dëshira për jug është pafundësi  
Një limiti i shpirtit që ndjell marrëzi  
Për dëshirë për jug ndez ne gjak  
Trupin braktis e në qiell e flak.

Dëshira për jug ngjall dhimbje  
Shpirti im i mbledh me endje  
Dëshira për jug krijon nostalgji  
Uliksi kërkon rrugën për shtëpi.

Dëshira për jug, ndjenjë e vërtetë  
Një iluzion që me mban në jetë...  
Dëshira për jug, përherë në rikthim,  
Përherë në hap, përherë në udhëtim.

## **Pasqyra e një poeme**

Poema t'i humb celësat, shpesh  
e shpërndahet si zogjtë në erë  
Çdo derë e hapur pasqyren fsheh  
Shpërhapet me anë ëndrrës së lirë.

Poemat perhumben hapsirë-kohë  
Nuk kanë një shtëpi, një vendbanim  
Sic celësi derën e vet do të njohë  
Drita e të se vertetes me një drejtim.

Poema në shpirtin tënd ka shkruar  
Shpërlarë në shiun vjeshtës  
Pasqyrat; që diellin e kanë errësuar  
Krijojne monumente të së perjetshmes.

## **Alkimi e zezë**

Për ju o shpirtrat e paepur;  
Lind përherë një diell i ri  
Krijim i një bote të mohuar  
Udhëtim për në fëmijëri.

Për ju o shpirtrat e vetmisë;  
Lindja e vdekja ne pafundësi  
Krijon sic bën guri i filozofise  
prish e ndërton me frenezi.

Per ju o shpirtrat poetik;  
Lindja gjithmonë si një gabim  
Aq të thellë dhe aq patetik  
Si era që shpie në perëndim.

## Himn për Apollonin

Karroca vërtitet eliptikisht  
vallëzon në qiellin rastësorës  
tërheqje e harkut pafundësisht  
karroca ngjitet drej aurorës.

lavdi e mrekullisë Apollon!  
karroca lundron drejt diellit  
deshirë e etertë mbretëron  
karroca e lavdisë së hyjit.

lëvduar krijuesi estetik!  
karrocë ndicuese në agim  
lëvduar harpa e zotit mitik!  
karroce e arte plot vezullim.

karroca ngjitet në horizonte  
shkëlqen në dritën që po agon  
harku i lëshuar drejtshënonte  
karrocën nget ti; hyji Apollon.

## Hypnos

Ka vetëm një ëndërrues,  
ai ëndërron procesin kozmik  
si nje statujë e Budës  
thërret mbi vete fatin tragjik.

Kjo më shpie në solipsizëm  
E kam parë ëndërr jetën time  
Aty çdo dëshirë është alpinizëm,  
apo thjesht ka qënë zhgjëndërr?

Ka vetëm një ëndërr,  
ajo është vetë aktor e teatër.  
Si një statuje fati e verbër  
Krijon dëshirën më të pastër

Kjo na shpie në skizofreni,  
ëndërr me njëmijë e një fytyra  
Aty çdo dëshirë është magji  
Zgjimi sjell botën pa ngjyra

## KRIJIMET LETRARE TË KONKURSTIT: “Njeriu dhe koha”, “Unë jam poet”

*Në muajin dhjetor 2018 në bibliotekën “Marin Barleti” mes shkollave të mesme të bashkisë së Shkodrës u zhvillua konkursi letrar me temë: “Njeriu dhe koha” dhe “Unë jam poet”. Fillimisht krijimet letrare u dorëzuan gjatë një periudhe 3 javore. Në këtë konkurs morën pjesë 31 nxënës nga shkollat e mesme: “Peter Mahringer”, “Oso Kuka”, “Shejnaze Juka”, “Hasan Riza Pasha”, “At Gjon Karma”, Guri i Zi.*

*Në përfundim për krijimet më të mira në poezi dhe në prozë u dhanë edhe çmimet e mëposhtëme. Në shenjë vlerësimi dhe mbështetjeje për autorët e rinj po botojmë me këtë rast edhe krijimet letrare fituese të çmimit të parë, të dytë dhe të tretë.*



## Çmimi I

Klevisa **BARDELI**

*Shkolla "At Gjon Karma", Gur i Zi*

*Klasa: XII-A*

### **"Unë jam poet..."**

Në shqyrtime të dijes e pasionit fshihet shkëndija që mbase ka lindur e ndezur, por që kërkon dhe të ndizet. Kemi rrugëtuar në pafundësinë e shpirtit dhe besoj se jemi të vetmit që kemi ngulur themelet e ndjenjes dhe dashurisë shpirtërore. Aty ku fshihet padituria e ngallënjimi i shpirtit për të kërkuar dritë e për të ndritur copëzat, që ndoshta koha i ka lagur. Shkruaj, prandaj ndoshta jam! Shkruaj duke prekur thellësinë e skutat e errëta që ndoshta TI nuk ia shfleton dot vetes, madje ndoshta si ndien ato se ekzistojnë. Jam loti yt i fshehtë, që rrjedh në venat e gjakut duke të sjell puhizat e kujtesës e dashurisë që mbase mund të kenë fjetur brenda teje. Vazhdueshmëri pasionante që thyen çdo sketerrë e hekur të botës duke kërcitur krahët dhe duke kapur pikën tënde më të dobët. Të shkruash në kaq hapësira të vogla e, që nuk mjaftojnë për ta rifilluar përjetësinë poetike, inversionin njerëzor, që ruan metrikat mbi të cilën shkruan poeti.. Unë jam poet! Sepse kam arritur të pjekem mbi vargjet e bukura të një poezie kohore që erdhi e m'u bashkangjiti duke më bërë të tillë. Duke më bërë tu çasem heshtjeve e të gëloj mes provincave të lirisë duke iu bashkuar vuajtjeve, dashurive, gëzimeve e kështu arrita të njoh botën e shpirtit.

Më mjafton vetëm të hap e të shfletoj e të humbas në kujtime. Aty ku më sjellë ndërmend çdo vuajtje apo gëzim të kaluar, pas sekondave që tashmë mbeten vetëm hije të kujtesës. Mjafton të shikoj titullin apo numrin e t'i rikthehem trajtave të pashquara të asaj kohe që sot duket, sikur janë shquar e veçuar në vete duke mbetur kërcitje e lehtë e paprekshme dhe e paharrueshme. Kemi shëtitur botën me mjetin e vetëm, që pasionit tim i kushton shtrenjtë "LIBRI", pasion që nuk blihet, sado

që të kesh pafundësinë e monedhave prej ari. Jemi bërë një me mjaft pena të ndritura, me të cilët kemi ndarë të njëjtin pasion. Kemi qarë me dhimbjet, shkrimet e Shekspirit, jemi tërbuar e rebeluar duke rënë në dashuri me dozat poetike të Bodlerit duke kaluar në ekstazat e letërsisë, pra duke u ushqyer me to.. ! Poezia e poetit është përqafimi që mbush boshllëkun shpirtëror, është ajo që shkrihet e bëhet një me ty duke i dhënë mungesave kuptimësinë e tyre. Poeti është artist e artisti është personi që ngrihet mbi çdo kult, për të ulëritur se ku ndodhet liria, që shpesh shtiret si e palidhur në pranga. Jemi ne poetët që me armët tona thyjemë dyert e burgjeve, bashkohemi shpirtërisht me vuajtjet duke u bërë një si ato. Rrugëtojmë mes atyre vargjeve, me qëllim që të prekim sado pak ndjenjën njerëzore e t'i kthejmë me pamje nga dielli, rrugëtim i gjatë që të lodh damarët e këmbëve. Brezi i sotëm nuk lëkundet mes vargjeve që shtryllin mesazhin e jetës. Poezia e poetit është revoltë, dhe ku poeti është I revoltuari realist me të cilin bashkohet i gjithë komuniteti duke prohoritur që ia vlen ta lexosh e rilexosh. Poeti është optimisti, romantiku i ndritur që vlerëson hapur natyrën përreth. Të jesh poet do të thotë të kesh një botë të madhe shpirtërore, e cila ka brenda ndjenjat e gjithë botës, ku me këto ndjenja arrin të prekësh lexuesin e ta flirtosh në rreshtat e tu.



**Çmimi II**Evina **KOMI**

Klasa: XI-A

*Shkolla: Hasan Riza Pasha***Poezi: “Njeriu dhe Koha”**

A të kujtohet sa herë ke thënë  
 kam kohë për gjithçka se jam i ri?  
 Sa shumë gjëra pa bërë ke lënë...  
 E di se je penduar, e di.  
 A ke tani kohë të luash,  
 ti që doje të rriteshe sa më parë?  
 A mundesh akoma “kam kohë” të thuash,  
 ti që kohë për asgjë s’ke ndarë?  
 A nuk të mbushen sytë me lot  
 të kaluarën duke kujtuar?  
 A të duket se frymë nuk merr më dot,  
 kur kujton sa zemrat i ke lënduar?  
 A mund ta përqafosh mamanë,  
 pa menduar se edhe pak jetë i ka mbetur?  
 A mund të kthesh pas babanë,  
 që ka kohë që në dhé është duke fjetur?  
 A mund ta riskicosh tani jetën?  
 Ta kthesh në atë që ke ëndërruar...  
 Sa gjëra peng të mbetën...  
 Sa ëndrra pa u realizuar...  
 Njeriut një jetë i është ofruar,  
 por ti tënden nuk e vlerësove.  
 Je vonë për të jetuar...  
 Je vonë, se kohën e shpërdorove

Arbri **KOPLIKU**

*Klasa: 11A*

*Shkolla: Kolegji Hasan Riza Pasha*

**Ese: “Njeriu dhe koha”**

Një kokërr rëre rrëshqet poshtë hinkës elegante. Një tjetër e ndjek pa përtesë. Moment pas momenti, barku i pafundëm i orës me rërë ka vend për çdo kokërr. Edhe thjesht simboli më klishe i fjalës “kohë” e bën mendjen njomëzake njerëzore të kërcejë në atë gjeratoren e thikët e madhështore, në pyetjen e madhe që nuk merr dot përgjigje: “Ç’është... koha?”. Njomëzake, pasi nuk është asgjë para mençurisë së kohës. Madhështore, pasi “qenia më inteligjente e planetit” nuk ka hasur të tillë gjëgjëzë, sublimiteti i së cilës ta nxisë që ta adhurojë, në vend të përpjekjes drejt zgjidhjes.

Subjekt i çdo mënyre të menduari të provuar ndonjëherë, vetë koncepti i kohës ka zënë vend në korniza me ngjyra e përmasa të larmishme përgjatë asaj që njerëzimi i quan “histori”. Njëfarë Aristoteli, quhej ai i pari që e vendosi në kontekstin e së pafundmes. Një tjetër e shihte nga thjerra e opinionit skeptik e “racional”, duke e konsideruar mike të vjetër, sekretet e së cilës janë kuptuar nga njeriu kurioz. Ajnshtajn ia thoshin emrin këtij ëndërrimtari me këmbë në tokë. Sot, podiumi i perfeksionit e precizionit njerëzor udhëhiqet nga zembreku i artë i orës. Këtu fshihet edhe opinionimi i deritanishëm i “njeriut modern” mbi vetë perfeksionin: rrjedhshmëria e papërmbajtshme e kohës. Një forcë epike që do t’ia kishte zili edhe inxhinieri më pak ambicioz, ajo “perfectus in machina” (lat. “Makina perfekte”) i shtrin krahët e saj shumë më egër se ç’i leverdis rehatisë tokësore: është i pakundërshtueshëm fakti se njeriu ishte ai që e krijoi orën, por shumë më skeptike përgjigjja e pyetjes “A e kontrollon njeriu atë?”.

Është aq e thjeshtë sa të hedhësh sytë përreth. Sado që krenaria njerëzore nuk e koncepton si të mundshme, universi nuk rrotullohet

rreth jetës inteligjente. Përkundrazi, kjo jetë kaq e ngjashme me atë kokrrizën e rërës është më e ngutura për t’iu nënshtruar motorit primar, dëshmitarit të duruar të çdo hapi e çdo kapërcimi të bërë ndonjëherë. Si ai mësuesi që nuk nxjerr zë deri sa e gjithë klasa të heshtë nga prania imponuese, koha nuk ngutet me ne. Nuk ngutet, pasi të gjithë e dinë se kujt i përket fjala e fundit.

### Çmimi III

Suhejla KOMI. S.

*Shkolla Austriake “Peter Mahringer”.*

#### “Njeriu dhe koha”

Kalëroj mes yjesh pa fund  
 Me ngjan se dikush me flet  
 Mendohem nëse duhet  
 të kthehem pas  
 Në rrjedhën e kohës ku gjithçka  
 ishte e bukur  
 Kalëroj, flokët më çohen përpjetë,  
 Mendojem t’i ul, gati sa si shkull,  
 Me forcën e dorës që ka  
 humbur kontrollin.  
 Sa vite kaluan dhe ajo dorë  
 është duke rënduar mbi kohën e trishtë.  
 E prap kalëroj.  
 ... Sa vite kalova pa u ndalur,  
 Diku u rrëzova por prap u ngrita,  
 Më tej një mjegull më pengoi shikimin.  
 E çava dorën  
 Që ka humbur kontrollin,  
 Derisa njëçast rashë nga një yll  
 Dhe nuk u çova më.

Edona **ZEFI**

*Klasa: IX b*

*Shkolla Austriake "Peter Mahringer"*

## **“Njeriu dhe koha”**

Njeriu dhe koha... Njerëzit janë të gjithë ata persona që na rrethojnë. Koha është një nga gjërat më të papërceptueshme në universin tonë. Por mes konkretes e abstraktes ka një melodi, notat e të cilës tregojnë lidhjen mes tyre.

Njerëzit janë të pranishëm në jetën tonë gjithmonë. Disa na duan, të tjerëve nuk i pëlqejmë. Disa na vlerësojnë, të tjerë jo. Në jetën e disave jemi prioritet, e tek disa të tjerë jemi veç një opsion. Nota e parë e melodisë është fakti se meqënëse jeta është si një lojë, nuk duhet ta shpenzojmë kohën për të ftuar disa njerëz të cilët nuk kanë një vend. Nuk kanë një vend, sepse nuk e meritojnë kohën tënde. Pra, mos e shpenzo duke luajtur një lojë që nuk ka për të të sjellë asnjë fitim. Në vend të kësaj kalo kohë me ata që të duan dhe të vlerësojnë. Me atë të cilët edhe në rastet më të trishtueshme në jetën tënde, veç me një buzëqeshje të gëzojnë. Sepse koha është një dhuratë e çmuar për njerëzit, është një copëz e jetës që ti e jep dhe që nuk kthehet më pas. Notat e tjera, të melodisë së abstraktes dhe konkretes, kanë të bëjnë me diçka që një filozof, shkrimtar dhe poet ka thënë, pikërisht, Ralph Ēaldo Emerson. Ai është shprehur duke thënë se kohët e këqija kanë një vlerë të madhe shkencore. Këto kohë janë raste që një person që ka si qëllim të mësojë nuk i humbet kurrë. Pra, për tu shprehur përmes disa notave të tjera, koha ka si qëllim të mësojë njerëzit të jetojnë. Por edhe njerëzit duhet të kenë qëllim që të jetojnë sa kanë kohë. Si? Të jetojnë sa nuk është tepër vonë.

Ne njerëzit, unë dhe ti kemi një jetë. Por në këtë jetë ka një kohë. Një kohë e cila nuk është e pafundme. Dhe asgjë nuk është e përjetshme. Andaj, për ty, që je një njeri që e njeh kohën dhe përpiqesh ta administrosh

---

mirë dua të të them diçka. Ndalo së premtuari duke përdorur fjalën “përgjithmonë,,. Sepse në këtë botë edhe vetë jeta është e përkohshme. Një fragment i kësaj melodie, do të të thoshte ty, që koha fluturon. Edhe ti fluturon në kohë. Ndjenjat ikin dhe vijnë. Momentet krijohen dhe zhduken. Historitë shfaqen e në heshtje shuhen. Po koha... Koha...Koha formon një hije. Një hije e cila mund të jetë një siluetë kënaqësie ose një siluetë që të tremb. Në rastin e parë ti dhe koha jeni një. Në rastin e dytë do të të nxisja duke thënë se për të ardhmen ka gjithmonë një shpresë që ti të bëhesh një me kohën. Shkrihu në të dhe merr një formë të veçantë dhe mbreslënëse. Njerëzit nuk të analizojnë sipas kohës sepse nuk munden. Po të analizojnë nga kjo hije. Nga gjurma që koha lë tæk ti. Prandaj duaje kohën. Melodia mes kohës dhe njeriut përcaktohet nga ti. Sepse ti ke në dorë kohën. Dhe melodia e vërtetë je ti.

Vitjola **DODA**

*Shkolla: "Peter Mahringer"*

*Klasa: IX*

## **"Unë jam poet"**

Ndonjeherë jeta të përcjell xixëllonja në shpirtin tënd. Ato të bëjnë të ndiesh ato ndjenja që nuk mund t'i mbërthesh nga shpirti por dora t'i shkruan ato që mendja i thotë e shpirti i ndjen. Zemra jote ndihet më e lehtësuar sepse, ato ndjenja që nuk gjenden në ndonjë fjalor në botë. Shpirti mund të jetë i trazuar nga retë që përplasen me mendimet që nuk i bashkohen zemrës. Por, shpirti mund të jetë i ngopur me rrezet e diellit apo pas atij ylberi që erdhi pas atyre mendimeve të vrazhda që trazuan ujvarën e ndjenjave.

Sido që të jetë shpirti, zemra apo truri ndjenjat tua do të burojnë gjithmonë dhe do të jenë të hedhura me shkrim, me një shikim apo me një të folur. Ato do të botohen në mendjen e një shpirti tjetër dhe pasi ta bësh këtë bora do të shkrijë ose ajo do të ngrihet dhe diellit do t'i duhet kohë ta shkrijë.

Por, askush nuk duhet të dorëzohet. Shkëndijat përvëluese që i nxore nga mbretëria e shpirtit tënd të kanë bërë ty poet. Çdokush është poet. Ato shkëndija bëjnë dritë si xixëlloja në errësirën tënde dhe ti mundohesh t'i nxjerrësh jashtë. Pasi t'i i nxjerr mund ta ndezesh zjarrin e dikujt tjetër apo ta shuash atë. Ti përsëri je një poet. Sa herë që drita bie mbi deget e jetës sonë, ne zgjasim kërcejtë për ta kapur atë e të ushqehemi. Ai moment kur ato rreze të arta bien mbi ne; shpirti ynë ringjallet nga shiu i tepërt që mundohej të thyente degët; zemra jonë lulëzon edhe njëherë duke buzëqeshur; mendja çel petalet e saj që mund të kenë mbetur ndonjë pikë shi pormbi të do të reflektojë rrezja e parë që do të bie mbi të. Tashmë shpirti yt është në ndjenjën më të bukur të saj që quhet: Lumturi.

Tashmë nga ky fener që ndriçoi jetën tënde, ti mund të shkruash

---

me mendje apo me zemër vargje në librin tënd të kujtimeve që do të përshkruajnë jetën tënde. Por, dielli nuk do të ketë një kohëzgjatje të pafundme. Nëse puhiza do të tundojë gjethet tua atëherë ti përsëri do të shkruash për të lehtësuar shpirtin tënd të shqetësuar nga tronditjet e ajzbergeve që tundën ujin e qetë qërridhte në thellësinë e tij. Përsëri ti je një poet. Sepse, pas çdo prishje moti e pas cdo xixëllonje që shkëlqente thellësinë e oqeanit tënd të pa përshkrueshëm, ti përsëri shkruajte vargje e rreshta që i shprehe nga burimi i pafundësisë së ndjenjave që dolën për një arsye dhe ti i botove me fjalë apo vepra. Dhe unë jam një poete. Sepse, pas këtyre xixave padukshme që i dhanë dritë shpirtit tim, i shpreha në këtë letër duke lënë duart e mia të notojnë lirshëm mbi dërrasën e kësaj anijeje që do të niset për udhëtim. Dhe këtë udhëtim do ta shkruaj në librin e jetës time dhe kushdo që ta lexojë do t'i them që edhe nëse ky udhëtim s'do të përfundojë bukur, eksperiencia gjatë rrugës bëri që unë të derdh keto fjalë mbi atë libër.

▪Ese▪

**Ermira ALIJA**

### **XHEVAHIRI**

*(Portreti një gruaje të panjohur)*

Ajo për të cilën po shkruaj, nuk është një personazh i njohur. Zakonisht shkruajmë për njerëz që kanë punuar me përkushtim në një fushë të caktuar, në vazhdimësi, sistematikisht, që i janë dhënë diçkaje, që është bërë ideal, qëllim i tyre i jetës.

Por ka edhe gjeste, veprime, momente që peshojnë shumë... ndoshta peshojnë sa një jetë, sepse pas tyre fshihet një forcë e madhe, e cila nuk krijohet lehtë. Aq sa ndoshta i duhet edhe më shumë se jeta e një individit. Ndoshta i duhet jeta e një familjeje, ndoshta e një grupi, ndoshta e një rrethi... Askush nuk di të thotë me saktësi sa i duhet. Ndoshta është edhe magji, siç themi shpesh “Ia jep Zoti”. Por prapë, gjithçka duket njëkohësisht si asgja e çdo gja. Me siguri mund të themi vetëm se këto gjeste janë shembuj jo të zakonshëm, janë zgjedhje që dëshmojnë rezistencë të fortë ndaj joshjes së provokimit.

Personazhi për të cilin do të flas, është një njeri i thjeshtë. Emrin nuk ia kemi harruar, e përmendim shpesh në biseda, pavarësisht se nganjëherë kafshimet e ndërjegjes na thonë që duhej të tregoheshim më të kujdesshëm, më mirënjohës. Na rrëmben rrjedha e përditshmërisë dhe nuk mund të dalim prej saj, deri kur na duket se na mbulon e keqja. E atëherë kujtesa kërkon ndonjë dritë që hedh shpresë. Nuk e di pse shpresa më ngjan me perlat. Ndoshta, sepse ato krijohen nga reagimi molusqeve ndaj të keqes qëi hyn brenda. E perlat ekzistojnë. Vazhdojnë të ekzistojnë. Në disa forma dhe ngjyra, bile.

Por ajo grua për ne është si perlë e bardhë, sepse aty ishte ajo pranë detit. Kurse ne ishim të rinj. Kishim dy fëmijë të vegjël që nuk kuptonin,



por janë rritur duke dëgjuar të flitet për të. Herë mbas here. Nuk e dimë a jeton akoma... Nuk dimë për familjen e saj a gjendjen. Në fakt duhet t'i dinim.

Ka kaluar aqkohë dhe nganjëherë mendoj se sa do t'i ketë zgjatur asaj rruga nga bregu deri te shtëpia e plazhit, ku ishim vendosur për pesëmbëdhjetë ditë. Nuk duhet të ketë qenë aq e lehtë. Një portofol me një shumë të madhe parash shqiptare dhe të huaja.

- Me sa mend ke mbajt aq shum'lekë në portofol? – e kishte pyetur tim shoq, shoku i tij.

Kur ndodhin ngjarje të tilla, duket se në shtëpi bie një hije dëshpërimi, si hije shejtani. Por edhe dikujt që e gjen një portofol, mendoj se mund t'i bjerë një hije shejtani, vetëm se me ngjyra të tjera, vetiake natyrisht.

Është shumë subjektiv perceptimi i vlerës së një objekti, jo si rëndësi, sepse të gjithë për shembull e kuptojnë se sa i rëndësishëm është për një familje një televizor, një lavatriçe, një frigorifer, a diçka tjetër, aq sa sot mund të quhen normale. Por nuk ka qenë gjithmonë dhe për gjithkënd kështu. Kësaj po i shtoj tani edhe perceptimin që lidhet me faktin se sa vite kursimi mund t'i kushtojnë dikujt një frigorifer, një lavatriçe, një televizor!

Dhe përpara shumë vitesh, kur ndodhi kjo, duheshin disa vite kursimi të fortë për të blerë një televizor, disa vite të tjera të tilla për të blerë një lavatriçe ... e kështu me radhë. Pra, po t'i mblidhje disa të tilla të rëndësishme, duhej një jetë. Një jetë kursim. E shuma që ishte në portofol, ishte një çast për një jetë.

A është dhuratë prej Zotit gjetja e një shume parash? Larg qoftë, po duket sikur Djalli mund të paraqitet edhe me petkun e Zotit. Dhe vërtet, a mund të themi se Zotin dhe Djallin i ndan nganjëherë shumë pak?

Dokumenti identifikues i portofolit në këtë rast? Dëshmia se ato para janë të dikujt?

Para pak kohësh, sime bije i kishin rënë 300 \$ duke shkuar nga stacioni në shtëpi, në Essen të Gjermanisë. Kishte dalë t'i kërkonte me shpresë se mos i gjente. Kishte shpresuar. I ishte dukur pak kohë, pak minuta. Esen është një nga zonat e Gjermanisë Perëndimore që ka qenë gjithnjë dhe vazhdon të jetë me standard të mirë jetese. Por nuk i kishte gjetur.

*Edhe engjëlli, edhe djalli/ flenë brenda tek i gjalli*, - thoshte Naimi në vargjet e tij.

E, atëherë, kur ne në shtëpinë e plazhit e kishim pranuar humbjen,

kur po mendonim se ashtu ishte shkruar, dera trokiti dhe një grua e panjohur hyri në dhomë me njëfarë droje.

- A jeni ju ...? – pyeti gruaja. – A ju ka humbur një portofol?

Të gjithë pamë njëri-tjetrin me çudi. Si ishte e mundur? A mund të ishte e vërtetë? Dikush ka sjellë portofolin? Bashkë me lekët? Të gjitha? Nuk mungon asgjë?!

E kishte gjetur në breg. Kishte kërkuar për të gjetur pronarin dhe kishte kërkuar jo pak për këtë. E çuditshme. Nganjëherë mendoj me vete se çfarë duhet të ketë menduar ajo grua duke ardhur. Çfarë do të kenë thënë me vete? Po më pas? E ka menduar ndonjëherë më pas?

Sa më shumë që njoh jetën, aq më thellë e kuptoj bukurinë e ardhjes së asaj, Tina Koçekut.

Kur e mira duket se bëhet përditë e më e vetmueme, më kujtohet se Tina ka qenë vetëm. Askush nuk e ka detyruar. Vetëm vetja. Vetëm forca e vet e brendshme. Një forcë e madhe, që më shtyri mua të shkruaj. Një forcë e madhe që nderon njeriun, në kohën kur duket se fshehja e të vërtetave është zgjidhje e mashtrimit triumf.

E në fakt mbas më shumë se njëzet vjetësh, veprimi i Tinës mbart fuqi për të provokuar thelbin materialist njerëzor.

Ajo grua nuk harrohet në shtëpinë tonë. Atë do ta mbajnë mend edhe fëmijët tanë, ndoshta edhe nipërit, edhe mbesat. Veprimi i sajë ngjan perlës së detit xhevahirit të rrallët tokës. (Kam lexuar se perlat janë konsideruar gurë të çmueshëm dikur, xhevahirë).

Unë di që shumë njerëz mbajnë xhevahirë, që mund të shikohen, por ka prej tyre që mbajnë edhe xhevahirë të tjerë, më të çmueshëm, të padukshëm, por që jetojnë gjatë duke ndritur shpirtra.

Elsa Stefi **KOLA**

## IMPRESIONE...

Shkodra më mbush me frymëzim me vlerat e saj të përcjella brez pas brezi, me mënyrën e të jetuarit, të shprehurit të ndjenjave, fjalës ledhatuese e sidomos humorit. Komunikimi, gjuha elegante të jep mundësi të shijosh hapësirën e lirisë shpirtërore. Këtu transmetohet kulturë dhe unë e ndiej veten brenda saj. Kam ndier në sinkron bukuritë e natyrës dhe të shpirtit njerëzor, që krijojnë një simfoni në vete...

Atëherë si mundet të qëndrojnë njeriu indiferent?

Ndërgjegjja të thotë të ndjekësh linjën. Kam punuar, por nuk munda të realizoj ato që ëndërroja kur isha studente. Shumë të papritura shoqëruan jetët tona, por e rëndësishme është që hyra në historinë e hapësirës kulturore shkodrane, në ditë të mira e të vështira, kur njerëzit e ndjenin nevojën e tingujve muzikorë që ndikonin emocionalisht tek çdo zemër shkodrane, pasi arti, kultura e tradita janë forca e këtij qyteti me njerëz të lindur mes vlerash dhe personalitetesh të ndritura të krijimit dhe interpretimit.



### *Fillimet e mia*

U linda në Fier më 23. 07. 1948 në një familje intelektualësh. Ndjeshmëria për muzikën erdhi nga babai, ish-student i “Normales së Elbasanit”. Krahas edukimit pedagogjik, nën udhëheqjen e prof. Ludovik Naraçit, ai zotëronte instrumentin e violinës. Studimet e mesme i bëra në liceun artistik “Jordan Misja”. Për 3-vite realizova programin e kursit 4- vjeçar të ciklit të mesëm (1962-1965).

Fillova punën në qytetin e Fierit si mësuese muzike dhe drejtuese e ansambleve dhe komplekseve vokale. Në vitet 1968-1970, punova në qytetin e Bajram Currit, si mësuese vullnetare. Për herë të parë në atë qytet, pa ndërprerë aktivitetet folklorike, krijova formacionet vokale në grup, kore e komplekse. Me këto risi kemi dhënë koncerte në Tiranë dhe në Vlorë, në raste festash kombëtare.

U ktheva në Fier, qytetin e lindjes dhe fillova punën në shkollën e muzikës “Andon Xoxa”.

Pranë kësaj shkolle ndoqa kurset 1- vjeçare, që Ministria e Arsimit dhe Kulturës hapi në qytetin e Fierit në 2 specialitete, kompozicion e dirigjim, me pedagogun Simon Gjonin. Pasi mbarova kursin me vlerësimet e jurisë së përbërë nga personalitetet e muzikës shqiptare, Ermir Krantja, Simon Gjoni, Albert Paparisto dhe Anita Tartari, në vitin 1973, fillova studimet në Akademinë e Arteve në degën “Dirigjim orkestral”, (cikli 4- vjeçar) me Prof. Mustafa Krantja. Në mbarim të studimeve në vitin 1977, pata fatin të jem dirigjentja e parë femër që drejtonte formacionet orkestrale.

Profesor Mustafai më mësoi teknikën e përsosur e cila mundëson përcjelljen e emocioneve tek dëgjuesit. U vendosa në qytetin e Shkodrës, me tradita të shkëlqyera në sferën e artit profesional. Diplomën e mbrojta më 25 mars 1978, në teatrin “Migjeni”. Dirigjova një koncert vokal-instrumental, i cili u mbyll me “Fantazi për piano, kor e orkestër” të L. V. Bethoven, interpretuar nga formacioni vokal-instrumental i Filarmonisë së qytetit. Për herë të parë në historinë e artit në Shkodër, një femër drejtonte një formacion muzikor, aq më tepër një koncert vokalo-instrumental.

Ky ishte sukcesi im i parë!

*Muzikantët e mëdhej të Shkodrës....**Prenkë Jakova*

Kompozitori Prenkë Jakova është cilësuar, si njëri nga kompozitorët shqiptarë më të rëndësishëm të kohërave; krijuesi i operës së parë kombëtare “Mrika” dhe i operës “Skenderbeu”. Kur unë erdha në Shkodër, ai fatkeqësisht nuk jetonte më. Do të filloja punën me formacionet artistike të shtëpisë së Kulturës, Shkodër. Edhe pse me baza diletante, formacionet ishin mjaft të përgatitura dhe të disiplinuar. Në vitin 1977 u formua formacioni vokal-instrumental “Filarmonia e Qytetit”. Krijimi i Filarmonisë më ndihmoi të realizonim programin me kor e orkestër, ku pianiste ishte vajza shkodrane Marita Vuksani.

Në rrëfimet e bashkëkohësve të Prenkë Jakovës dëshmohet se ai ishte jo vetëm një artist i madh i Shkodrës dhe i Kombit, por edhe një qytetar, intelektual me vizion të gjerë. Ishte ai qëkëmbënguli pa reshtur në vitet 60’ të shekullit të kaluar, pranë institucioneve administrative qendrore dhe vendore për hapjen e shkollës së muzikës (që sot mban emrin e tij) më 17. 01. 1961. Hapja e këtij institucioni solli në vite rritjen e nivelit artistik të jetës muzikore të qytetit. Nga ajo periudhë evidentohen mësuesit: Ndoc Shllaku, drejtori i 30 nxënësve, Lajde Banushi klasa e parë, Gjon Kapedani pianist dhe mësues solfezhi.

*Brezi i parë i muzikës profesioniste shqiptare.**Çesk Zadeja*

Eshtë kompozitori ynë më i shquar në risi dhe në koncepte sa krijuese, sa shqiptare, por edhe elitare. Emri dhe vepra e tij përbëjnë vlera të pakrahasueshme në albumin e artë të muzikës sonë të kultivuar. Në veprat e tij dëgjohet tingëllima brilante e shpirtit, virtyteve dhe krenarisë shqiptare.

Le të kujtojmë romancën perlë të tij: “*Ej ju male...*”, në të cilën ndihet madhështia e epizmit të thellë shqiptar. Ai ishte autori i “*Simfonisë së Parë Shqiptare*”(Nr1), i baletit (muzika) “*Delina*” dhe “*Para stuhisë*”, (bazuar në tekstin e J. Xoxes: “Lumi i vdekur”), Koncertit për piano e orkestër, disa sonatave për violinë e orkestër, etj.. etj...

Çesk Zadeja ishte muzikant, gur themeltar i artit profesionist, akademik, me një botë shpirtërore të pasur, mjaft i dashur dhe i respektuar nga studentët dhe kolegët e tij.

*Tonin Harapi, një dimension i madh njerëzor...*

Eshtë kënaqësi për mua të sjell këtu ato ndjesi që kam përftuar gjatë viteve të studimit e më vonë nga pedagogu, kompozitori, muzikologu e mendimtari shkodran, ToninHarapi.

Tiparet dalluese që përbëjnë thelbin e individualitetit njerëzor të prof. Toninit janë të veçanta. E para që më vjen në mendje është buzëqeshja e tij. Kam lexuar, që “buzëqeshja është kod profetik prej drite të shenjtë”, që tek ai zbulonte lirinë e brendshme si privilegj të artistit për të përçarur gëzimin hyjnor tek të tjerët, me të dy fuqitë që zotëronte, emocionin e inteligjencën.

E prisnim me kënaqësi orën e tij, zemra e tij e hapur krijonte një marrëdhënie të përzemërt me ne studentët. Ai ndiqte rezultatet tona dhe na ndihmonte me këshillat e tij për një interpretim dinjitoz. “Vetëm at’herë, -thoshte- do të jeni të aftë të përçoni mendimin e thellë dhe emocionin e fuqishëm falë kjo, kuptimit të asaj muzike që kalon përmes filtrit të zemrës tuaj”.

Kur mbroja diplomën në teatrin “Migjeni”, më 25 Mars 1978, Prof. Tonini në pamundësi për të ardhur më dërgon një telegram, në të cilin lexohej: “Ju uron me zemër Tonin Harapi”. Akoma kujtoj me keqardhje se ai nuk mundi të dëgjonte ekzekutimin tim të diplomës, që ishte vepra e tij “*Rapsodia për piano*”. Telegrami më emocionoi. Më ngohu së tepërmi, ky telegram i një personaliteti të muzikës shqiptare, një njeriu të madh me një botë tejet të pasur shpirtërore. Akoma më kanë ngelur në mendje komentet e tij plot frymëzim që përçonin tek ne ndjesitë e rralla që të fal muzika. Komentet e tij ishin pjesë e momenteve më të bukura të jetës.

Prof. Tonini nuk ishte thjesht vetëm instrumentist dhe kompozitor, kritik e publicist, por para së gjithash, ai mund të cilësohej “një dimension i madh njerëzor”. U lidh fort me kangën qytetare shkodrane, e cila u bë objekt përkushtimi gjatë gjithë jetës. Rrethuar nga magjia e tyre, veprat e Harapit janë lirike, romantike, melodioze ashtu si vetë personaliteti i tij... Mesazhet e tyre derdhin frymëzim për larminë e veprave muzikore që mund të krijoheshin bazuar në tabanin kombëtar, pjesë e së cilës ishte edhe muzika e kultivuar qytetare shkodrane. Në çdo vepër të prof. Toninit dëgjon botën e brendshme të tij, energjitë pozitive që ndihen në çdo vepër shkruar nga dora e tij. Ishte energjia që grumbullonte dhe shpërndante bukuritë e jetës. Mbështetur në këto visare të rralla shpirtërore, ai shkroi

romanca e suita brilante për harqe e piano.

*Marie Kraja Paluca*

Për Marie Krajën kënga popullore ishte zbulimi brilant i një serë elementesh, si: figuracioni ornamental piktoresk, që e bënte këngën popullore një romancë mjaft të kultivuar. Ky interpretim artistik e profesional ishte kyçi i artë që e çoi atë drejt një interpretim origjinal me të gjitha vlerat që zotëronte: formimin, kulturën dhe mençurinë për të hyrë në labirinthe të traditës, dhe në sekretet e jareve të mrekullueshme shkodrane. Me vizione dhe rezonime të pasura timbrike, Maria tanimë do të ballafaqohej e sigurtë në botën e madhe të artit vjenez ku kreu shkollën e mesme “Moxarteum” dhe mbasi doli fituese e një konkursi mori emrin “Princesha koloraturë”. Mbasi përfundoi studimet e larta në Konservatorin e Grac-it do të këndonte me dinjitet në skenat e Tiranës, Shkodrës, Korçës, ku do të cilësohej, si: “zonjë e nderuar e vokalit tonë!”. Debutoi jashtë vendit në Hungari, Çekosllovakia, Itali, Rusi, etj. Deri në moshë të thyer punoi me përkushtim në fushën pedagogjike duke nxjerrë artistë të rinj cilësor të vokalit.

Maria Kraja, jo vetëm në ambientet artistike shqiptare, por edhe në ambientet jashtë vendit, ngeli: ”Bilbili i këngës shqiptare... !”

*Mustafa Krantja, profesori im i dirigjimit*

Pas kryerjes së studimeve në Pragë, Krantja themeloi të parën orkestër simfonike në Shqipëri (1951). Është i pari shqiptar që shkëlqen në dirizhimin ndërkombëtar dhe i pari në hapësirën shqiptare të themelimit të institucioneve të rëndësishme të muzikës. Atij i takon merita e formimit të Teatrit të Operas e Baletit Kombëtar (1953) dhe Orkestrës Simfonike të Radio-Televizionit (1962). I pari pedagog i dirigjimit në Konservatorin e Tiranës. Duke qenë se debutoi në skena botërore, figura e Krantjes pozicionohet në hierarkinë e figurave të elitës botërore. Universiteti i Kembrixhit e kurorëzon me “Diplomë Nderi”. Qendra biografike e këtij Universiteti e shënon në Vol. 17 të Enciklopedisë Botërore. Instituti Amerikan i biografive i jep çmimin universal të arritjeve: “Guvernatori deputet”.

Mustafa Krantja, është njëri nga përruesit e muzikologjisë shqiptare. Çekija është atdheu i tij i dytë. Ministria e jashtme e Çekisë i jep medaljen “Antonin Dvorzhak” me motivacionin: “Për ndihmesën e tij në përhapjen e kulturës çeke”. Përktheu e drejtoi operan “Nusja e shitur” e kompozitorit B. Smetana dhe vepra nga Dvorzhak, Suku, Novak, Jonaček etj. Është



guri i themelit i artit profesionist të dirigjimit në Shqipëri.

*Lukë Kaçaj. Interpretues monumental!*

Loro Sata në librin e tij “Legjendat nuk vdesin” kushtuar këngëtarit, shkruan: “Artist që mbante brenda vetes vullkane dhe përcillte drithma emocionale”. Ky artist i madh me at` za të mrekullueshëm, me forcë tingëlluese shpërthyes, ishte vigan që iu ngjiti skenës lirike vokale shqiptare, por edhe asaj botërore”.

Mësimet e para muzikore, por edhe të kantos fillimisht i mori pranë gjimnazit klasik “Illyricum” të Shkodrës nga fretërit, personalite të shquara të muzikës shqiptare, si At Martin Gjoka, At Filip Mazreku etj. Në vitin 1955, përfundoi shkëlqyeshëm studimet në konservatorin “Pjetër Iliç Çajkovski” në Moskë. Artist i vlerave të rralla cilësore. Figura të tilla qëndrojnë në Olimp të Artit Muzikor shqiptar dhe më tej. Ishte një interpretues i klasit botëror, por diktatura e vrau duke u përpjekur të nëpërkëmbte aftësitë artistike dhe krenarinë e tij.

“Ata e prangosën simbolin e lirisë, por Lukë Kaçaj me talentin, shpirtin e artin e tij ishte vetë tempulli i lirisë, lindur në vendin e shqiponjave !!!! - shkruante L. Sata.

Figura të tilla qëndrojnë perjetësisht në Olimp të Artit muzikor; ato janë “Krenari Kombëtare” e më gjerë.

*Tish Daija*

Akademik, kompozitor, “Artist i Popullit”, autori i muzikës së baletit të parë shqiptar “ Halili dhe Hajrija” dhe i shumë vepra të plota e të përkthyer në formë, përmbajtje, tingull e aromë kombëtare... Njeri i madh i botës shpirtërore!

*Pjetër Gaci*

Kompozitor dhe violinist virtuoz. Muzika e tij mbart intonacione të thella të thesarit artistik e shpirtëror të kombit. E tillë ishte kënga: “ Per ty Atdhe”!

Për këtë personalitet do të citoja një thënie të Pjerrë La Ruse: “ Originaliteti i një talenti të rrallë nuk përsëritet kurrë .... Ai vdes pa pasardhës. ”

*Sandër Çefa*

I paharruar do të mbetet në kujtesën time profesori i harmonisë Sandër Çefa. Shkodran i mrekullueshëm që së bashku me të afërmit e tij të



---

familjes Çefa, krijojnë një harmoni perfekte në identitetin e tyre kulturor këtu në Shkodër!

Janë të paharrueshme orët e mësimit, ku gjithçka ishte mirëkuptimi student-profesor. Ora e mësimit na paqësonte shpirtin. Ekzekutonte në piano duke komentuar dhe na dhuronte momente të përkryera duke na dhënë të kuptojmë vlerën e rolit të harmonisë në një vepër muzikore. Prof. Sandri na trajtonte me shumë respekt. Ishte zemër e hapur!

Më kujtohet një shprehje e tij: “Mos harroni. Vepra artistike i qaset publikut nëpërmjet vizionit të artistit, është fruti që nxirret nga emocionet e tij, pasi tingujt muzikorë në harmoni ndezin një zjarr të madh emocional!

**▪Muzikologji▪**

Edmond BUHARAJA

**GJERGJ KASTRIOTI-SKENDERBEU NË MUZIKËN  
OPERISTIKE DHE REAGIMI I KRITIKËS ZYRTARE**

Bibliografi të bollshme mbi përfshirjen e Gjergj Kastriotit në literaturën artistike rezultojnë jo vetëm në shqip, por edhe në të tëra gjuhët ballkanike, si dhe në latinisht, italisht, frengjisht, spanjisht, anglisht, gjermanisht, portugalisht, suedisht, polonisht, hungarisht, rumanisht, rusisht, etj., etj.<sup>1</sup> Tipologjitë e përjetimit artistik të kësaj figure janë nga më të ndryshmet: nga gojëdhënat te miti, nga poezia te proza, nga artet plastike tek ato grafike, nga mjeshtëritë figurative tek ato performuese, nga shprehjet dëgjimore tek ato audiovizive<sup>2</sup>. Në një hapësirë të tillë tërësia e literaturës rezulton e pafundme dhe e shumëngjyrtë. Me këto premisa, jemi të detyruar ta ngushtojmë objektin e hulumtimit vetëm për veprat e realizuara në kulturat italiane, franceze dhe shqiptare, duke marrë si emërues të përbashkët praninë si protagonist të figurës së Skënderbeut në spektaklin më të madh muzikor, pra në gjininë operistike.

Deri më sot rezultojnë këto operar<sup>reth</sup> figurës së Gjergj Kastriotit, të cilat po i rreshtojmë në rend kronologjik:

---

1 *Me të drejtë është pohuar: «Figura e heroit shqiptar i ka tejkaluar kufijtë e ngushtë të Shqipërisë për të influencuar tipologjikisht literaturën franceze, angleze, italiane, kroate, suedeze, hungareze, rumune për të cituar vetëm disa, duke u bërë fillimisht një epos i kërkuar i Rilindjes e më vonë i Kryengritjes europiane» [SPEDICATO 2007, 9].*

2 *Studimet dëshmojnë se “sasia e pamasë e veprave letrare (drama, romane, tregime, poezi...), që tejkalojnë numrin 400, të shkruara më së shumti në gjuhë të huaja e nga autorë të huaj, është një dëshmi e qartë e interesit të gjallë që ka ngjallur gjithnjë në të gjithë Europën figura e Skënderbeut, ndoshta figura më emblematike midis luftëtarëve europianë të të gjitha kohërave» [SHKURTAJ 2007, 39].*

- i. Salvi – Vivaldi, *Scanderbeg* (Firenze, 22 korrik 1718), [SALVI 1718];<sup>3</sup>
- ii. Zaniboni, *Le valorose azioni del principe Scanderbeg, vincitore d'Amurat Iperator de' Turchi* (1730) [ZANIBONI 1730];<sup>4</sup>
- iii. La Motte/La Serre – Rebel/Francœur, *Scanderberg* (Paris, 27 tetor 1735) [REBEL – FRANCOEUR 1735], e Fontainebleau 1763 [REBEL – FRANCOEUR 1779]);<sup>5</sup>
- iv. Berard-Germain-Étienne, *Scanderberg*;<sup>6</sup>

3 *Libreti: Antonio Salvi (1664–1724); muzika: Antonio Lucio Vivaldi (1678–1741). Në rolet kryesore: Scanderbeg – Giovanni Battista Carboni; Doneca – Francesca Cuzzoni-Sandoni; Aroniz – Antonio Ristorini; Ormondo (Count of Urana) – Giovanni Pietro Sbaraglia; Climene – Anna Gugliemini; Amurat II – Geatano Mossi; (vajza e Amurat-it) Asteria – Agata Landi; (i dashuri i Asteria-s) Acomat – Rosa Venturini. Drama per Musica në tre akte Scanderbeg e Salvi – Vivaldi-t u replikua në skenë 18 herë në periudhën 25 korrik-15 shtator 1718 në «Teatro della Pergola» e Firenze-s. Në të njëjtin sezon e me të njëjtën trupë artistike u programua edhe në Siena gjatë verës së 1718-ës.*

4 Antonio Zaniboni [Bologna 1690–1767] ishte me origjinë fisnike, e bënte pjesë në Accademia dell'Arcadia, ndërsa më pas themeloi edhe të tijën Accademia de'Nascosti. Në libret vepra përkufizohet si «opera comica» [ZANIBONI 1730], por nuk dimë nëse është muzikuar apo jo, e aq më tepër, nëse është vënë në skenë. Në të vërtetë, me përjashtim të Tomaso Albinoni-t, kompozitorët që kanë bashkëpunuar me të janë sot tërësisht të harruar. Gjithsesi, personazhet e operas janë: Scanderbech – Principe d'Albania; Doneca – destinata sua Sposa; Aranit – Padre di Doneca; Ormondo – Generale di Scanderbech; Violetta – Serva di Doneca; Pantalone – di Corte; Amurat – Gran Signore; Asteria – Sua Figlia, Amante di Tamur – suo Generale; Ormus – Ministro d'Amurat; Gradellino – Schiavo di Amurat.

*Opera projektohet në tre akte, respektivisht me 18, 20 dhe 11 skena, e përmbillet me Sonetto-n e Sanderbech-ut. Libreti duket se ka të njëjtin burim me atë të Salvi-t, pasi të dy flasin për rrëmbimin e Doneca-s, e përfshijnë edhe personazhe të fantazuar si Asteria. Ngjarja fillon me Amuratin «poshtë Krujës, kryeqyteti i Shqipërisë» dhe përfundon me fitore e kryeheroit që këndon: «Fitova më në fund, fitova, e tashmë lavdia | ndërthur nderime, dhe Palma në emër tim, | Rënia fatale e Përbindshit | Të jetë për armiq të shembull për t'u kujtuar. [...]» [ZANIBONI 1739, 83].*

5 *Opera me Prologue dhe pesë akte. Libreti: Antoine Houdar de La Motte (1672–1731) / Jean-Louis-Ignace de La Serre (1662–1756); muzika: François Francoeur (1698–1787) / François Rebel (1701–1775). Tragedie en musique Scanderberg i La Motte/La Serre – Fracœur/Rebel u vu në skenë në Opéra të Paris me 27 tetor 1735 duke merituar plot 33 replika. Më pas u rimorr e rishikuar në Fontainebleau në 1763-shin.*

*Të kihet parasysh që në Francë shtesa bey/beu është shndërruar në berg.*

6 *Mendohet të ketë qenë edhe një operë e tretë, e kompozuar nga politikani dhe natyralisti francez Berard-Germain-Étienne comte de Lacépède me shumë gjasa po me libret të La Motte/La Serre ndoshta e papërfundur, gjithsesi e azgjësuar nga*

- v. Koçi, *Skenderbeg*;<sup>7</sup>
- vi. Siliqi – Jakova, *Gjergj Kastrioti – Skënderbeu* (Tiranë, 17 janar 1968);<sup>8</sup>
- vii. Gjeluci – Grimci, *Bijtë e Skënderbeut* (Durrës, 16 janar 1968);<sup>9</sup>
- viii. Noli/Tole – Tole, *Skënderbeu Kryezoti i Arbërit*.<sup>10</sup>

Qysh në fillim duhet theksuar se ka një dallim thelbësor midis këndvështrimit të operave europiane me ato shqiptare, pasi në kulturën perëndimore Skënderbeu shikohet më shumë si «dashurues dhe luftëtar» [Così 2007, 61], pra inkuadrohet në figurën e kalorësisë, duke reduktuar në këtë mënyrë atë vlerë morale që në bregdetin lindor të Adriatikut i autori i saj. Cf. ROBERT 1963, 178.

7 Harallamb Kristo[for] Koçi [Koço] (lindur më herët sesa viti 1869), i cili ka emigruar nga Boboshtica për në Odesë në 1878-ën, duket se ka mbaruar universitetin në Peterburg, e po aty mendohet se ka ndjekur edhe Konservatorin. Ka të dhëna që me libret të vetin të ketë realizuar në 1890-ën në Odesa një opera mbi Skënderbeun. Me aq sa disponojmë deri më sot, kjo duhet të jetë edhe e më e hershmyja opera e krijuar nga një shqiptar; por, në mungesë të dokumentacionit të certifikuar, nuk mund të avancojmë asnjë hipotezë pune. Gjithsesi, mbetet shumë domethënës fakti që Skënderbeu të jetë protagonist i saj, çfarë do të pohonte edhe një herë — gjithnjë nëse do të kishte nevojë — për vlerën shtetformuese që pati kjo figurë në vetëdijen e shqiptarëve.

8 Libreti: Llazar Siliqi (1924–2001); muzika: Preng Jakova (27. 06. 1917–16. 09. 1969); dirigjent: Mustafa Krantja; regjizor: Pirro Mani; as. regjizorë: J. Bitri e L. Gurakuqi; skenograf: Shaban Hysa; kostumet: Niko Proгри; mjeshtër kori: Milto Vako. Në rolet kryesore: Skënderbeu – Xhoni Athanas e Ibrahim Tukiqi; Ajdin Muzaka – Ramiz Kovaçi; Donika – Nina Mula, Gjenovefa Heba, Irena Gjergo, Leonora Pejo; Jerina Sokolana – Rozmari Jorganxhi; Interpreti kori, ansambli i valleve dhe orkestra e Teatrit të Operas dhe Baletit.

Numri i artistëve gjatë aries “Lirinë s’ua solla unë...” arriti në 280 persona. Jemi pra në tipologjinë e Grand Opéra, gjini që u shfaq në Francë pas 1820-ës e vijoi deri në 1890-ën. Trajtat esenciale të saj janë: spektakolarizimi i skenave me temë historike; kontrastet e forta me gërshetim të koreve masive që fitojnë një peshë të posaçme; numri i konsiderueshëm i personazheve kryesorë e, veçanërisht, i atyre dytësorë me përfshirjen edhe të baletit; orkestra me organikë mjaft të madhe. Grand Opéra parapëlqente strukturën me pesë akte, ndërsa ajo nga Siliqi – Jakova diferencohet duke u nyjtuar në vetëm dy të tillë.

9 Libreti: Matish Gjeluci (1934–2012); muzika: Abdulla Grimci (1919–2018); dirigjent: Ermir Dizdari; regjizor: Enver Plaku; skenograf: Hysen Devolli. Në rolet kryesore: Skënderbeu – Napolon Llalla e Ibrahim Nova; (farkëtari) Gjeto Curri – Sotir Afëzollit; (e bija e Gjetos) Bardha – Ferial Kamata; (tregtar) Syk Tharku – Qemal Golja; (komandanti turk) Anadoll Pasha – Dashamir Gjata; (luftëtar) Memeci – Naim Nova; kori dhe orkestra e qytetit të Durrësit.

10 Opera në fjalë doli fituese te “Konkursi Mbarëkombëtar i Krijimtarisë Muzikore” organizuar me rastin përkujtimin të 550-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar.

atribuojnë Skënderbeut.<sup>11</sup>

Duhet thënë se rikthimi i interesimit rreth jetës kalorësiake, është shfaqur në Europë qysh nga shekulli XV. Rishpërthen kështu «entuziazmi, kryesisht letrar, për këtë pakicë që gëzonte një *status* të veçantë në shoqëri. Rrëfimi i aktivitetit aventuror, i dashurive të pamundura ndaj edhe tragjike, kërkesa për një bashkësi vlerash dhe niveli jetese dinjitoz, shpirti i sfidës dhe i situatave të skajshme, i endjeve në kërkim të një hapësire të pakufizuar edhe në autoritet, do të përbëjnë *tòpoi-të përkufizuese*» [BUHARAJA 2018, 55]. Tematika në fjalë do të rishfaqet herë pas here në varësi të zhvillimeve historike e kjo shpjegon edhe pse kulturat italiane dhe franceze do t'i drejtohen kalorësit vetmitar arbër të shekullit XV. Nuk është rastësi që kulti kalorësiak evropian e gjeti kulmin e vet në Spanjën kryesisht të jugut në luftë prej shtatë shekujsh me arabët, ndërsa ai ballkanik përgjatë të ashtuquajturës ‘linja Jireček’, ku konsumohej tragjedia më e madhe midis Lindjes dhe Perëndimit. Në të dy mënyrat kalorësiake kishte një shkrirje tërësore të principeve të besimit dhe të nderit me interesat e territorit e të klasës dominuese. Gjithsesi dy tipologjitë e kalorësisë ishin diakronike: pikërisht në kohën kur Spanja triumfoi ndaj arabëve, Ballkani u thye nën peshën otomane e kjo shpjegon pse kalorësia spanjolle, Don Kishoti shenjtor dhe i çmendur, e gjen veten në shek. XVI jashtë kontekstit historik, ndaj edhe pa asnjë marrëdhënie me hapësirën e gjallesës fizike, aq më tepër me kombin e vet, kështu edhe i dënuar të falimentojë në çdo formë aktiviteti; ai ballkanik, Kopiliqi e Skënderbeu, të dy princër kalorsiakë e idealistë, do të dominojnë kontekstin historik në raport të pazgjydhshëm me territorin duke u radikalizuar në psikologjinë e bashkësisë së vet aq sa të shndërrohen në simbole mitike të një identiteti tashmë etnik [BUHARAJA 2016, 261].

Në dhjetëvjeçarin e dytë të shekullit XVIII, Perandoria Otomane, pas disfatash të shumta në objektivin e saj mësymës, u bind përfundimisht

11 *Nga lista e mësipërme e operave nuk do të përfshihen në këtë trajtesë (ii) — nga e cila disponojmë vetëm libretin, (iv) dhe (v) — për mungesë tërësore të dokumentimit faktik — (vii) — për faktin e thjeshtë që kjo mbetet kryesisht në nivelin e veprimtarive amatoriale, si dhe (viii) — pasi nuk është ekzekutuar ende e plotë.*

*Jo pa të drejtë është nënvizuar: «Pa dyshim, opera e Jakovës, [...], është afresku më i madh që muzika shqiptare t'i ketë kushtuar ndonjëherë heroit kombëtar. Autori me angazhim të madh ia ka dalë të realizojë një kryevepër në të cilën shkrimi 'italian' dhe temat folklorike shkrihen kaq mirë sa që vepra do të meritonte të jetë parë edhe sot e lirë nga shtrëngimet e detyruara nga regjimi totalitar, në mënyrë që t'i atribuojmë vendin që meriton në trashëgiminë e artit shqiptar» [Ciko 2007, 59].*

që koha e ekspansioneve të mëdha kishte marrë fund, e kështu u detyrua të nënshkruante në 21 korrik 1718 në PassaroËitz (Požarevac) traktatin e paqes me Republikën e Venezia-s në krah të së cilës ishte rreshtuar edhe Austria. Ndarja territoriale do t'i nënshtrohej principit të së drejtës romane *interdictum uti pessidetis* që i siguronte gjithsesi osmanëve ruajtjen e integritetit të territoreve të pushtuara në jug të Danubit, me përjashtim të Beogradit deri në afërsi të Nisch-it.

Franca, e cila kishte nënshkruar qysh më 1536-ën një marrëveshje “diplomatike jo ideologjike” me Perandorinë Otomane, një traktat ky që do të vijojë deri në shekullin e XIX, do ta forcojë edhe më shumë bashkëpunimin strategjik dhe taktik me aleatin mysliman në funksion anti-hasburgjik.

Ja pra ku buron edhe vetëdija e diferencuar që shoqëroi trajtimin e figurës së Skënderbeut te dy fqinjët latinë, duke prodhuar pika krejt të ndryshme shikimi: për venezianin Vivaldi dhe për toscanin Salvi, *Scanderbeg*-u përfaqësonte anti-osmanin *par eccellenza*, aleatin e *Serenissima*-s, e kështu subjekt epik, aq sa në rendimin e aktorëve kryeheroi prezantohet si «Re dell’Albania» [SALVI 1718, 5]; për francezët La Motte/La Serre – Francœur/Rebel *Scanderberg*-u ishte thjesht një kalorës jashtë funksionit të tij etnik e kështu i çlirët në mpleksje aventurash dashurie qoftë me princeshën serbe, realisht e martuar me Amuratin me të cilin do të lindë Muratin II, armiku për jetë a vdekje i Skënderbeut e qoftë me konkubinën e sulltanit. Krejt ndryshe do të trajtohej kryeheroi ballkanas nga Siliqi, Jakova, për të cilët *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* ishte Heroi Kombëtar e, si i tillë, simboli i vetëdijes etnike arbëro-shqiptare.

Në parathënieën e libretit në italisht, pasi bëhet një përmbledhje e shkurtër e historisë duke nisur qysh nga fakti që «Giovanni Castriotto [Gjon Kastrioti]» i cilësuar «Re dell’Albania», pra «Mbret i Arbërisë/Shqipërisë», u detyrua t’i jepte peng Amuratit II fëmijët, midis të cilëve edhe «minorenin Giorgio [Gjergj]» [SALVI 1718, 3], nënvizohet shprehimisht: «Ky subjekt është një nga pjesët më të mira që paraqesin aktorët.<sup>12</sup>Për t’i shërbyer siç duhet, e në komandën e shumë Miqve, dhe

<sup>12</sup> Në tekst *Istrioni*. Mesa duket, ndonjë trupë me emër interpretonte asokohe përshtatje teatrale të jetës dhe të veprës së Skënderbeut, por nuk kemi të dhëna plotësuese në këtë pikë. Për libretistin e *Scanderbeg*-ut rolet ndahen në dy grupe: (i) «Aktorë Grekë» *Scanderbeg*, *Doneca*, *Aroniz*, *Ormondo*, e *Climene* — e (ii) «Aktorë Turq» — *Amurat II*, *Asteria*, *Acomat* [SALVI 1818, 5]. Veç reduktimit të jashtëzakonshëm të numrit të personazheve, tipike kjo e spektakolit barok, bie në sy që arbërit cilësoheshin si

Padronëve jam shtyrë ta reduktoj për Muzikën, duke i lejuar vetes t'i ndryshoj disa Skena, të ul numrin e Aktorëve, e të lartësoj Spektakolin» [*ibid.*, 4]. Është e kuptueshme që, megjithë sfondin historik, për teatrin fiorentin të shekullit XVIII ishte i rëndësishëm, kryesëpari, shfaqja baroke me tërë madhështinë e saj.

Libretisti nuk do të mungojë të pohojë edhe *background*-in ideologjik të vargjeve të veta, që merrnin nismë nga përplasja e dy kulturave: kristiane katolike *versus* myslimane sunite, ndaj e përmyll parathënien e tij me nënvizimin: «Zërat e pahijshëm e profanë, duhen konsideruar në gojën e personazheve barbare nga kombësia, nga zakonet, e nga besimi, asnjëherë si ndjenja të autorit, që ushtron besimin katolik roman, e neverit të gjithë atë që nuk është sipas diktimit të asaj» [SALVI 1718, 4].

Franca e shekullit XVIII, ndonëse e besimit katolik, ishte më shumë nën ndikimin e iluministëve anglezë: Locke, Newton, Hume e Bacon, sa për të përmendur disa emra, ndaj intelektualët e saj nuk e trajtonin si posaçërisht problematike marrëdhënien me një një tipologji tjetër besimi. *L'âge del lumières* me Voltaire, Montesquieu, Fontenelle, etj., po detyronte një rrjedhë krejt tjetër e Parisi po projektohej të shndërrohej në kryeqytetin e Europës. Kjo situatë e re e të përndriturve që synonin të bëheshin *philosophes* me mision pedagogjinë ndaj shoqërisë ku jetonin, shoqërohej edhe me pragmatizmin e politikës franceze që e konsideronte aleate të saj Perandorinë Otomane, veçanërisht në raport me Austrinë dhe me Venezia-n.

Duhet thënë se ndërkohë edhe vetë Myslimanizmi i supershtetit të Azisë së Vogël kishte ndërmarrë përmirësime substanciale e kjo falë dinastisë me origjinë shqiptare Köprülü (Qyprillij), të cilët qysh nga 1656-a e deri në 1735-ën, pra viti që u shfaq *Scanderberg*-u Rebel e Francœur, e kishin administruar në funksionin e vezirit të madh, duke i dhënë një pamje krejt tjetër. Nën këta kryeministra, Perandoria Otomane jo vetëm që arriti shtrirjen territoriale më të madhe të saj, por me Ahmet Pashën (1661–1676) mblodhi rreth vetes edhe një inteligjencë që shfaqti një profil më intelektual e më të hapur në bashkëpunimin midis

---

“grekë”, ndoshta për shkak të besimit të tyre ortodoks që ende sot, në nivel zyrtar, cilësohet si “Kisha greke e shqiptarëve». Ngjarja është marrë nga Sagredo, *Istoriche de' Monarchi Ottomani e, posaçërisht, nga «P. Duponcet Francese della Compagnia di Gesù nella vita di Scanderbeg», kjo e fundit përkthim i ri (1709) në frengjisht i veprës së Barletit (Historia de vita et gestis Scanderbegi) realizuar nga Jean Nicolas Duponcet.*



qytetërimeve dhe kulturave.<sup>13</sup>

Në këtë situatë duhet të jetë menduar edhe prodhimi i një opere me temë nga kryeqendra e Perandorisë Osmane e si *topic* u përzgjedh arbëri më i njohur në Europën kristiane, një kalorës ky që ishte formuar ushtarakisht në oborrin e Sulltanit. Kështu, pikërisht kjo fazë e jetës së kryeheroit do të shërbente si kontekst i zhvillimit të ngjarjeve, gjithsesi joreale, që merr përsipër të trajtojë libreti i de La Motte-s. Pozicionimi francez, posaçërisht i pazakontë, buron prej fakti që nga e tërë historia që mund të themi pa mëdyshje e lavdishme e princit të Krujës, u mënjanua tërësisht njëzetepesëvjeçari i luftës pa kompromis ndaj supershtetit mysliman, me fjalë të tjera, qoftë i fitoreve të pabesueshme të viteve 1443–1451 ndaj mundësit të Gjon Kastriotit, domethënë Murad-it II, në oborrin e të cilit vetë Gjergji kishte merituar emrin Skënderbej e qoftë i triumfeve të atyre 1451–1468 ndaj Mehmet-it II që kishte mposhtur Kostantinopojën, por jo Krujën.

Duhet shtuar që, ndonëse vëmendja artistike franceze u fokusua në periudhën para 1443-shit, historia trajtohet gjithsesi tërësisht me licenca, pa baza historike e me ngjarje të trilluara për t'ia përshtatur skpektaklin shijes parisiane. Qysh nga fillimi i projektit nga de La Motte, pra aty rreth vitit 1710 e deri në vdekjen e dramaturgut në 1731, libreti kishte ecur, megjithatë, mjaft ngadalë, aq sa nuk ishte përmbyllur ende finalja, motiv që detyroi angazhimin e de La Serre. Me plotësimin e tekstit kompozitorët Rebel e Francœur, të cilët kishin realizuar bashkërisht edhe dy vepra të tjera përpara *Scanderberg*-ut<sup>14</sup>, prodhuan versionin e parë që u shfaq në *Opéra* të Paris në 1735-ën, më pas i ndryshuar në atë të 1763-shit.

Ambientimi dhe personazhet mbeten të njëjtë në të dy versionet, por përfundimi i tyre dhe i historive të trilluara, sikurse vërehet nga Tab. 1, ndryshon. Duhet thënë që artistikisht, në dallim nga *Scanderbeg*-u i Salvi – *Vivaldi*-t, *Scanderberg*-u i La Motte/La Serre – Rebel/ Francœur është

13 Do të mjaftonte të përmendnin këtu polakun *Wojciech Bobowsky* (Ali Ufki, 1610–1675) — që realizoi, pos përkthimit të *Biblës në turqisht*, edhe *Mecmûa-i Sâz ü Söz* (Përmbledhje veprash instrumentale dhe vokale), apo *Evliya Çelebi* (1611–1682), i cili në dhjetë vëllimet e *Seyahatname* përshkroi etni të ndryshme të Perandorinë duke dokumentuar natyrën dhe kulturën e zonave të veçanta të supershtetit për të kuptuar rolin e jashtëzakonshëm që luajti posaçërisht *Fazil Ahmed Köprülü* (kryeministër nga 1661–shi deri në 1676-ën), në imazhin më modern të Perandorisë Otomane, të cilën e pajisi madje edhe me një bibliotekë ende ekzistuese.

14 Numri i veprave të shkruara bashkërisht nga Rebel e Francœur është më shumë se njëzet.



më kompleks, me skena më masive e më shumëngjyrëshe, tipike kjo e *grandeur-it français*. Nuk kanë nisur ende të famshmet *querelles* të operas franceze ndaj asaj italiane e në Paris pak e njohin, për të mos thënë që injorojnë tërësisht, spektaklin barok të Gadishullit Appennin. Ambientet masive të haremit, të turqve, të jeniçerëve, të skllevërve, të grekëve e të shqiptarëve, të gjitha me një skenografi e kostumeri magjepsëse nën sfondin e xhamisë, janë të shpeshta në këtë vepër që paraprin në kohë gjininë e *Grand Opéra*-s. Orienti tërheqës me tërë ekzotizmin e tij miklues nuk është trajtuar stilistikisht nga ana muzikore. E gjithë shprehja tingëllore e kërcimeve dhe e *divertissements* është ndërkallur në format muzikore tipike franceze: *Minuet, Rigaudon, Ritournelle, Air (pour les Grecques, pour le Turques, pour les Janissaires, des schythes, en Fanfare), Loure, Tambourin, Marche, Gavotte, Chaconne* dhe *Prélude*. Nuk kanë hyrë ende në kulturën franceze të famshmet *alla turca* që do të joshin kompozitorët *mitteleuropeian*: nga Haydni te Mozarti, nga Beethoveni te Schubert-i, nga Liszt-i te Brahms-i.

Tab. 1. Përfaqje e operave mbi Skënderbeun krijuar nga Salvi – Vivaldi (1718), La Motte/La Serre – Rebel/Francoeur (1735, e 1736) dhe Silliqi – Jakova (1968).

<i>Tipologjia:</i>	Salvi – Vivaldi, <i>Scanderbeg</i> (Firenze, 22 korrik 1718).	La Motte/La Serre – Rebel/Francoeur, <i>Scanderberg – Versioni I</i> (Paris, 27 tetor 1735).	La Motte/La Serre – Rebel/Francoeur, <i>Scanderberg – Versioni II</i> (Fontainebleau, 1763).	Silliqi – Jakova, <i>Gjergj Kastrioti – Skënderbeu</i> (Tiranë, 17 janar 1968).
<i>Akte:</i>	<i>Drama per musica.</i>	<i>Tragedie.</i>	<i>Tragedie.</i>	<i>Drama per musica.</i>
<i>Skena:</i>	3 akte. 9 (3+3+3).	3 akte. 34 (4+5+4+7+7).	Prolog dhe 5 akte. 34 (4+5+4+7+7).	2 akte. 6 (3+3).
<i>Topic:</i>	Konflikt kulturor: Tirani profan otoman <i>versus</i> Mbretit të ndriut kristian.	Konflikt i brendshëm: Mbreti/Sulltani <i>versus</i> Kalarosit më të rëndësishëm për motive xhelozie.	Konflikt i brendshëm: Mbreti/Sulltani <i>versus</i> Kalarosit më të rëndësishëm për motive xhelozie.	Konflikt ndëretnik: Skënderbeu/arbër <i>versus</i> Murad II/otomanë.
<i>Koha e historisë:</i>	Koha e papërcaktuar (e hipotizueshme pas 1443).	Para 1443.	Para 1443.	28 nëntor 1443–29 qeshor 1444.
<i>Trajtimi i historisë:</i>	Me licenza.	Me licenza.	Me licenza.	Historik sipas Barletit [1508–1510].
<i>Personazhe arbër:</i>	'Aktorë Grekë': Scanderbeg, Doneca, Aroniz, Ormondo, e Climene.	Pa diferencim etnik: Scanderberg, Amurat, Servilie, Roxana Mupfli, Osman, Vizir, Jamissaires, Melpomène, Polimnie, Magie, Amour, Sulltaneshat, Bostangi.	Pa diferencim etnik: Scanderberg, Amurat, Servilie, Roxana Mupfli, Osman, Vizir, Jamissaires.	Skënderbeu, Gjergj Ariantii, Vrana Konti, Tanush Topia, Pal Dukagjimi, Lek Dukagjimi, Ajdin Muzaka, Moisi Golemi, Domika, Mamica, Diveta, Ndre Farka, Balë Gjinaku, Marin Shpendi, Damian Miroshi, Jerina Sokolana, Gjon Flamura, këngëtarë lab, ushtarë, popull. Francesco, Murati II, Ali Pasha, Hasan Beu, Talipi, jeniçerë.
<i>Personazhe otomanë:</i>	'Aktorë Turq': Amurat II, Asteria, Acomat.	Recitativë, arie, ansamble. 2 korale në skenën finale;	Recitativë, arie, ansamble vokale, kore miksë e baletit;	Recitativë, arie, ansamble, kore (miksë, i robnavë, i vajzave, mashkullor i jeniçerëve, i fëmijëve), balet; <i>symphonie dramatique; harmoni tonale.</i>
<i>Përbërësit vokalë:</i>	???: <i>basso continuo.</i>	Recitativë, arie, ansamble vokale, kore miksë e baletit;	miksë e baletë (greke, turke, jeniçere, harem, e skithe); <i>symphonie dramatiques; basso continuo.</i>	Arbërit kërkojnë lirinë me Skënderbeun si përfaqësues i këtij ideali; raporti Skënderbeu – Domika është i pranishëm, por jo mbizotëruës.
<i>Endja tekstuale:</i>	Acomati myslliman dhe kristiani Ormondo, dashurojnë Asteria-n; kjo dëshiron Skënderbeun, por ky ëndërron vetëm Donecan.	Amurati dëshiron Servilie (Jerina serbe) e cila dashurohet me Skënderbeun, por në mes këtyre që të vrasë veten dhe e të të ambiciozja Roxana.	Amurati dëshiron Servilie (Jerina serbe) e cila dashurohet me Skënderbeun, por në mes këtyre të fundit përzihet ambiciozja Roxana.	Veneziani Francesco demaskohet, e këshu arbërit janë më të bashkuar se kurë; përmbillet me korallen "Fitore! Fitore! Fitore!
<i>Përfundimi i konfliktit:</i>	Amurati vdes nën muret e Krujës, ndërsa Asteria e Acomati lihen të lirë; Skënderbeu triumfon.	Roxana denoncon të dashuruarit e largohet; Servilie vret veten në emër të paqes; Amurati i dëshpëruar pengon Scanderberg- un e hillohet që të vrasë veten dhe e të të lirë për të ndjekur lavdinë e luftës.	Roxana vret veten; Servilie kërkon të vrasë veten, por Amurat-i e fal; dashuria e Scanderbeg-ut me Servilie-n triumfon.	Procedim <i>a pannelli</i> ; <i>Final scene-complex</i> me përqëndrim të personazheve. <i>Lieto fine.</i>
<i>Teknika e ndërthurjes:</i>	<i>Kostelacion i personazheve:</i> <i>Liaison des scènes;</i> <i>Final scene-complex;</i> <i>Lieto fine.</i>	<i>Kostelacion i personazheve:</i> <i>Liaison des scènes;</i> <i>Final scene-complex;</i> <i>Tragico fine.</i>	<i>Kostelacion i personazheve:</i> <i>Liaison des scènes;</i> <i>Final scene-complex;</i> <i>Lieto fine.</i>	

Me ariet e personazheve dhe me ansamblet e gërshetuara me korale masive shtjellohet konkretisht: *éternelle amour* (*dashuria e përjetshme*) e Skënderbeut me Servilie-n dhe përpjekja e tyre për t'u arratisur me ndihmën e Osman-it; refuzimi i Roxana-s prej Skënderbeut dhe përgatitja për hakmarrje nga ana e saj, synimet e Sulltan Amurat-it për Servilie-n, karriera e Skënderbeut si vezir, dëshira e Amurat-it për t'u martuar me Servilie-n, ndonëse ka marrë vesh nga Roxana marrëdhënien e saj me Skënderbeun. Deri në këtë çast, të dy versionet, megjithë ndryshimet e tyre, paraqiten substancialisht të barasvlershëm. Ajo që ndryshon do të jetë përmbyllja: te versioni 1735-ës Servilie vret veten duke bërë thirrje për paqe midis Amurat-it dhe Skënderbeut, çfarë bind sulltanin të pengojë vetvrasjen e kalorësit të tij më të rëndësishëm duke i uruar lavdi në rrugëtimin e vet fitimtar ushtarak; te versioni i 1763-shit, Servilie tenton vetvrasjen, por Amurati e fal, e kështu dashuria e saj me kryekalorësin triumfon. Ajo që vetvritet është Roxana, e cila, në versionin e parë thjesht ishte detyruar të largohej nga oborri mbretëror.

Një trajtim i kësisojtë i Skënderbeut, nga një anë binte ndesh me të dhënat faktike, pasi nuk rezultojnë gjëkund historira të tilla e nga tjetra kontrastonte fortësisht me realitetin arbër të kohës. Bregdeti lindor i Adriatikut dhe banorët e tij, sikurse edhe pjesa më e madhe e Ballkanit, do të mbetej madje për dy shekuj të tjerë në kufijtë e të ashtuquajturës 'Turqia europiane'. Rilindja Kombëtare, duke nisur qysh nga imagjinari epos i munguar, një farë *Skënderbejade* e arbëreshëve [DE RADA 1866], e deri tek *Istori e Skënderbeut* [FRASHËRI 1898], e kishte këndvështruar sociologjikisht Gjergj Kastriotin si nismëtar të vegimit shtetformues arbër, e rrjedhimisht shqiptar. Me këtë optikë, figura që do të shpallej Hero Kombëtar i shqiptarëve ishte trajtuar dhe gjykuar me të tjera parametra, domethënë më së shumti si *Scanderbeccu i pafaan* [DE RADA 1872–1884].

Është lehtësisht i përfytyrueshëm, në këtë mënyrë, trajtimi artistik i diferencuar në linjë principi midis konceptit të kalorësit kristian kundër sulltanit mysliman apo edhe konkurent në histori dashurie me të, gjykim ky i anës perëndimore të Adriatikut, dhe prijësit vegimtar e besëlidhës i etnisë së vet që mbron të drejtën e ekzistencës së kombit nga ku ka dale, i idealizuar në bregun përkundraill.

Krejt ndryshe do të jetë fati i kalorësisë ballkanike, ku gjallesa heroike detyrohej nga nevoja e skajshme për mbijetesë fizike, bëmat nga pamundësia e të jetuarit në paqe, zulma, pasojë e një jete në kufijtë

e sëpamundurës. Gjithsesi, nga fundi i shek. XV edhe në Ballkan, paralelisht me atë europian, realizohet edhe disfata e dytë e idealit kalorësiak. Ka megjithatë një dallim të madh midis përfundimit të të dyve: nëse kalorësia europiane i mbijetonte vetvetes duke e thjeshtuar forcën e saj etike në *fiction*, mjafton të kujtohet këtu kalorësi *Don Kishoti* i Servantes-it apo *Scanderberg-u* i de La Motte-s, ajo ballkanike do ta tejshkonte kohën e vet përmes rritjes së pareshtur të idealit etik që do të shërbejë si bërthamë nukleare për diferencimin etnik... [BUHARAJA 2016, 261].

Në vargun e veprave vokale apo instrumentale dhe orkestrale prodhuar nga shqipfolësit në përkushtim të idealit të tyre shtetformues spikat posaçërisht *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* [JAKOVA – SILIQI 1977], pika më kulmore e artit skenik rreth kësaj tematike. Opera u vu në skenë në 17 janar 1968 e ishte ndër më të rëndësishmet veprimtari artistike në përkujtim të 500-vjetorit të vdekjes së prijësit arbër.<sup>15</sup>

Përplasja e ballkanasve me ushtritë që vinin nga Azia e Vogël kishte filluar më herët, madje në betejën e Fushës së Mëllenjave në qeshor të vitit 1389 arbërit ishin shfaqur aty si një njësi etnike gjithëpërfshirëse me emra të tillë si:

- Gjergj Balsha II — sundimtari i Shkodrës që kishte nën zotërim edhe Vlorën, Pejën, Prizrenin, Dibrën e Madhe, Ulqinin, Tivarin dhe Budvan
- Teodor Muzaka — zot i Beratit dhe i Myzeqesë;
- Dhimitër Jonima — zotëruar i hapësirës përfaqësojë rrugës Lezhë-Prizren;
- Andrea Gropa — dominues i rajoneve me qendër Ohrin.

Veç tyre kishte gjithashtu udhëheqës të ardhur nga Himara dhe Epiri e në të kishte marrë pjesë madje edhe Gjergj Kastrioti, gjyshi i Heroit Kombëtar. Në këtë linjë gjykimi, Skënderbeu nuk i erdhi Arbërisë si 15 *Të dhënat flasin që porosinë për operën mbi Heroin Kombëtar Jakova ta ketë marrë drejtpërdrejt nga drejtuesi faktik i shtetitshqiptar, pra nga Enver Hoxha. Cf. KALOÇI2016. Administrata e kohës, në pretendimin e saj të tepruar si e vetmja realizuese faktike e ëndrrës vegimtare shtetformuese të Kastriotit të madh, ishte padyshim e interesuar në propagandimin e figurës së Skënderbeut, por kjo ka të bëjë me background-in, por jo me kontekstin e veprës. Edhe reklamimi i pavërtetë që Mrika (1 dhjetor 1958), me autorë gjithnjë Siliqi – Jakova, të ishte e para opera shqiptare rendohet në të njëjtin orientim politik.*

*Në këtë optikë, këto pohime mund t'i përkasin ndonjë forme ideologjike të historisë së muzikës, por jo Muzikologjisë në synimin e hartimit të një historiografie muzikore shqiptare gjithëpërfshirëse.*

një i panjohur, si një i pa histori, por si trashëgimtar i një tradite shumë të rëndësishme, ku përfshihej edhe i ati, Gjon. Në 1389-ën, mbi të tërë, edhe mbi kryekomandantin e koalicionit ballkanik Princ Llazari, u shqua posaçërisht vrasësi i Murati-t I, Milush Kopili. Gjithsesi, në rrëfimet popullore mbi këtë kalorës arbër që historia nuk e dokumenton, i transformuar nga historiografia serbe në fillim të shekullit XIX si Milosh Kopiliq (Miloš Kobilić) e më pas Milosh Obiliq (Miloš Obilić), emër të cilin e mbante edhe më i larti i ish-federatës jugosllave, vrasësi i sulltanit u zbeh shpejt në sytë e arbërve, pikërisht nga shfaqja e figurës së Kastriotit të madh që ia doli të tejkalojë çdo parashikim në krijimin e një identiteti etnik. Skënderbeu nuk shfaqet si bukëshkali kalorës kryeneç që sfidon sulltanin e perandorisë më të madhe të kohës. Ai është udhëheqësi i një etnie që e unifikon nën veshjen katolike, duke e diferencuar kështu në mënyrë vendimtare nga ajo ortodokse e popullsiive të tjera të Ballkanit. Prijësi i Krujës ka si aleatë natyralë Papën e Romës, mbretërit e Regno di Napoli dhe pjesërisht dogët e *Serenissima-s* veneziane.

Veprimi skenik i operës së Jakova – Siliqi-t nuk synon të jetë gjithëpërfshirës i veprës 25-vjeçare të Heroit Kombëtar, por thjesht i fillimeve të epopesë së lavdishme e më konkretisht: nga kthimi i Skënderbeut në Krujë më 28 nëntor 1443 dhe përpjekjet e tij për të njëjtësuar etninë e vet brenda një aleance mbrojtëse e deri te fitorja e parë mbi otomanët në fushën e Torviollit më 29 qeshor 1444, akt ky që u dha zemër jo vetëm arbërve, por bindi edhe ballkanasit, edhe europianët që ushtritë e Perandorisë më të fuqishme të kohës ishin gjithsesi, të thyeshme.<sup>16</sup>

---

*16 Një synopsis i libretit të Siliqit do të ishte: Vjeshtë e vitit 1443. Arbërit për të luftuar robërinë osmane kanë dalë maleve me shpata në duar. Kryezotët vendas, me nismën e Skënderbeut, kërkojnë të lidhen në një aleancë. Skënderbeu u flet fisnikëve Gjergj Arianiti, Vrana Konti, Tanush Topia, Pal Dukagjini dhe të birit Lekë se ka ardhur koha të ngrenë krye kundër Sulltan Muratit II. Lekë Dukagjini, i ri krenar dhe ambicioz, nuk e pranon rolin udhëheqës që ka marrë Skënderbeu.*

*Pas betimit për të mos e lëshuar kurrë shpatën arbërore, luftëtarët përgatiten për t'u përballur me ushtrinë osmane. Akti i parë është marrja e kështjellës së Krujës ku lartësohet flamuri arbër. Hareja përfshin të rinjtë që këndojnë e kërcëjnë, ndërsa më të vegjlit luajnë.*

*Përkundër atmosferës festive të vendasve, venedikasi Francesco përpiqet të mbjellë përçarjenmidis arbërve, duke mikluar ambicien e Lekë Dukagjinit. Ndërkohë edhe ushtria osmane po i afrohet Arbërisë. Skënderbeu arrin ta fusë në grackë Murati-n II, duke i dërguar përmes Francesco-s një plan beteje të rremë. Me demaskimin e*

Një vepër kësisoj kërkon medoemos një angazhim të madh, qoftë në nivel solistësh, qoftë të koreve posaçërisht masive. Veç kryeheroit Skënderbe, në opera shfaqen si protagonistë edhe figurat e rëndësishme historike, si: Ajdin Muzaka, Gjergj Arianiti, Pal Dukagjini, Tanush Topia, Vrana Konti, Moisi Golemi. Krahu i arbërve përbëhet gjithashtu me fshatarë kryengritës, si: Ndre Farka e Balë Gjinaku, me luftëtarë të thjeshtë, si: Marin Shpendi, Damian Miroshi, këngëtari lab, vajza luftëtare Jerinë Sokolana, si dhe historiani Gjon Flamura. Në opera përvijohet edhe bota femërore me Donikën, e bija e Aranitit, gruaja e ardhshme e Skënderbeut, e cila përfaqëson planin lirik të operës dhe me Mamicën bashkë me Jerina Sokolanën. Në krahun e kundërt, veç jeniçerëve e ushtarëve, shfaqen kamandanti Ali pasha e Hasan Beu si dhe oficeri turk Talipi që synon asgjesimin e Skënderbeut përmes atentatit. Në linjën e ndodhive historike, futet në opera edhe veneziani Francesco, i cili vihet përkrah forcave armike.

Prodhimi artistik i Jakova – Siliqi-t prezanton një opera tërësisht simetrike me dy akte, me nga tre tabllo secili (cf. Tab. 2):

Tab. 2. Strukturimi *inmacroforma* i operas *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* të Jakova – Siliqi-t.

---

*venedikasit, arbërit janë më të bashkuar sekurrë për t'u përballur në Torvioll me pushtuesin otoman. Luftëtar Diveta e mbron me trupin e vet Skënderbeun nga atentati me thikë të helmuar i Talipit. Beteja nis e në përfundim të saj ushtria osmane shpartallohet. Lajmërimi i fitores bëhet me këngë në gojë.*

AKTI I	Tablloja I <i>shpresa dhe besimi te Skënderbeu</i>	- “Po agon ditë e re” – kori i kryengritësve; - “N’ durt’ osmanve patëm ra” – kori i robinave; - aria e Damianit; - dialogë të personazheve të ndryshëm; - “Dita po vjen” – korale.
	Tablloja II <i>paraqitja e figurave kryesore të operas</i>	- “Po na fton Atdheu” – kori i luftëtarëve; - “Lule jemi, lule mbajmë ndër duar” – koralja e vajzave; - Aria e historianit Gjon Flamura; - “Si truma zogjsh” – aria e Donikës; - Hyrja e Skënderbeut; - Skënderbeu – Ajdin Muzaka (duet); - “I madhi çast po vjen” – aria e parë e Skënderbeut; - “Kruja është e jona!” – korale.
	Tablloja III <i>Marrja e Krujës</i>	- Korale festive, valle që nënvizojnë gëzimin dhe harenë; - “Lirinë s’jua solla unë, lirinë e gjeta këtu...” – aria e dytë Skënderbeut.
AKTI II	Tablloja IV <i>atmosfera në Krujën e çliruar shfaqet konflikti te arbërit</i>	- “Fluturoi pëllumbi i bardhë” – kori i fëmijëve; - Vallja e vajzave; - Mamica – Donika (duet); - Aria e Francesco-s; - Aria e Lekës.
	Tablloja V <i>kampi osman</i>	- “O trima jeniçerë” – kori i osmanllinjve; - Aria e Ali pashës.
	Tablloja VI <i>Bashkimi i arbërve dhe kundërvënia e palëve në konflikt</i>	- “Ushtari trim” – korale për flijimi e ushtar Diveta-s; - Demaskimi i Francesco-s; - Kthesa tërësore e Lekë Dukagjinit; - “Fitorja është jona” – korale; - “Beteja e Torviollit” – <i>interlud</i> orkestral; - “Fitore! Fitore! Fitore” – korali final.

E skematizuar në këtë mënyrë, arkitektura e operas duket e strukturuar saktë dhe e baraspeshuar kundrejt ngjarjeve të mirëfillta historike që i



dhanë jetë. Jakova e konceptoi operën e vet si një vepër monumentale në stilin e *Grand Opéra*-s me pjesëmarrje të solistëve të shumtë, të koreve të ndryshëm (miks: të robinave, vajzave dhe fëmijëve nga ana shqiptarëve, si dhe ai mashkullor i jeniçerëve nga ajo osmane), të baletit dhe të orkestrës. Pa hyrë në analiza të mirëfillta stilistike mund të thuhet se muzikalisht ariet e personazheve janë shkruar me një gjuhë tipike operistike në vazhden e traditës europiane e posaçërisht asaj italiane, ndërsa koralet janë ato që, në një farë mënyre, shfaqin atmosferën e viteve '60 në Shqipëri e kështu me një dominim të tonit marcial, më pranë këngës masive.<sup>17</sup>

### ***Reagimi i kritikës zyrtare***

Duhet thënë se endja e operas nuk pati një rrugëtim të lehtë: libreti i Siliqit u ripunua katër here, deri sa mori pamjen që shohim sot. Edhe Jakova u detyrua të ripunojë disa pjesë,<sup>18</sup> spostime apo shtesa skenash, etj., çfarë bëri që orkestrimi, për mungesë kohe, të realizohej nga disa duar, duke ndikuar jo pak në kohezionin e veprës.<sup>19</sup> Jakova, veç instrumenteve të tunxhit e të drunjta që i kishte studiuar qysh në gjimnazin e Shkodrës, dallohej për lojën në fizarmonikë, klarinetë dhe kitarë, por e tëra kjo bënte pjesë në formimin autodidakt,<sup>20</sup> ndërkohë që

17 *Këto tipare që po vërejmë për operan Gjergj Kastrioti-Skënderbeu rezultojnë akoma edhe më të ndjeshme e më të theksuara te Mrika, duke përbërë, me sa duket, një trajtë stilistike të procedimit dhe diferencimit kompozitiv të arieve dhe koralet të Jakovës.*

18 Cf. TRABOINI 2016.

19 «Përveç Prenk Jakovës, në orkestrimin e muzikës së operës në fjalë kanë marrë pjesë: Mustafa Krantja, Çesk Zadeja, Tish Daija e Tonin Harapi» [SOKOLI 1978, 54].

20 «Në shtatorin e vitit 1942 ai [Jakova] shkoi për studime në Itali, ku u regjistrua në Konservatorin e Muzikës "Santa Cecilia" të Romës, në degën e klarinetës, të cilën e "përfundoi shkëlqyeshëm", thuhet në kujtimet e vëllait të tij Çeskut» [KALOÇI 2016], një e dhënë e cila nuk përputhet me atë që pohohet pak më poshtë — «Fundi i vitit 1944, e gjeti Prenk Jakovën si mësues në qytetin e Shkodrës [...]» [ibid.], pasi koha për të përmbyllur studimet rezultoi e pamjaftueshme. Për t'u thelluar në përvetësimin e klarinetës, Jakova (sikurse dhe Çesk Zadeja për trompë) u dërgua në Romë, por burimet nga «Accademia nazionale di S. Cecilia (sede di via della Conciliazione, 2-00193 Roma)» pohojnë të kundërtën e saktësisht: «[A]naliza e "Annuario della Regia Accademia di Santa Cecilia" ka evidentuar mungesën e çfarëdolloj tipi marrëdhënie midis Accademia-s dhe Shqipërisë gjatë periudhës 1939-1945. Në fakt, nuk rezultojnë qytetarë të shtetësisë shqiptare midis akademikëve e midis studentëve të Konservatorit të Muzikës e kurrë Akademia nuk organizoi aktivitete muzikore në vendin ballkanik. Edhe kërkimi i kryer drejtpërdrejt pranë Arkivit historik, në fazë riorganizimi gjatë periudhës së regjistrimit, ka dhënë përgjigje negative» [TRANI 2007, 488].



në Shqipërinë e fundit të viteve gjashtëdhjetë kishin arritur të shkolluarit e parë nga Konservatore të rëndësishme të Lindjes, fakt ky që, në një farë mënyre, e paragjykonte krijimtarinë e operistit shkodran.

Gjithsesi, publiku e priti mjaft mirë e me dashamirësi të hapur veprën e re të firmosur nga Jakova – Siliqi, ndërkohë që shtypi i përditshëm e kaloi premierën e operas me një informacion të ATSH mjaft të shkurtër e të përgjithshëm, të botuar në dy organe, ku i mëshohej më shumë pranisë në shfaqje të udhëheqjes së lartë të kohës.<sup>21</sup>

Mesazhi i nënkuptuar i këtij pozicionimi politik ishte më se qartë, domethënë: mosaprovimi zyrtar i operas, por jo të gjithë arritën ta lexonin e ta kuptonin këtë. Kështu, tre ditë pas shfaqjes, pra me 20 janar 1968, kompozitori i sapodiplomuar Feim Ibrahimimi shkruan jo vetëm për «meloditë e rrjedhshme që përshkojnë krejt operën» e që «ndihmojnë kuptimin», por thekson madje që «[n]ë të konceptuarit e krejt veprës ndihet një hap i madh përpara në të gjitha problemet tekniko-profesionale të autorit, pa humbur thjeshtësinë dhe gjerësinë e melodisë», e kështu, ndonëse «disa të meta, me kërkesa më të mëdha, mund të evitoheshin», si për shembull: «Tema duhej të tipizohej më mirë në kuadrin epiko-heroik. Tema e Skënderbeut e parë në këtë prizëm do të ndihmonte mjaft dhe në dramaturgjinë muzikore», përfundohet, gjithsesi, që «vepra në tërësi qëndron. Ajo krijon emocione. [...] Opera *Gergj Kastrioti-Skënderbeu* është një sukses i ri i kompozitorit Prenk Jakova [...]» [IBRAHIMI 1968, 4].

Hartuesi i shkrimit shkon edhe më tej në vlerësimet e veta duke nënvizuar: «Me të drejtë autorët e kanë nxjerrë Skënderbeun një udhëheqës që mbështetet në mendimin dhe forcën e popullit», çfarë «shprehet qartë në çdo moment dhe më spikatur në arien e Skënderbeut [...] Linja popull-Skënderbe përshkon krejt operan duke u rritur nga fillimi deri në fund», fakt ky që gjykohet si «një ndër anët shumë pozitive» të veprës. «Gjuha muzikore është e thjeshtë, pa komplikime» me pjesë të goditura «siç janë ariet e Lekë Dukagjinit, Donikës, plakut me flokë të bardha, etj. ». Veç numrave solistikë, edhe koret «përshkohen nga melodi të qarta, duke shpërthyer simbas momentit që këndohen», me një fjalë: «I gjithë spektakli paraqitet i larmishëm dhe i pasur me situata nga më të ndryshmet» [*ibid.* ].

Shkrimi vlerësues i Ibrahimimit [1968, 4] mbi operën e fundit nga Jakova – Siliqi mbeti, megjithatë, një zë tërësisht i izoluar në shtypin e

21 Cf. ATSh 1968a:1; 1968b:1.

kohës. Pak ditë më pas situata ndryshoi krejtësisht duke marrë pamjen e një mësymjeje që tejkalonte përplasjet e ligjshme midis logjikave kompozitive dhe këndvështrimeve stilistike individuale që artistë të veçantë mund t'i pretendojnë si më efektivet e më në linjë me prurjet e artit të tingullit. Pritja e operas nga qarqet drejtuese dhe nga kritika zyrtare ishte shumë e ftohtë,<sup>22</sup> e në thelb të gjitha kundërvëniet do t'i mëshonin «mungesës së frymës revolucionare tek figura e Skënderbeut, si dhe frymës luftarake», domethënë: «Nuk u kritikua niveli muzikor, por u kritikua fryma lirike e arieve, ku tregohet dashuria e Skënderbeut për Donikën dhe mungesa e aksionit luftarak» [Shqiptarja. com 2012].

Më 28 janar kritikën me shkrim arritën pikën kulmore me pjesëmarrjen e emrave nga më të rëndësishëm të artit shqiptar. Pasi paralajmërohet që «opera *Skënderbeu* nxjerr një sërë problemesh për muzikën tonë dhe për artin dramatik të saj», vijohet me nënvizimin: «Një ndër këto probleme është kuptimi i asaj që themi: muzika të shprehë lidhjen e heroit me masat», ide që sipas firmatarëve «shpesh [...] e marrim përciptazi», madje mund të flitet për «[k]uptim vulgar të lidhjes me masat» e si pasojë, «për ta lidhur me masat heroin e veprës muzikore, grumbullojmë skena koresh, mes të cilave patjetër ndodhet edhe heroit», duke besuar kështu se «[m]jafton që heroit të jetë në mes të masës, pa s'ka rëndësi se këngët që këndon kjo masë kori të jenë pa ngjyra dhe të zbehta» [ZADEJA – AGOLLI 1968, 3a-b]. Për kritikët kjo lidhje realizohet kur muzika «shpreh thellësitë e tabanit të tokës shqiptare», e nëse spektatori do «ta ndiejë atë dhe ta kujtojë» sociologjikisht duke folur, «kjo do të ishte lidhja e dyfishtë me masat: Skënderbeu me masat e shekullit të tij dhe vepra me masat e shekullit njëzet në Shqipëri» [*ibid.*, 3b].

Dobësia e koraleve që vërehet në këtë paragraf mund të jetë edhe e saktë, por pozicionimi i kritikës zyrtare në terma të estetikës së realizmit socialist demonstroi që bashkë me shkollimin, studentët shqiptarë që vinin nga universitetet apo konservatoret e Lindjes, mbartnin edhe teori të parafabrikuara që do të ndikonin fortësisht në artin në përgjithësi e atë muzikor në veçanti e në këtë këndvështrim Prenk Jakova shfaqet si objektivi i parë i kësaj tendence. Prania e heroit pozitiv është një domosdoshmëri për estetikën me frymëzim marksist, por ky hero, duhet të jetë i rrethuar nga masat që janë pasqyra ku ai sheh veten.<sup>23</sup>

22 Cf. Ciko 2012.

23 Me këtë optikë, do të mund të thonim që roli i masave nuk është dytësor — siç

Në këtë prizëm, duke qenë që vetë masat shfaqen pa identitetin e tyre tipizues, aq më tepër kur fjala është për arbër në luftë kundër pushtuesit otoman, është e qartë që edhe kryeheroi i tyre paraqitet shumë-shumë si personazh, pa ndonjë vlerë të spikatur. «[...] Skënderbeut i mungon leitmotivi dhe kjo ka bërë» gjithnjë sipas kritikëve në fjalë «atë që të ketë pak funksion në vepër», kështu «ardhja e tij në skenë kufizohet me disa sinjale muzikore» [*ibid.*, 3b] e madje: «Herë-herë ai duket si kalorës i thjeshtë, që rruga rastësisht e ka nxjerrë në një grumbull njerëzish, si një njeri që i tregon karvanit ndonjë shteg të panjohur për të ecur. Bota e tij e brendshme është e thatë dhe ai shëmbëllen me një hije» [ZADEJA – AGOLLI 1968, 3d].

Përdorimi i termit ‘kalorës’ lë të hamendësohet që autorët e shkrimit (hiper)kritik të kenë pasur dijeni të trajtimit që i është bërë Heroit Kombëtar në operat e huaja të sipërpërmendura e jo vetëm: ata duket se kanë përvetësuar edhe principet sociologjike në themel të teorive që hetojnë idealin e kësaj kategorie mjaft të veçantë në shoqëritë perëndimore. Skënderbeu i paraqitur nga Siliqi – Jakova prezantohet përmes dy arieve si dhe merr pjesë në disa duete e mund të kërkohej që roli i tij muzikor të ishte edhe më i plotë. Në pohimin e kritik-shkruesve shprehet qartë:

Në operën *Skënderbeu* spektatori kishte një dëshirë të madhe që figura e saj qendrore, Skënderbeu, si nga ana dramaturgjike, ashtu edhe muzikore, të ishte e fortë, e gjallë, interesante. Ai donte të shihte një Skënderbe ushtar, strateg dhe burrë shteti, siç ishte në të vërtetë ky hero legjendar i botës shqiptare. Pa mohuar ato merita që ka kjo figurë në opera, ne mendojmë se gjer në pjekurinë e saj artistike mbetet shumë për të bërë. Skënderbeu shfaqet dhe fshihet, vërtitet në skenë dhe zhduket, pa lënë ndonjë emocion. Në figurën e tij mungon preokupimi dhe mendimi; ai nuk ndeshet me individualitete të tjera, nuk sugjeron e nuk vepron [ZADEJA – AGOLLI 1968, 3c-d].

Gjendja e padiferencuar prek të gjithë solistët e kështu: «Heronjtë flasin me një gjuhë në ariet, sepse, siç thamë, mungon individualiteti i tyre», çka rezulton «edhe në reçitativë» e «vihet re më qartë se kudo në ansamblet», ku personazhet «ndryshojnë nga pamja e nga veshja» *ndodh me Scanderbeg-un e Salvi – Vivaldi-t, e as kolorik, pra si te Scanderberg-u i La Mote/La Serre – Rebel e Francœur. Në këndvështrimin e estetikës së realizmit socialist, këto vepra do të likujdoheshin, sikurse edhe ndodhi realisht, thjesht si të prodhuara nga shoqëri ku masat janë të shtypura, të tëhuajzuara e kështu edhe në pamundësi për të paraqitur kurrfarë trajte karakteriale tipizuese.*

[*ibid.*, 3b], por jo nga gjuha muzikore. «I vetmi që ka një shkëndijë individualiteti është personazhi i Lekë Dukagjinit» [*ibid.*].

Ndonëse në kryefill të shkrimit ishte pohuar se «[k]a momente që muzika e veprës të ngjall emocion. Në të ka skena, sidomos masivet, ku kumbon muzika shqiptare [...]», posaçërisht në pjesë të tilla si «aria e mullisit plak, aria e Lekë Dukagjinit, skenat lirike të grave me koret me shtama e ndonjë tjetër» [*ibid.*, 3a], në vijim gjithçka trajtohet krejt ndryshe. Në nënvizimin e autorëve, staticiteti karakterizon edhe koralet që mbesin njëlloj «nga një tablo në tjetrën», ndaj «për ta ndihmuar kompozitorin», theksohet «se koret pa funksion në opera mbeten vetëm si relike të rastit, por jo si ndjekëse të situatave dramatike» [*ibid.*, 3c]. Edhe simfonizmi i temave demonstroi shkëputje që «ndërpresin dramën dhe e bëjnë një grumbull tablosh» [*ibid.*, 3b].

Në mbështetje të *credo*-ve të tyre artistike dy (hiper)kritikët në fjalë nuk do të kursejnë as edhe slogane të tipit: «Partia e ka theksuar gjithnjë se populli kërkon një art me përmbajtje të madhe dhe me formë të lartë» me të cilat «arti mund të edukojë njeriun e ri dhe mund ta hedhë nga aksioni në aksion» [*ibid.*, 3b-c]. Perifrazimi stalinian,<sup>24</sup> aq më tepër nëse kemi parasysh se në çfarë faze kishte hyrë Shqipëria,<sup>25</sup> bëhej posaçërisht i rrezikshëm për Jakovën, e pasojat filluan t'i shfaqen shumë shpejt, sidomos në sferën e stabilitetit psikik...

Kritika që vinte nga Zadeja – Agolli duket se i drejtohej vetëm kompozitorit.<sup>26</sup> Realisht, nëse përmbajtja verbale do t'i kishte rezervuar më shumë hapësirë heroit kryesor, është e qartë që muzika nuk mund ta anashkalonte tekstin e po kështu regjisori do ta kishte nxjerrë në pah edhe më tepër kryeherin e veprës. Prania e një mase aq të madhe personazhesh dhe me pjesëmarrje aq aktive të koreve e ngushtonte

24 Faza që i atribuohet Stalinit rezulton të jetë: «Shkrimtari [alias: artisti] është një inxhiner i shpirtit». E thënë në fillim të viteve tridhjetë, ajo do të bëhet motto në përkufizimin e principeve të doktrinës së realizmit socialist përgjatë Kongresit të Shkrimtarëve dhe Artistëve (Moskë, 1934) e do të përdoret në vijim në politikën represive ndaj artistit: «“Shoku Stalin ju ka quajtur ‘inxhinierë të shpirtit’, ” u shpjegon Ždanov-i kongresistëve. “Çfarë kupton kjo? Cilat përgjegjësi rëndojnë mbi shpatullat tuaja?”» [WESTERMAN 2006, 131].

25 Duhet kujtuar që kishte nisur lufta kundër besimeve fetare e pas pak do të fillonte dhe “asgjësimi” i grupeve që akuzoheshin si puçistë në ushtri, sabotues në ekonomi apo me ndikime borgjeze në art.

26 Në të vërtetë emri i libretistit nuk përmendet gjëkund në shkrim, ndërsa regjisori, piktori, dirigjenti i orkestrës, mjeshtri i korit si dhe kolektivi i Teatrit të Operas dhe Baletit përgëzohen në veçanti.

sigurisht hapësirën që mund t'i rezervohej figurës themelore. Në këtë rast opera duhej (i) ose të ishte shtjelluar në më shumë akte, e rrjedhimisht më shtrirë në kohë, por kritikët e ndryshme nënvizonin faktin që vepra edhe kështu ishte e gjatë, ndaj u shkurtuan mjaft fragmente (ii) ose të ishte kufizuar numri i personazheve dhe të ishte ngushtuar rrethi i ngjarjeve me pasojë tkurrjen e karakterit monumental që sigurisht për Jakovën kishte qenë synimi kryesor.

Ajo që këshillonin kritik-shkruesit ishte një ripunim tërësor i operas duke synuar qoftë përmirësimin dramaturgjik, gjë që do të kërkonte një rindërtim të libretit, e qoftë të shtratit muzikor me synim përmirësimin stilistik të shprehjes muzikore.<sup>27</sup>

Në të njëjtën frekuencë edhe Simon Gjoni, rreth dy javë më pas, ndonëse nuk përputhet me gjykimin e mësipërm mbi paraqitjen muzikore të masave në vepër, me: «Masa e luftëtarëve dhe e popullit [...] përfaqësohet në opera në shtrirje mjaft të gjerë dhe me një gjuhë muzikale të goditur»<sup>28</sup> [GJONI 1968, 1a] e shtrin kritikën e vet jo vetëm mbi kompozitorin, por edhe mbi libretin:

Kjo figurë monumentale [Skënderbeu] që çdo shqiptari i është tipizuar në çdo kohë që nga njohuritë e para të fëminisë, duke iu bërë kështu simbol i guximit, trimërisë, heroizmit, atdhedashurisë, luftimeve të popullit tonë për liri, duhet të gjente zgjidhjen e denjë si në dramë, ashtu edhe në muzikë. Por duhet thënë se autorët nuk ia kanë arritur plotësisht realizimit me sukses të kësaj figure qendrore. Është e vërtetë që ai gjendet mjaft dendur në skenë, por roli i tij, aksioni, forca e tij organizatore luftarake, udhëheqëse nuk gjejnë zgjidhje aq të kënaqshme [ibid. ].

Këtë të metë Gjoni [1968, 1b] e sheh si ndikim nga këndvështrimet e operave europiane që priren drejt një «gjuhe poetike të rëndomtë» e me «një dozë të fortë konvencionalizmash dhe manierizmash».<sup>29</sup> Kritiku

<sup>27</sup> «Ata që e duan artin, duke i thënë kompozitorit ndonjë vërejtje, nisen nga dëshira e përmirësimit të veprës, në mënyrë që ajo të mos jetojë vetëm një ditë jubilarë a festive, por të bëhet bashkudhëtare e gjatë e skenës. Kemi bindjen se kompozitori Prenk Jakova do të ulet përsëri në partiturat e operës Skënderbeu dhe do të punojë mbi to me këmbëngulje dhe seriozitet, sepse tabani i saj tanimë është formuar; ajo dëgjohet nga spektatorët dhe ndiqet prej tyre» [ZADEJA – AGOLLI 1968, 3d].

Njëzet muaj më pas Jakova u nda nga jeta në rrethana jo plotësisht të qarta e nuk kemi informacion nëse ka menduar apo ka nisur ta ripunojë operën e tij të dytë dhe të fundit.

<sup>28</sup> Këtu artikullshkruesi veçon koralen «Kruja, Kruja është e jona» [GJONI 1968, 1a].

<sup>29</sup> Kritik-shkruesi nuk qartëson nëse vërejtja mban si objektiv vetëm veprat që kanë

flet edhe për «një dozë mjaft të theksuar inaktiviteti» të kryeheroit me një *leitmotiv* të mbetur në fazën elementare, «i pazhvilluar, i pathurur organikisht me momentet e tjera dramatike» [*ibid.*, 1a]. Ai do të kishte dashur që krahu antagonist i turqve, të cilët «i kanë sjellë vendit tonë aq shkatërrime, vuajtje e tmerr, sa që kudo ku shkelte këmba e tyre s'kishte tjetër përveç vdekjes [...] të ishte trajtuar më me ashpërsi», pa «atë përshtypjen më tepër të një orientalizmi lirik të përgjithshëm [...]» [*ibid.*, 1a-b].

Ndonëse demaskimi i Francesco-s, i cili përfaqëson në libret politikën me dy faqe të Venedikut, në gjykimin e Gjoni-t është realizuar mirë, kjo figurë gjithsesi «kaq negative dhe e urryer do kërkonte një gjuhë muzikale po aq djallëzore, të deformuar siç është vetë personazhi, sepse aria e tij kryesore tingëllon mjaft e ëmbël dhe e dashur» aq sa, «ndoshta, do të ishte më e pershtatshme për ndonjë figurë pozitive» [*ibid.*, 1b].

Edhe pse linjat episodike, «fragmentalizojnë tërësinë e operas» [*ibid.* ], libreti i Siliqit vlerësohet gjithsesi si «një punë më e mirë, më e kujdesshme dhe më e thelluar, si nga ana dramaturgjike, ashtu edhe në gjuhën poetike» [*ibid.*, 2b]. Problemi qëndron, mesa duket, vetëm te muzika,<sup>30</sup> ku «është dobësuar figura qëndrore» dhe «konflikti nuk është realizuar aq mirë», çfarë bën që të «lindë edhe përshtypja e një suite tabllosh ma tepër se sa e një tërësie dramatike» [*ibid.* ]. Edhe reçitativi «duhet të ruajë intonacionet e gjuhës amtare, kadencat e saj, nuancat, skadimin [sic!], frymëmarrjen etj. » [*ibid.*, 1b] e këtu dallohet ndonjë përparim në krahasim me operan Mrika. Me këto premisa, shkrimi

*si topic Skënderbeun, e këtu edhe mund mund t'i jepnim ndonjë të drejtë, apo gjykon en bloc tërë operan perëndimore, çfarë do të mund të shpjegonte fare qartë edhe rrugëtimin e mëvonshëm që iu detyrua gjinisë më të madhe skenike në Shqipëri.*

*Në harkun kohor 1968–1990 u prodhuan këto opera: Kasapi – Gaci, Përtej mjegullës (1971); Marku – Harapi, Zgjimi (1975); Agolli – Zoraqi, Komisari (1975); Kraja – Kapidani, Celula e kuqe (1976); Siliqi – Daija, Vjosa (1980); Luca – Gaci, Toka jonë (1981); Zheji – Mula, Borana (1984); Idem, Nëna e trimave (1987); Mato – Zoraqi, Paja (1989); Uli – Dergjini, Besa (1990). Me pak përjashtime, topic-u i tyre është dukshëm i orientuar ideologjikisht.*

*Me këto premisa, një studim muzikologjik me këndvështrim sociologjik do ta vlerësonte operan Gjergj Kastrioti-Skënderbeu të realizuar nga Jakova – Siliqi si shprehje e fundit në këtë gjini e subjektivizmit krijues. Megjithë dobësitë e saj, kjo vepër kishte ruajtur, gjithsesi, lirinë individuale të shprehje dhe të këndvështrimit personal. Pas saj, opera do të ishte gjinia më e kontrolluar nga censura.*

*30 Pothuajse të gjitha shkrimet këtu, përfshirë edhe atë të Gjoni-it [1968], nuk avancojnë asnjë kritikë ndaj regjisorit, skenografit e, aq më tepër, ndaj stafit të Teatrit të Operas dhe Baletit.*



përmbillet me kërkesën mëdyshëse për rishikim e veprës që mbase mund ta ndryshojë situatën, pasi: «Dobësitë që vihen re, ndoshta, kanë mundësi të ndreqen [...]» [*ibid.*, 2c].

Edhe marsi i 1968-ës nuk kaloi pa probleme. Revista *Nëntori*, në rubrikën ‘Kronika kulture’, përshkruan *synopsis*-in e operas duke mbajtur, gjithsesi, një qëndrim kritik. «Që në tabllonë e dytë figura dalluese e operas, Skënderbeu, duket mirë e përcaktueme nga ana skenike, por muzikalisht e zbehtë» [KALEMI 1868, 156a]. Skena e takimit të princave arbër, «që duhet t’ ishte një nga ma të fortat e operas, del jo sa duhet e fortë muzikalisht dhe nga ana skenike nuk krijon aq emocione. Asaj i mungon dramaciteti, kontrasti e konflikti i brendshëm» e kështu «me zhvillimin e saj të plogët, nuk i komunikon spektatorit randësinë e momentit e të ngjarjes» [*ibid.*, 156b].

I rreshtuar në të njëjtën linjë të kritikave të ardhura nga Zadeja – Agolli dhe Gjoni, Kalemi nuk sheh dallime muzikore midis princave, veç veshjes së tyre. Megjithatë ka edhe ndonjë numër muzikor që mund të veçohet, si për shembull: «Shumë bukur dhe prekëse tingëllon aria e plakut, personazh i goditun popullor» [*ibid.*, 157a], «aria e goditun» e Lekë Dukagjinit, si dhe tema e Krujës që «përfundon kohën e parë», «melodia e bukur dhe e gjallë e së cilës ruhet në kujtesën e dëgjuesve» [*ibid.*, 156b]. Autori i shkrimit nënvizon faktin që «[p]ërgjithësisht opera *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* u prit mirë nga amatorët e shumtë» të Teatrit të Operas dhe Baletit, «[p]or Skënderbeu historik, Kastrioti i njohun nuk doli i plotë dhe i qartë në të», e kështu, në vend që t’i tregonte spektatorit «karakterin e tij kompleks», në prodhimin artistik në fjalë «lufta dhe jeta e heroit plotësohen ma tepër me imagjinatë e fantazi, se sa nga scena dhe muzika» [*ibid.*].

Sidoqoftë, Kalemi gjykon që «opera asht një vepër e mirë e kompozitorit Preng [sic!] Jakova. Ajo ka momente të bukura, melodi plot frymëzim», ku veç arievë të sipërpërmendura, bien në sy «koralet masive që tërheqin me madhështinë triumfale, simbolizuese» duke përbërë «një hap përpara në krijimtarinë e autorit» [*ibid.*]. Në fund, një përgëzim masiv për të gjithë interpretët, dirigjentin, regjizorin, skenografin, kostumeristin të cilët, «me shijen dhe zgjedhjen e drejtë në fushat e tyre, krijuan ngjyra shumë të bukura e të gjalla».

Sikurse vërehet, i vetmi që kritikohet me emër e mbiemër mbetet përsëri kompozitori, ndërsa libretisti as që përmendet...

Situata u rëndua edhe më tepër në javën e parë të prillit të 1968-

ës gjatë mbledhjes në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve me temë: «Diskutim krijues për operën *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*», pasi vepra në fjalë «shtroi një radhë problemesh, siç janë: interpretimi sot i temës historike, karakteri demokratik i kësaj forme muzikore, dramaturgjia muzikore, gjuha kombëtare e të tjera» [ATSh 1968d, 2]. Fjalën e parë e mori Zadeja, i cili «nga një analizë mjaft e hollësishme [...] arriti në përfundimin që aty nuk ka konflikt qendror, sepse forcat antagoniste ndahen në shumë episode», aq sa mund të shtrohet pyetja: «Cili është Gjergj Kastrioti» të cilin «ne nuk e shohim» [*ibid.*, 2a]. Edhe pse vlerësohet si «faktor shumë pozitiv» përvijimi i «koncentrimit melodik» me linjë të «qartë, emocionale dhe kombëtare», duke ruajtur në përgjithësi origjinalitetin, vërehet megjithatë se kryeheroi «paraqitet i zbehtë» e kjo sepse «leitmotivi i tij është më fort një sinjal i jashtëm dhe nuk kryen rolin udhëheqës si hero kryesor» [*ibid.*]. Duke mos shquar dallim midis «trajtimin intonativ e muzikor [...] të heronjve negativë dhe të atyre pozitivë», Zadeja shtron pyetjen: «[K]u qëndron lufta e të kundërtave»? [*ibid.*]. Për më tepër, disa personazhe arbër, me intonacionin e tyre të «trishtë», kanë «në përgjithësi karakter pesimist e në ndonjë rast ndihmojnë për të krijuar atmosferën e panikut»<sup>31</sup> [*ibid.*].

Zadeja kritikon staticitetin e koreve, sepse «në operan ku zhvillohet drama popullore, si në ato epiket, kori, masa» duhet të marrë «pjesë aktive dhe vendimtare» [*ibid.*]. Po kështu, mungesa e ansambleve, në pohimin e Zadesë, «nuk justifikohet në një dramë epike, me kaq shumë personazhe, me konflikte të gjëra» [*ibid.*, 2b]. Sa për mbështetjen instrumentale u vërejt se «krahas përdorimit me vend të orkestrës, sidomos në shoqërim, në shumë momente psikologjike, citohen edhe materiale tematike pa vend» [*ibid.*]. Sidoqoftë, «të gjitha këto të meta» arsyetohen si «të natyrshme në këtë etapë të rritjes së kulturës sonë socialiste» [*ibid.*].

Duhet thënë që pjesa më e madhe e diskutuesve, megjithë vërejtjet, mund të kishin «anuan më tepër nga vlerësimi pozitiv» [*ibid.*], por

31 Për këdo që ruan në kujtesë se çfarë tumbetohej me të madhe asokohe, konkretisht: “atmosfera e pashoqe revolucionare”, “hovi i papërmbajtshëm i masave popullore në luftën e drejtë për liri”, e të tjera ideologjizma të kësajsojta, është e qartë se etiketimi si «i trishtë» dhe «pesimist» i personazheve pozitive, portretizimet artistike të të cilëve, aq më tepër, «ndihmojnë për të krijuar atmosferën e panikut» barazvlente me asgjësimin tërësor të veprës, me pasoja lehtësisht të parashikueshme për autorin e saj.



kjo nuk e ndryshoi tendencën e mbledhjes.<sup>32</sup> Duke pranuar që «opera është sukses për krijimtarinë tonë operistike dhe për autorin», Dhimitër Shuteriqi, në cilësinë e kryetarit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, nënvizoi që «drama personale që u tha se i mungon operas *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*, nuk duhej të ishte një dramë e tillë, si ajo që njihet në shumicën e veprave klasike» [*ibid.*, 2c]. Gjatë arsytimit mbi «çështjen nëse do të jetë kjo formë e operas që do të vazhdojmë të krijojmë», ai do të shtrojë pyetjen retorike: «A nuk ka ardhur koha që ta rishikojmë ndikimin e traditës klasike e të mendojmë që opera të bëhet një gjini e cila të jetë më afër epokës sonë?» [*ibid.*].

Si do të mund të shpjegohet tërë kjo mësymje hiperkritike ndaj Jakovës, fakt që detyroi angazhimin e emrave nga më të rëndësishmit e artin shqiptar, ndërkohë që opera paralele, me të njëjtën temë e me të njëjtin objektiv celebrativ, e realizuar në Durrës nga Gjeluci – Grimci, vetëm lavdërohej, edhe pse jo me firma të kritikës zyrtare.<sup>33</sup> *Bijtë e* 32 *Për Tonin Harapi-n «opera është një sukses i shumanshëm» dhe se një «radhë të metash dramaturgjike e muzikore që ka» janë pasojë e «redaktimit të fortë që i është bërë, kur është vënë në skenë, që e kanë zbehur e dobësuar në shumë drejtime» [ATSh 1968d, 2b]. Në të njëjtën linjë arsytimi, Albert Paparisto, ndonëse e pranon «dobësinë te veprimi dramatik muzikor i operës», thekson që edhe «redaktimi ka sjellë më shumë dëm se dobi» pasi janë «hequr dy tabllo, duke lënë në mes personazhe [...], duke shpërndarë materiale në tabllo të ndryshme» [*ibid.*]. Mustafa Krantja vlerësoi tingëllimin «thelësisht shqiptar» të operas, edhe pse kryeheroi mund të ishte shprehur muzikalisht me «një frymëmarrje më të gjerë» [*ibid.*].*

*Nga një tjetër pikë shikimi, Baki Kongoli gjykoj se «diskutime si këto janë përvojë për të gjithë dhe u vlejnë të gjithë krijuesve, të cilët ende nuk po i përgjigjen me puls in e duhur vrullit revolucionar të ditëve tona» [ibid., 2c]. Duhet theksuar se në dekadat në vijim, mbledhje me tematika të ngjashme, jo rrallë herë u kthyen në procese të vërteta e të mirëfillta, ku vetë krijuesit do të vihen në bankën e të akuzuarit pa mundësi apelimi. Mjafton të kujtojmë që, edhe në informacionin e dhënë nga ATSh-ja për mbledhjen në fjalë, nuk përfshihet as edhe një argument apo arsytim që vetë Jakova mund të ketë afruar për veprën e vet. Ai personalisht rezulton tërësisht mungues, aq sa mund të shtrohet pyetja: a ka qenë i pranishëm kompozitori në atë diskutim?!*

33 *Duket si humor, por në një shkrim të gjatë në katër kolona mbi operën e vënë në Durrës flitet me entuziazëm të paparë në kritikën tonë muzikore për aktorët që «janë amatorë të thjeshtë, me duar të plasaritura, plot kallo, që rrudhin vetullat kur u thyhet një thikë, që zemërohen kur shoku i tyre nuk e realizoi normën, që gëzohen pastaj kur shohin shifrat e planit të ngjiten gjithmonë lart» [ZP 1968, 3a]. Në operën *Bijtë e Skënderbeut* «[k]ompozitori krijoi një muzikë me motive popullore. Në pentagramë dhe në skenë u ngjit folklori ynë i pasur. Ndaj muzika tingëlloi e ëmbël, e thjeshtë, e lehtë për t'u kuptuar» [*ibid.*, 3b]. Intervistohen edhe njerëz të thjeshtë që kujtojnë se para çlirimit nuk siguronin dot as bukën e gojës, kurse sot, jovetëm që jetojnë për mrekulli, por u jepet mundësia edhe të këndojnë në skenë, duke përfunduar: «Në*

*Skënderbeut* u shfaq gjithashtu në Teatrin e Operas dhe Baletit në prani të udhëheqjes më të lartë të politikës e të shtetit,<sup>34</sup> e megjithatë nuk pati asnjë reagim negativ. Revista *Nëntori*, menjëherë pas shkrimit të sipërpërmendur të Kalemi-t [1968], vijoi me trajtimin e veprës së realizuar në Durrës e cila «pati një sukses të merituar» [OLLDASHI 1968, 157b]. Amatorët vinin nga prodhimi, madje «shumica u ngjitën për herë të parë në skenë. U ngjitën edhe fituan» e kjo, me sa nënvizohet, nga fakti që «[p]unëtorët demonstruan në skenë hovin revolucionar që i karakterizon, forcën dhe dashurinë që kanë për artin dhe kulturën» [*ibid.* ]].

Të dy operave shqiptare për Heroin Kombëtar u jepet e njëjta hapësirë në faqet e organit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, por ajo që të befason është fakti se për të dytën nuk ka asnjë rresht kritik, madje në asnjë nga shkrimet e shfaqura në shtypin e kohës, nuk shfaqet ndonjë dilemë e kësisojtë.

Në këtë mënyrë, nga kritika zyrtare, përmes shtypit të përditshëm dhe të specializuar, opera *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* u paraqit si dështim tërësor i kompozitorit Jakova e si e tillë, këshillohej vetëm ripunimi, ndërsa *Bijtë e Skënderbeut* u propagandua pa asnjë mëdyshje si fitore e merituar e amatorëve.

Pas kësaj mbi operën *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* do të bjerë heshtja pothuajse e plotë...

Sot, në distancën kohore të një gjysmë shekulli, mund të pohojmë me bindje që viti 1968 shënoi kthesën rrënjësore në konceptimin e artit shqiptar.<sup>35</sup> Duke u mbështetur mbi principet estetike të importuara nga gjirin e masave ka talente të mrekullueshëm [...] të cilët «shohin veten e tyre dhe që krenohen me mundësitë e tyre artistike» [*ibid.*, 3d].

*Me të njëjtin ton edhe Drita [1968, 1a] e një dite më pas, flet për sukses të merituar të punëtorëve amatorë të Durrësit të cilët, «të mbështetur nga partia, i kaluan me guxim duke bërë pluhur e hi ndonjë mendim konservator e skeptik se opera nuk na qënka punë që mund ta bëjnë amatorët». Dyqind amatorë «punuan me zell e dëshirë të madhe dhe bënë që çfaqja të tingëllojë me zë të plotë» [*ibid.* ].*

34 Cf. ATSh 1968c, 2.

35 Në vitin 1968 pozicionimi i kritikës së specializuar duket mjaft i radikalizuar. Me premisën që «Marksizëm-leninizmi na mëson se arti është pjesë e ideologjisë në fuqi», orientohet që, «në komentimin e njëres apo tjetres epokë apo rrymë artistike, të njërit apo tjetrit kompozitor, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se, me gjithë progresivitetin e tyre, përfaqësonjësit e epokave të ndryshme, duke futur këtu edhe ata më gjenialët, nuk kanë qenë të shpëputur nga ideologjia në fuqi», ndaj, si rrjedhojë: «S' duhet të ketë asnjë idealizëm as për Bet-hovenin [sic!], as për Verdin, Musorgskin a Çajkovskin; prandaj është detyrë e lëndës së historisë së muzikës që, duke iu drejtuar krijimtarisë

Lindja, tanimë do të nyjetohej hapur detyrimi për një tjetër tipologji artistike në përgjithësi e vokalo-skenike në veçanti, me qëllim shmangien tërësore të prurjeve perëndimore. Në një shkrim mbi dekadat e majit të po atij viti, kritika zyrtare, pa e përmendur fare operan e fundit të Jakovës të pak muajve më parë, do të orientojë:

[...] një i ri vullnetar, apo një partizan shqiptar nuk mund të këndojë as si Rudolphi i Puçinit as si Zhernondi i Verdit. Pikërisht një akademizëm dhe një ton të tillë ne shpesh herë nuk e kemi kapërxyer në operat tona; atë e shikojmë tek *Lulja e Kujtimit* dhe tek *Heroina*, herojt e të cilave flasin me gjuhën dhe mënyrat e personazheve klasike. [...]. *Mrika* u përpoq të na e sjellë këtë atmosferë [të kohës sonë], por muzika e saj nuk mundi akoma të ngjitej në atë nivel artistik që kërkon opera [PAPARISTO 1968, 2a].

Dhjetë vjet më pas, Ramadan Sokoli do të shfaqet më i rezervuar në shkrimin e vet. Ai e vlerëson libretistin si «poet që ka dhënë një kontribut të vyer» edhe në gjininë e operas, ku shfaq madje «mjeshtri artistike», si «për nivelin e lartë ideoartistik të vargjeve ashtu edhe për anën dramaturgjike duke skalitur një sërë personazhesh» [SOKOLI 1978, 52–53]. Autori nuk paraqet kritika personale ndaj shprehjes tingëllore duke u kufizuar në pak fjalë: «Muzika në operë në përgjithësi është e lidhur mirë me përmbajtjen e tekstit dhe arrin një farë individualizmi duke skalitur secilin personazh» [*ibid.*]. Një vlerësim mjaft i përmbledhur jepet edhe për trajtimin e masave: «Koralet në përgjithësi kumbojnë fuqimisht e me theksime heroike [...] ndonëse nuk rriten gjithmonë nga akti në akt por qëndrojnë në përmasa fillimtare» [*ibid.*, 54].

Sokoli shquan përparimin stilistik të autorit në krahasim me operan

---

*së tyre, t'i analizojë ata nën prizmin e dialektikës materialiste» [STRINGA 1968, 20–21]. Është e qartë se jemi përpara një qëndrimi sociologjik që e gjykon artin «si një superstrukturë e shoqërisë», një «shtrim marxist i vizionit të botës», ku «është e nevojshme të dallohen një varg rrymash» [BORDONI 2005, 9]. Mendimi estetik shqiptar i kohës që po flasim bën pjesë në grupimin që shkon «nga sociologjizmi vulgar te materializmi dialektik» [*ibid.*]; i pari «është në bazë të Realizmit socialist (i përcaktuar edhe zdanovizëm)» [*ibid.*, 12], rrymë ku bën pjesë «së paku pjesërisht [...] Georgij Plechanov (1856–1918), Louis Aragon e Lukács i viteve Dyzetë e Pesëdhjetë [...]» [*ibid.*].*

Dy të fundit ishin njohur pak, për të mos thënë aspak, në Shqipëri, për arësytën e thjeshtë të etiketimit të tyre si revizionistë. Ai që ka ndikuar së tepërmi në klimën artistike shqiptare të viteve Gjashtëdhjetë është i pari, i transkriptuar si Plechanov, bashkë me Vorovski-n, Lunaçarski-n e Gorki-n, të botuar në vitet 1961–1974 nga Alfred Uçi e Zija Xholi.

*Mrika*, duke avancuar, gjithsesi, një objeksion lidhur me orkestracionin për «mungesë uniteti që rrjedh nga duart e ndryshme që e kanë punuar» [*ibid.*]. Autori i përmyll paragrafët e paktë duke përmendur, megjithatë, edhe gjykimet qoftë të shkrimeve në shtypin e përditshëm, qoftë të diskutimit mbi operën, ku, midis vërejtjeve, «mund të përmendim kritikën që iu bë veprës për linjën dramaturgjike dhe karakterin e saj pllakatesk: u tha se ajo paraqitet shpeshherë e copëtuar, pa zhvillim logjik dhe vazhdimësi midis tabllave të ndryshme, pa kryqëzimin e duhur të temave (të personazheve) që i japin shkas konfliktit muzikor pa të cilin nuk zhvillohet dot drama etj., etj.» [*ibid.*, 55]. Megjithatë, përfundon Sokoli, «realizimi i një vepre të këtillë nxirrte shumë probleme e nga më të ndryshmet», pasi «nuk ishte një punë e lehtë» [*ibid.*].

Bie në sy që edhe ky botim i 1978-ës, ashtu si shtypi i ditës së 1968-ës, kur trajton operan tjetër nga Gjeluçi – Grimci, *Bijtë e Skënderbeut*, nuk parashtron asnjë vërejtje mëdyshëse, por thjesht pohon: «Kritika ka vlerësuar lart gadishmërinë dhe frymën luftarake të punëtorëve që ndihmuan në realizimin e kësaj vepre artistike» [*ibid.*, 56].

Pak kohë më pas, në fillim të viteve tetëdhjetë, duket se vepra e Jakovës fillon të rivlerësohet: «Për frymën heroike, për kompleksitetin dhe për larminë e ngjarjeve e të figurave si dhe për përmasat madhështore të trajtimit, ajo qe një operë e tipit të ri» [KALEMI 1982, 40]. Shkrimi i shmanget qëndrimin kritik duke vijuar thjesht me paraqitjen e skenave të veprës,<sup>36</sup> ku haset madje, edhe ndonjë gjykim stilistik: «Në muzikën e operës, e shquar për forcën emocionale, për gjerësinë e shtrimit, për frymëmarrjen e thellë dhe për qartësinë intonative, kompozitori përdori gjerësisht recitativin e kënduar» [KALEMI 1982, 40–41].

Megjithatë, koha nuk punonte ende në favor të Jakovës...

Në këtë klimë, në botimin e vetëm që kemi deri më sot në nivel universitar mbi kronikën e artit të tingullit në vendin tone, pra maketi me dy vëllime i përgatitur nga ish Instituti i Lartë i Arteve, *Historia e Muzikës Shqiptare* [PAPARISTO et al. 1983] operas *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* nuk i jepet asnjë hapësirë.<sup>37</sup>

Dyzetekatër vite pas premierës, vepra e fundit e Jakovës u ringjiti

36 Autori në të vërtetë rimerr me shkurtime dhe pa shembuj muzikorë analizën përshkruese të tij të propozuar pak vite më parë. Cf. KALEMI – ÇEFA 1979a, 126–136.

37 Opera *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* përmendet shkarazi vetëm në informacionin e shkurtër mbi këngëtarën Marie Kraja ku ajo ka interpretuar rolin e Donikës. Cf. PAPARISTO et al. 1983a, 151.

në Teatrin e Operas dhe Baletit<sup>38</sup>. Mund të themi se tashmë ka ardhur koha e një rishikimi filologjik të saj me synimin për ta risjellë në versionin origjinal. Kështu do të mund të prekim përfytyrimin e pastër personal të kompozitorit shkodran, i cili nuk ishte nisur të riprodhonte një histori autentike të Heroit Kombëtar, por thjesht të afronte një përjetim individual, domethënë artistik dhe subjektiv, çfarë është në fund të fundit edhe misioni i artit. Sulmi, nga sa rezulton në këtë shkrim i organizuar ndaj operës, nuk u kufizua në planin e një kritike stilistike ndaj shprehjes tingëllore, veprimtari kjo e pranueshme në dialektikën e zhvillimit të artit, por u pozicionua kryesisht në rrafshin e përmbajtjes, ku detyroheshin, për më tepër, këndvështrime të parafabrikuara estetike në kuadrin e doktrinës së importuar të realizmit socialist.

Situata të ngjashme me ato që pësoi Jakova në vitin 1968 do të ripërsëriteshin në 1971-shin, 1975-ën dhe në 1981-shin me të njëjtin frymëzim dhe me të njëjtin antagonist, realitete të trishta këto që shkërmoqën progresivisht synimet dhe rezistencën e artit shqiptar në kërkim të një shprehjeje artistike më personale, të diskutueshme, por gjithsesi të ligjshme. Kanalizimi gjithnjë e më tepër i mjeshtrisë së tingullit në hullinë e realizmit socialist, madje kjo në formën më të skajshme të dogmatizmit të tij, solli prodhimin e një sërë veprash jo vetëm vokale, por edhe orkestrale apo simfonike, thellësisht ideologjike, situatë që pushoi së ekzistuari vetëm nga fillimi i viteve nëntëdhjetë, duke lënë, gjithsesi, një zbrazësi pothuajse të plotë në historinë e subjektivizmit shprehës që karakterizon artin, e shoqëruar kjo edhe me një nivel minimal të teknikës kompozicionale në caqet e amatorizmit.

Me këtë optikë, zbardhja e kronikës së zezë që shoqëroi operan

---

38 *Opera Gjergj Kastrioti-Skënderbeu u rivu në skenë më 19 qeshor 2012 me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë me pjesëmarrjen e mbi 200 artistëve. Grupi prodhues përfshinte: regjizor – Carlo Saletti; as/regjizor – Ada Gurra; skenografia – Platon Bardhi; kostumet – Edlira Qyshka, Platon Bardhi, Klement Mihali; mjeshtrë koncertues – Zhani Ciko; dirigjentëtori – Dritan Lumshi, Milto Vako, Zef Çoba, Irida Bega; dirigjent i bandës – Halim Teqja; koreograf – Arian Sukniqi; interpretojnë – kori, solistët, trupa e baletit dhe Orkestra Simfonike e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit; artistë të Ansambllit Popullor; kori i Universitetit të Arteve; kori i Fëmijëve të Liceut Artistik “J. Misja”; fëmijët e Qendrës Kulturore; Forcat e Armatosura dhe Orkestra Frymore; Qendra e Hipizmit PANTO. Në rolet kryesore: Skenderbeu – Roy Stevens, Erlind Zeraliu; Mamica – Manjola Konjari, Irida Dragoti, Ivana Hoxha; Donika – Irini Nikolla, Emiljana Palushaj, Dëshira Ahmeti, Shpresa Beka; Gjon Flamura – Ylber Gjini; Pal Dukagjini – Sidrit Bejleri, Ariol Xhaferrri; Lek Dukagjini – Armando Kllogjeri, Riad Ymeri; Francesku – Armando Likaj [cf. MILE 2012].*

*Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* vlen për të kuptuar edhe më mirë atë që ndodhi më pas deri në 1991-shin.

### **Bibliografia:**

*ATSh (1968b, e enjte, 18 janar)*. “U dha premiera e operës *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*. Ishin të pranishëm shoku *Enver Hoxha* dhe udhëheqës të tjerë të partisë dhe të shtetit.” *Zëri i Popullit (Organ i Komitetit Qendror të P. P. Sh.)*, XXVII/15 (6054): 1.

*ATSh (1968b, 21 janar)*. “U dha premiera e operës *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*. Ishin të pranishëm shoku *Enver Hoxha* dhe udhëheqës të tjerë të partisë dhe të shtetit.” *Drita. (E përjavshme letrare. Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë)*, VIII/3 (369): 1.

*ATSh (1968c, 4 shkurt)* “Amatorët e Durrësit çfaqën në Tiranë operën *Bijtë e Skënderbeut*. Asistojnë shoku *Enver Hoxha* dhe udhëheqës të tjerë.” *Drita. (E përjavshme letrare. Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë)*, VIII/5 (371): 2.

*ATSh (1968d, 7 prill)*. “Opera jonë kombëtare në rrugën e formimit të saj – “Diskutim krijues për operën *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*.” *Drita. (E përjavshme letrare. Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë)*, VIII/14 (380): 2a-c.

*BARLETI, Marin (Marinus Barletius) (1508–1510)*. *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarvm Principis*. Venezia: de Vitali.

*BORDONI Carlo (ed., 2005)*. *Introduzione alla Sociologia dell’arte*. Napoli: Liguori Editore.

*BUHARAJA Edmond (2018)*, “Skënderbeu në ndërgjegjësimin identifikues dhe krijues të etnisë së tij.” In *Bota Shqiptare në përkujtim të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*. Përmbledhje e materialeve të Takimit XIII Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca (Shkup, 1–3 shtator 2018), 51–68. Shkup: Alb-Shkenca.

*BUHARAJA Edmond (2016)*. *Historiografia e Shprehjes Muzikore në Shqipëri dhe Diasporë. Nga prania njerëzore në tokën shqiptare deri në shek. XVI. Paralele kulturore në këndvështrimin: estetik, semiotik, semantik dhe antropologjik*. PhD diss. Universiteti i Tiranë – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë – Departamenti i Arkeologjisë dhe i Trashëgimisë Kulturore. Tiranë.

*CIKO Zhani (2007)*. “Scanderbeg e la musica epica albanese.” In *Luisa Cosi (ed.)*. *L’aquila e la mezzaluna. Storia, letteratura e musica nel nome di Scanderbeg — Atti del Convegno di studio (Tirana, 1° agosto 2006)*, 53–



60. Mario Spedicato (collana di studi diretta da), 'Medit Europa'. Galatina: EdiPan, 2007.

CIKO Zhani (2012, 11 qeshor). "Si vrau veten Preng Jakova për operën "Skënderbeu." *Panorama* <http://www.panorama.com>.

COSI Luisa (2007a). " 'Amante e Guerriero' – L'epopea di Scanderbeg nella tradizione operistica del XVIII sec. " Luisa Cosi (ed. 2007). *L'aquila e la mezzaluna. Storia, letteratura e musica nel nome di Scanderbeg — Atti del Convegno di studio (Tirana, 1° agosto 2006)*, 61–112. Mario Spedicato (collana di studi diretta da), 'Medit Europa', 2007. Galatina: EdiPan.

DE RADA Jeronin (1866). *Rapsodie d'un poëma albanese raccolte nelle colonie del Napoletano*. Firenze.

DE RADA Jeronin (1872–1884). *Scanderbeccu i pafan*. 4 ed. Corigliano Calabro, 1872, 1873, – Napoli 1877, e 1884.

DRITA (1968, 28 janar). "Sukses i merituar i amatorëve të Durrësit. Mendime të spektatorëve për operën Bijtë e Skënderbeut." *Drita (E përjavshme letrare. Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë)*, VIII/4 (370): 1, e 4.

GJONI, Simon (1968, 11 shkurt). "Mbi operën Skënderbeu." *Drita (E përjavshme letrare. Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë)*, VIII/6 (372): 1a-b–2a-c.

IBRAHIMI Feim (1968, e shtunë, 20 janar). "Opera Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në Teatrin e Operës dhe Baletit." *Zëri i Rinisë XXVII/6*: 4.

FRASHËRI Naim (1898). *Istori e Skënderbeut*. Bukuresht.

JAKOVA Prenkë – SILIQI, Llazar (1977). *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Opera në dy akte (6 tablo)*. Tiranë: Shtëpia botuese e librit shkollor.

KALEMI Spiro (1968, mars). "Opera Gjergj Kastrioti-Skënderbeu." *Nëntori (Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë)*, XV/3, 156a–157b.

KALEMI Spiro (1982). *Arritjet e artit tonë muzikor. Vepra dhe krijues të muzikës shqiptare. Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Sh. Mara (red.) dhe L. Bubani (korr.)*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor.

KALEMI Spiro – ÇEFA Sandër (1979). *Historia e Muzikës Shqiptare. Analiza e Veprave*. 2 vol. *Për shkollën e Mesme të Muzikës*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor.

KALOÇI Dashnor (2016, 10 prill). *Vdekja tragjike e Prenk Jakovës, kollosit të muzikës shqiptare*. In *Kolec Traboini (2016, 10 prill)*, "Prenk Jakova (1917-1069). Kompozitor gjenial, krijues i operas së parë shqiptare (28 dhjetor 2002)." *Shkoder.net... <http://shkoder.net/prenk-jakova/>*. TRABOINI 2016.

MILE Alma, (2012, 11. 06). In Zhani Ciko (2012, 11 qeshor), "Si vrau veten Preng Jakova për operën "Skënderbeu, " Panorama. <http://www.panorama.com>.

OLLDASHI Kozeta (1968, mars). "Bijtë e Skënderbeut. " Nëntori (Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë), XV/3, 157b–159b.

PAPARISTO Albert (1968, 30 qeshor). "Zhvillimi i mëtejshëm i muzikës sonë duhet t'u përgjigjet aspiratave revolucionare të masave. " Drita (E përjavshme letrare. Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë), VIII/26 (392): 2–3.

PAPARISTO Albert, Aleksandër ÇEFA, Fatmir HYSI, Hamide STRINGA, Iliriana DEMA, Kosta KOLI, Spiro KALEMI, Tonin ZADEJA, e Zana SHUTERIQI (1983). *Historia e Muzikës Shqiptare*, 2 vol. Përgatitur nga Instituti i Lartë i Arteve. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor.

REBEL – FRANCŒUR (n. d., rreth 1735) *Scanderberg – Tragedie* (Ms 2427). *Réprésentée par l'Académie Royale de musique le 27 octobre M. D CC XXXV*. Mathieu Degland (incisore). Paris: le Sr. Francœur la veuve Boivin, le Sr. Le Clerc.

REBEL – FRANCŒUR (1779). *Scanderberg. Tragédie. Revised version. Nouvelle édition dans laquelle les Divertissemens sont refaits à neuf pour la plus grande partie. M. S. 2427, With precisation: «Cette Partion de Scanderberg est Conformes aux intentiones des Auteurs»*. 1<sup>st</sup> esecution: 22 Octobre 1763.

ROBERT Frédéric. (1963). "Scanderbeg le héros national albanais dans un opéra de Rebel et Francœur. " In *Recherches sur la musique française classique III*, 171–178. Paris: A. et J. Picard.

SALVI Antonio (n. d., [1818]). *Scanderbeg – Drama per musica* (libretto). Firenze: Anton Maria Albizzini.

SOKOLI Ramadan (1978). *Figura e Skënderbeut në Muzikë*. Tiranë: Shtëpia botuese "8 Nëntori".

SPEDICATO Mario (2007). "Giorgio Castriota Scanderbeg tra Albania e Puglia. " In Luisa COSI (ed. ). *L'aquila e la mezzaluna. Storia, letteratura e musica nel nome di Scanderbeg — Atti del Convegno di studio* (Tirana, 1° agosto 2006), 9–28. Mario Spedicato (collana di studi diretta da), 'Medit Europa'. Galatina: EdiPan, 2007.

STRINGA Hamide (1968, shtator). «Për një ngritje të mëtejshme ideo-profesionale të kuadrit muzikor. " Nëntori (Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë), XV/9, 11–24.

SHKURTAJ Gjovalin (2007). "La figura di Giorgio Castriota Scanderbeg nella letteratura e nel folklore. " In Luisa Cosi (ed. ), *L'aquila e la mezzaluna*.



*Storia, letteratura e musica nel nome di Scanderbeg — Atti del Convegno di studio (Tirana, 1° agosto 2006), 37–52. Mario Spedicato (collana di studi diretta da), 'Medit Europa'. Galatina: EdiPan, 2007.*

*Shqiptarja.com. (2012). Kryqëzimi i Prenk Jakovës nga Dritëro Agolli e Çesk Zadeja. <http://shqiptarja.com/>*

*TRABOINI Kolec (2016, 10 prill). "Prenk Jakova (1917-1069). Kompozitor gjenial, krijues i operas së parë shqiptare (28 dhjetor 2002). " Shkoder.net... <http://shkoder.net>*

*TRANI, Silvia (ed., 2007). L'Unione fra l'Albania e l'Italia. Censimento delle fonti (1939–1945) conservate negli archivi pubblici e privati di Roma. Pubblicazione degli Archivi di Stato. Strumenti CLCCIII. Ministero per i beni e le attività culturali. Direzione generale per gli archivi. Citta di Castello (PG): Edimond.*

*ZADEJA Çesk – AGOLLI Dritëro (1968, e djelë, 28 janar). "Opera Skënderbeu. " Zëri i Popullit (Organ i Komitetit Qendror të P. P. Sh. ), XXVII/24 (6063): 3a-d.*

*ZANIBONI Antonio (1730, 5 Septembris). Le valorose azioni del principe Scanderbech Vincitor d'Amurat Imperadore de' Turchi, opera comica. Dedicata a sua eccellenza il Signor' Abate Girolamo Venier. Nobile Veneto. Bologna: Costrantino Pifarri sotto le Scuole.*

*ZP (1968, e mërkurë, 24 janar). "Punëtorët ngjiten në skenë. " Zëri i Popullit (Organ i Komitetit Qendror të P. P. Sh. ), XXVII/20 (6059): 3a-d.*

*WESTERMAN Frank (2006). Ingegneri di anime. Franco Paris (tr. ). Milano: Feltrinelli (ed. or. Idem, Ingegnieurs van de Ziel, 2002).*

**▪Trashëgimi kulturore▪**

Gjush SHELDIJA

**SHPIJAT TIPIKE TË SHKODRËS****Shpija shkodrane në përgjithësi:**

Shkodra si qytet i vjetër, ruen një numër të madh ndërtesash të vjetra; tipi i vjetër i shpís shkodrane lidhet me tipet e shpijave të Krujës, Beratit, Tiranës e që morën emnin e tipit të shpijave të qyteteve. Ky tip shpije ka lidhje të ngushtë me shpinë bizantine, e cila ishte e ngrahun po si këto t'onat dhe e veçueme prej tjeravet për të kenë ma të qetë në jetesën e tyne.

Mjeshtrat e punimit të këtyne ndërtesave ishin dibranë; këtu duhet vërejtë se mbiemni dibranë asht marrë për antonomazi prejse dibranët qenë mjeshtra muratorë dhe daltuesa gurit.

Mjeshtra të përmendun për punime daltimi në dru pat Shkodra në vjetin 1800 e deri vonë siç kjenë Isa Bushati, Ustah Cufja, Dan Çeliketa, Zef Hilë Arseni, Kolë Idromeno, Simon Kromiqi, Gjon Shllaku, Gjon Nika, Zef Dajçi etj.

Banesat e Shkodrës ndjekin pothuajse të gjitha trajtën planimetrike të një kand-drejtji, ku zakonisht gjanësija asht gjatësija e një dhome 7-8 metra dhe gjatësia asht zakonisht gjanësija e 3-4 dhomave, rreth 24 metra.

Këto dhoma paraqesin pjesën e mbyllun të shpisë me mur të trashë 70 centimetra, i cili e rrethon i njëjtë në të katër anët; nëndamja e mbrendshme asht e bame me perde çadëm.

Pjesa e çilun e shpisë shtrihet para sajë e thirret çardak me masë sa pjesa e mbyllun e cila nga njena anë mbështetet në murin e shpisë mbyllun dhe nga ana tjetër me një varg shtyllash guri të kapun me gëlqere; kështu për pjesën e sipërme, ndërsa pjesa e poshtëme quhet hajat.

Shkallët guri kapen me çardakun dhe zakonisht janë jashtë. Ndër shpija të mdha shifen shkallët dyshe domethanë shkallë me tre qemerë; një i naltë mjedis me dy shtroje guri të latuem dhe nga dy qemerë ndër të dyja anët, dy ma të mëdhej e dy tjerë ma të vegjël. Shpija e Gjokë Muzhanit në rrugicën Karl Topija, e Musa Dulit në Ndocej, Kolë Llupi-Melgushi në rrugën e Kinema Rozafatit, e Shuk Serreqit në Perash, kanë shkallë dyfishe ndërsa shpija e Luigj Gurakuqit, Zef Gjonej në Perash etj. i kanë njëshe. Sipri shkallvet ma gjatë dhe rreth shpijave shtrihet e gjatë streha e cila mbron shpinë nga lagështina dimnit dhe pret rrezet e forta të diellit gjatë verës.

Evolucjoni i këtij prototipi kaloi nëpër shkallë të vogla derisa trajta e jashtëme u shndrrue tue lanë veç sa gjurmët e para.

Si shkallë e parë e evolucionit kje qoshku i vogël, nalt mbi çardak 0. 50-1 metër, jashtë këtij në një anë, si te shpija e Luigj Gurakuqit, ndërsa qoshku i parë fillestarë ishte përkundruellë derës së oborrit, sipri shkallvet, ku i zoti i shpisë mbikqyrte lëvizjet në nadjë e në mbiramje.

Si shkallë e dytë e evolucionit asht mbyllja e qoshkut me xhama: ky soj qoshkut, i mjedisit, shifet në shpinë e Zef Gjonej, Ndrekë Shirokës etj. një qoshk n'anë ka shpija e Muzhanit; shpesh ky qoshk i mbyllun anash çardakut u përdor si odë pritjeje.

Prej ksajë shkalle evolucioni kaloi në një shkallë zhvillimi ma të plotë, ku qoshku mbyllet me mur që në themel të shpis tue lanë gjithënjë çardakun në mjedis, të çilun, si te shpija e Myfti Plakut n'Ajasëm.

Shkalla e fundit e këtyne zhvillimeve të ndërtesës tipike shkodrane asht çardaku i mbyllun krejtësisht, siç shifet në shpinë e Kolë Serreqit, Mehmet e vllazënve Gjyli, Shan Dedës, Ndrekë Shirokës, Loro Shirokës, Gjovalin Sumës, Pjerin Simonit; te burgu ordiner, te Shpija e Kulturës etj.

Nëndamja e mbrendshme e shpis shkodrane asht ajo e odavet të veçueme, të cilat lidhen me anë të çardakut me njena-tjetrën. Në shtesën e mavonëshme dy anat e çardakut u lanë si oda pritjeje për miq ndërsa odat tjera mbetën për përdorim të konakut. Ndamja e mbrendshme paraqitet ma së mirit prej planimetrisë së shpijavet të Shkodrës.

### **Paraqitja e odës:**

Paraqitja e odës nga pikëpamja e stolivet të mbrendshme asht mjaft interesante: oda në faqen e murit ku asht dera, asht e veshun me trapazan; në faqen kundruellë, oxhaku me dy dritore anash; dy faqet e tjera simetrike me ndonji dritore dhe dollapë të murosun.

**Tavani:**

Tavaniasht drunit të punuëm me daltime simetrike ku del në shesh forma e rombit, e mbyllun me thupra të daltime në trajtë të litarit të thjeshtë, si te shpija e Mark Kakarriqit, e kapun me lule pesë gjethesh, si te shpija e Kolë Sumës; katër qoshe me viza, si te shpija e Lord Paget (Sahati i Hinglizit).

Tavani në mjedis ka një rrozon të punuëmnë trafor me reljev, me sfond shamatatelit florinit, ndikim i artit bizantin, si te shpija e M. Gjylit, Qazim Ramadanit, Hasan Zenelit, Visho Barbullushit etj. Ndër katër qoshet e tavanit në trajtë tetë-kandëshi janë mbërthyer katër copë qoshe tavani, punim artistik me daltime që të shumtën herës, dy kundruellë kanë vizatime të njillojta mjesa dy tjerët ndryshojnë, si te shpija e Mushanoviqvet, e Rrojejvet, e Kazazvet; diku qoshet trekandshe janë me motiv të barabartë. Këto janë pjesët e çdo ode me përjashtim t'odës së zjarrit. Oda e pritjes asht ma e stolisun se të tjerat e ka anash minderë me jstekë, qylyma, saxhade persijet, cerga për shtroje. Në pjesën katholike mungojnë minderët por shtrohen jstekë bogosijet të rrahun me mjedisa të qendisun me nyyra. Gja për t'u vretjtë se si ndër të vorfën si ndër pasanikë odat e pritjes janë të ngjashme njena me tjetrën.

Tavani asht drraset të daltime në katër anët, me suazë të gdhenun me motive të ndryshme, të shumtën e herës me lule. Shtroja e tavanit paraqitet në dy trajta: e drejtë ase me goviç. Shtroja e drejtë dahet në romboida simetrikë dhe në mjedis një rreth të zbkuruem me daltime. Shtroja me goviç paraqitet me një kube gëlqereje simetrike, si te shpija e L. Gurakuqit, te oda e dytë e Bep Muzhanit. Kjo trajtë paraqitet ma e re.

**Trapazani:**

Çdo odë shkodrane asht e pajisun me një trapazan drunit; trapazani asht dy trajtash: i thjeshtë dhe i dyfishtë. I pari ka në pjesën e jashtëme katër të ndame; dera e të hyemit, vendi i arkës së nuses, musandra për dyshekë, jergana dhe jstekë, dera e qelerit dhe e nevojtores.

Kësi trapazanash ka shpija e Kolë Sumës, Mikel Çekës, Bep Muzhanit, Mushanoviqvet, Hasan Zenelit etj. Trapazani i dyfishtë ka edhe një rruginë përpara që shërben për të lanë të mbathunat në një anë, për të hypë femnat në trapazan nga shkalla e mësheftë: gjinden kësish në shpi të Zef Sumës. Qazim Ramadanit etj.

**Oxhaku:**

Asht i punuëm me reljev, n'allçi, i xjerrun me jaki e me motive të ndryshme që të shumtën e herës janë të njajtë me ato t'odës. Diku ma

i hjedhtë e diku ma i gjanë. Oxhaqet ma të bukur i kanë shpija e Tonin Jubanit, Zef Sumës, Kolë Sumës, Qazim Ramadanit, Mehmet Gjylit etj.

Ndër dy anët e oxhakut janë dy dritore qorre për të vuem bardakët e venës e katrovat e ujit. Ma andej dy dritore me kapakë të dhenun, me stolina simetrike si të dollapvet e me parmakë drunit, nder ato ma të vjetrat e me parmakë hekurit të punuem në vend, ndër ato ma të rejat.

Nën oxhak votra e madhe, punue me tulla smaltet, me prak druni të lëmuëtë; mjedis demiroxhaku ku mbshteteshin trupat e trashë lisit: anash në votër, dy mashë: një hekurit për prush e një priçit me kolla gjarpnusha për t'i ndezë me gacë cingarën miqvet.

#### **Muret- Sergija-Palicat:**

Muret janë të thjeshta, me bordure lulesh: këto bordure ndjekin gjithëkund anët e dritoreve, dollapit, sergjijave, dyervet. Në tri anët e odës siellet një sergjidruni të punuem me kolla-kolla e lajle, shpesh herë punue në trafor. Sergji punue me hart ka shpija e Zef Sumës, shpija e Sahatit të Hinglizit, shpija e Kakarriqit. Ndër to vendoseshin enë priçit, gastarejet, xhixhet, të bukura e me vlerë artistike. Ndër dy qoshet kundruellë, në krah t'oxhakut ishin të nguluna në mur dy palica trekandëshe, edhe këto me lajle dhe daltime: këtu vendoseshin shpesh sendet ma përdoresh, si tasi i pareve t'imta, fushekë me ndonji kupë të bukur.

#### **Dollapët ase raftet:**

Ndër dy anët e odës, karshi njëni-tjetrit, të futun në mur, ishin dy dollapë punue në dru, me vizatime, lajle dhe daltime të bukura, shpeshherë me altoreljev, si shifen te shpija e Çekës, Rrojit, Gjylej etj. Kishte edhe rafta punue në trafor në pjesën e sipërme që merrte emnin palicë. Nji i tillë punue me art e mjeshtri të madhe shifet në shpin e Sahatit të Hinglizit, n'odën e mjedisime. Vizatimet ndryshojshin shumë ndër kapakë ndërsa pjesa e sipërme ndryshonte: herë paraqitet me një të çelun voezake, herë me tri, herë me dy. Këtu shtijshin sende pijet, filxhana, kupa etj.

#### **Shtroja:**

Ndër të gjitha shpijat, pa përjashtim, shtroja asht drrasë e trashë lisit, kapun me trenë me gozhda hekurit të punueme në vend, me krenë të trashë. Drrasat ishin të gjana 30-40 centimetra dhe të zdrukthueme.

N'odën myslimane, tue fillue bri oxhakut e rreth deri ke dera, ndër të dy anët, rreshtoheshin minderët, punue në drrasë t'ultë 30 centimetra, e gjanë afër një metër për të ndejë kambëkryq. Sipri këtyne shtrohej

rrgosta, mbi to shilte me lesh, sipri saxhade të çmueshme e jestekë të qëndisun prej dorës së vashës shkodrane, me lule, lajle e zbukurime të mëndashta e të leshta. Ndër oda katholike nuk kishte minderë, por në vend të tyne, pështetë për mur, ase shkapërderdhë ambël, jestekë bogosijet, të rrahun, të çatisun, me mjedisa me oda, kokrra, lule, etj.

Kur ma vonë hyni karriga, jestekët mbetën sa për dukje. Ndër kohë ma të vona, minderët filluen me u çue mbi 50 centimetra.

### **Odat e shpisë:**

Shpija në përgjithësi kishte këto oda: dy ndër anët e çardakut; njena e pritjes e tjetra oda divide, që shërbente si zyrë për marrëdhanje tregtare, shoqnore, ku ruheshin dokumentat, të hollat, në një arkë të blertë druni të fortë e të trashë, mbërthye me pafta hekuri. Në këtë odë mblidhej edhe këshilli familjarë për të marrë vendime me randësi kryesore.

Në mjedis çardaku i çelun, me parmakë drunit të daltuem me vija vertikale, shtylla e mbajtëse në trajtë kapiteli të zgjatuem, druni së fortë, të daltuem me thepa e lajle. Sipri shkallës, kundruellë derës së madhe t'oborrit, vinte qoshku, i çuem nalt kund një metër mbi çardak, ku ditën rrijshin gra dhe varza, me punë të dorës e në nadje dhe në mbramje, i zoti i shpisë pinte kafen, nepte e merrte me shegerta, tregtarë, bujq, detarë, etj.

Qylyma dhe jestekë për rreth si shtroje.

Ndër dy anët, një të me derë të dhomës së miqvet e të odës divide, dy dyer të daltueme, një kapakut, ku hapej rrugina: n'e djathtë të njenës e n'e majtë të tjetrës rruginë, ka dy oda rresht: oda e të zotët të shpisë, oda e vllazënve beqarë; në tjetrën oda e pleqvet dhe oda e varzavet. Mjedis oda e zjarrit, odë e madhe sa të thuesh, me votër mjedis, me vargue, vegsha, gjygyim bakrit, saxhakë të ndryshëm, mashë të madhe; kahë fundi i odës stjollli, çarraniku i bylmetit, arkët e harxhit, dollapi në mur i pijeve, e kahë fundi kapangja me shkallë për të komunikuem me ahre. Në fund një tjetër rruginë ku vijshin nevojëtoret anash dhe qeleri ase baja në mjedis.

Poshtë, n'e majtë të të hyemit, mbas shkallvet, soba për fshatarë e bujq mysafira; sheneshini dhe hajati i haptë për të ndemë teshat në kohë shiu. Ahri i pijes ku rresht e rresht mbi kamaneca vendoseshin fuqijat e venës e të rakisë, goviçat e mdhej; n'ahrin tjetër hamarët me grunë, kollomoq, arkët e miellit të bardhë, qypat e gurit me ullij, voj, qypat e dheut të pjekun me tëlyenë, djathë, pistil mollatartash, ushuj, rasoll, dengat e kafes, sheqerit, orizit, groshës; në tavan vjerrë proshutat

e majme, vargjet e hudrave, qepëve, tuba e mëndërsë thame, flixigena etj.

Bri derës s'ahrit, shtera e madhe gurit të latuem me qyski hekurit për të shtypë kafën.

Para shpije, pusi me grykë të punume me daltë, me motive të ndryshëm; bri pusit një të njëni me tjetrin dy lugjet gurit, për të lanë teshat, rrasa, mastela me uej; në qoshe të çekerkut të pusit varë kova e madhe bakrit dhe çengeli për të xjerrë kovën kur kjo këputej dhe binte në pus.

Përballë derës së madhe, kulla në fund t'oborrit, ku sipri vendohet sana për bagëti dhe poshtë shtalla ose shtrati i lopës, viçit, kalit. Një të kullë të sanës, tharku i thiut, një grimë ma andej afër kopshtit kësolla e pulavet, rikave, patave, shotave, pulë hinet, pulë-detseve, bibavet. Nën pullaz të kullës kësolla e pllumbavet; bri derës së kullës kësolla e qenit, me tas ujit e çini gjelle përpara.

Rreth shpije në tri anët oborri me gjithëfarë pemësh dhe lulesh, e mbrapa kopshti me barishte, perime e në fund të këtij, arkapija ase dera e mbsheftë për të komunikuem me rrugë ase kojshi.

Shpija në katër anët rrethue me avullija të nalta kater e ma metër për të qenë të sigurtë dhe të qetë nga zhurma dhe kurrështjaje jashtëme.

Shpijat e Shkodrës që mbajnë ende sot karakteristikat tipike të tri shkallëve t'evolucjonit janë mjaftë: këtu po çekim emnat e tyne në përgjithësi e mandej për ndonjenën prej tyne ma me randësi po bajmë përshkrimin ma t'imtë.

shpija e Gjokë Muzhanit - rruga Karl Topija; Pjetër Gurakuqit-rruga e Gurakuqvet; Musa Dulit- lagja Ndocej; Vllaz. Gjylej-rruga Çinari Hoxhë Dheut; Dr. Karamitrit (e vjetra) - rruga 28 Nanduer; Çekejve - rruga e Arrës së Madhe; Ndrejë Sumës- rruga Spitalit; Kolë Sumës- rruga Sumej; Qazim Ramadanit- Perash; shpija e Kazazve-Perash; shpija e Rrojejve-rruga e Perashit; Filip Serreqit- rruga Dragushej; Kolë Serreqit; Vllaz. Kakarriqi- Serreq; vllaznit Mushanoviq -Xhamija e kuqe; Myfti Plakut- Ajasëm; Cafo Begut- Ajasëm; Drishtaj-Dudas; Prek Pashës- rruga Kapidan Pashës; Qelës (Famullija) ; Parrucës-rruga e Spitalit; Tonin Jubanit- rruga Çobej; Pashko Çobës- Kinema Rozafat; Gaspër Çobës; Gaspër Llupit; Isuf Sokolit- Dërgut; Elez Mukës – Zdralej; Lord Paget- (Sahati i Hinglizit); Kolë Pemës -- Xhamija e Kuqe; Zef Gjonej- Sarreq-Ballabane; Gaspër Çekës-rruga Sumej; Ndrejë Shirokës-rruga Spitalit; Gjon Shirokës-rruga Skanderbe-



Perash; Cin Shirokës- rruga Curanej; Filip Loro Krajës - Dugajët e reja; vllaz. Bushati- 28 Nanduer; Loro Shirokës- Skanderbeg; Kolë Ujkës- Kinema Rozafat.



### **Shpijat ma tipike:**

Shpija e Bep Muzhanit ase Gjokë Muzhanit

Shpi tipike shkodrane e cila paraqitet në tansi me dy palë shkallë gurit të latuem, me qemër, me çardak dhe qoshk të çilun. Kjo ndërtesë mban mbi derë t'oborrit datën 1794. Dera me qemërgurit dhe dritore qorre, ndër të dyja anët me frangjija mjedis gungës, asht krejtësisht e tipit të dyerveshkodrane të shekullit të kaluem. Nga çelja e rrugës së re asht damtue mjaft por sidomos punimet e përshtatshmënis të bamë nga fabrika e shqopës e kanë damtue serjosisht esthetikën e kësaj shpije. Hjekja e trapazanit për t'a çuem në Muzé të Tiranës e ka shemtue fare odën ma të mirën që kishte. Duket se shpija gjatë evolucjonit ka pësue mjaft ndryshime.

Odat përbrenda i ka me tavane, kapakë dritoresh drunit të daluem: në tavan spikatë trajta e rombit. Ka një gur mullinit vojtit të murosun mbasi shpija ka pasënd'oborr mullinin; ka vetëm një odë karakteristike të plotësue: tavani i sajë asht një goviç voezak, bamë me gëlqere e me copa drunit të daluem dhe si shifetnuk asht i një kohëshëm me



ndërtesën. Nd'oborr, ka një grykë pusit gurit një copet, punim vendi, me disa lajle e një kryq.

*Shpija e Pjetër Gurakuqit*

Gjindet në rrugën e Gurakuqej; trajta e jashtëme paraqitet ma e vjetër, e shkallës së parë të evolucionit. Një pjesë e jashtëme e çardakut asht e mbyllun ma vonë. Qoshku ka mbetë origjinal. Në pjesën e mbrendshme ka një odë karakteristike komplete, por edhe ksaj kanë nisë me i u çartë sergjijat e trapazani. Tavani i saj asht me një goviç oval prej gëlqerjet i kombinuem me copa druni të gdhenun, por nuk tregohet i njëkohëshëm me ndërtesën.

Nd'oborr gjindet edhe një grykë pusit një cope, i thjeshtë.

*Shpija e Ndreke Sumës-Heqimit*

Në krye të rrugës së Spitalit, gjindet shpija e Zef Sumës, shpi tipike shkodrane që ka rrujtë karakteristikat si mbrendë si jashtë, të trajtës së parë t'evolucionit. Ka një dhomë shumë të bukur, me tavan, rozon, qoshe, trapazan, musander, rafta, të gjithë drunit të daluëm, me një mjeshtri të rrallë e ndoshta e vetmja e kësaj tipit si punim me të vërtetë artistik.

Oxhaku i kësaj ode asht i mrekullueshëm por ma i ngushtë dhe i hjedhët. Si çardaku me parrmakë drunit të daluëme, si shkalla gurit me dy qemër e qoshku i çuem, kanë qëndruë të paprekun tue rrujtë origjinalitetin. Asht mbajtë mirë, pa u lye kurrfare. Dyshemja asht mberthye me gozhda me krenë të mdhej, punuëm në vend, dhe raftat me thumba priçit, punim vendi edhe këto.

*Shpija e Kolë Sumës*

Ndodhet në rrugën omonime, në krye të sajë n'e djathët. Si shpi e ka bjerrë karakteristikën origjinale sepse janë bamë punime herë mbas here. Veçse shka, asht mbajtë mirë dhe rrujtë bukur. Në derë t'oborrit, qemerit gurit të latuëm, ka të shkrueme datën 1839. Oda tipike shkodrane ka një tavan që dallohet nga të gjithë tavanat e tjerë sepse në kryqzim të rombit, ka një lule pesëkandëshe gjetshesh të gdhenun dhe të ngujuëm mjedis. Trapazani asht i mbyllun me gëlqere me dritore romboike, kafazlije, në gjasim të shpis së Gjylejve.

Oxhaku që ka kjo odë asht madhshtuer, punim artistik dore së parë, ma i gjanë se i Zef Sumës, me dy rrozona gipsit në dy anët e kresë. Kjo shpi ka nisë ndertimin e sajë këtu e 150 vjet ma parë dhe data i asht vuer asht krye: ka në shpi disa qypa vojtit.

*Shpija e Qazim Ramadanit*

Në rrugën e Rrojve në Perash, tue dalë kah Pazari i vjetër, gjindet

shpija e Qazim Ramadanit e cila ka përbrenda një odë tipike shkodrane, me tavan drraset origjinal, me rrozon, punue n'altoreljev, musandër jashtë ode nën trapazan; dyshemja me gozhda vendit krenësh së mdhej: mbërthimi i raftave asht i bamë me thumba priçit. Dollapët në mur i ka me altoreljev, tavani me hyll tetëkandësh, kombinacion orjental. Ka një kamin me goviç të njeshëm, në gëjasim t'atij të Zef Sumës dhe të Mikel Çekës por ma artistik se i dyti. Këte e kanë punue disa mjeshtra vendas. Asht ndertue rreth vjetit 1800.

*Shpija e Vllaz. Kakarriqi*

Ndollet në Lagjen Serreq, sot përdoret nga Shpija e Pionierit. Pamja e jashtëme, shkallët dhe çardaku kanë një dukje moderne, ndërsa shpija përbrenda dmth. Dhomat kanë mbajtë karakterin tipik shkodranë në tansinë e tyne, përveç goviçavet t'oxhaqevet që janë cungue tue mbajtë vetëm pjesën e murueme. Ka tri oda me tavane, trapazane, dollapë murit, palica dhe sergjija të daltueme dhe të gdhenuna vende-vende me altoreljev: një dollap i zgavrruem në mur i ndamë në dy pjesë në trajtë të kandë-ndrejtit, ka përpara dy harqe druni të punuem në trafor, ku spikatë mjeshtriya e artistit vendas; asht mbajtë mirë. Muret e odavet kanë gjurmët e një tubze të shtypun në mur rreth e përçark dritorevet, dollapëve, dyerve.

Në këtë shpi asht kenë gjetë një shtyllë gurit para se të nisëshin punimet modernizimi, një rrasë gurit me datën 1741.

Nd'oborr të kësaj shpije ka një sasi punimesh me gur të daltuem: gryka e pusit gurit një cope, ku n'altoreljev duket një kelk me oste; një lug në trajtë kand-ndrejti me daltime anash, ma i gjanë se lugjet e zakonëshme dhe ma i cekët. Ka edhe një kapitël stilit korintnik me gjeth akantit, si ato të gjetun në Kala të Shkodrës, dy ulishta gurit një cope, dy gjyle gurit të kalasë, mjaft të mdhaja.

*Shpija e Myfti Plakut n'Asasëm*

Shpi me pamje të jashtëme të mbyllun nga poshtë nalt; ruen një odë me vlerë artistike, me tavan e trapazan të daltuem bukur, i kohës së re.

*Shpija e Lord Paget - Sahati i Hinglizit-*

Kur u çel rruga e re u patën shembë dy pyrgjet e derës së oborrit, me kapakë drunit të skalitun, i asht hjekë krejtë pamja tërheqëse që kishte kjo ndërtesë tipit meskohuer në Shkodrën t'onë.

Ndërtesa ka qëndrue në karakteristikën e sajë origjinale, me mure gurit të daltuem, me një pyrg me frangjija aty-këtu. Mbrenda shpija ka tri oda: e para ka një derë me ornamente e një tavan të thjeshtë me ndamje

në trajtë rrumbit, mjerisht lye me bojë tesh së vonit. Dhoma e mesme e montueme paraqet tansin si odë tipike shkodrane me tavan e trapazan por pa musander as vend arke. Ka një derë në mjedis që asht një kryevepër daltimi në dru, me vizatime të bukura e të çuditëshme, që s'i ka asnjë derë shkodrane. Në mur një dollap t'inkasuem me të punuem në trafor në pjesën e sipërme. Trapazani asht i mbyllun dhe mban trajtën origjinale; një gja tipike asht se ky trapazan ka parmakë në gjysë e teposhtë/

Saloni i madh i kësaj shpije asht një ansambël i kombinuem copash të ndryshme daltimesh dhe gdhenjesh; rrozonin e ka mjaft të bukur e të madh. Trapazani i mbajtur mbi dy shtylla druni të daltuem me altoreljev dhe motiva orjental, me tre harqe i mbajtur mbi dy shtylla ka sipri dy kapitelavet drunit daltime të bukura. Trapazani në pjesën e sipërme, edhe ky kombinacion copash të ndryshme daltimesh shkodrane, me kafazlije punue në trafor. Për nën trapazan ka një punim imitacion oxhakut në dru, të stilit orjental.

### **Gryka pusesh**

#### *Gryka e pusit e Bjankut*

Gjindet në shtëpinë e trashigimtarëve të G. Sumës, në rrugën Karl Topija; grykë pusit ndër ma klasikët dhe artistiket që njëfen deri sot në vendin t'onë. Asht gurit një copet, i madh, me gdhenje lulësh e fëtyrash paksa të prekuna nga një dorë e pakujdesëshme dhe damtuese.

#### *Grykat e pusit të Shpis së Parrucës*

Janë dy copë, njena mermerit të kuq e tjetra mermerit të bardhë, me ornamente e stema të bukura artistike. Janë mbajtë deri diku mirë.

#### *Gryka e pusit e Kakarriqit*

Asht punim i kujdesëshëm, i studjuem mirë, në gur të bardhë, një copet me vlerë artistike në shej. Asht mbajtë shumë mirë dhe me kujdes. Mban trajtën origjinale si pus meskohuer.

#### *Luani i Shën Markut*

Një krye luani, paksa i thyem, punue në gur të thjeshtë, gjindet në shpin e Parrucës dhe asht i mbajtur mirë. Thuhet se asht kenë gjetë në Kala të Shkodrës.

Adnan **MUKA**  
Bërhan **DIZDARI**

## SHKODRA DHE LULET



Qyteti i Shkodrës është i njohur dhe i vlerësuar për lashtësinë historike, traditat patriotike, tregtinë, kulturën, artin, mikpritjen etj. pjesë përbërëse e këtij emri shumë të mirë janë edhe lulet shumëngjyrëshe e të shumëllojshme e gjelbërimi masiv. Drandofilet me meragjylin, karajfilat dhe zambakët, që kanë qenë dhe mbetën auroa e luleve të Shkodrës, janë objekt dhe i këngës popullore.

Kultivimi i luleve pasqyron: kulturë, krijon ambjente të pastërta e të këndëshme, të bukura e aromatike, siguron shplodhje që të kënaqë shpirtin dhe sytë ëmbël e qetësisht pushojnë. Lulet kanë dhe vlerë kurative.

Lulja joshë bletën, ambjenti i lulëzuar nxitë vizitat e njerëzve, tregon pasuri shpirtërore, mikpritje e në mikpritje Shkodra është veçanërisht e shquar. Kjo është arsyeja që trashëguam tradita të mëdha e me vlerë në rritjen e luleve e gjelbërimit e shtëpive.

Karakteristikë dalluese e mjaft dyerve të mëdha qytetare ka qenë një pjesë e ndarë dhe e mbrojtur e oborrit e quajtur kopshtar, e përcaktuar plotësisht për lulet. Edhe në oborre, pjesërisht ose tërësisht është kultivuar lulja. Mbi dhjetë ngjyra drandofilesh me erë, ku mbizotëronte maragjyli, shumë lloje zambakësh, të bashkëshoqëruara me zymbyla, lule: alli, ojme, elbaroza, krap, sheboje, kadife, gradiola, shemshire, tulipane, luleborë e luledimër etj, janë mbjellur në oborre. Gjithashtu pranë dyerve të oborrit, mureve rrethues e fasadave të shtëpiave, në shumë raste janë ndeshur lulevila, derhana (lule mustaku?!), shermasheku dhe lule kaçça deri në tetë ngjyra.

Në funksion të luleve njëvjeçare, në vazo, arka apo enë të përafërta me to, kanë qenë: anët e shkallave, kryet e shkallës (safalleku), çardaku e qoshet, si dhe pragjet e dritareve e balkonet. Në këto hapsira e vende janë rritur: karajfilat, vjolet e vjollcat, harap qypi, lulevathi, mullagat si dhe bimësi e vogël me gjethe ose me lule aromatike: fasligeni, jasemini, lule llokumi, rezmaria, sindebesini, mastrapati, lule mosprek, babaniku etj.

Në përkujdesin për lulet, ekzistonte një ndarje pune: luleve njëvjeçare, me dashuri të veçantë, iu shërbyen gratë e vajzat, ndërsa drandofileve e luleve të tjera të oborrit, si dhe bimëve dekorative shkurre e të larta, i u shërbyen burrat.

Tre parqe publike të bukura, me 3000 m<sup>2</sup>, hijeshonin Shkodrën.

Pas vitit 1944, si rezultat i ndryshimeve revolucionare ekonomiko-shoqrore, zbatimit të planeve urbanistike etj, shumë oborre e kopshtare u zhduken ose u zvogëluan e shpesh e kthyenë funksion të zarzavateve e pemëve frutore, si rrjedhojë të pakta e me gisht numëroheshin shtëpitë me lule. Një pjesë e mirë e llojeve të luleve u rralluan e disa prej tyre u zhduken.

Krahas zbatimit të studimeve urbanistike, ndërtimit të pallateve, rrugëve të reja dhe ndërmarrjeve të mëdha, u zmadhua dukshëm sipërfaqja e lulishteve publike, të sistemuara drejtë në mbjellje e harmonikisht të kombinuara: lulet me shkurre e drurët dekorativ. Në serën e N/jes Komunale Gjelbërim, filloi kultivimi e trajtimi i luleve mbi baza shkencore e agro-teknike që i shërbeu prodhimit të fidaneve për

lulishtet, po dhe plotësimi të kërkesave në rritje, kryesisht të qytetarëve që banonin në apartamente të reja. U importuan fara lulesh e bimësh të tjera dekorative si: begonjat, gjetheshqiponjat, fikusi, kaktuset, shpatat, palmat e saksive, fini dekorativ etj.

Kalimi në pluralizëm, kur shteti dje dhe sot nuk është në gjendje të mbrojë pronën publike, sipërfaqja e lulishteve u pakësua e u degradua nga kioskat, prerjet, bagëtia e njerësit pa kulturë. Pjesa e ngelur e këtij mjedisi të bukur, keqas, disi gjallon, në saj të punës së Nd/jes së Gjelbërimit. Dukuri pozitive e e mirëpritur është zgjimi shumë i shpejtë i interesit për lulet e bimët dekorative. Ekziston një rivalitet i theksuar në mes të familjarëve, për t'u prezantuar me ambiente estetike e të zbukuruara me lule e bimë natyrale, e ka rënë shumë përdorimi i luleve artificiale.

Kërkesat e mëdha për lule kanë nxitur e rritur bisnezin i cili aktualisht realizohet nga individë amatorë e profesionist në prodhimin e tregtimin e farërave të luleve, te vazove e pak të dherishteve.

Si rezultat i zhvillimit të këtij biznesi në qytet, në Nd/jen e Gjelbërimit, e cila ka një fond të pasur të luleve autoktone, po dhe të ardhura si: astret (angleze), rodemberg, lontane, lupin shumëngjyrësh dhe në disa ekonomi të vogla private, po lulëzon prodhimi për shitje i luleve e bimëve dekorative. Gjithashtu nga tregtarë si dhe individë me shije, për kënaqësi personale, po importohen farë, lule e bimë dekorative e fondi i luleve është gjithmonë në rritje. Shija dhe madhësia e buxhetit, kryesisht e grave, do të ndikojë e përcaktojë në përzgjedhjen e luleve e bimëve dekorative, që do të mbisundojnë në oborre, banesa, në institucione e ambiente të shërbimeve publike.

Mund të duket paradoksale për aktualitetin, po fatbardhësisht ekzistojnë pak individë me pasion të lartë, që kanë investuar e investojnë punë e mjete financiare të mëdha, që kanë krijuar oborr e ambiente shtëpije të zbukuruar me lloje lulesh e bimësi dekorative të larmishme, një pasuri mahnitëse. Dhe për çudi, këta që me të drejtë duhen quajtur *ARTISTË TË LULEVE*, janë relativisht të pakënaqur, përpiqen e kërkojnë për të patur gjithnjë e më shumë lule të reja.

Që përzgjedhja e luleve të bëhet sa më drejtë mendojmë se duhet dhe mendimi e ndikimi i specializuar ndërmjet shkrimeve, bisedave, dokumentarëve televiziv dhe botimit të broshurave, për të dhënë informacionet e domosdoshme, shumë të nevojshme për mirërritjen dhe ripërtëritjen e luleve. Që të lulëzohet, detyrë e rol të veçantë në

dritëzimin e dijeve e cultures së luleve, mendojmë se duhet të realizojë: Katedra e Biologjisë, Shoqata e Ambientalistëve (ose një seksion i saj) nëpërmjet nxitjes dhe planifikimit:

1. të temave për mbrojtje diplome e titujve shkencore;
2. të përkrahjes morale e material të studiuesve për shkrime e botime, koleksionimit të fondit të luleve autoktone, fotografimeve dhe realizimit të dokumentarëve televiziv;
3. të rritjes së kërkesave për një kulture tregtare bashkohore në etiketimin me disa njohuri themelore të kultivimit, emërtimin e ambalazhimit të luleve:
4. periodikisht, një herë në vit, ose çdo disa vite, të organizohen ekspozita ose panairë lulesh dhe nderohen me çmime e diploma:
  - a. oborret më të bukura;
  - b. ambientet e banesave me shumë lule;
  - c. bisnezmenë, tregtarë e prodhues të dalluar lulesh.
5. të shpallet jargavani, që është drejt zhdukjes së plotë, bima dekorative e Shkodrës.
6. të nxitet e të përkrahet biznesi i prodhimit e i shitjes së dherishteve, që është shumë i kërkueshëm e i domosdoshëm për mirëritjen e luleve dhe njëherit dhe fitim prurës.

QëShkodrës t'i rikthehet, në një shkallë edhe më të lartë e të dukshme, krenaria e saj për lulet, si simbol e pasqyrë kulture e qytetarie, duke u bazuar në mirënjohjen tonë të madhe për paraardhësit, të punojmë e të sakrifikojmë që brezat e rinj të na jenë mirënjohës dhe t'a trashëgojnë dashurinë për lulet e ambientet e lulëzuara, që asnjë hapësirë boshe e copë toke me oborr, në banesa e në ambjente publike të mos mbetet pa lule.

## Izet BEBEZIQI (1905-1982)<sup>1</sup>

### GJENDJA ARTISTIKE DHE SOCIALE E VLORËS

#### I

Mjerisht nuk kemi të themi shumë rreth gjendjes në fjalë. Kemi më se fare pakë mbeturina dhe dokumenta përkatëse nga kohët e ndryshme, që të na jepshin deri në një farë piket të kuptojmë si tanësi një gjëndje ekzakte t'artit në vetvedi. Por megjithëkëtë dhe këto na hën mbujtë me rujtë aty këtu gjurma dhe dukunë të njëj arti të dikuershëm sidomos nga ndërkohët greko-romake.

Vlona dhe rrethi i saj nuk ka qënë përveç kohës greko-romake një tokë e begatëshme për zhvillimin e artit në çdo pikëpamje. Në shekujt e parë para dhe pas lindjes së Krishtit, janë krijue këtu nënë influencën dhe ndikesen e cultures greke (Doriakvet) qëndra qytetrimt si Orikoni (Pasha–Limani), Auloni (Zvërneci), Amanthia (Ploça-Sevaster), Palissa (Palasa), Himera (Himara), Drimades (Dhërmi), të cilat nëpërmjet të shartimevet të kulturës së më-pasëshme romake patën pas një zhvillim të konsiderueshëm. Pa dyshim, zgjerimi dhe përhapja e këtyne qendrave të kulturës nëpër katunde si edhe në popullin e visevet në fjalë, ka pas n'ato kohë një influence mirëbâse mbi lartësimin e shkallës së qytetërimit të popullit përgjithësisht të kësaj krahine. Aqë âsht e vërtetë

*1 Intelektual i shquem i qytetit të Shkodrës, me origjinë nga Peja. Mbaroi studimet në universitetin e Gracit në Austri. Ka kenë nxanës i N. Joklit. Ka pasë një veprimtari të gjânë intelektuale në fusha të shumta, si hulumtues, arsimtar, polemist dhe studiues i zellshëm, sidomos i kulturës së arbëneshve. Si kundërshtar i diktaturave burgos nga fashistët italianë dhe më vonë prej komunistave. Në ishullin e Ventotenes u njoh dhe u bâ mik i përjetshëm i ish- presidentit të Republikës italiane Sandro Pertini. Punoi shumë vite në bibliotekën "Marin Barleti". Në vitin 1994 iu dha titulli "Mësues i popullit". Ishte mësues në shkollën tregtare në Vlonë. Artikulli që po botojmë asht botue në revistën : "Kombi", e përmuajshme kulturore. Drejtor Ali KUQI. Vjeti I. –N. I. , 1938ff. 3-5.*



saqë në mbarim dhe përfundim të periodit të parë sulmimi i konsullit Paul Emilit mundi të gjejë në këto vise, që përbânin Epirin e asaj kohe, shtatdhet qytete, të cilat ranë viktimë dhe u banë flí mësymjes pushtuese romake. Por rranja e qytetërimit, që ishte formue zafillësisht në këto rehje, sigurisht nga kultura greke, nuk u zhduk dot fare, përkundrazi lëshoi filiza të rà, të cilat kanë një karakteristikë greko-romake, kështuqë, ndërmjet të shekullit II dhe të V-të mbas Krishtit shohim një art autokton, i cili në landën që përdorëte ishte më se dekadent ose në të râm tëposhtë. Ky art në çfaqjen e gjallësis së tij përmban një origjinalitet të spikatësivët ose të tërheqshmënivët, që mund të quhet si një shtytje e parë ose si një rreze e parë drejtë një kulturës autoktone.

Roma vetë nuk kishte më mundësi të merrej me provincat më të afërme të Prendimit, mbasi ishte e ndërmarrun për s'tepri nga turimet dhe mësymjet e popujvet barbarë. Ndikimi i kulturës klasike në këtë mënyrë u bënë dita ditës më i dobët. Materiali i mirë i ndërtimevet të parandajme, të cilin e gjejmë të përdoruem si në Apolonia (Pojan), Orikum, Byllis dhe Amanthia, sidomos gjatë kohës klasike, mungon më se fare tani në këto krahina. Porse idea dhe shpirti si frymë e kulturës vazhdonte gjithnjë dhe njeriu u shterngue të përdori një të tillë material ose lëndë ndërtimi si bje fjala stufë ose sesenë (gur-gëlqeres) që gjindej në këtë nahí. Porse, mjerisht, artisti autokton nuk i ka më ato stërholli klasike të spikatësivët dhe të çfaqjevet të tërheqëshme në statuetet dhe në ndërtimet ose godinat dhe kështu u bënë n'artin e vet më tepër një artist ekspresiv në të cilin u tepruen karakteristikat e veçanta të çdo njenit objekt, sepse i afroreshin mënyrës primitive të parimit dhe të mendimit aqë dhe më tepër të ndjenjës përkatëse. Të tilla statuesha, vasash, maskash dhe tepricash të godinave dhe të mbeturinave arhitektonike dhe artistike i gjejmë në vëndet e sipër thanuna kulture të prefekturës së Vlonës dhe prandej mundi t'i sodisim e t'i marrim e t'i pranojmë si çfaqjet e para të një artit vandalok ose karakteristikisht të vëndit në fjalë.

Porse dhe arti i këtyrë vëndevët, sikundër dhe ay i të gjithë visevet të tjera, vetë tretet dhe zhduket në valvitjet e dyndjevet të popujvet. Në këto nahí përkundrejtë influencës, që pat ushtruem dyndja dhe emigrimi gotik, në disa motive t'artit, të cilat rrojnë ende pranë disa fisevet shqiptare veriore alpine, nuk ka lanë këtu asnjë vrragë dhe gjurmë përkatëse. Ndërsa arti byzantin çfaqet në këto krahina, në stýlin e kishave, të mveshjes origjinale të granisë, të të mbetunave dhe të gërmadhavet të kalavet si edhe me anë të tyre thekson përshtypjen ose ndikesën e

vet në mendësin. Por mjerisht dhe këto të mbetuna nuk përmtojnë sot formimin e gjykimit të saktë mbi gjendjen artistike t'asaj kohe, sepse Kanina, Himara, që kanë qënë qendra eklesiastike dhe ushtarake kanë pësue në rrjedhje dhe vazhdim të kohënavet, që pasojnë kaqë ndyshime, sa që nuk mundet t'identifikohet n'asnjë pikë një prototyp i artit të thjesht byzantin. Megjithëkëtë influence e artit byzantine rron ende në periodat që pasojnë si në stilin e godinavet është dhe n'atë të mvshjes, si bie f. në qëndisje, në motivet e stolis për sa u përket ndryshmenis s'arhitekturës dhe të skalis së drunit në vetvedi. Mbi këto shtrohet mâ vonë, pas shekullit XV influence e stolis dhe e artit ottoman. Fakti asht ky: Vlonës vetë i kanë mungue pas zhdukjes së tri qëndrave kulturele të sipër-përmenduna (Orikumi, Amanthia, Alouni), që patën qënë qendra kulturet me randësi të veçantë, cilsit relative për një zhvillim artistik, prandej nuk mundi të zhvillojë dhe të çfaqë, qoftë në jetën artistike, qoftë në jetën shoqnore, veçorinat artistike të kohënavet të perëndueme (Arhitekturë, qëndisje, skalisje druni etj), që u zhvilluen mâ gjerësisht në qendra administrative të periodit byzantine dhe ottoman si p. sh. në Berat dhe në Gjirokastër. Arsye e kësaj dukunije një nder të shumëtat është se Vlona gjatë ndërkohës byzantine dhe turke ka pasë kryesisht artin dhe mjeshtrin luftarake. Nga këto vise rekrutoheshin shumica e mercenarëvet, ushtarvet me pagesë, që sherbenin me harxhe mâ parë në Byzant, mâ pas himariotët dhe disa herë Dukatasit n'ushtrinë dhe në flotën veneciane, napolitane, e frënge dhe të tjerë leber n'atë otomanen: pa dyshim cilësit luftarake të kësaj popullate, që krijuen ndoshta këtë prirje dhe tendencë u zhvilluen me përdorimin shekullor të tyre, saqë sot mund të quhet popullata e këtyne visevet nga mâ trimet e mâ luftarët të Shqipnis, porse fatkeqësisht arti me kohë u la fare mbas dore. Si përfundim të kësaj paraqitjeje dhe të këtij fakti duem të kuptojmë kangët fare karakteristike katër zanesh të këtyne popullatave në fjalë, (kangë trimnije, vajtime, rrëfime kangë dashunije, që kanë ndoshta elemente (si melodi melodiose dhe permbanje-orchestrime-Chor, shumë arhaike, të cilat mund të na paraqesin një traditë dhe një të përngjame afermendsh mbas një studimit t'imtë përkatës me këngë apollonike të para dymi vjetvet. Sigurisht ata që merren me folklorë dhe me dituni klasike do të gjejnë mjaft landë studimi dhe rrëmimi në këto rehje. Ky përfundim vetë nuk duhet të na çudisi, kurse të mendojmë, që këto vise janë po vetë nga natyra shumë të veçueme. Këtu në një qark që përfshinë prefekturën e Vlonës dhe Kurveleshin e prefekturës së Gjinokastres,

rronin në kohët e lashta popullata të quejtuna “Kaonike” (Kaoniertë) me nandë fiset e veta Molosët, të cilët kishin ata qejtë e famshëm të mbiemnuem “qejt Molosiet”. Këto qenë në luftë tmerri i armiqvet e ish-in të njohun si fisi mâ trim e mâ luftarë (nga grekët) “Epirit barbar” (të huej). Sot këto vise banohen nga Arbërit, që ndahen prap në fise: Labërit e lumit të Vlonës, Kurveshasit dhe Himariotët. Janë fise, që jo vetëm kanë pasë mundësinë të riejnë në vazhdim të të gjithë historis së tyre cilësitë luftarake, por se kanë pasë dhe veçoritë e kolonizatorëve, se të shtymë nga ngushticat e vendit dhe nga nxitja e të luftuemit kanë kriju me kohë kolonina shqiptare në Greqi, Itali, Romani dhe çuditrisht mâ së fundi një fshat gjysmë shqiptar pranë Sadës në Jemen, ku kanë pàsë vajtun si mercenarë me Koxha Sinan Pashën rreth vitit 1550. Në pikëpamje sociale popullata e Vlonës ndahet në tri besime: myslimane, katolike, dhe orthodoxe. Kanë një dashtuni të thellë ndërmjet vedit. Gruaja muhamedane ka qënë mâ e përparueme se ajo evisevet të Veriut, sidomos dhe me reformën moderne të zbulimit të fytyrës, veçse po vazhdon gëzimin e lirisë së fitueme vetë parandej. Vlonjati vetë është mjaft arsimdashës e kryekrejet atdhetarë i flakët. Tregtia vertitet sidomos rreth ullinit dhe bujqësisë e blegtorisë të cilat mjerisht nuk janë ende aq të zhvillueme. Fanatisem fetar të thuesh mâ se nuk gjindet fare. Si influencë e kohës bizantine ka mbetëende sot petku i zi i gravet kristiane.

## II

Mbasi folëm në vija të përgjithshme mbi gjendjen artistike dhe sociale, tani po i përshkruejmë këtu rradhazi ato pak vlera me vlerë historike ashtu artistike në vetvedi. Kemi një herë kry-krejet t’ashtu-quejtunën “Xhamija e Plumbit”.

Nga të gjitha shenjat arhitektonike, që sado të transformueme gjatë rrymës së kohës, por që ende shquhen, mund të besojmë se rreth kohës 1300 -1400 do të jet krijueme në lagjen “Çerekçije” nën influencën e përziemjes së artit arhitektonik byzantine-sllav xhamija e soçme në fjalë e “Plumbit”. Si mbas ndërimit të saj këjo xhami zanafillisht do të ket qënë caktue dhe probabilisht destinuesi “Babtister”. Me pushtimin ottoman u transformue sigurisht në xhami, tue iu ndryshue trajta origjinale e kubës dhe e faqës së hyrjes ose anës principale kryesore. Në fillim ka pasë qënë mbulue me plumb, që kishte një ”Estamps” ravizim osenji resëm të vjetër, i cili është riejtun në bibliotekën e Venedikut e

që daton nga viti 1638. Këjo xhami shquhej mu në rranzën e Vlonës dhe anës së limanit t'asaj kohet. Sulmimet veneciane ndërmjet 1680-1725 probabilisht detyruenë përdorimin e plumbit të xhamis për nevoja të rendit luftarak. Rindërtimi i asaj, sikundër se shifet sot, do të kët ngjarë ndërmjet 1750. Asht i vetëmi monument në Vlonë, që ka vleftë jo vetun arhitektonike, por edhe historike. Afër mendsh ruejtja dhe përmirësimi i kësaj pormendore, tue pasë kujdesin e moscenimit të stylit original, ashtë një detyrë e arsyeshme.

Po nga perioda ottomane daton dhe vorreza, që gjindet në krye të kodrinës të quejtëme “Kuzum-Baba”, ose “Kuzgun-Baba”. Vendi vetë âsht i paracaktuem dhe i predestinuem për t'u ba një vend “ i shënuar “ose siç i thonë gegnisht “i zgjedhun” për tyrbe, etj. Nji gojëdhanë e lashtë tregon, se nji burrë i shejtë, “Kuzum-Baba” ose “Kuzgun-Baba” tue shetitë e bredhë botën erdhi dhe në Qafë të Koçiu të përme hye në Vlonë. Por mjerisht në këtë vend i duel në pritë disa cuba dhe dojshin t'a rjipnin. Mbasi i shenjtji, ishte nji njeri tepër i vorfën dhe pa gjê-sendi, cubat për “inad” ia prenë kryet. Me gjithë këtë “Kuzum-Babai” nuk e prishi qefin dhe gazmendin e vet, porse mori kokën e tij nën sjetull dhe erdhi në vendin e të njajtit emën, ku rà përkohësisht i shtiem si i vëdekun. Me kohë përmbi atë vend u ngreh nji tyrbe ose mausoleum dhe u godit nji teqe Bektashinjsh. Evlija Çelepiu e vizitoi këtë teqe, të cilën e gjeti plot me dervishë dhe në nji gjëndje të begatëshme. Zhgatriimi dhe prishja e urdhënit të Jeniçerëvet, që solli me vehte si rrjedhim përbuzjen e sektës së Bektashinjvet, në të cilën banin pjesë të shumica e jeniçerëvet, pati dhe këtu riperkusionet e veta: Teqeja në fjalë probabilisht ra 130-150 vjetvet. Sot aty gjinden vetum disa tyrbe nga të cilat e para pranë “Kuzum-Babait”, âsht e Kapllan Pashait dhe e fëmijës së tij; e dyta e Ali dhe Ahmet beut me fëmijën e tyne; e treta âsht e Sulejman Pashait që janë po tënjajtit fis dhe e katërta âsht e Sirrih beut dhe e bashkëshortes së vet. Gojëdhanja e tregueme ma nelt vet âsht përsëritja e besimit Sarisalltëkut, që ka banesa e përjetshme, të cilat në rasën e tij janë nji provë e gjallë, se ky ka qenë i nderuem nga sekta e Bektashinjvet.

Nga xhamit e qytetit mund të thomi se asnjëna nuk ka nji vleftë arhitektonike, por se disa prej kësosh, sado të padukëshme, kanë lidhje me ngjarje dhe me persona me randësi, ndërmjet cilavet shquhen këto:

a. Në hymjen e Vlonës, në lagjen “Vrenes” âsht nji xhami e vogël dhe modeste, e cila âsht shenja e parë e sundimit ottoman në qytetin e

Flamurit. Pra, siç shohim është lidhun ngurtësisht me emnin e pushtuesit të parë të Vlonës, Evrenos Zade Kasëm bey.

b. Xhamija e “Tabakëve” është ngrehun me urdhën të një të quejtun Kasëm Pasha, që me këtë rasë është Mimar Kasimi, i cili pat qenë një arhitekt i famëshëm i Turkis në shekullin(XVIII) tetëmëdhjetë dhe me origjinë shqiptare, sepse kishte lindun më një katund afër Beratit. Transformimet e ndryshme kohë pas kohe, e kanë shëmtue këtëxhami, e cila ruenë sot vetun një mindare me proporcione shumë të bukura ndërtoeme 40 vjet më parë me gurët e vjetër.

c. Xhamija e Sheh Jakupit goditë në një styl romano-venecian. U pat rindertue dhe rigoditun nga Neshad Pashë Vlora si për kujtim të djalit të vet. Si i atiashtu dhe i biri bashkë me t’amën gjinden të varrosun në oborrin e sajë. Këjo xhami nuk shquhet për madhështin as dhe për stypin e sajë se i mungon kjartësija e linjevet e detajevet, porse ka veçanërisht njëvleftë historike për arsye se me te, sikundër ka qenë përpara rrenimit të saj, është lidhun gojedhanja e vetëme, që populli jonë e ka trashigue brez pas brezi e cila vërtetohet me një dorëshkrim të quejtun “Mir-at-el-Qainat” – Pasqyra e Botënavet -. Si pas kësaj gojedhanje Sulltan Sulejman Kanuni – Ligjddhanësi- kurka pasë ardhë në Vlonë rreth gjymsës së shekullit XV ka pasë banue në Teqen e një burri të mirë të quejtun Sheh Jakup. Në mëngjes, kur pyet Shehi, se çka dëshëronte për mundimet e veta, kërkoi nga Sulltani transformimin e asajë dhome, që kishte fjetë dhe bujtë mbreti, në një faltore. Dëshira e tij u plotësue nga Sulltani. Dhe fëmija e tij u vue kujdestar mbi këtë xhami, tue i dhanë një pasuni të përshtatëshme.

Vorrezat e Shehut me të gjithë femijnë e vet gjinden kundrejtë mindarës nën një pllakë çementoje, ku shënjoht seicili me një katërkandsh të ravizuem.

Sa për kishat mjerisht nuk kemi se ç’të themi. Kisha orthodokse vetë nuk ka ndonji cilësi arhitektonike. Godina siç paraqitet sot probabilisht është ngrehun në të tetëmdhetin shekull. Por sigurisht nuk ka asnjë dyshim se këtu si edhe në vëndin e quejtun “Kisha e Shën Thodorit” të ngrehun dhetë vjetë më parë me një shije arhitektonike të pa-blueshme si art dhe esthetikë në vetvedi do të kenë qënë dhe kisha të vjetra, sepse një “Estamps”– ravizat-, që daton rreth vitit 1540-50 paraqet këtu dy kisha. - Vlona ka dhe një kishë katolike të thjesht.

**▪Tradita arsimore▪**Njazi **KAZAZI****NJË HISTORIK I SHKUTËR I SHKOLLËS NORMALE TË  
MOTRAVE STIGMATINE**1. *Hyrje:*

Vitet e fundit kam patur rastin të botoj disa shkrime, si: - *“100-vjetori i shkollës normale të Shkodrës”*, *“ZANI I NALTË”*, Botues Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Revistë shkencore dhe kulturore, Viti VI (XIX), Nr. 19 (172), Tiranë, 2017, fq. 44-49 (ISSUE), - *“95 vjetori i Gjimizit të Shtetit, 1922-2017”*, në *“ZANI I NALTË”*, Botues Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Revistë shkencore dhe kulturore, Viti VI (XX), Nr. 21 (174), Tiranë, 2017, fq. 51-60. etj.

Në vazhdim të punës sonë po japim edhe një histori të shkurtër të *Shkollës Normale të Motrave Stigmatine*.<sup>1</sup>

2. *Fillimet e arsimit shqip në trevën e Shkodrës:*

Siç e kemi theksuar edhe më lart, përpjekjet për arsimin në gjuhën shqipe në qytetin e Shkodrës kanë qenë të hershme. Ndonëse në kushte të vështira dhenë një nivel të ulët, kanë kontribuar për t’u mësuar fëmijëve gjuhën shqipe.

Në këtë kuadër vend të rëndësishëm zuri edhe puna për mësimin e vajzavesi nevojë e domosdoshme për përgatitjen e nënave që të mëkonin tekfëmijët dashurinë për atdheun, për jetën, për virtytet e larta të shqiptarit.

Vend të rëndësishëm në shkollat femërore të Shkodrës zë puna e mësueses Kushe Mica. Ajo që nxënëse e mësuesit Shore Markja për të cilin kemi folur në shkollat private të gjysmës së parë të shek. XIX.

Bashkëkohësit tregojnë se Kusha ishte grua me kulturë të gjerë

---

1 Dr. Ludovik Shllaku: *“Shkollat klerikale... ” “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2002, fq. 82-88.*

(zotëronte frëngjishten e italishten, ishte me trup të lartë, e hijshme në fytyrë, me sjellje shembullore dhe e pajisur me inteligjencë dhe mprehtësi). Pas dy vjetësh vështirësish dhe pengesash arriti që në gusht të vitit 1859 në një ceremoni të thjeshtë të qytetarëve shkodranë të hapë shkollën e parë laike të njohur në historinë e arsimit dhe të shkollave shqipe, të njohura me emrin “*Shkolla e KusheMices*”.<sup>2</sup>

Shkolla vazhdoi deri në vitin 1897, vit në të cilin mësuesja u largua nga nxënësitsaj për arsye të moshës. Numri i nxënësve në këtë shkollë në përgjithësi qe i lartë. Kështu, në vitin 1865, ajo kishte dy mësuese me 86 vajza.<sup>3</sup>

Ruhen deri në ditët tona lista të nxënësve të shkruara nga dora e KusheMicës. Në shkollë u përdor alfabeti latin tradicional i veriut. Aftësia e tyre ishte e kufizuar, megjithatë disa fletore shkrimi dhe aritmetike, si dhe punimet e dorës të bëra nga nxënëset, flasin për një punë të kujdesshme dhe arsimore të mirfilltë. Një nga nxënëset e para të KusheMicës, Tina Nikë Gjergji, hapi më vonë edhe ajo një shkollë shqipe për vajza në vitin 1873-74. Nga fundi i shekullit XIX në të dy shkollat femërore të Shkodrës kishte 120 vajza.

Shkollat e Kushe Micës, Tina Nikës dhe Tereze Berdicës nuk qenë shkolla fetare. Ata mbaheshin kryesisht me të ardhurat që siguronin me ndihmat ekonomike të disa familjeve qytetare të kamura, të cilat ishin të interesuara dhe nuk kursenin asgjë për arsimin dhe edukimin e vajzave të tyre. Mësueset dhe shkollat që drejtonin ato përfituan edhe një shumë të vogël në lekë nga fondiaustriak pas lutjeve të herëpashershme që u bënë. Kërkesa për ndihmë dhesubvencion sado të vogël shërbente njëkohësisht jo vetëm si mbështetje e qeverisëaustro-hungareze për këto shkolla, por edhe si presion ndaj qeverisë turke.

### 3. “*Vështrimi i shkurtër për shkollën Normale të Motrave Stigamtine:*”

Por në historinë e shkollave për vajza që arritën deri në rangun e shkollësë mesme vend të rëndësishëm zë padyshim *shkolla Normale e Motrave Stigmatine*. Si edhe për shumë shkolla të tjera në vitet e diktaturës komuniste, edhe për këtë shkollë është mbajtur në heshtje, 2 Tomë Gjyshja, “*Qendra Arsimore e Kushe Mices në Shkodër*”, gusht 1859, në almanakun “*Shkodra*”, 1961 fq. 193-194. (Nga ky autor janë shkruar edhe 2 shkrime të tjera për këtë shkollë).

3 Kabineti Pedagogjik, “*Historiku i Arsimit të rrethit të Shkodrës*”, pjesa I, fq. 11, Shkodër 1980. (Dorëshkrim).



madje janë denigruar, duke u quajtur shkolla fetare, antikombëtare e me tjera eptitete që nuk i përgjigjen të vërtetës historike, duke e varfëruar kësisoj historinë e shkollave të mesme në Shkodër, e për rrjedhojë edhe historinë kombëtare.

Kujtojmë se Motrat Stigmatine që më 1879 hapën shkollat e tyre përvajza. Në fillim si fillore dhe pastaj fillore e qytetëse bashkë. Këto që përmendëmmë sipër dhe të gjitha shkollat e tjera për vajza kanë qenë herë private, herë klerikale apo edhe shtetërore. Ato ndonëse jepnin një arsim të kufizuar, luajtën një rol të rëndësishëm arsimor, pedagogjik dhe atdhetarpër mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe edhe në elementin femëror, kryesisht në Shkodër.

Pas fitores së pavarësisë kombëtare, në vitet e pushtimit austro-hungarezapo të krijimit të shtetit shqiptar pas viteve '20 doli në evidencë në mënyrë të veçantë përgatitja e mësueseve vendase për shkollat shqiptare të vajzave, për të ngritur nivelin e tyre. Në fillin vajzat dërgoheshin për të kryer studimetpedagogjike në shkollat e Austrisë, Italisë, Turqisë apo gjetkë. Natyrisht, nëkushtet e mentalitetit shqiptar dhe gjendjes së vajzës shqiptare në përgjithësi, ky numër ishte i kufizuar.

Shtypi i kohës, i cili ka qenë pasqyrë e plotë dhe e saktë e ngjarjeve kryesore, jep të dhëna me interes dhe të rëndësishme për historinë e arsimit në Shkodër. Kështu në gazetën “*Posta e Shqypnisë*” lexojmë se “... në Shkodër u hap njëshkollë për mjeshtre (mësuese) ku vazhdojnë mësimet rregullisht 9 vajza, <sup>4</sup>pokështu u dërguan në Austri 13 vajza për të vazhduar shkollën pedagogjike.”<sup>5</sup>

Në vitin 1922 në të gjithë kuadrin e problemit të Normales provizore, bëhet fjalë për një shkollë normale femërore. Ministria e Arsimit me shkresën nr. 1265\1, Tiranë 30. 8. 1922, dërguarInspektorisëArsimitShkodër, si përgjigje të telegramit nr. 961, datë 26. 8. 1922, porositi: “*Dy rendet e fundit të qytetëses do të formojnë një rendpërgatituer të shkollës normale femërore. Rendi i parë i qytetëses do të formojërendin e gjashtë të fillores ata qi kanë dalë prej rendit të pestë me numra fort tëmirë futen në rendin e VI-të të tjerët në rend të V të sivjeçëm tue formue rendine V të fillores.*

*Këta të dy rendet V e VI të fillores të e rendi përgatituer i Normales do tëgjinden në shkollëqytetëse e 4 rendet e tjerë mbeten në fillore. Dy*

<sup>4</sup>“*Posta e Shqypnisë*”, viti i parë, nr. 76, 25. 8. 1917, fq. 3.

<sup>5</sup>“*Posta e Shqypnisë*”, viti I, nr. 99, 17. 10. 1917, fq. 2.



*drejtoret e dy mësueset ma të zonjat do të ndahen në ndërtesë të qytetësës. Drejtorja e qytetësës do të ketë administratën e nën titullin Drejtores Normales Femërore me rendet e mësipërme të filllores. Na lajmëroni cilat mësuese janë ma të zonjat për m'u shënuem për këtë shkollë.*”<sup>6</sup>

Është e qartë se bëhet fjalë për një shkollë normale femërore që në vitin 1922 me dy klasat e larta të filllores V e VI dhe një klasë përgatitore për normale. Drejtoresha e qytetësës do të ishte edhe drejtoreshë e kësaj shkolle normale. Siç e theksuam edhe më lart, shkolla Normale e Motrave Stigmatine, e themeluar mbi bazën e shkollës së mëparshme, që një pjesë të shpenzimeve i mbulonte me subvencionet e Inspektorisë së Arsimit dhe të Ministrisë. Kështu nga një bordero e muajit tetor 1919, përveç personelit të të gjitha shkollave të qytetit, tregohet edhe subvencioni për shkollat e motrave Stigmatine të qytetit dhe të Shirokës (përkatësisht 800 dhe 150 franga)<sup>7</sup> këtë e shohim edhe në bordero të tjera.

Që në vitin 1922, provinciali i Françeskanëve të Shkodrës, Atë Palë Dodaj i drejtohet Ministrisë së Arsimit me një kërkesë “...që shkolla të kishte pranë internat (konvikt) për vajzat” që do të përgatiteshin për mësuese. Në të thuhet: “Prej shekujsh e shumë herë kje dftue dishiri e nevoja me çilë ktu në Shkodër një internat për vajza të krahinave të ndryshme të Shqypnisë me qëllim që me i bâ gadi përmësuese të shkollave femnore. Kështu edhe na kjo dishiri ky internat t'u jetë ndër kujdes të motrave françeskane të Shkodrës të cilat mbajtën një shkollë me mâ se 300 xanse të përjashtme dhe ma pak xase të përbrendshme. Shkolla e tyre është përbâ prej 5 klasash fillestare e prej tri klasash qytetnore të rregullueme mâ së miri.”<sup>8</sup>

Se cili qe mendimi i Ministrisë së Arsimit për këtë problem nuk e dimë hollësi, por, me sa duket, propozimi i klerit katolik u miratua.


Kjo duket qartë edhe nga shkresa e sipërshënuar, sepse nuk do të kishte kuptim kërkesa për pagimin e qerasë së ndërtesës për konviktin nga Ministria e Arsimit pa u miratuar hapja e kësaj shkolle. Veç kësaj, në fund të shkresës kugjendet vula e protokollit të Ministrisë së Arsimit me datë 01. 02. 1921, gjendet edhe ky shënim me dorë “Çashtja e shtëpisë

<sup>6</sup> Fotokopje e shkresës në fjalë gjendet në Muzeun e Shkollës pedagogjike (më pas MSHP).

<sup>7</sup> Muzeu Historik i Shkodrës, Fondi i trupave aleate, D. 3 V. 1941.

<sup>8</sup> Arkivi Qëndror i Shtetit (më pas AQSH), F. 295, D. 306, Dok. 201, datë 23. 01. 1922. (cituar sipas prof. Islam Dizdarit, Historiku i shkollës pedagogjike, Pjesa III, Dorëshkrim, fq. 33.)

në Shkodër u krye prej Ministrijet<sup>9</sup>. Firma e palexueshme, datë 08. 02. 1922.



Shkolla Normale e Motrave Stigmatine ishte një shkollë e mesme e plotëme 4 vjet, pas një klase gatimore. Në vitin 1927-28 nxori maturantet e para të cilat u emëruan mësuese në shkollat fillore të vendit. Kemi pasur fatin të konsultojmë një vendim të tillë për emërimin e njëres nga ish-maturantet e para të kësaj shkolle, të cilin po e sjellim të plotë më poshtë:

Dekret nr. 242 i Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Shqiptare, Tiranë më 20. 10. 1928: “Në themel të propozimit tonë nr. 3493, datë 10. 10. 1928 e pëlqimtë Këshillit Ministrues, nr. 1542 me 13. 10. 1928 po emnoheni mësuese në shkollën femnore Shijakë. ”<sup>9</sup> Në dekret shënohet me bojë: Filloi punën më 25. 10. 1928. Pranë vulës së Shkollës Plotore-Shijakë, firma Bektishi. (Shih kopjet e deftesave shkollore të Nusha

9 Dekret i kësaj ministrie, dërguar mësuese N. Zeka (Fistani) e datëlindjes 1906 nga e cila kemi marrë menjëherë të dhëna interesante për këtë shkollë që do t'i rreshtojmë më poshtë.

Zekes).

Nga dokumentacioni që ruhet në Arkivin e Shtetit, Tiranë, kemi krijuar idenë e plotë se sa nxënësë maturante përfunduan studimet në këtë shkollë sipas viteve që po i japim këtu më poshtë:

Maturantet e para që kryen provimet e shtetit me 24. 06. 1928 qenë:

Kristina Shuteriqi, Liza Kodheli, Luçije Serreqi, Margerita Mazrreku, Nusha Zeka, Sanije Jahja, Terezina Shiroka, Viktorja Lazri, Viktorja Jaku<sup>10</sup>

Në vitët në vazhdim kemi gjetur këto të dhëna për ecurine e kësaj shkolle:

- Në vitin shkollor 1927-28, moren dëftesa pjekurie- 9 nxënësë.
- Në itin shkollor 1928-29, nxori dimoren dëftesa pjekurie - 8 nxënësë.
- Në vitin shkollor 1930-31, moren dëftesa pjekurie - 9 nxënësë.
- Në vitin shkollor 1931-32, moren dëftesa pjekurie - 5 nxënësë.
- Në vitin shkollor 1932-33, moren dëftesa pjekurie - 9 nxënësë.<sup>11</sup>

Provimet e maturës për vitin 1932-33 u dhanë kur kjo shkollë ishte mbyllur dhe nxënësit ishin transferuar në shkollën normale femrore të Gjimizit të Shtetit. Por megjithatë shkolla Normale e Motave Stigmatine ishte mbyllur, si shumë shkolla private dhe provimet që u zhvilluan nga një komision shtetëror, në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe të drejtorisë Gjimizit. Ajo që bie në sy është se të gjithë mësuesit e tjerë anëtarë të provimeve të pjekurisë ishin mësuesit e asaj shkolle: mësuesia e matematikës, drejtoresha e shkollës Konsilja Muzhani; mësuesia e gjuhës shqipeImakolatë Tedeskini; mësuesi i pedagogjisë, Ambroz Marlaskaj etj.<sup>12</sup>

Dhanë provimet e stazhit:

Viti shkollor	Numri i nxënësve që morën dëftesën e pjekurisë	Dhanë provimet e stazhit
1927-1928	9	5
1928-1929	8	3
1930-1931	9	-
1931-1932	5	1
1932-1933	8 plus 1	-

Shkolla Normale e Motave Stigmatine nxori disa breza maturantesh.

10 AQSH, Fondi 295, Viti 1932, Dosja 6, Fleta 10.

11 AQSH, Fondi 251, Viti 1932, Dok. 241 dhe po aty F. 699, Viti 1935, Dok. 30.

12 AQSH, F. 251, D. 361, Fletët 177-189.

Për 5 vite ku morën dëftesën e pjekurisë gjithsej 41 vajza, shumica nga Shkodra dhe rrethet e saj.<sup>13</sup> Kjo shkollë punoi në bazë të planeve dhe programeve shtetërore, kontrollohej dhe subvencionehej nga shteti.

Përtëkrijuar një idem të plotë përtë, po analizojmë botimin: “*Programa e mësimëve të shkollës Normale Mashkullore dhe Femërore*”, Tiranë 1925, Miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit.

Po japim një pasqyrë të planit mësimor të Shkollës Normale të Motrave Stigmatine:

Nr.	Lëndët	Klasat dhe orët				
		Gatimore	I	II	III	IV
1.	Gjuhë shqipe	6	6	5	5	3
2.	Pedagogji	-	-	3	3	2
3.	Histori	2	2	2	2	2
4.	Gjeografi	1	2	2	2	2
5.	Gjuhë frënge	3	3	4	4	4
6.	Matematikë	4	4	4	4	3
7.	Histori natyre	1	3	3	3	1
8.	Dituri natyre	2	2	2	2	1
9.	Bujqësi teoritike	2	2	2	2	2
10.	Bukurshkrim	2	1	1	1	1
11.	Vizatim	2	2	2	2	2
12.	Punë dore	1	1	1	1	1
Shuma e orëve javore		26	28	31	31	24

Mendojmë se është me interes për historinë e pedagogjisë për të përcaktuar raportin e lëndëve njëra me tjetrën, sipas vendit që zënë me sasinë e orëve javore, e cila paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lënda	% që zë	Vendi që zë
1.	Gjuhë shqipe	Nga 12. 1- 23. 0	1
2.	Pedagogji	Nga 8. 3 -9. 7	5
3.	Histori – gjeografi	Nga 6. 4 - 8. 1	6
4.	Gjuhë e huaj	Nga 10. 7 - 16. 6	2
5.	Matematikë	Nga 12. 1 -15. 4	3
6.	Histori natyre	Nga 3. 9 -10. 4	4
7.	Vizatim	Nga 6. 4 - 8. 3	6

Për të gjykuar sadopak për punët nxënësve në këtë shkollë në

<sup>13</sup> Cituar sipas Prof. Islam Dizdarit, art i cituar fq. 7.

lëndë të ndryshme na japin dorë disa fletore shënimesh të mbajtura dhe të ruajtura me kujdes nganjë nxënese e kësaj shkolle,<sup>14</sup> të cilat po i përshkruajmë më poshtë:

Fletore hartimi e klasës V, viti shkollor 1922-23: Janë bërë gjatë vitit 14 hartime. Tri tema lidhen me ngjarje të shënuara të Atdheut, që synojë për të edukuar tek nxënësit dashurinë për atë. Temat në fjalë, si *“Kujtime Nandorit”*, *“Dita 28 Nanduer”*, *“Si mundet një femën me e dëftue dashtunin e vet kah Atdheu”* i krijonin mundësinxënësit që shprehnin ndjenjat e thella të dashurisë për Atdheun. Kështu në këtë fletore lexojmë: *“Dita e 28 Nandorit na paraqet të shpërthemit e parë të një lules së bukur praverore, të përhjedhin e e flamurit kuq e zi...”*. Kurse në hartimin e tretë lexojmë: *“Edhe gruajado t’i kujtojë me zemër ndjesi të gjalla për Atme të vet, tue me rrit gënjien me dashtuni dhe bashkim me shoqni për të mbarë dhe për të mirë të Atdheut”*.

Kështu janë edhe temat: *“Kalenderi i ri”*, *“Një kunorëme lule të freskëta”*, *“Prej dritares sime”*, *“Një shoqja ime”*, *“Klasa jonë”*, *“Zina kotet, mbështet kryet në prehnin e gjyshes dhe e mori gjumi...”*, të cilat marrin shkas nga ngjarje të ndryshme, të thjeshta, të zakonshme të jetës familjare, brenda dhe jashtë shkollës, duke i krijuar mundësi nxënësve për dhënë gjykime të pavarura, larg temave të politizuara... Ndërsa temat *“Babë i dashtun...”* *“Mari e dashtun...”* *“Shoqe e dashtun...”* janë ndërtuar në formën e letrave, dërguar njerëzve të dashur të fëmijëve. Ato kanë ndjenja e mendime të çiltra, të pastra, pa asnjë lustër, fjalë zemre...

Ashtu siç thekson edhe programi, në fletoret e analizuar duket kujdesi për t’i dhënë aftësi dhe shprehi praktikenxënësit e kësaj për t’upërshtatur me situata të ndryshme ligjërimiti.

Nga një fletore tjetër shohim se edhe në lëndën e pedagogjisë janë parashtrime me shkrim sipas njëtme të caktuar. Kështu gjatë një viti janë bërë 8 hartime të tilla. Hartimi i fundit mban datën 04. 08. 1928. Fletorja ka format të gjërë dhe hartimet zënë 56 faqe të shkruara pastër, bukur me shumë kulturë që është për t’u patur zili. Hartimet janë korrigjuar me shumë kujdes nga mësuesi. Shkrimet në fund të çdo hartimi, janë shumë korrekte, përmbledhin problemet kryesore të përbahtjes, formës dhe orotografisë, duke dhënë përfudime të sakta për punën e nxënësit me qëllim që ai të ishte plotësisht i qartë për atë që ka bërë, duke folur për punën serioze të mësuesve.

<sup>14</sup> Fletoret e hartimeve të ish-nxëses të kësaj shkolle Nusha Zeka (Fistani).

Duke konsultuar disa dëshmi shkollore të dhëna nga drejtoria e shkollës Normale të Motrave Stigmatine krijojmë një ide, për punën e dokumentacionit shkollor. Dëftesat dhe dëshmitë shkollore në fjalë, që janë shtypur në shtyshkronjat e Shkodrës, flasin edhe një herë për rregullsidhe punë konkrete në këtë fushë. Dëftesat plotësojnë mendimin e shprehur më parë për planin mësimor të shkollës, që përmendëm në fillim të shkrimit. Kështu në vitin I dhe të II bëheshin 14 lëndë. Në klasën II pedagogjia, veç atyre të vitit të I, si: besim; këndim, shkrim, gramatikë, hartim; numëratore; dhematje; histori e dituri natyre; histori e dheshkronë; bukurshkronjë; ravizë; punë dore; italisht.

Veç vlerësimeve në lëndët e mësipërme, sipas klasave, në çdo dëshmi ndeshim vlerësime edhe për tri drejtime të tjera (gjë që i kemi ndeshur edhe në dëftesa të shkollave të tjera të para vitit 1944), si të sjelljes, të qëndrimit dhe kujdesit të nxënësit në shkollë dhe jashtë saj të cilat shprehen me fjalët: të prumë, cenë dhe trajtë e përjashme, të cilat vlerësohen me nota.

#### 4. Përfundime:

Ne u përpoqëm të japim në mënyrë të përmbledhur shkollën *Normale të Motrave Stigmatine*, duke përvijuar ato që lidheshin me fillimet e saj, me 5 maturat që përfunduan këtë shkollë, me planin mësimor, lëndët që jepeshin, raportet që zënë etj. Gjatë 50 viteve të fundit, deri në vitin 1990, kjo shkollë, por edhe disa shkolla të tjera nuk janë përmendur fare, duke u lënë në heshtje apo denigruar, por nuk duhet "harruar" një e vërtetë e madhe se në ato mësuan, dhe nga bankat e tyre dolën intelektualë, atdhetarë dhe mësues të zotë që ndihmuan në përparimin e kombit dhe qytetërimit ndaj ato duhet të zënë vendin që meritojnë në historinë e arsimit kombëtar shqiptar.



## ▪Recensione▪

Selman **SHEME**

### **VEPËR ME VLERA TEORIKO-SHKENCORE DHE APLIKATIVE**

*(Nail Draga, ETNIA DHE HAPËSIRA,  
Botoi : “Art Club”, Ulqin, 2017)*

Në fillim të shek. XIX-të në të gjithë Europën dhe në gadishullin e Ballkanit fillojnë lëvizjet nacionale për çlirim kombëtar dhe krijimin e shteteve kombe. Nacionalizmi fillestar në Europë kishte funksione humane dhe ishte në përputhje me tendecat e brendshme shoqërore. Në këtë kohë u krijua dhe u përhap sllogani “liri, barazi, vllazëri”.

Deri në fillim të shek. XIX-të shqiptarët, sllavët e jugut dhe grekët kishin plane të përbashkëta për organizimin e kryengritjeve çlirimtare kundër osmanëve. Më vonë, kur Perandoria Osmane nisi tërheqjen në mënyrë të pakthyesmenga Ballkani, aleatët e deridjeshëm të shqiptarëve u shndërruan në armiq edhe më të këqij se osmanet.

Sllavët e jugut dhe grekët, në dallim nga shqiptarët, duke qenë të organizuar rreth sistemit të kishës ortodokse dhe duke u sponsorizuar nga shtetet europiane, të cilët që nga koha e iluminizmit qytetërimin e vet e perceptonin si fryt të kulturës antike helene dhe asaj kristjane, fituan rëndësi historike. Në këtë kohë u projektuan kufijtë e bazuar në real-politikë apo në interesa kombëtare të mbrojtura ushtarakisht. Këto interesa nuk marrin parasysh trashëgiminë kulturore, historike apo realitetet etnike në terren, por një aspekt të ri atë të gjeopolitikës dhe gjeostrategjisë.

Projektet për copëtimin e trojeve shqiptare, mes Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, e kanë zanafillën që në vitet 30 të shek. XIX-të, kur Greqia sapo ishte formuar si shtet i pavarur, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi ishin shpallur principata autonome. Në këtë periudhë u hartuan

dhe u publikuan dy programepolitike dhe ideologjike, “Naçertania” dhe “Megalo-Idea”, qellimi i të cilave ishte ndër tëjtjera coptimi dhe aneksimi i trojeve shqiptare. Këto aspirata u mbështetën nga Fuqitë e Mëdha në Kongresin e Berlinit(1878), në Konferencën e Ambasadorëve në Londër(1913) si dhe në Konferencën e Versajës(1919), ku u vendos copëtimi i trojeve shqiptare në katër pjesë, nga të cilat më pak se gjysma u përfshi në kufijtë politikë të shtetit shqiptar. Tre pjesët e tjera ndonëse me popullsi etnike shqiptare dhe terësisht të religjionit mysliman u aneksuan nga monarkitë e krishtera, nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia.

Libri “Etnia dhe hapësira”, shkruar nga studiuesi dr. Nail Draga, ka si objekt kryesor studimi hapësirën etnogjeografike shqiptare të skajit veri-perëndimor të trojeve të trungut etnik që historikishtkanë qenë dhe janë populluar nga shqiptarët. Duke u mbështetur në dy koncepte gjeografike që përdoren gjerësisht për të përkufizuar raportet midis gjeohapësirësme etnogjenezën e një komuniteti njerëzor, autori ka ditur të trajtojë një problematikë të gjerë e komplekse të karakterit historik, gjeopolitik, demografik, ekonomik, social dhe mjedisor të lëndës së marrë në studim.

Libri përmbledh 11 studime, referate dhe kumtesa të prezantuara nga autori në dy dekadat e fundit në konferenca dhe tubime shkencore të mbajtura në Mal të Zi, Kosovë dhe Shqipëri.

Që në kryeun e parë të veprës parashtrohen fakte dhe të dhëna mbi bazën e të cilave bëhen analiza shkencore të procesit historik dhe rrethanave politiko-shoqërore të aneksimit të trojeve shqiptare nga Mali i Zi si dhe aplikimi i projekteve për deportimin e popullsisë shqiptare dhe kolonizimin e këtyre territoreve me popullsi sllave.

Megjithësepër ngjarjet historike, të periudhës së Krizës Lindore(1875-1878) ka një mori studimesh, në këtë libërdr. Nail Draga preferon t’i referohet një autori që ka mbetur i panjohurpër opinionin e gjerë siç është Spiridon Gopçeviqi. Ky studiues në librin e tij “Crnogorski- turski rat (1876-1878)”, ofron të dhëna me interespër hapësirën etnogjeografike shqiptare. Gopçeviqi është ndër të pakët autorë të huaj që territoret e banuara me popullsi shqiptare t’i cilësojë jo si pjesë e Perandorisë Osmane por me emrin që quheshin nga popullsia vendase, Shqipëri, ndonëse në atë kohë Shqipëria nuk ishte shtet i pavarur.

Në projektin për pavarësi të Malit të Zi nga Perandoria Osmane, në kontekstin gjeopolitik një vend të posaçëm në këtë libër zë analiza



e operacioneve për zgjerim territorial me synimin e daljes në det, ku aspiratat pushtuese përfshinin viset veri-perëndimore shqiptare, dukepërfshirë edhe bregdetinTivar-Ulqin.

Materializimit të këtij projekti, nga viti 1876-1913, autori i kushton një hapësirë të gjerë duke evidentuar aleancat ushtarake dhe marrëveshjet me Rusinë, pa përfillur përkatësinë etnike të popullsisë në territore që aspironte. Duke u mbështetur në të dhënat autentike që prezanton S. Gopçeviqi, që sipas autorit verifikohen edhe nga burime të tjera nga literatura e konsultuar, populli shqiptar luftoi për të mbrojtur tërësinë e vet territoriale por rrethanat ushtarake e gjeopolitike të kohës ishin të papërshtatshme për shqiptarët.

Trojet shqiptare në veri-perëndim të Vilajetit të Shkodrës, gjatë Luftërave Ballkanike u aneksuan nga Mali i Zi dhe u sanksionuanme vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Diplomati i shquar shqiptar Rasih Dino, kryetar i delegacionit shqiptar i deklaroi Konferencës sëAmbasadorëve në Londërse”.... *paqja dhe qetësia e Gadishullit do të arrihejvetëm nëseShqipërisë në të ardhmen do t'i jepej një strukturë homogjene dhe kufijtë e saj do të ndiqnin vijën e kufirit të atëhershëm me Malin e Zi, të përfshinin bashkë me hinterlandin e tyre përkatës qytetet e Ipekut, Mitrovicës, Prishtinës, Shkupit dhe Manastirit, deri në Meçovë dhe të ruanin kufijtë ekzistues deri në Prevezë”.*

Personalitetet shqiptare, pavarësisht nga trauma që pësuan me cungimin e trojevetë tyre

e përshëndetën vendimin e Konferencës së Ambasadorëve pasi tashmë u krijua një shtet i pavarur shqiptarqë do të shërbente si pikëmbeshtetje për të realizuar në të ardhmen programin madhor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Interes paraqet në këtë libër deduksioni që arrihet lidhur me pasojat e aneksimit të trojeve periferike shqiptare, shpërnguljes së popullsisë dhe kolonizmit të trojeve shqiptare me sllavë në veri dhe grekë në jug të vendit. Sipas autorit disa nga rrjedhojat ekëtij procesijanë:

-*Sëpari*, u ngushtuan trojet e trungut etnik shqiptar nga 75. 000km<sup>2</sup>, në 28. 748km<sup>2</sup>në Shqipërinë Londinezedhe 10. 908km<sup>2</sup> në Republikën e Kosovës.

-*Së dyti*, është dëmtuarvitaliteti i kombit që përcaktohet edhe nga hapësira territoriale nga komunikimi i gjerë me krahinat periferiketë saj që sot janë në Mal të Zi.

-*Së treti*, lëvizjet migruese, shpopullimet dhe shpërnguljet nëpërmjet gjenocidit kanë krijuar çrregullimedemografike, në kuadrin e potencialit të përgjithshëm të popullsisë shqiptare në Ballkanin Perëndimor.

-*Së katërti*, copëtimi i trojeve shqiptare është shoqëruar më dëmtrimin e traditave kulturore kombëtare e krahinore. Shpërbërja e fshatrave, qendrave urbane, objekteve të kultit dhe kulturës materiale, qendrave arkeologjike, kalave etj., kanë dëmtuar rëndë trashëgiminë kulturore iliro-arbëroro-shqiptare, por edhe veneciane dhe osmane të cilat janë jo vetëm me vlera krahinore dhe kombëtare por edhe evropiane dhe botërore, pasi kultura dhe arti nuk njih kufij shtetesh.

Një vend të posaçëm në këtë libër zënë problemet gjeohapësire, demografike dhe ekonomike si:

-Shtrirja territoriale, vendbanimet dhe popullsia shqiptare në Mal të Zi.

-Roli i rrethanave historiko-shoqërore në ndryshimin e strukturës kombëtare të popullsisë në regjionin Ulqin-Tivar,

-Lëvizjet migruese dhe popullimi i vendbanimeve shqiptare në zonat malore etj.

Bazuar në një mori të dhënash dokumentare e arkivore, në këtë libër sillen argumente që dëshmojnë rrudhosjendhe tkurrjen e trojeve shqiptare në Mal të Zi që nga antikiteti dhe veçanërisht në kohën moderne. Si rezultat i okupimeve dhe vendimeve të padrejta politike në përcaktimin e kufijve, spastrimeve etnike etj., viset shqiptare në Mal të Zi janë mikroregjione gjeografike pa unitet territorial. Në këtë drejtim, thekson autori, ka ndikuar edhe organizimi administrativ territorial i sistemit komunal që është kushtëzuar nga diktati politik i shtetit malazez pa marrë parasysh strukturën kombëtare të popullsisë.

Në problematikat e shumtatë librit interes të veçantë paraqet trajtimi i strukturës kombëtare të popullsisë. Në gjysmen e dytë të shek. XIX-të Shkodra ishte qendra kryesore gravituese për të gjithë gjeohapësirën e Shqipërisë Veriore. Ajo dallohej për fluksin dhe refleksin e qarkullimit të mallrave, njerëzve dhe kapitaleve, nga Rrafshi i Dukagjinit dhe Fushë-Kosova, në drejtim të Detit Adriatik me avanposte, portet kryesore të saj Tivarin, Ulqinin, Obotin dhe Shëngjinin.

Sifoni apo koridori jugorujor Deti Adriatik-Lumi Buna-Liqeni i Shkodrës-Virpazari, ishin arteri i brendshëm ujqor dhe rruga jetike ekonomike në qarkullimin e mallrave të qytetarëve. Pas vendimeve të Kongresit të Berlinit dhe deri në vitet 1912-1913, me aneksimin e

trojeve shqiptare struktura etnike e popullsisëfilloi të ndryshojë. Kjo është periudha e spastrimit etnik dhe zhvendosjes së popullsisë me dhunë. Rast i veçantë i këtij procesiqë trajtohet hollësisht në këtë libër është qyteti i Ulqinit, që u sakrifikua për hir të interesave të Fuqive të Mëdha, duke ia dorëzuar Malit të Zi. Duke iu referuar të dhënave që jep autori në këtë libër, në vitin 1861, në Tivar dhe në Ulqin, pjesa më e madhe e popullsisë ishte e religjionit mysliman, ndërsa pas Kongresit të Berlinit, në periudhën 1878-1913, struktura etnike e popullsisë filloi të ndryshojë.

Ndryshimet gjeopolitike diktuan emigracionine një pjese të popullsisë në Shkodër dhe vise të tjera shqiptare dhe kolonizimin e këtyre trevave me popullsi sllave.

Bazuar nga treguesit e të dhënave të publikuara nga regjistrimi i popullsisë së vitit 2003, në këtë libër autori evidenton disa dukuri interesante demografike.

- *Së pari*, për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore lëvizja natyrore e popullsisë për periudhën 1991-2003 ka saldo pozitive falë shtimit natyror me rreth 50. 000 banorë.

- *Së dyti*, Mali i Zi në aspektin kombëtar është një shtet heterogjen i përbërë nga një mozaik popujsh, ku në aspektin sasior asnjë popull nuk paraqet shumicë e për rrjedhojë kemi të bëjmë me një mjedis tipik multinacional, multikulturor, multigjuhësor e multirelegjioz.

- *Së treti*, në Mal të Zi shqiptarët janë populli më i vogël të cilët nuk janë me prejardhje sllave. Pjesëmarrja reale e shqiptarëve në numrin e popullsisë në Mal të Zi ka qenë dhe është më e lartë se ajo e paraqitur në statistikat zyrtare.

- *Së katërti*, mbi bazën e të dhënave të regjistrimit të vitit 2003, duke analizuar lëvizjen migruese të popullsisë vërehet procesi demografik i shpopullimit të hapësirave malore dhe detarizmit të popullsisë. Për rrjedhojë në regjionin bregdetarë dëndësia e popullsisë është 2-3 herë më e lartëse sa mesatarja e vendit.

Ky proces është më i theksuar në vendbanimet dhe viset shqiptare në Mal të Zi, që janë në pozita të pafavorshme periferike, të mungesës së tokës si faktor i rëndësishëm i lokacionit ekonomik, migrimit të popullsisë aktive, dominimit të popullsisë së moshës së tretë, mungesës së infrastrukturës dhe investimeve kapitale.

Nga parashtrimi që i bën autori në këtë libër, lëvizjes migruese të popullsisë arrihet në konkluzionin se në trevat shqiptare në Mal të Zi

janë zhvilluar tre procese demografike:

1. Në zonat malore është zhvilluar procesi i dezertifikimit të popullsisë, shkretinimit apo shpopullimit të plotë të shumë vendbanimeve. Kështu popullsia e 14 vendbanimeve të Shestanit ka rënë nga 1834 banorë në vitin 1948, në 408 banorë në vitin 2003. Fshatra të tilla si Gurrëza, Lukiqi, Marstjepaj etj., janë dezertifikuar dhe sot nuk kanë asnjë banor. Dukuri të shpopullimit dhe shkretnimit demografik në periudhën 1991-2003 vërehen edhe në vendbanimet e Plavës, Gucisë, Hotit, Grudës, Rozhajës etj. Mjedisi natyror me resurse të kufizuara, mungesa e investimeve nga strukturat shtetërore janë disa nga faktorët që analizohen gjerësisht në këtë libër.

2. Në vendbanimet që shtrihen nëzonat fushore, kodrinore e zonat periurbane ka ndodhur procesi i kompensimit demografik, ku është vërejtur dukuria e vendosjes së popullsisë së ardhur nga zonat malorepor edhe lëvizjessë popullsisë nga këto zona në Ulqin apo edhe jashtë vendit.

3. Në komunën e Ulqinit, ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë ka ndodhur procesi i përqëndrimit demografik.

Duke u mbështetur në trendet e lëvizjes migruese të popullsisë, autori arrin në deduksionin se procesi i shpopullimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen nga zonat malore në drejtim të qendrave urbane.

Në dekadat e fundit, njerëzimi është ballafaquar me probleme ekonomike, sociale e sidomos ambientale, që përfshijnë energjinë, ndotjen e mjedisit, strehimin, transportin etj. Të jashtëzakonshme janë problemet ekologjike, si rezultat i ndërhyrjes së njeriut në mjedis, duke krijuar shqetësime për komunitetinnë nivel makro dhe mikro rajonal. Zhvillimet ekonomike dhe shoqërore, lëvizjetmigruese etj., kanë ristrukturuar dhe ridimensionuar hapësirën gjeografike.

Në librin “*Etnia dhe hapësira*” problemet ambientale zënë një vend të posaçëm. Gjeografia është një fushë akademike që mund dhe duhet të japë kontributin e saj në zgjidhjen e shumë problemeve ambientale që lidhen me burimet natyrore, administrimin, përdorimin e tokës dhe planet e zhvillimit lokal dhe rajonal. Studiuesi NailDraga, në këtë drejtim, jo vetëm prezanton realitetin mjedisor dhe analizon faktorët e ndotjes së mjedisit, veçanërisht në sistemin ujor Moraça-Liqeni i Shkodrës-Lumi Buna dhe lagunat bregdetare, por jep edhe impaktet në biodiversitet, duke sugjeruar masat përkatëse që “bomba ekologjike” të mos dëmtojë mjedisin.

Librimbylletmeparashtrimineprogramevetëzhvillimitinfrastrukturor dhe ekonomik nëpërmjet shfrytëzimit racional të resurseve natyrore dhe humane, të financimeve ndërkombëtare, si rruga për ndërprerjen e emigracionit, rritjen e produktit shoqëror dhe zhvillimin e qëndrueshëm të trevave shqiptare në Mal të Zi.

Libri “*Etnia dhe hapësira*” ka vlera të veçanta teoriko-shkencore pasi në shkrimin e tij janë përdorur dhe zbatuar parime dhe metoda bashkëkohore në trajtimin diakronik dhe sinkronik të objekteve, dukurive, fenomeneve dhe strukturave gjeografike. Ky botim ka edhe vlera shkencore aplikative dhe praktike pasi shqyrtimi dhe analiza e problemevekomplekse gjeografike, demografike, ekonomike dhe mjedisore përfundojnë me një seri sugjerimesh dhe rekomandimesh që i ofrohen pushtetit vendor dhe qendror, faktorit politik shqiptar etj., që të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm në këtë hapësirë shqiptare ndërkufitare.

Libri me përfundimet që ofron shërben si bazë solide për planifikimin hapësinor rajonal dhe subrajonal në rrugën e krijimit të eurorajonit të Adriatikut, si një fazë tranzicioni të integritit të Shqipërisë dhe Malit të Zi në Bashkimin Europian.

I uroj autorit dr. Nail Dragës vijimësi në realizimin me sukses edhe të botimeve të tjera me nivel të lartë shkencor dhe aplikativ në shërbim të proceseve integruesembarëshqiptare në Ballkanin Perëndimor.

**Zef ÇOBA**

**“OPERA” DHE “KENDEMI” NË LIBRAT E STUDIUESIT  
FERIT BALA**

Pedagogu i kantos Ferit Bala, ka vendosur të sfidojë çdo pengesë dhe vështirësi, duke u treguar i palodhur në punën serioze për të përmbushur plotësisht misionin e tij. Megjithëse prej vitesh gëzon moshën e pensionit, ai punon në qetësinë e punës studimore, duke i sjellë kryesisht artistëve të rinj dhe opinionit publik, një lëndë me vlera të veçanta. Përvoja e tij si këngëtar dhe në mënyrë të veçantë përvoja e gjatë pedagogjike në fushën e kantos, kanë sjellë në dinamikën e laboratorit të tij një eksperiencë që kërkon ta vendosë në altarin e dijes, për t’i sherbyer në tërësi mendimit studimor të fushës që ka lëvruar, e në mënyrë të veçantë studiuesit shqiptar të kudondodhur e opinionit publik në tërësi.

Duke e zhvilluar aktivitetin kryesor në qytetin e Shkodrës, njëkohësisht edhe qyteti i lindjes, ai ka vendosur në tryezën e punës pedagogjike e studimore dy institucione të rëndësishme, të cilat me kalimin e viteve vetëm janë konsoliduar, për të përforcuar bindjen se në këto dy kolona qëndron edhe suksesi i shkollës sonë vokale kombëtare:

1. Përvoja botërore në studimin e vokalit dhe përsosjen e teknikës vokale si dhe krijimtaria muzikore botërore e shkruar për këtë instrument.

2. Përvoja kombëtare e pasur me larmi e stile tradicionale të interpretimit vokal të krijimtarisë popullore dhe arti i kultivuar.

Arti i këndimit siç dihet është mjeti më i pasur për të transmetuar në mënyrë shumë organike gjuhën e shpirtit. Si i tillë, ka të bëjë me ndjeshmërinë, psiqiken, natyrën, historinë, vlerat e jetës të një populli që jeton në një trevë të caktuar, në një krahinë, të një kombi apo në tërësi të shoqërisë njerëzore. Në këtë vështrim edhe Shkolla jonë

e Kantos, ka përgatitur artistë të aftë për të interpretuar me vetëdije e profesionalizëm muzikën vokale të kultivuar dhe i ka shërbyer në tërësi edhe evidentimit e konsolidimit të artit të këndimit tradicional të të gjitha trevave shqiptare. Këtë dukuri profesori Ferit Bala e ka mbajtur parasysh dhe e ka realizuar në vitet që drejtonte degën e kantos në Shkollën “Prenk Jakova”, si dhe e ka afirmuar edhe me mendimin profesional të shfaqur në punën studimore.

Sipas dëshmisë së tij, që në vitin 2000 kur ishte në emigracion, fillon e plotëson fletët e librave që na paraqiten të përfunduar, me diapazon shumë të gjerë për operan. Sukses i operas si krijimtari e gjini muzikore në punimin e Ferit Balës, nuk është parë i shkëputur nga eksperiencia njerëzore e përdorimit të tingullit vokal si mjet artistik komunikimi, deri tek nivelet më të larta studimore e shkencore shumëshekullore, për njohjen e zotërimin e këtij instrumenti të pasur muzikor, çështje, të cilat i ka trajtuar pjesërisht edhe në librat që ka botuar ndërmjet këtyre viteve. Po ashtu është vepruar edhe për evidentimin e të gjitha gjinive muzikore të aplikuara në shekuj e në vende të ndryshme për instrumentin e vokalit e terminologjitë specifike të përdorura.

Katalogu i këngëtarëve lirikë shqiptarë, paraqitet shumë i gjërë dhe i realizuar me portrete e profile të plota, të përshkruara me kujdes me të dhënat kryesore për secilin prej tyre. Ai zë fill me nismëtarët, ato që ngritën bazat e shkollës së këndimit në Shqipëri e përfshin deri këngëtarët e afirmuar vitet e fundit, me sukseset e tyre në Teatrin e Operas në Shqipëri, Kosovë dhe në skenat prestigjioze të botës. Ky katalog jep një paraqitje të admirueshme dhe të mbush me kënaqësi të veçantë. Nga njëra anë është tabloja me hapësirën e artit dhe kulturës botërore në Shqipëri, nga ana tjetër artistët shqiptarë përkrah emrave më të shquar lirikë botërorë, protagonistë në veprat më të famshme të literaturës operistike. Sukses i këngëtarëve shqiptarë në skenat e botës, shembull i shkëlqyer, model edhe për aspiratat tona kombëtare, është përshkruar me dokumentacion të pasur, realizëm e ilustrime fotografish, të cilat autori i ka siguruar me durim e këmbëngulje.

Për t’i shërbyer mirë çështjeve studimore mbi vokalin, kur ndalon tek «*Pedagogjia vokale në shekuj*», me vend autori nënvizon nocione filozofike mbi domethënien e tingullit vokal, këndimin e këngën në tërësi. Citon mendimtarë, filozofë, psikologë, studiues, muzikologë etj., me definicione të rëndësishme e bindëse, për të arritur sipas studimit të tij tek kuptimi isotëm, *sekënga është ”modulimi i zërit sipas ligjeve*

*të intonimit, të ritmit, të frazeologjisë, të ngjyrës dhe të shprehjes së ndjenjave njerëzore. ”*

Historia njerëzore e përdorimit të zërit, mundësive shprehëse të tij dhe e studimit të teknikës vokale, në përmbledhjen e Ferit Balës vjen e plotë që nga kohët e hershme, në Mesjetë, tek lindja dhe zhvillimi i operas e deri tek kohët moderne. Janë prekur e trajtuar stilet e interpretimit, format e gjinitë muzikore të lindura e të praktikuara për vokalin, si në lëvrimin e artit tradicional në vende të ndryshme të botës, ashtu edhe për artin e kultivuar. Janë shpjeguar format e gjinitë muzikore komplekse, si : Oratori, Meshja, Rekuemi, Kantata etj., që i paraprinë lindjes së teatrit muzikor, Operas. Janë trajtuar gjerësisht shkollat e ngritura në vendet e ndryshme e përfaqësuesit më të spikatur të mendimit studimor, që me vlerat e punës së tyre e sukseset rrezatuan dije e art, me të cilat u bë e mundur që të lindin vepra monumentale e të ngrihen në vende të ndryshme të botës trupa prestigjioze, të cilat kënaqin e mahnisin spektatorët me forcën e madhe shprehëse.

Në kapitujt e fundit jo rastësisht ndalon tek Shkolla Shqiptare e Kantos dhe Figura të Shquara Pedagogjike Shqiptare, sepse pedagogu i kantos e studiuesi Ferit Bala me këtë përmbledhje voluminoze i dëshmon lexuesit e studiuesit shqiptar angazhimin serioz dhe përgjegjësinë e tij, për t’i sherbyer artit e kulturës sonë e në mënyrë të veçantë shkollave të kantos



**Gëzim PUKA**

**NJË REFLEKTIM KRITIK RRETH DRAMËS « JUGORI »  
TË REGJISORIT DINO MUSTAFIÇ VËNË NË TEATRIN  
« MIGJENI » TË SHKODRËS**

Shfaqja “Jugori” e Rainer Werner Fassbinder-it, me regji të Dino Mustafiç, ka ardhur si një risi në skenën e Teatrit “Migjeni” të Shkodrës. Ndërtimi i prologut me aktorë që reflektojnë përshtypjet rreth tekstit. Vendosja e tyre në amfiteatër dhe e spektatorëve në skenën me ndenjese arka birre. Krijohet një provokim i qëllimshëm mosrehatije, që do të vijë sa nga teksti i thurur nga autori, aq edhe nga teksti i thurur nga aktorët. Sfida është tipike brehtiane, ku spektatorit do t’i kërkohet gjykimi në fund. Nyja lidhëse e spektaklit ndërtohet mbi një thelb ironik tipik postmodern. Luhet me një tekst të drejtpërdrejtësisë dhe të referencialitetit, për të zgjuar përvojat alternative të spektatorëve në raport me dialogun.

Luhet me sentimentalizmin e përvojave migratore, që janë jetuar.

Teksti kërkon të neveritë dhe shpotisë pa diferencim të huajt dhe vendasit, viktimat dhe agresorët, për të mbërritur drejt një epilogu ku të humbur janë të gjithë ata që jetojnë me stereotipe paragjykimesh.

Duke qenë se teksti luan me shenja gjuhësore stereotipe, që i përkasin regjistrin të ulët gjuhësor, thënë ndryshe poetika e tij përfshin ligjërimin e disa vetjeve vepruese të zvetënuara, atëherë edhe tekstura teatrore do të jetë në përshtatje me këtë vizion shfaqjeje, ku hapësira dhe koha përcillen brenda një mungesë totale të kufijve. Në këtë teatrin e Dino Mustafiçit ka rënë jo vetëm kufiri me spektatorët, të cilët shpesh lëvizin në mosrehatinë e tyre, me koston edhe të një shpërqendrimi të qëllimshëm apo sforcimit për ta rikthyer vëmendjen drejt gjërave të shumta dhe lëvizshmërisë së madhe, që po ngjet në skenë.



Në një provincë gjermane ka mbërritur një i huaj që përbuzet, përdoret, shfrytëzohet, rrahet, dëbohet nga një komunitet provincial, që vendoset në stade të ndryshme ideologjike, nacionaliste, religjioze. Duke qenë pre e vesit dhe varësisë nga e keqja, vetjet vepruese brenda një skenë të mbushur me arka, shishe dhe tapa pa fund birrash, gjejnë si të vetmen mundësi shfryerje të krizës së tyre ekzistenciale një emigrant që e bëlbëzon gjuhën e tyre, por që ka naivitetin dhe çiltërsinë e dobisë së jetës.

Në këtë rrafsh shfaqet një konflikt më shumë i një natyre filozofike, sesa i një natyre politike dhe sociale, që një lexim i shpejtë dhe i pavëmendshëm mund t'ia lejojë këtij lloj teatri. Kundërvëniet kulturore dhe ideologjike kanë në qendër të tyre qëndrimin ndaj dobisë dhe bukurisë së jetës së thjeshtë, ndaj më ngjan se në këtë pikëvështrim regjisor i që solli këtë shfaqje ka një lloj postromantizmi brenda një postmodernizmi ironik, për lidhjen e humbur me natyrën e thjeshtë të gjërave dhe të sjelljeve njerëzore. Shfaqja nuk e adreson vëmendjen tek shkaktarët, ajo përcjell mesazhin se në këtë botën tonë moderne ka humbur humanizmi.

Të gjitha shenjat e tekstit, të skenës, të plastikës e paraqesin këtë humbje të madhe të njeriut. Dy dashnorë që kacavirren në një zgarë murale burgu, për të kërkuar një puthje të botëve të ndryshme, dy dashnorë që sublimohen në ballkonin e lartë në murin fundor të skenës.

## ▪Bibliofili▪

Zenepe DIBRA

### KONTRIBUTI I DISA AUTORËVE SHKODRANË NË PËRKTHIMET NË GJUHËN SHQIPE

Shkodra një qytet i zhvilluar ekonomikisht dhe kulturalisht që në fillimin e shek. XX e ndjen nevojën e lidhjes më me intensitet me botën e jashtme, me vlerat e kulturës, të jetës, historisë dhe zhvillimeve të saja. Nga ana tjetër duke kuptuar që kjo lidhje me kulturat dhe qytetërimin në mes të shumë lidhjeve të tjera, bëhet edhe nepërmjet përkthimeve, bota intelektuale shkodrane e kuptoi që kjo fushëdo të hapte perspektiva të reja për zhvillimin e mirëfilltë kulturor pa të cilin shoqëria njerëzore nuk do të bënte dot përpara. Jo vetëm në fushën e kulturës të përkthimeve të dramave, romaneve, poezive, historive, një fushë e veçantë ishte edhe ajo e përkthimeve fetare ku nevoja shpirtërore e tre komuniteteve që bashkëjetonin në Shkodër, kondicionte punën e përkthyesve edhe në këtë lëmë. Në fushën e përkthimeve shkodranët do të kontribojnë duke i dhënë publikut shqiptar vepra të disa prej shkrimtarëve më të mëdhenj të kohërave, në shqipërime, nga më cilësoret. Kjo do të fillonte që në fund të shek. XIX, dhe pikërisht në v. 1872, kur kleriku Ejëll Radoja merr përsipër përkthimin nga latinishtja, në dialektin gegë të shkodranishtes, të “*Kuvendit të Arbërit*” të zhvilluar më 1703.

Zhvillimi i kulturës në qytetin e Shkodrës, që merr vrull nga aktivitetet artistike të grupeve amatore do ta bënte të mprehtë përkthimin e disa veprave të shkrimtarëve të shquar botërorë, të dramave dhe komedive. Që kur jepet shfaqja e parë teatrale në Shkodër në v. 1879 dhe më vonë mbas krijimit të shoqatave kulturore-artistike, lindi nevoja e materialeve skenike, për drama, komedi dhe pjesë të ndryshme teatrale apo muzikore, që kishin nevojë për skenarë cilësorë që jo vetëm mungonin nga autorë vendas, por edhe ato që ishin nuk mjaftonin përkundrejt dëshirës dhe

vrullit amator të grupeve artistike të shpërndarë në disa shoqëri teatrore. Për këtë nevojë, u angazhuan shumë intelektualë shkodranë, mësues, regjisorë, dramaturgë, shkrimtarë, studiues. Veprat që ato përkthyen dhe u vunë në skenë të adaptuara, ishin nga letërsia e huaj klasike dhe moderne e autorëve: Eskili, Sofokliu, Euripidi, Shekspiri, Gëte, Shileri, Molieri, Alfieri, Kornej, Kalidasa, Pushkimi, Çehovi, Metastasi, Silvio Pellico, Gianini, A. Ferrari, Ibsen, etj. Autorët e përkthimeve, ishin personalitete, si Imzot Pashko Babi, Anton Xanoni, Hilë Mosi, At Gjergj Fishta, Imzot Vincens Prennushi, Kolë Mirdita, Kolë Plani, Ndre Plani, Cuk Simoni, Ndoc Vasia, Kolë Thaçi, Lin Luka, Tom Gjyshja, Karl Gurakuqi, Injac Zamputi, Henrik Lacaj, etj., të cilët kanë përkthyer me dhjetra drama, komedi, pjesë humoristike, etj. Ato zgjidhnin shkrime të këtyre autorëve që i përshtateshin situatës dhe ambientit shkodran për zgjim kombëtar, për dënimin e veseve dhe zakoneve të këqija dhe konservatore të shoqërisë shqiptare, si dhe kontekste të tjera shumë moralizuese për drejtuesit politikë lokalë, familjen, bashkëshortët, fëmijet, gratë, etj. Disa nga këto përkthime ishin: “*I ligu për mend*”, komedi e Molierit, përshtatur nga At Gjergj Fishta, “*Bardhi e Ferdinandit*”, dramë e Silvio Pelikos, përkthyer nga Shuk Gurakuqi, “*Llogoret e mullinjve*”, dramë e Lemoene”, përkthyer nga A. Xanoni, “*Juli*”, dramë, përkthyer nga Kolë Mirdita, “*Konte Kavalo*”, dramë, përkthyer nga Cuk Simoni, “*Shnjor Puci*”, melodramë, nga Zef Gianini, përkthyer nga Lazër Shantoja, “*Shkolla e magjarve*”, komedi, përkthyer nga Kolë Plani, “*Konti i Retimos*”, dramë mesjetare fiorentine, përkthyer nga Henrik Lacaj, “*Eustaku*”, dramë e P. Metastasi, përkthyer në vargje nga Kolë Thaçi, “*Ati i atdheut, Kozimo dei Medici*”, dramë e përkthyer nga Tom Gjyshja, etj.

Në rrjedhë të viteve, shumë shkrimtarë e përkthyes të mirëfilltë shkodranë, shumë prej të cilëve kishin kryer edhe shkollat e larta për gjuhë të huaj, duke rritur cilësinë dhe interpretimet lanë gjurmë në shkollën shqipe të përkthimeve.

\*Ardian Marashi, ka përkthyer nga frëngjishtja romanet: “*Dhuna e një vere*” (Adrien Salmieri), Tiranë 1989; “*Murtaja*” (Albert Camus), Tiranë 1994; vëllimin “*Muri*” (Jean-Paul Sartre), Tiranë 1995, etj., e gjithashtu autorë shqiptarë në frëngjisht, në antologjinë poetike *La Nouvellepoésie en Albanie* (Poezia e re në Shqipëri), etj.

\*Arshi Pipa la një trashëgimi të pasur në fushën e përkthimeve poetike nga latinishtja, italishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, anglishtja,

duke mbetur në dorëshkrim vëllimi poetik “*Lyrika latine*” (rreth 250 faqesh) dhe vëllimi poetik “*Autobiografia*” në tri gjuhë evropiane.

\*Cuk Simoni, si përkthyes është i pari që solli në shqip, në dialektin modern gegë, “*Pinokun*” të shkrimtarit italian K. Kolodi. Gjithashtu ai përktheu “*Njeriu i padukshëm*” të Zhyl Vernit. Më 1929 botoi nëgjuhën esperanto, një histori të Skënderbeut me titull “*Skanderbeg heroo de Albanuio*”

\*Dedë Gajtani (Kola), i cili ka zotëruar latinishten, italishten, frengjishten, spanjishten, gjermanishten, anglishten dhe greqishten e vjetër, ka përkthyer poezitë e poetëve të mëdhej klasikë, si Manzoni, Hygo, Alighieri, Goethe, Schiller, Corducci, Leopardi, Ada Negri, Chateaubriand, Logfelloë, përrallat e Ezopit dhe Fedrit etj. të sjellur në librin monografik “*Ded Gajtani (Kola)-Përkthime, poezi dhe Poema*”, Tiranë, 2014

\*Ernest Koliqi, u dallua si përkthyes nga italishtja në shqip dhe nga shqipja në italisht, me veprën “*Poetët e mëdhenj të Italisë*” (1932-1935), në dy vëllime. Nga shqipja në italisht përkthen disa poezi të At Gjergj Fishtës, si dhe poemën “*Dasma*” të A. Asllanit, etj.

\*Ferid Hafizika përkthyer veprat “*Lufta për Shkodrën*”, 2005, e autores E. Durham, “*Rrethimi i Shkodrës*”, 2006 e autores Hortense von Zambauer, “*Muhamedi a. s. i Dërguari i Fundit*”, 2006, i autorit M. A. Kan, “*Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve*”, 2009 të autores E. Durham, “*Islami Politik*”, 2010 të autorit G. E. Fuller.

\*Ferdinand Leka ka përkthyer vepra autorësh të njohur, si: “*Të fejuarit*” (A. Manxoni), “*Lirika të zgjedhura*”, (F. Petrarka), “*Triumfi dhe tragjizmi i Erazmit të Roterdamit*”, (S. Cvajg) si dhelibra nga fusha e filozofisë, etj.

\*Frano Alkaj, i diplomuar në letërsinë klasike në Universitetin e Bukureshtit, si zotërues i gjuhëve antike greqisht dhe latinisht i ka filluar përkthimet që herët, kur në v. 1938 shtypshkronja françeskane në Shkodër nxori në botim “*Këngën XXIII të Iliadës (Vrasja e Hektorit)*” të përkthyer prej tij.

\*Gazmend Krasniqi ka sjellë në shqip “*Poezi anglo-saksone e shek. XX*” (antologji poetike, bashkautor), Tiranë 2004, “*Unë dhe zonjushë Mandible*” (tregime nga Donald Barthelme), 2004, romanin e Henry James “*Deizi Miler*”, 2007, përkthime letrare në revista letraro-artistike si dhe në suplementet letrare të shumë të përditshmeve shqiptare.

\*Gjon Shllaku një nga vazhduesit e përkthyesve të shquar, më 1965

botoi poemën “*Iliada*” të Homerit, më 1995 botoi veprën e plotë me shtatë tragjeditë e Sofokliut, poemën *Gjeorgjikat të Virgjilit* në vitin 2000, eposin frëng “*Kënga e Rolandit*” më 2003, etj.

\*Henrik Lacaj përktheu nga latinishtjaveprat e humanistëve shqiptarë, si M. Barleti (Rrethimi i Shkodrës), vepra ngaletërsia antike dhe ajo klasike, si veprën e Virgjilit “*Eneida*”, “*Edipimbret*”, të Sofokliut”, poezi të zgjedhura nga antikiteti grek (Lirika antike greke), poemën “*Metamorfozat e Ovidit*”, poemën “*Mbi natyrën të Lukrecit*”, etj.

\*Hilë Mosisi përkthyes dhe përshtatës i disa veprave të autorëve të huaj, njihet përveprën “*Cubat*” (1928) vepër e Frederik Schiller-it, dramëtrí aktesh “*Filja*”, komeditë e Goldonit: “*Shërbëtori i dy zotnive*” e “*Dy Shërbëtorët*”.

\*Injac Zamputi ka përkthyer dhe transkriptuar nga latinishtja dhe italishtja mesjetare dokumente historike të botuara nga Instituti i Historisë në serinë “*Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*”.

\*Jonus Tafilaj, ishte përkthyesi i romanit turk “*Jaban*” (“I huaj”), si dhe i romanit bullgar “*Mësuesi idealist*”. Ka kontribuar si bashkautor në një botim akademik për studimin dhe përkthimin nga osmanishtja të afro 600 fermaneve që kanë lidhje me Shqipërinë nga v. 1484-1900, botuar në një katalog nga Drejtoria e Arkivit të Shtetit. Duke qenë edhe bashkëkohës i Ismail Qemalit, së bashku edhe me disa aktivistë të tjerë dha një kontribut të jashtëzakonshëm, në përkthimin në shqip të shumë dokumentave të qeverisë së përkohshme të Vlorës, që u botuan me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë.

\* At (Luigj) Jak Marlekaj, në v. 1937, përktheu dhe botoi shqip veprën me titull “*Zëmra n’udhtim*” të shkrimtarit, Milly Dandolo, përktheunë italisht melodramën e njohur të Fishtës “*Jerina, regina dei fiori*” (Jerina, mbretëresha e luleve), Bari 1973, përktheu në gjuhën italiane *Visarët e Kombit*

\*Karl Gurakuqi ka shqipëruar nga italishtja, gjermanishtja, serbokroatishtja dhe latinishtja disa vepra letrare, shkencore dhe historike.

\*Mark Harapi është përkthyesi i parë i romanit “*Të fejuarit*” (I Promesi Sposi) të A. Manxonit në vitin 1942.

\*Nikoll Dakaj është i pari përkthyes që ka arritur të sjellë modelet e heksametrit në shqip, në të dyja të folmet shqipe, toske dhe gege, përfshirë edhe standardin letrar, që nga Homeri e poetët grekë e latinë dhe deri në kohën e dezintegritimit të heksametrit.

\*Guljelm Deda, ish i burgosur politik, ka lënë një vepër madhore, siç është përkthimi i kryeveprës së letërsisë italiane dhe botërore, “*Orlandi i Çmendun*” të Lodoviko Ariostos.

\*Mark Dema (shih) bëri përkthimin nga latinishtja të poemës “*Eneida*” të Virgjilit, përkthim i shumë i arrirë nga ana letrare, gjuhësore dhe poetike.

\*Mark Ndoja ka përkthyer “*Ferri*” nga Komedia Hyjnoree Dante Aligerit, botuar më 1997

\*Pashko Gjeçi përveç shumë përkthimeve ngaletërsia botërore, si: Homer (Odiseja), Shekspir (Hamleti), Gëte (Fausti, pjesa e parë), Rasin (Andromaka), me përkthimin e “*Komedisë hyjnore*” nga Dante, realizoi një ndër arritjet më të shquara të gjithë kulturës së përkthimit në gjuhën shqipe.

\*Primo Shllaku ka përkthyer “*Lulet e së keqes*” të Charls Boudelaire (Botimet Albas).

\*Përkthimeve në shqip nga letërsia orientale, fetare apo laike, si dhe nga veprat origjinale në fushën e islamologjisë, në veçanti e të orientalistikës, përveç autorëve më me kontribute, disa të tjerë, kanë kontribute më me pak prodhimitari, si :

a. Sheh Ahmet Shkodra ka përkthyer “*Mevludin*”, në shqip me germa arabe dhe më vonë me germa shqip, si dhe “*Ilahitë*”;

b. H. Abaz Golemi ka përkthyer “*Poezi të Sadiut*”;

c. H. Esat Myftia ka përkthyer Hadithe dhe proverba arabe; përktheu kapitullin e “*Jasinës*” të Kuranit.

\* Hafiz Riza Ulqinaku ka përkthyer në gjuhën shqipe (1873), librin “*Mevludi Sherif*” të poetit të famshëm turk Sulejman Çelebiut nga Bursa. Kjo ishte vepra më e vështirë për t’u përkthyer, edhe në ditët e sotme është më i përsosuri dhe më i popullarizuari dhe më i përhapuri në gjuhën shqipe. Gjithashtu ka përkthyer një libër në vargje “*Huda Rabimm*” të dijetarit dhe filozofit turk Haki Erzurum.

\*Dom Simon Filipaj, nga Ulqini, bëri botimin e plotë të Biblës në shqipen standarte sipas tekstit “*Nova Vulgata*”, i pari botim tërësori Shkrimit të Shënjtë në gjuhën shqipe. (Ferizaj, 1994).

\*Sadetin Limani ka kontribut në përkthimin e 18 librave të botuaranga gjuhët gjermanisht, anglisht, frëngjisht dhe italisht, ndër të cilët “*Rainer Maria Rilke*”, përmbledhje me poezi, “*Shoqëria e hapur dhe armiqtë e saj*” me autor Karl Poper, vëllimi i I-rë (Platoni); “*Zonja Ataturk*”, gjinia: histori e autorit Ipek Çalishla, “*Inspektori i inspektorëve*” -



roman, me autor Orhan Kemal, “*Bisedat e Konfucit*” të Konfucit, etj.

\*Safet Sofia Juka(1921-2005), është përkthyesë nga gjermanishtja në anglisht e librit “*Albanian’s Golgotha*” i deputetit, gazetarit dhe shkrimtarit austriak Leo Freundlich, që do t’ishërbentepër të publikuar dhe ndërkombëtarizuar çështjen shqiptare të kosovarëve

\*Shpëtim Kelmendika shqipëruar nga gjuha italiane poetët Montale-n, Ungaretti-n, Quasimodo-n e Loi-n. Me disa nga këto përkthime ka kontribuar në antologjinë e poezisë italiane, hartuar nga D. Omari.

\*Haxhi Hafiz Vehbi Sulejman Gavoçika botuar 6 vepra të përkthyer nga arabishtja dhe të përshtatura në shqip dhe 21 vepra vepra origjinale në gjuhën arabe, ku veçohet “*Min kadajal- mer’etil- muslimë*” vepër që ka për qëllim të sqarojë shumë parime të pastra islame në lidhje me gruan dhe vendin e saj në shoqëri. Ka800 shkrime dhe replika me vlera shkencore e kulturore.

Pjesa dërmuese e të cilave të shkruara e të botuara në gjuhën arabe, e kanë afirmuar edhe më tepër emrin e Vehbi S. Gavoçit në skenën e botimeve islame botërore.

\*Imam Vehbi Ismailiqë nga viti 1960 dhe deri sa ndërroi jetë, ka shkruar, ka përkthyer, ka botuar dheribotuar, mbi 50 libra, fetare- letrarë, të cilat janë përkthyer në rreth 25 gjuhë të ndryshme. Ka qenëpërkthyes i shumë veprave letrare nga gjuha arabe në atë shqipe, si dheartikuj të ndryshëm, të gjitha këto të paraqitura 46 vepra në 8 volumet e veprave të tij të botuara nga Shtëpia ‘Logos-A’ (me qender në Shkup).

\*Vinçenc Prennushi si përkthyes dha një kontribut të madh duke shqipëruarnjë varg veprash të shquara: “*Fabiola*”, nga N. P. Eïseman (1925), “*Quo Vadis*” nga H. Sienkeviç (1933), “*Burgjete mija*” nga S. Peliko (1939) ndërsa në periodikë solli në shqip pjesë nga Shatobrian, Fenelon, Manzoni, Dante, ëeber.

\*Zef Simoni që punoi si përkthyes në Agjencinë Telegrafike Shqiptare (ATSH) dhe si kryeredaktor e përkthyes në Ndërmarrjen e Botimeve Tiranë, është konsideruar si një nga përkthyesit më të mirë në Shqipërinëe kohëve moderne. Ka ribotuar dhe shqipëruar në gjuhën letrare “*Pinokun*”, që kishte përkthyer babai i tij Cuk Simoni; më 2016 ka përkthyer romanin “*Lord Xhim*” të autorit Joseph Conrad.


\*Zija Vukaj, shkrimtar, që ka përkthyer rreth 15 vepra dhe pjesë nga krijimtaria e më shumë se njëzet autorëve të rëndësishëm të letërsisë botërore. Ndër to mund të përmendim dy romane të autorit nobelist



italian Luixhi Pirandelo, “*Marta Ajala*” dhe “*Një, asnjëdhe njëqind mijë*”; nga autori i famshëm Gabriele D’Annunzio romani “*Kënaqësia*”, romanin e shkrimtarit brazilian, Paulo Coelho’s “*ALEPH*”, nga Alberto Moravia, 61 tregime të përmbledhura në librin voluminoz “*Tregime romane*”, nga autori francez Emil Zola, romanin e famshëm “*Naná*”, poezi të poetëve italianë Ungareti, Kuazimodo, Saba etj.

**Bibliografia:**

1. *Akademia e Shkencave e Shqipërisë “Fjalor enciklopedik shqiptar”, vëll. III, Tiranë, 2009*
2. *Andrea Skanjetit “100 vjet teatër në Shkodër 1879-1979” (kujtime), Tiranë 2002;*
3. *Zenepe Dibra: “Fjalor Enciklopedik i hapësirës shkodrane”, vëll. I, Lezhë 2015;*
4. *Zenepe Dibra: “Fjalor Enciklopedik i hapësirës shkodrane”, vëll. II, Lezhë, 2016;*
5. *Nexhmi Bushati “Kontribute të dijetarëve shkodranë në fushen e orientalistikës”, Seminari VI Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Nëntor, 2005*

**▪In memoriam▪****HASAN LEKAJ, PEDAGOG, BIBLIOFIL DHE BOTUES I SHQUAR I LETËRSISË SHQIPTARE**

Hasan Lekaj (1940-2018)

Më 26. 06. 2018 u nda nga jeta pedagogu, bibliofili dhe botuesi i shquar i letërsisë shqiptare, Hasan Lekaj. Lindi në Shkodër më 01. 06. 1940. Shkollën mesme e mbaroi gjimnazin “28 Nëntori” në Shkodër. Në vitin 1965 diplomohet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, në degën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë. Në vitet 1959-1960 punon në Institutin Pedagogjik dy vjeçar me detyrën sekretar i korrespondencës dhe bibliotekar. Gjatë periudhës 1966-1975 ishte mësues i letërsisë në Gjimnazin “29 Nëntori” në Shkodër dhe në vazhdim pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, deri në vitin 2010, ku ligjëron si titullar lëndët: *Letërsia Bashkëkohore Shqipe* dhe *Letërsinë Bashkëkohore Ballkanike*; ndërsa me ndërprerje ka ligjëruar *Letërsinë e huaj shek. XVIII-XIX*; *Letërsinë për fëmijë*; *Metodikën e leximit dhe të Letërsisë*. Në vitet 1992-1996 dhe 1998-2002 ishte përgjegjës i sektorit të Letërsisë Shqipe në Katedrën e Letërsisë. Në

vitet 2003-2008 ishte Drejtor i Departamentit të Letërsisë. Bashkautor i tekstit *“Letërsia e huaj e shekullit të XX”*. Ishte pjesëmarrës aktiv në veprimtaritë shkencore dhe pedagogjike në shkallë kombëtare dhe ndërkombtare. Ka botuar në revistat periodike shkencore mbi 150 studime dhe artikuj kritikë, njëkohësisht ka udhëhequr 76 tema diplome. Si botues ka redaktuar rreth 200 studime, monografi dhe përmbledhje kritike të veprave letrare. Në korrik-gusht të vitit 1996 kryen një kurs kualifikimi në Universitetin e Kozencës, Itali. Në vitet 1966-1973 drejton Almanakun letrar *“Shtigje të çeluna”* dhe ishte anëtar i redaksisë së Almanakut *“Shkodra”*. Nga viti 1967 deri në vitin 2007 ishte anëtar i Këshillit artistik në Teatrin *“Migjeni”*. Në vitet 1992-2000 zgjidhet nënkryetar i *“Shoqatës Kombëtare për Mirëkuptim dhe Paqe”* të cilën e përfaqëson në Athinë, Moskë, Tivat etj. Nga viti 1996-2008 ishte anëtar i *“Mensa International”* me qendër në Londër. Nga viti 1994 deri në vitin 2018 ishte kryetar i Shoqatës Kulturore *“Camaj-Pipa”* dhe drejtues i entit të saj botues. Është dekoruar me Urdhrin *“Naim Frashëri”* të Klasit të Tretë dhe me *“Mirënjohjen e Universitetit Luigj Gurakuqi”* më 26. 10. 2012.

Ishte i përkushtuar ndaj letërsisë shqiptare. Vlen të veçohet kontributi i tij si botues në botimin e veprës letrare të shkrimtarit Martin Camaj, deri në vitet 1993 i panjohur në Shqipëri. Është ndër të parët botues privatë që me iniciativën e tij i hyri botimit dhe afirmimit të veprës së Camajt në Shqipëri, duke e shoqëruar botimin me fjalor shpjegues për fjalët arkaike. Ky botim mbetet botimi më besnik i veprës së Camajt brenda Shqipërisë. Gjithashtu ndër autorët e traditës botoi edhe veprat e Ernest Koliqit, disa prej të cilave, si: *“Shija e bukës së mbrueme”* dhe *“Rrajët levizin”*, për herë të parë në Shqipëri. Ribotoi romanin *“Oh”* të Anton Pashkut, *“Sytë e Evës”* të Azem Shkrelit etj. Prof. Hasani ishte ithtar i fortë i gegnishtes, të cilën e lëvroi vazhdimisht edhe gjatë diktaturës komuniste, në folur e në të shkruar. Shumë prej veprave të botuara nga shtëpia botuese *“Camaj-Pipa”* dalloheshin edhe prej lëvrimin të gegnishtes nga autorët e vjetër e të rinj. Ishte ndër botuesit e parë të veprës letrare disa autorëve, si: Ridvan Dibra, Gazmend Krasniqi, Sokol Zekaj, Ledia Dushi, Dodë Kaçaj, Arben Prendi, Lisandri Kola etj.

Mori pjesë në paniret e librave të zhvilluara brenda vendit dhe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi. Gjithashtu ishte dhe kryetar i shoqatës së pakicës kombëtare malazeze *“Duklja”*. Si njohës i gjuhëve sllave

mori pjesë me ligjërime dhe si përkthyes në tubimet që zhvilloheshin në Beograd e Podgoricë. Ishte dashamirës i madh i librit. Krijoi bibliotekën e vet personale me mbi 13.000 tituj librash dhe mbi 12 botime periodike. Përmes saj ndihmoi vazhdimisht kolegët dhe studentët e tij që i mbeten mirënjohës. Ndoshta është rasti që edhe institucionet arsimore apo akademike të kujtohen për këtë pasuri të jashtëzakonshme që ka kjo bibliotekë dhe që do të ishte krenaria e çdo biblioteke universitare apo publike.

Prof. Hasan Lekaj ishte dhe mbeti adhurues dhe përçues i artit të fjalës, një nga pedagogët më të shquar të letërsisë. Ai përcolli për vite me radhë shumë breza studentësh në universitetin e Shkodrës, të cilëve përmes punës së tij të pasionuar u ngjizi dashurinë për letërsinë dhe profesionin e mësuesit. Puna e tij e përkushtuar do të kujtohet gjatë jo vetëm nga ne kolegët e tij, por edhe nga krijuesit e këtij qyteti e më gjerë, të cilët ai i mbështeti përmes promovimit dhe botimeve të krijimtarisë së tyre. Edhe gjatë viteve të fundit të jetës edhe pse ishte në pension nuk e ndërpreu aktivitetin e tij të palodhur dhe të dobishëm në shërbim të letërsisë dhe kulturës kombëtare. Gjithmonë karakterizohej nga optimizmi dhe projektet që dëshironte t'i realizonte deri në ditët e fundit. Revista "Gegnia" e konsideron vdekjen e prof. Hasan Lekajt si një humbje e madhe për letërsinë dhe kulturën kombëtare, veçanërisht për letërsinë dhe kulturën geqe.

**Prof. as. Dr. Vinçens Marku**

**Dr. Gëzim Puka**

**Prof. as. dr. Arben Prendi**



